

BIBLIOTEKA

949.65

037

ALBANIJA E SHKENCAVE E SHQIPERISË

SHABAN DEMIRAJ

**EPIRI,
PELLAZGËT, ETRUSKËT
DHE SHQIPTARËT**



INFBOTUES

944.03
D3F

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

SHABAN DEMIRAJ

EPIRI,
PELLAZGËT, ETRUSKËT
DHE SHQIPTARËT



INFOTUES

Tiranë 2008

Dy fjalë

Duke u marrë gjatë vjetëve të fundit me problemin e prejardhjes së gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptar, më ka qëlluar shpesh të ballafaqohem me teza të ndryshme jo vetëm për origjinën e kësaj gjuhe dhe të këtij populli të lashtë, por edhe për vendbanimin e tij të hershëm në Gadishullin Ballkanik. Këto çështje, që janë trajtuar gjerësisht në librin *Prejardhja e shqiptarëve në dritën e dëshmimeve të gjuhës shqipe* botuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë më 1999 dhe anglisht më 2006 me titullin *The origin of the Albanians, linguistically investigated*, kishin nevojë të plotësoheshin më tej sidomos për disa probleme gjithashtu mjaft të diskutueshme. Të tilla janë, ndër të tjera, ato që kanë të bëjnë me përkatësinë etnike të banorëve të Epirit gjatë shekujve, aq më shumë kur një temë e tillë për periudhën e lashtësisë së hershme gërshetohet edhe me problemin e banorëve paragrekë të njohur me emrin pellazgë të cilët, sipas disa studiuesve, etnikisht dhe gjuhësisht kishin lidhje edhe me etruskët e Italisë. Prandaj në këtë vepër të re, kushtuar kryesisht banorëve dhe gjuhës amtare të Epirit gjatë shekujve, u pa e nevojshme që një kapitull, dhe pikërisht Kreu I, t'i kushtohet problemit të pellazgëve dhe të etruskëve. Një kapitull i tillë u pa i nevojshëm, sepse në veprën e porsapërmendur problemit të pellazgëve i ishte kushtuar pak hapësirë, ndërsa ai i etruskëve nuk ishte prekur fare. Dhe një qëndrim i tillë në atë vepër u mbajt, jo vetëm sepse synimi kryesor i saj ishte të argumentohet që shqiptarët janë pasardhës të një populli, që qysh prej kohësh të lashta banonte në brigjet lindore të Adriatikut dhe të Jonit, por edhe sepse teza mbi prerjardhjen pellazgjike të shqiptarëve si edhe teza mbi lidhjet midis shqipes dhe etruskishtes ishin dhe mbeten gjithnjë të pandriçuara bindshëm. Dhe kjo nuk është e papritur, po të kihet parasysh se njohuritë tona për pellazgët mbeten gjithnjë të paqarta, për arsye se prej tyre nuk kemi dëshmi të shkruara në gjuhën e tyre. I vetmi mbishkrim, që mbahet për pellazgjik, ai i një guri varri në ishullin e Lemnos, i zbuluar qysh në vitin 1885, me gjithë përpjekjet e disa brezave specialistësh, nuk është ndriçuar ende plotësisht.

Për sa u takon përpjekjeve për të sqaruar gjuhën e pellazgëve me anë të

mbishkrimeve etruske dhe këto të fundit me anë të gjuhës shqipe, ato më janë dukur dhe më duken, të paktën, të paargumentuara bindshëm.

Trajtimi i pellazgëve, qoftë edhe përmbledhtas, në këtë vepër të re ishte i pashmangshëm, për arsye të tezës mjaft të përhapur ndër studiues të huaj dhe shqiptarë mbi praninë e një populli të tillë paragrek shumë të lashtë në Gadishullin Ballkanik dhe jashtë këtij gadishulli. Pellazgët, një popull shumë i lashtë paragrek, madje sipas disave edhe paraindoeuropian, në mjaft botime nga një varg studiuesish, sidomos shqiptarë, konsiderohen si stërgjyshërit e shqiptarëve. Për sa u takon përpjekjeve për të sqaruar gjuhën e pellazgëve me anë të mbishkrimeve etruske dhe këto të fundit me anë të gjuhës shqipe, siç do të shtjellohet në Kreun I të këtij libri, përpjekje të tilla, të bëra shpesh me paragjykime joshkencore, nuk e kanë kapërcyer pragun e fantazisë apo të dëshirës për të mbrojtur një tezë pa shfrytëzuar, të paktën, ç'është shkruar nga specialistë të njohur, si p.sh. nga studiuesi hollandez van Windekens për pellazgët dhe pellazgjishten, apo nga etruskologu italian Pallottino ose nga studiuesi gjerman Steinbauer etj. për etruskët dhe etruskishten. Për më tepër, në të dyja rastet janë bërë përpjekje për të argumentuar një tezë, duke bërë disa krahasime me fjalë të shqipes së sotme, pa marrë aspak parasysh se fjalët e shqipes së sotme, edhe kur janë të trashëguara, në kohën e pellazgëve apo të etruskëve kishin përbërje fonetike të ndryshme nga ato të shqipes së dokumentuar. Mjafton të përmendim këtu, sa për shembull, mendimin e shprehur nga disa studiues shqiptarë se emri i *Toscana*-s në Itali lidhet me emrin *toskë* të Shqipërisë Jugore. Prandaj ndaj përpjekjeve të tilla në këtë vepër është mbajtur qëndrim kritik.

Problemi i pellazgëve nuk mund të anashkalohej edhe për arsye se autorët e vjetër grekë dëshmojnë që pellazgët qysh para ardhjes së tribuve greke në Ballkan banonin, ndër të tjera, edhe në Epir, ku kishin themeluar edhe tempullin e lashtë të Dodonës me orakullin e tij të famshëm. Në atë tempull orakulli në krye të herës fliste në një gjuhë të ndryshme nga greqishtja dhe vetëm më pas, kur atë tempull e përvetësuan grekët, atje ajo gjuhë e lashtë u zëvendësua me greqishten. Prandaj në këtë vepër u është kushtuar edhe më shumë hapësirë temave që në një mënyrë a në një tjetër lidheshin me problemin e Epirit. Një gjë e tillë u pa e nevojshme edhe për

arsye se në literaturën e botuar për Epirin, sidomos nga autorë grekë, bien në sy përpjekje për ta paraqitur atë si një trevë burimisht greke, megjithëse përpjekje të tilla bien në kundërshtim me dëshmitë e autorëve të vjetër grekë dhe një gjë të tillë e ka vënë në dukje, ndër të tjerë, edhe studiuesi i njohur anglez Hammond në veprën e tij të vëllimshme të vitit 1967 kushtuar Epirit, f. 423.

Vëmendja, që i është kushtuar Epirit në këtë vepër, u nxit edhe nga mundësia, që pata në këtë ndërkohë, për të shfrytëzuar më shumë të dhënat e defterëve të vjetër osmanë për popullsinë e asaj zone qoftë nëpërmjet artikujve të botuar nga Ferit Duka, Vexhi Buharaja, Petrika Thëngjilli etj., ose drejtpërdrejt nëpërmjet defterit osman të Arvanidit të botuar nga Inalçiku ose nëpërmjet defterit osman për vilajetin e Janinës, që është transkribuar nga Vexhi Buharaja dhe që ndodhet në Arkivin e Institutit të Historisë në Tiranë. Nëpërmjet atyre defterëve osmanë del qartë përbërja etnike e popullsisë së viseve të ndryshme të të ashtuquajturit Epir edhe në shekujt para sundimit turk, d.m.th. në shekujt e fundit të mesjetës. E, po të mbahen parasysh edhe rrethanat historike të mëparshme, kur i ashtuquajturi Epir ishte nën sundimin e Perandorisë Bizantine dhe nën ndikimin e madh të kishës ortodokse greke, nuk është vështirë të arrihet në përfundimin se gjendja demografike e Epirit e pasqyruar në defterët e vjetër osmanë është e trashëguar nga një periudhë më e hershme. Si rrjedhim, nëpërmjet defterëve osmanë mund të hidhet dritë edhe mbi procesin e helenizimit të Epirit, sidomos në viset e tij më jugore. E, për ta ndriçuar edhe më mirë këtë proces, u pa e nevojshme të botohen edhe një kapitull për zonën e Bregdetit Jugor dhe një për Gjirin e Vlorës, si edhe një kapitull për fshatrat e luginave të Dropullit dhe të Vurgut të Delvinës. E, duke qenë se gjatë kapitujve të ndryshëm të kësaj vepre janë bërë krahasime edhe me gjuhën e mesapëve, u pa e nevojshme që në fund të botohet, si shtojcë, edhe kapitulli kushtuar gjuhës së asaj popullsie të lashtë të Italisë Juglindore

Pra, temat e botuara në këtë vepër kanë si bosht kryesor të ashtuquajturin Epir gjatë shekujve, duke nisur nga koha e pellazgëve e deri në kohët e reja. Duke qenë se për çështjet e trajtuara janë botuar shumë shkrime me qëndrime të ndryshme nga autorë të ndryshëm, është parë e nevojshme që të merren në shqyrtim ato të

autorëve më të njohur, veprat e të cilëve janë përfshirë edhe në *Bibliografinë* në fillim të këtij botimi. Gjithsesi, edhe kur autori i kësaj vepre ka mbajtur qëndrim kritik ndaj atyre shkrimeve, ai e vlerëson punën e autorëve të tyre si përpjekje për të hedhur dritë mbi disa nga problemet më të vështira dhe njëherazi më të rëndësishme të historisë së lashtë të Ballkanit. E këto përpjekje duhen vazhduar, por natyrisht duke mos u nisur nga paragjyqime të paargumentuara shkencërisht.

Autori

Pasqyra e lëndës

Dy fjalë	3
Bibliografi e përgjithshme	14
<i>Kreu i parë</i>	
<i>Pellazgët, etruskët dhe shqiptarët</i>	26
• Mendimet e disa autorëve të vjetër dhe më të rinj për pellazgët dhe për Orakullin e Dodonës (§ 1).....	26
Popujt paraindoeuropeanë në Gadishullin Ballkanik (§§ 2-4).....	27
• Pellazgët sipas autorëve të vjetër grekë (§§ 5-6).....	29
Georgievi dhe van Windkensi për pellazgët (§§ 7).....	30
• Gjuha e pellazgëve sipas van Windekensit (§ 8).....	32
Mbishkrimi i Lemnos (§ 9).....	33
• Shtrirja tokësore e pellazgëve (§§ 10-11).....	34
Popullimi i hershëm i trevave të banuara sot nga shqiptarët (§§ 12-15).....	35
Problemi i lidhjeve midis pellazgëve dhe shqiptarëve sipas Hahn-it dhe disa autorëve të tjerë të huaj (§ 16).....	38
I njëjti problem vështruar nga Nikollë Keta, Sami Frashëri, Spiro Konda, Dh. Pilika etj. (§§ 17-18).....	39
Shpjegimet e Spiro Kondës për emrin e <i>Athinës</i> dhe emrat e disa perëndive si <i>Zeusi, Demetra, Afrodita</i> etj. dhe vërejtjet përkatëse (§§ 18-22).....	40
Lidhjet e supozuara midis pellazgëve dhe etruskëve (§ 23).....	45
Origjina e etruskëve dhe e gjuhës së tyre sipas Pallottino-s dhe Steinbauer-it (§§ 24-25).....	46
Orvatjet për të shpjeguar mbishkrimet etruske me anë të shqipes nga Majani, N. Vlora etj. (§§ 26-27).....	48

Disa përfudime të përgjithshme (§ 28).....	50
<i>Kreu i dytë</i>	
<i>Gjuha amtare e të ashtuquajturit Epir gjatë shekujve</i>	52
<i>I. Hyrje</i>	
Shtirija hapësinore e Epirit dhe fiset e tij kryesore në lashtësi (§ 1).....	52
Burimi i emrit <i>Epir</i> dhe përdorimi i tij kryesisht nga grekët në një periudhë të caktuar historike. Përdorimi i tij nga Barleci, Frang Bardhi etj. Mendimi i Hammond-it për këtë çështje (§§ 2-3).....	54
<i>II. Gjuha amtare e të ashtuquajturit Epir në lashtësi</i>	
Mendimet e Hahn-it, Kretschmer-it, Çabejt, Métais-it etj., si edhe të disa autorëve grekë (§ 4).....	56
Dallimi midis gjuhës së mbishkrimeve dhe gjuhës amtare popullore (§ 5).....	58
Cilësimi i banorëve të Epirit si “barbarë” nga autorët e vjetër grekë dhe kuptimi i termit “barbar”.....	59
Argumentet për origjinën greke të epirotëve dhe vërejtjet përkatëse (§§ 6-7).....	59
Vërejtje për emrat e disa perëndive të grekëve të vjetër (§ 8).....	63
Monumentet e kulturës dhe gjuha amtare në Epirin e lashtë (§ 9).....	63
Vërejtje rreth mendimit të Weigand-it për origjinën trake të shqiptarëve (§§ 10-11).....	65
Ndikimi i kulturës greke (§ 12).....	67
Vërejtje për mendimin mbi gjuhën greke të Epirit të lashtë dhe mendimi i Hammond-it (§ 13).....	68
A ka zëvendësuar gjuha shqipe greqishten në Epir? (§ 14).....	68
<i>III. Epiri në Perandorinë Romake dhe Bizantine</i>	
Pushtimet romake në Ballkan dhe në Epir (§ 15).....	70
Zëvendësimi i latinishtes nga greqishtja në Perandorinë Bizantine (§ 16).....	71
Cila ka qenë gjuha amtare në Epir gjatë mesjetës? (§ 17).....	71
Huazimet e vjetra greke dhe latine me karakter mbarë shqiptar (§ 18).....	72
A ka qenë popullsia shqipfolëse e Epirit e ardhur?.....	74

Vërejtje për mendimin e D. Nicol-it mbi shtegtimet e arbëreshëve gjatë shekullit XIV (§§ 19-23).....	74
Ndikimi grek mbi popullsinë më jugore të Epirit (§ 24).....	78
<i>IV Epiri pas pushtimit osman</i>	78
Gjendja etnike e Epirit sipas defterëve osmanë të popullsisë (§ 25).....	78
Emrat tipikë shqiptarë <i>Lekë, Gjon, Gjini</i> etj. në Epir sipas defterëve osmanë (§§ 26-27).....	80
Emri mbarëshqiptar <i>Gjon</i> në viset e Epirit jugor (§ 28).....	82
Karakteri mbarëshqiptar i emrit <i>Gjin</i> dhe prania e tij në viset e Epirit Jugor (§§ 29-30).....	84
Rreth përhapjes së emrit <i>Gjergj</i> (§ 31).....	87
Rreth përhapjes së emrave <i>Pal e Pjetër</i> (§ 32).....	87
Emra të tjerë tipikë shqiptarë (si <i>Bardhi, Dreri</i> etj.), si edhe emra me tinguj që i mungojnë greqishtes në viset jugore të Epirit (§§ 33-34).....	89
Rreth emrit të (N)artës në Epirin Jugor (§ 35).....	90
Ndikimi grek në onomastikën e Epirit (§ 36).....	91
Disa përfundime kryesore mbi gjendjen etnike të Epirit në lashtësi, mesjetë dhe sot (§ 37).....	92
 <i>Kreu i tretë</i>	
“Kolonitë” greke, romake dhe romane në brigjet e Jonit dhe të Adriatikut	95
“Kolonitë” greke dhe romake në brigjet e Jonit dhe të Adriatikut dhe roli i tyre në përhapjen e greqishtes, përkatësisht të latinishtes (§§ 1-2).....	95
Lidhja e ndikimit grek mbi stërgjyshërit e shqiptarëve me problemin e prejardhjes së tyre (§ 3).....	99
Në ç’përmasa ka vazhduar ndikimi i gjuhës dhe i kulturës greke gjatë mesjetës në viset e banuara nga shqiptarët? (§§ 4-5).....	100
Çështja e emrave <i>Epidamnos</i> dhe <i>Dyrrhachium</i> në lashtësi (§ 7).....	103
Mosromanizimi i viseve fshatare (§ 8).....	104

Grupet romane endacake dhe emërtimi i tyre: <i>arumunë, vlllehë, çobanë</i> (§§ 9-10).....	105
Sa ka qenë dhe sa është numri i përgjithshëm i arumunëve në Shqipëri? (§ 11).....	107

Kreu i katërt.

<i>Romanizimi në Europën Juglindore - kohëzgjatja, përmasat dhe pasojat</i>	109
Dy fjalë për përbërjen etnike të Ballkanit në prag të pushtimeve romake (§ 1).....	109
Gjurmë të popujve të ndryshëm indoeuropianë në Ballkan, të ardhur gjatë shekujve të mëparshëm (§ 2).....	110
Pushtimi romak i Ballkanit (§ 3).....	110
Me ç'popuj erdhën në kontakt romakët në Ballkan (§ 4)?.....	111
Romanizimi i Dalmacisë (§ 5).....	111
Romanizimi i Dakisë dhe faktorët që e mundësuan këtë (§ 6).....	112
Ku është ngjizur etnosi rumun (§ 7)?.....	113
Arumunët dhe origjina e tyre (§ 8).....	114
Ngadalësimi i procesit të romanizimit pas ndarjes së Perandorisë Romake në vitin 395 (§ 9).....	115
Mosromanizimi i grekëve dhe i shqiptarëve (§ 10).....	116
Mendimet e Thunmanit, Hamp-it etj. mbi praninë parasllave të shqiptarëve në trojet e tyre (§§ 11-13).....	117
Huazimet e vjetra latine të shqipes dhe karakteri i tyre arkaik si edhe huazimet nga greqishtja e vjetër si dëshmi e autoktonisë së shqiptarëve (§§ 14-15).....	119
Faktorët kryesorë që penguan romanizimin e plotë të stërgjyshërve të shqiptarëve (§§ 16-18).....	121
Rigjallërimi i etnosit arbëresh pas ndarjes së Perandorisë Romake në vitin 395 (§§ 19-20).....	123
Gjurmët e sundimit romak në gjuhën shqipe (§ 21).....	124
Gjurmët e sundimit romak në greqishte (§ 22).....	125
Përfundime rreth pasojave të sundimit romak në Ballkan (§ 23).....	125

Kreu i pestë

<i>Gjuha amtare në bregdetin jugor shqiptar gjatë shekujve</i>	127
Vështirësitë e sqarimit të këtij problemi për lashtësinë e hershme (§ 1).....	127
Lidhja e kësaj çështjeje me atë të gjuhës amtare të të ashtuquajturit Epir në lashtësi (§ 2).....	128
Të dhëna që tregojnë mungesën e romanizimit të kësaj zone në lashtësi (§ 3)..	129
Dëshmitë gjuhësore për praninë e hershme të elementit autokton në këtë zonë (§§ 4 -5).....	130
Rigjallërimi i elementit vendës pas ndarjes së Perandorisë Romake më 395 (§ 6).....	131
Cila ka qenë gjuha amtare në <i>Himarë, Dhërmi e Palasë</i> gjatë shekujve? (§ 7)...	131
Karakteret mbarëshqiptar të emrave vetjakë <i>Gjon, Gjin, Gjike, Pal</i> në këto vendbanime, sipas defterëve osmanë (§§ 8-15).....	132
Dëshmi të tjera për përkatësinë etnike dhe gjuhën amtare shqipe të kësaj zone (§ 16).....	140
Dëshmi të misionarëve basilianë (§§ 17-22).....	140
Dëshmitë e Pouqueville-it dhe të Leake-ut. (§§ 23-24).....	143
Letra dërguar careshës Elizabeta Petrovna (§ 25).....	145
Përhapja relativisht e vonë e greqishtes në tri vendbanimet e lartpërmendura dhe faktorët e një dukurie të tillë sipas Petro Markos (§§ 26-28).....	145
Përfundime (§ 29).....	

Kreu i gjashtë

<i>Gjuha amtare në vendbanimet e Gjirit të Vlorës gjatë shekujve</i>	148
Gjiri i Vlorës dhe Oriku e Aulona (§ 1).....	148
Lashtësia e këtyre vendbanimeve dhe gjuha e tyre amtare (§ 2).....	149
Lashtësia e emrit të Vlorës sipas dëshmimeve gjuhësore dhe të disa autorëve të vjetër (§§ 3-4).....	150
Dëshmia e Ptolemeut për qytetin skelë të Aulonas (§ 5).....	150
Lashtësia e Orikut dhe e Aulonas (§ 6).....	151

Karl Paçi për vendin e Vlorës së lashtë (§ 7).....	152
Cilët kanë qenë banorët e parë të Vlorës së lashtë (§§ 8-9)?.....	153
Emri i Vlorës në burimet greke, sllave etj. (§ 10).....	154
Vërejtje kundër mendimit për burimin grek të emrit të <i>Aulon</i> s (§§ 11-12).....	155
Përkatësia etnike dhe gjuha amtare e banorëve të Vlorës gjatë shekujve (§§ 13-16).....	156
Emrat tipikë shqiptarë <i>Gjon, Gjin, Gjike</i> etj. në defterët osmanë dhe rotacizmi <i>Vlonë>Vlorë</i> (§§ 17-20).....	159
Emri i fshatit <i>Arta</i> a <i>Narta</i> pranë Vlorës dhe prejardhja e banorëve greqishtfolës të <i>Nartës</i> dhe të <i>Zvërnecit</i> (§§ 21-23).....	163
Përfundime (§ 24).....	167

Kreu i shtatë

<i>Rreth fshatrave të Dropullit dhe të Vurgut dhe banorëve të tyre gjatë shekujve</i>	168
Fshatrat sot greqishtfolës të <i>Dropullit</i> dhe të <i>Vurgut</i> të Delvinës - probleme (§ 1).....	168
Tri shpjegimet për burimin e emrit <i>Dropull</i> (§ 2).....	168
Evolucioni <i>Hadrianoupolis>Dropull</i> , përfutur në gojën e një popullsie shqipfolëse (§ 3).....	171
Gjuha amtare e dikurshme e fshatrave të <i>Dropullit</i> (§§ 4-5).....	172
Fshatrat e luginës së <i>Dropullit</i> sipas defterëve osmanë (§ 6).....	173
Emrat karakteristike shqiptarë (<i>Gjon, Gjin</i> etj.) të fshatit <i>Goranxi e Sipërme</i> dhe <i>Goranxi e Poshme</i> , si edhe në <i>Derviçan</i> etj. sipas defterëve osmanë (§§ 7- 8).....	175
Përbërja etnike e fshatrave të <i>Dropullit</i> në kohën e pushtimit turk (§§ 9-10).....	176
Emrat tipikë shqiptarë <i>Gjon, Gjin</i> etj., në fshatrat e <i>Vurgut</i> , sipas defterëve osmanë dhe prejardhja e tyre (§§ 11-12).....	177
A ka qenë i hershëm elementi i vjetër shqiptar në fshatrat e <i>Dropullit</i> dhe të <i>Vurgut</i> (§§ 13-14)?.....	180

Kreu i tetë

<i>Mesapët dhe gjuha e tyre</i>	183
Mbishkrimet mesape sipas disa studiuesve (§ 1).....	183
Mendimi i Herodotit etj. mbi origjinën e mesapëve (§ 2).....	183
Mendimet e De Simone-s, Hamp-it, Pellegrinit, <i>Sufflay-t</i> dhe <i>Hammond-it</i> për origjinën ilire të mesapëve (§§ 3-4).....	184
Mbi bashkëpërkimet midis mesapishtes dhe shqipes. A ka qenë mesapishtja një gjuhë e tipit <i>satem</i> ? (§§ 5-6).....	186
Evolucioni *o>a në mesapishte dhe në shqipe (§ 7).....	187
Evolucioni *-m>-n në mesapishte dhe në shqipe (§ 8).....	187
Çaspirimi i mbylltoreve të aspiruara dhe theksimi nistor në mesapishte dhe në shqipe (§§ 9-10).....	188
Përfundime (§ 11).....	189

Summery

Chapter I. About the mother tongue of the Pelasgians and Etruscans.....	192
Chapter II. The mother tongue in Epirus in the course of centuries.....	201
Chapter III. The Greek, Roman and Macedo-Rumanian colonies in Albania...209	
Chapter IV. The romanization in the Balkan Peninsula.....	213
Chapter V. The mother tongue in South Albanian coastal settlements in the course of centuries.....	216
Chapter VI. The mother tongue in the settlements of the Valona bay in the course of centuries.....	218
Chapter VII. About the villages of the Dropull and Vourgos valleys and their inhabitants in the course of centuries.....	223
Chapter VIII. About the Messapians and their idiom.....	227
Treguesi alfabetik i autorëve të cituar.....	229
Treguesi alfabetik i emrave të përveçëm.....	233

Bibliografi e përzgjedhur

- Acta et diplomata I: 1913 = Acta et diplomata res Albaniae illustrantia. Vol. I. Vindobonae.
- Acta et diplomata II: 1916 = Acta et diplomata res Albaniae illustrantia. Vol. II. Vindobonae.
- Ajeti: 2005 = Ajeti, Idriz. *Studime dialektore dhe etimologjike*. Tiranë.
- Baçe: 1983 = Baçe, Apollon. "Sofratikë". Në: "Iliria" 2/1983.
- Banfi: 1985 = Banfi, Emanuele. *Linguistica balcanica*. Bologna.
- Bardhi: 1635 = Blancus, Franciscus. *Dictionarium Latino - Epiroticum*. Romae.
- Bardhyl Demiraj: Shih Demiraj B.
- Barić: 1955 = Barić, Henrik. Hymje në historinë e gjuhës shqipe. Prishtinë.
- Barletius: 1508 (?) = Barletius, Marinus. *Historia de vita et gestis Scanderbegi*. Napoli.
- Bartl: 1991 = Bartl, Peter. Zur Topographie und Geschichte der Landschaft Himara in Südalbanien. Në: "Münchner Zeitschrift für Balkankunde". 7. und 8. Band. 1991. München
- Bartoli: 1906 = Bartoli, Matteo. *Das Dalmatische*. I, II. Wien.
- Bereti: 1977-1978 = Bereti, Vasil. "Gërmime në Triport". *Iliria* VII-VIII. Shih edhe "Iliria" XV/2 (1985) dhe XV/2 (1986).
- Bërxolli: 2005 = Bërxolli, Arqile. *Minoritetet në Shqipëri*. Tiranë.
- Borgia: 1935 = Borgia, N. *I monaci basiliani d'Italia in Albania. Appunti di storia missionaria. Secoli XVI - XVIII*. Roma.
- Borgia: 1942 = Borgia, Nilo. *I monaci basiliani d'Italia in Albania. Appunti di storia missionaria. Secoli XVI-XVIII. Periodo secondo*. Roma.
- Brâncus: 1983 = Brâncus, Grigore. *Vocabularul autohton al limbi române*.

- București.
- Buharaja: 1967 = Buharaja, Vexhi. Rreth mbishkrimeve të fortesës së Elbasanit. "Studime historike" 1/1967.
- Buharaja: 1992 Buharaja, Vexhi. Kazaja e Delvinës (nga defteri osman i sanxhakut të Delvinës i vitit 1583), "Studime historike" 1-2/1992.
- Burime bizantine: = Burime tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë. Shek. X - XV. Përgatitur për botim nga Koço Bozhori dhe Filip Liço, Tiranë.
- Cabanes: 1997 = Cabanes, P. Epirus in the Roman period. Në: Epirus: 1997.
- Ceka: 1982 = Ceka, Neritan. Apolonia e Ilirisë, Tiranë.
- Ceka: 1987 = Ceka, Neritan. Mbishkrime byline. Në: "Iliria", 1987, 2.
- Cernoti: 1621 = Cernoti, Leonardo. Geografia, cioè Descrizione Universale della Terra, partita in due volumi, nel primo de' quali si contengono gli otto libri di Cl. Tolomeo. Padova.
- Chetta (shih Mandalà: 2003)
- Chrysos: 1997 = Chrysos, E. Slavic invasions and settlements. In: Epirus 1997.
- Cowgill: 1986 = Cowgill, Warren. Indogermanische Grammatik. Band I. Heidelberg.
- Cuntz (shih Itineraria 1929)
- Çabej: 1956 = Çabej, Eqrem. Për historinë e zanores /ë/ në gjuhën shqipe. *Buletin për Shkencat Shoqërore* 1/1956.
- Çabej: 1972 = Çabej, Eqrem. Problemi i vendit të formimit të gjuhës shqipe. *Studime filologjike* 4/1972.
- Çabej: 1974 = Çabej, Eqrem. Karakteristikat e huazimeve latine në shqipe. *Studime filologjike* 2/1974.
- Çabej: 1976 = Çabej, Eqrem. *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, vëll. 2. Tiranë.
- Çabej: 1976/a = Çabej, Eqrem. *Studime gjuhësore*. I, II. Prishtinë.
- Çabej: 1987 = Çabej, Eqrem. *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, vëll.

III. Tiranë.

Çabej: 2006 = Çabej, Eqrem. *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, vëll. VII. Tiranë.

Daka: 1984 = Daka, Palok. "Rreth disa antroponimeve të hershme shqiptare". *Studime filologjike* 3/1984.

d'Angély: 1962 = d'Angély, Robert. *L'énigme...* (vol. I) Les Pélasgues. Paris MCMLXII. (vol. III) Des Etrusques à l'Empire Byzantine. Paris MCMLXII.

Dara: 1906 = Dara, Gabriele. *Kënga e sprasme e Balës*. Catanzaro.

Defteri Osman i Janinës 1582-83 = Defteri Osman i vilajetit të Janinës i vitit 1582-83; transkribuar dhe përkthyer nga Vexhi Buharaja. Dorëshkrim në Arkivin e Institutit të Historisë, Tiranë.

Defterët Osmanë të Livasë së Vlorës të vjetëve 1506, 1520 dhe 1583. Ndodhen të fotokopjuar në Arkivin e Institutit të Historisë në Tiranë.

Demiraj, B.: 1997 = Demiraj, Bardhyl. *Albanische Etymologien*. Amsterdam - Atlanta, GA.

Demiraj, B.: 1997/a = Demiraj, Bardhyl. - *Sistemi i numërimit të gjuhës shqipe*. Tiranë.

Demiraj: 1988 = Demiraj, Shaban. *Gjuha shqipe dhe historia e saj*. Tiranë.

Demiraj: 1996 = Demiraj, Shaban. *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*. Tiranë.

Demiraj: 1999 = Demiraj, Shaban. *Prejardhja e shqiptarëve në dritën e dëshmive të gjuhës shqipe*. Tiranë.

Demiraj: 2000 = Demiraj, Shaban. *Rreth disa bashkëpërkimeve midis mesapishtes dhe shqipes*. SF 3-4/2000.

Demiraj: 2001 = Demiraj, Shaban. "Rreth emrit të qytetit të Vlorës dhe lashtësisë së tij". Në vëllimin: Konferenca shkencore *Vlora në rrjedhat e kohës*. Tiranë.

Demiraj: 2004 = Demiraj, Shaban. *Gjuhësi ballkanike*. Tiranë.

Demiraj: 2004/1 = Demiraj, Shaban. *Gjuha amtare në Bregdetin Jugor shqiptar gjatë shekujve*. Në vëllimin: *Himara në shekuj*. Tiranë.

- Demiraj: 2006 = Demiraj, Shaban. *The origin of the Albanians* (linguistically investigated). Tirana.
- De Simone: 1964 = De Simone, Carlo. "Die messapischen Inschriften". Në: *Krahe*: 1964.
- De Simone: 1990 = De Simone, Carlo. *La lingua messapica oggi: un bilancio critico*. Në: *Messapi*: 1990.
- Di Miceli: 1999 = Di Miceli, Francesca. "Per una storia delle ricerche sulla posizione dell'albanese fra le lingue della Penisola Balcanica". Në: *Studi in onore di Luigi Marlekaj*. Bari.
- Duka: 1991 = Duka, Ferit. "Realiteti etnik i Dropullit në burimet historike të shekullit XVI". (Defteri osman i regjistrimit të pronave dhe të popullsisë së sanxhakut të Vlorës, i vitit 1520). *Studime historike* 3-4/1991.
- Duka: 2001 = Duka, Ferit. *Berati në kohën osmane*. Tiranë.
- Duka: 2002 = Duka, Ferit. "Qyteti i Gjirokastrës në burimet osmane". *Studime historike* 3-4/2002.
- Duka: 2004. = Duka, Ferit. "Fasada bregdetare e Shqipërisë Osmane". Qyteti i Vlorës gjatë shek. XVI-XVII. *Studime historike* 3-4/2004.
- Duka: 2007 = Duka, Ferit. "Shoqëria dhe ekonomia në Çamërinë Osmane: Kazatë e Ajdonatit dhe Mazrakut (gjysma e dytë e shekullit XVI)". *Studime historike* 1-2/2007.
- Durante: 1959 = Durante, Marcello. "Il nome di Pésaro e l'accento iniziale in illirico". Në: *Annali dell'Istituto Universitario Orientale di Napoli*. Roma 1959/1.
- Dhrimo: 1974 = Dhrimo, Ali. "Një vështrim gjuhësor mbi toponiminë e Kurveleshit". SF 3-4/1974.
- Epirus: 1997 = EPIRUS. 4000 years of Greek history and civilization. Athens.
- Falaschi: 1984 = Falaschi, Nermin. *Antiche civiltà mediterranee. Pelasghi - Iliri - Etruschi - Albanesi*. Roma.
- Gjinari: 1989 = Gjinari, Jorgji. *Dialektet e gjuhës shqipe*. Tiranë.

59849

- Haas: 1962 = Haas, Otto. *Messapische Studien*. Heidelberg.
- Hahn: 1854 = Hahn, Georg von. *Albanesische Studien*. Jena.
- Hammond: 1967 = Hammond, N. G. L. *Epirus*. Oxford.
- Hammond: 1997 = Hammond, N.G.L. *Physical features and historical geography. Ancient Epirus - prehistory and protohistory. Epirus and the Greek world. The Greek heroes and the Greek colonies. The tribal systems of Epirus and neighbouring areas down to 400 B. C. The affinity of the Epirote tribes with their neighbours in the Central Balkan area. The entry of Epirus into the Greek world*. Në: *Epirus*: 1997.
- Hamp: 1957 = Hamp, Eric P. "Albanian and Messapic". Në: *Studies presented to Joshua Whatmough on his sixtieth birthday*. 'S Gravenhage.
- Hamp: 1966 = Hamp, Eric P. "The position of Albanian". Në: *Ancient "Indo-European dialects"*. Berkeley and Los Angeles.
- Hatzopoulos: 1997 = Hatzopoulos, M. B. *The boundaries of Epirus during Antiquity*. Në: *Epirus*: 1997, faqe 140-145.
- Hopf: 1873 = Hopf, Charles. *Chroniques gréco-romanes, inédites ou peu connues*. Berlin.
- Huld: 1985 = Huld, Martin E. *Ancient stratification of Ancient Greek loanwords in Albanian*. KZ vol. 98 (1985).
- Ilirët dhe Iliria: 2002 = *Ilirët dhe Iliria te autorët antikë*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti Arkeologjik.
- Inalcik: 1954 = Inalcik, Halil. *Hicri 835 [= 1831-32] tarihli sûret-i defter-i sancak-i Arvanid*. Ankara.
- Instat: 2001 = *Popullsia e Shqipërisë. Qarku i Gjirokastrës. Regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë i vitit 2001*. Botuar në Tiranë më 2004.
- Iordan: 1983 = Iordan, Iorgu. *Dictionar al numelor de familie românești*. Bucuresti.
- Islami: 1992 = Islami, Selim. "Epiri antik (Shënime për problemin etnik)": *Studime*

historike 1-4/1992.

- Ismajli: 2005 = Ismajli, Rexhep. *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*. Tiranë.
- Itineraria: 1916 = *Itineraria romana. Romanische Reisewege an der Hand der Tabula Peutingeriana, dargestellt von Konrad Miller*. Stuttgart.
- Itineraria 1929 = *Itineraria romana. Volumen primum. Itineraria Antonini Augusti et Burdigalense*. Edidit Otto Cuntz. Lipsiae.
- Jireçek: 1916 = Jireçek, Konstantin. "Valona in Mittelalter". Në: *Illyrisch-albanische Forschungen*. I. München.
- Jireçek: 1931 = Jireçek, Konstantin. *Slavianskoe naselenie v Albanii*. Sofia.
- Jireçek: 1984 = Jireçek, Konstantin. *L' eredità di Roma nelle città della Dalmazia durante il Medioevo*. A cura di Mario Capaldo. Roma.
- Kagan etj.: 1987 = Kagan, D., Ozment, S., Turner, F. M. *The Western Heritage*. Third edition. New York.
- Kastrati: 2002 = Kastrati, Sevdai. *Lufta e penave*. Tiranë.
- Katiçiq: 1976 = Katiçiq, Radoslav. *Ancient languages of the Balkans*. The Hague - Paris.
- Komata: 1991 = Komata, Damiano. *Qyteti iliro-arbëror i Kaninës*. Tiranë.
- Konda: 1997 = Konda, Spiro. *Shqiptarët dhe problemi pellazgjik*. (ribotim - Prishtinë).
- Kopitar: 1829 = Kopitar, B. J. *Albanische, walachische und bulgarische Sprache*. Wien. (Ribotuar në Ljubljana më 1945).
- Krahe: 1925 = Krahe, Hans. *Die alten Balkanillyrischen geographischen Namen*. Heidelberg.
- Krahe: 1941 = Krahe, Hans. *Beiträge zur illyrischen Wort- und Namen-forschung*. Indogermanische Forschungen LVIII. Band (1941). Zweites Heft.
- Krahe: 1955 = Krahe, Hans. *Die Sprache der Illyrier I*. Wiesbaden.
- Krahe: 1964 = Krahe, Hans. *Die Sprache der Illyrier II*. Wiesbaden.

- Kretschmer: 1896 = Kretschmer, Paul. *Einleitung in die Geschichte der griechischen Sprache*. Göttingen.
- KZ = Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung auf dem Gebiete der indogermanischen Sprachen. Berlin und Gütersloh.
- Leake: 1814 = Leake, W. M. *Researches in Greece*. London.
- Leake: 1835 = Leake, W. M. *Travels in Northern Greece*. I. London.
- Lombardo-Guzzo: 1990 = Lombardo, M. - Guzzo, P. G. I Messapi: "Aspetti della problematica". Në: *Messapi* 1990.
- Luka: 1978 = Luka, David. "Rreth disa toponimeve të regjistrit turk të vitit 1431". *Studime filologjike* 1/1978.
- Luka: 2001 = Luka, David. *Studime gjuhësore* VI. Shkodër.
- Majani: 1973 = Majani, Zahari. *Fundi i misterit etrusk*. Tiranë.
- Malombra: 1574 = Malombra, Gio. *La Geografia di Claudio Tolomeo Alessandrino, già tradotta di Greco in Italiano da M. Gio. Ruscelli et hora in questa nuova editione da M. Gio. Malombra ricorretta*. Venetia MDLXXIII.
- Mandalà: 1995 = Mandalà, Matteo. *Il Codice Chieutino*. Comune di Mezzoiuso (Palermo).
- Mandalà: 2003 = Mandalà, Matteo. *Nicolò Chetta nel bicentenario (1803-2003)*. Palermo.
- Mano: 2006 = Mano, Aleksandra. *Apolonia e Ilirisë*. Tiranë.
- Mansaku: 1982 = Mansaku, Seit. *Autoktonia e shqiptarëve në dritën e të dhënave të toponimisë së lashtë*. SF 3/1982.
- Mansaku: 1995 = Mansaku, Seit. "Çështja e autoktonisë së shqiptarëve në dritën e marrëdhënive të shqipes me latinishten". Në: *Seminari XVII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*. Tiranë.
- Mansaku: 1996 = Mansaku, Seit. "Probleme të historisë së gjuhës shqipe në dritën e marrëdhënive të saj me greqishten". Në: *Seminari XVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*. Tiranë.

- Martinet: 1986 = Martinet, André. *Des steppes aux océans*. Paris.
- Mayer: 1959 = Mayer, Antun. *Die Sprache der alten Illyrier*. B. II. Wien
- Meillet: 1936 = Meillet, Antoine. *Esquisse d'une grammaire comparée e de l'arménien classique*. Vienne.
- Memushaj: 2004 = Memushaj, Rami. *Histori e Kurveleshit*. I. Tiranë.
- Memushaj: 2004/1 = Memushaj, Rami. *Himara në dritën e të dhënave historike, gjuhësore dhe etnologjike*. Tiranë.
- Memushaj: 2004/2 = Memushaj, Rami. "Patronimia e Himarës". Në: *Himara në shekuj*: 2004, 293-319.
- Messapi: 1990 = I Messapi. Atti del trentesimo Congresso di Studi sulla Magna Grecia. Taranto-Lecce, 4-9 ottobre 1990. Istituto per la storia e l'archeologia della Magna Grecia. Taranto MCMXCI.
- Meta: 2002 = Meta, Beqir. *Tensioni greko-shqiptar (1939-1949)*. Tiranë.
- Métais: 2005 = Métais, Serge. *Historia e shqiptarëve. Nga ilirët deri te pavarësia e Kosovës (përkthyer nga frëngjishtja)*. Tiranë.
- Meyer: 1886 = Meyer, Gustav. "Der Einfluss des Lateinischen auf die albanesische Formenlehre". Në: *Miscellanea di filologia e linguistica in memoriam di Napoleone Caix e Angelo Canello*. Firenze.
- Meyer: 1888 = Meyer, Gustav. "Die lateinischen Elemente im Albanesischen". Në: *Gröbers Grundriss. I.I. Auflage (1888)*.
- Meyer: 1888/a = Meyer, Gustav. *Kurzgefasste Albanesische Grammatik*. Leipzig.
- Meyer: 1895 = Meyer, Gustav. *Neugriechische Studien. III*. Wien.
- Meyer-Lübke: 1914 = Meyer-Lübke, Wilhelm. "Rumänisch, romanisch, albanesisch". Në: *Mitteilungen des Romanischen Instituts an der Universität Wien*. Heidelberg.
- Mihăescu: 1966. = Mihăescu, Haralambie. *Les éléments latins de la langue albanaise*. Në: RESEE, 1-2/1966.
- Mihăescu: 1966/a = Mihăescu, Haralambie. *Influenca greceasc asupra limbii*

române. Bucuresti, 1966.

Mihăescu: 1978 = Mihăescu, Haralambie. *La langue latine dans le sud-est de l'Europe*. Bucuresti - Paris.

Miller (shih Itineraria 1916).

Murzaku: 2004 = Murzaku, Thoma. "Vllehtë e Shqipërisë - ilirë autoktonë të romanizuar". *Studime albanologjike*. Universiteti i Tiranës. 2004/2.

Nicol: 1997 = Nicol, D. The "Despotate of Epirus". In: *Epirus 1997*.

Nobbe: 1843 Claudii Ptolemaei Geographia, Edidit Carolus Fridericus - Augustus Nobbe, editio stereotypa. Tom I. Lipsiae sumptibus et typis Caroli Tauchnitii. 1843

Pallottino: 1949 = Pallottino, M. *La civilisation étrusque*. Payot Paris.

Parlangèli: 1960 = Parlangèli, Oronzo. Studi messapici. Milano

Patsch: 1904 = Patsch, Carl. *Das Sandschak von Berat in Albanien*. *Schriften der Balkankommission*. Antiquarische Abteilung. Wien.

Pedersen: 1897 = Pedersen, Holger. *Die albanesische l-Laute*. KZ 33 (1897).

Pedersen: 1905 = Pedersen, Holger. "Albanesisch 1905". Në: *Rom. Jb. IX (1905)*. Erlangen 1909.

Pellegrini: 1982 = Pellegrini, G. B. "Disa vëzhgime mbi elementin latin të gjuhës shqipe". *Studime filologjike* 3/1982.

Pellegrini: 1995 = Pellegrini, Giovan Battisti. Avviamento alla linguistica albanese. Palermo.

Pilika: 2005 = Pilika, Dhimitër. *Pellazgët - origjina jonë e mohuar*. Tiranë.

Pisani: 1971 = Pisani, Vittore. "La lingua dei Messapi". Në: *Archivio Storico Pugliese*. Anno XXIV (1971), fascicolo III-IV.

Polisi: 2002 = Polisi, Mehdi. *Gramatika e gjuhës turke (Fonetika dhe morfologjia)*. Prishtinë.

Pouqueville: 1921 = Pouqueville, F., -C., -H, -L. *Voyage dans la Grèce*. v. V. Paris.

- Pouqueville: 1926 = Pouqueville, F., -C, -H, -L. *Voyage de la Grèce, v. II (deuxième édition)*. Paris.
- Ptolemeu = Ptolemaeus, Claudius. *Geographia*. Shih: Cernoti: 1621; Fridericus Nobbe: 1843; *Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë*: 1965; Malombra: 1574; Ruscelli: 1564.
- Pulaha: 1974 = Pulaha, Selami. *Defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485*. Tiranë.
- Ramat: 1994 = *Le lingue indoeuropee*. A cura di Anna Giacalone Ramat, Paolo Ramat. Bologna.
- Reinhold: 1854 = Reinhold, C. H. T. *Noctes Pelasgicae*. Athenis. Ribotuar, i transkriptuar, nga Ardian Klosi në Tiranë më 2005.
- RESEE = *Revue des études Sud-Est Européennes*. Bucarest.
- Riska: 2005 = Riska, Albert. *Arumunët*. Elbasan.
- Rix: 1968 = Rix, Helmut. *Eine morphosyntaktische Übereinstimmung zwischen Etruskisch und Lemnisch: Die Datierungsformel. Nö: Studien zur Sprachwissenschaft und Kulturkunde*. Innsbruck.
- Rix: 1976 = Rix, Helmut. *Historische Grammatik des Griechischen*. Darmstadt.
- Rusha: 2001 = Rusha, Spiro. Himara në stuhitë e shekujve. Tiranë.
- Ruscelli: 1564 = Ruscelli, Giero. *La Geografia di Claudio Tolomeo Alessandrino, nuovamente tradotta di Greco in Italiano da Ieronimo Ruscelli*. Venetia, MDLXIII.
- Sandfeld: 1930 = Sandfeld, Kristian. *Linguistique balkanique, problèmes et résultats*. Paris.
- Santoro: 1982 = Santoro, Ciro. *Nuovi studi messapici*. Volume primo. Galatina.
- Santoro: 1983 = Santoro, Ciro. *Nuovi studi messapici*. Volume secondo. Galatina.
- Santoro: 1984 = Santoro, Ciro. *Nuovi studi messapici*. Primo supplemento. Parte I, Parte II. Galatina.
- Sasse: 1991 = Sasse, Hans-Jurgen. *Arvanitika. Die albanischen Sprachreste in*

- Griechenland*. Wiesbaden.
- Schramm: 1994. = Schramm, Gottfried. *Anfänge des albanischen Christentums. Die frühe Bekehrung der Bessen und ihre langen Folgen*. Freiburg im Breslau.
- Schwyzer: 1959 = Schwyzer, E. *Griechische Grammatik. Auf der Grundlage von Karl Brugmanns Griechischer Grammatik (3. Auflage)*. München.
- Scutari: 1997 = Scutari, Pasquale. *Uno studio fonologico e morfologico sulla parlata arbëreshe di San Constantino Albanese*. Cosenza.
- Seliščev: 1931 = Seliščev, A. M. *Slavianskoe naselenie v Albanii*. Sofia.
- SF = *Studime Filologjike*. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.
- SH = *Studime Historike*. Instituti i Historisë, Tiranë.
- Silvestri: 1994 = Silvestri, Domenico. *Le lingue italiche*. Në: Ramat 1994.
- Solta: 1980 = Solta, G. R. *Einführung in die Balkanlinguistik mit besonderer Berücksichtigung des Substrats und des Balkanlateinischen*. Darmstadt.
- Sommer: 1914 = Sommer, Ferdinand. *Handbuch der lateinischen Laut- und Formenlehre*. Heidelberg.
- Sotiri: 2001 = Sotiri, Natasha. *E folmja dhe toponimia e Qeparoit*. Tiranë.
- Sotiri: 2004 = Sotiri, Natasha. "E folmja e Himarës". Në: *Himara në shekuj*. Tiranë 2004, faqe 263-292.
- Steinbauer: 1999 = Steinbauer, Dieter H. *Neues Handbuch des Etruskischen*. St. Katharinen.
- Straboni: 1549 = Strabonos peri tēs geographias biblia iz´. Strabonis de situ orbis. Libri XVII. Basileae, per Henrichum Petri. MDXCIX.
- Sufflay: 1916 = Sufflay, Milan. "Die Biologie des albanischen Volksstammes". Në: *Ungarische Rundschau*, 1916/17, 1. Heft.
- Suhaçev: 1990 = Suhaçev, N. I. "Istrorumynskij jazyk". Në: *Osnovy balkanskogo jazykoznanija. Jazyki balkanskogo regiona*. Leningrad.
- Shkurti: 1976 = Shkurti, Spiro. "Vështrim etnografik mbi zonën e Vurgut" (Sarandë). Në: *Etnografia shqiptare* 8/1976.

- Shkurti: 1987 = Shkurti, Spiro. *Vurgu - Vështrim etnografik*. Tiranë.
- Topalli: 2007 = Topalli, Kolec. *Fonetika historike e gjuhës shqipe*. Tiranë.
- Totoni: 1964 = Totoni, Menella. *E folmja e Bregdetit të Poshtëm*. I, II. SF 1964, 1, 2.
- Triandafilidhis: 1995. = Triandafilidhis, Manolis A. *Gramatika e vogël e greqishtes së re*. Përkthyer nga Dhori Q. Qiriazhi. Selanik.
- Thëngjilli: 2005. = Thëngjilli, Petrika. *Toponimia historike në krahinën e Vlorës*. Tiranë.
- Thumb: 1910 = Thumb, Adalbert. *Altgriechische Elemente des Albanesischen*. IF 26 (1910).
- Ugolini: 2000 = Ugolini, Luigi M. *Butrinti* (përkthyer shqip nga Zef Simoni). Roma.
- Untermann: 1964. = Untermann, Jürgen. "Die messapischen Personennamen". Në: *Krahe* 1964.
- Veizi: 1998 = Veizi, Fane. *Bregu i detit në këngë*. Tiranë
- Vineis: 1994 = Vineis, Edoardo. Latino. Në: Ramat: 1994.
- Vreto: 1878 = Vreto, Jani. *Apologjia kundër artikullit "Epiri djep i helenizmit në Shqipëri!"*; ribotuar nga Kastrati, Sevdai: 2002, faqe 97-118.
- Windekens: 1952 = Windekens, A. J. van. *Le Pélasgique. Essai sur une langue indo-européenne préhellénique*. Louvain.
- Xhufi: 2006 = Xhufi, Pëllumb. *Dilemat e Arbërit*. Tiranë.
- Xhuvani - Çabej = Xhuvani, A.: 1962 = Xhuvani, A. - Çabej, E. *Prapashtesat e gjuhës shqipe*. Tiranë.

*Kreu i parë***Pellazgët, etruskët dhe shqiptarët**

1. Gjatë këtyre shekujve të fundit janë botuar shkrime të shumta si edhe vepra të plota, kushtuar prejardhjes së shqiptarëve nga një popullsi e lashtë paragreke, madje sipas disave edhe para-indoeuropiane, e quajtur pellazge. Siç do të shtjellohet më poshtë, nuk ka dhe vështirë se mund të kishte një mendim të përbashkët për prejardhjen dhe shtrirjen e një popullsie të tillë të lashtë. Por në përgjithësi është vënë në dukje se një nga trevat e banuara prej pellazgëve ka qenë edhe Epiri, ku ishte ngritur prej kohësh të hershme tempulli i *Dodonës* me orakullin e tij të famshëm. Lidhur me tempullin e *Dodonës*, Skymni (shek. III-II para erës së re) thotë se ai tempull ishte themeluar nga pellazgët (Shih *ilirët dhe Iliria*: 1965, f. 73). Edhe Pouqueville-i (1826, 189) pohon se faltoreja e *Dodonës* ishte ndërtuar nga pellazgët dhe prandaj e quan “*Dodona pellazgjike*” (f. 191). Edhe sipas studiuesit tjetër francez Métais (2005, 110):, “Ka shumë të ngjarë që *Dodona* të ketë qenë vërtet një faltore pellazge përpara arritjes së grekëve. Mendohet se ata e zbuluan gjatë shtegtimt të tyre drejt jugut dhe pastaj e përvetësuan. Lidhur me orakullin e *Dodonës* Herodoti shënon se “...sipas mendimit të përgjithshëm, është orakulli më i lashtë i Greqisë”. Për më shumë hollësira për tempullin dhe orakullin e *Dodonës* shih Pouqueville-in (1826, f.179 -197), si edhe Hammond-in (1967, 367vv., 399vv.). Ky i fundit (1967, f.367) pohon edhe: “Pak dyshim ka që banorët e parë të *Dodonës* erdhën nga jugu në epokën e hershme të bronzit dhe në traditën greke ishin identifikuar me pellazgët, për të cilët thuhej se kishin themeluar orakullin. Ishte e qartë që ai ekzistonte, kur arritën njerëzit e parë greqishtfolës dhe e adoptuan vendin e shenjtë për vete të tyre.” Po sipas këtij autori (f. 435): “E kemi parë se në periudhën rreth 1120 deri 800 para Krishtit *Dodona* ishte në lidhje vetëm me viset veriore dhe se ajo atëherë i përkiste një *mjedisi* ballkanik. Lidhjet e ngushta me veriu vazhduan prej vitit 800 deri në vitin 500 para Krishtit...”

Prandaj është e nevojshme të thuhet nja dy fjalë për atë popullsi të lashtë paragreke, aq më shumë sepse disa studiues i kanë paraqitur Pellazgët si stërgjyshërit e shqiptarëve e disa të tjerë kanë shprehur mendimin se ata kanë qenë përhapur edhe jashtë Ballkanit. Gjithashtu është e nevojshme të sqarohet nëse pellazgët kanë qenë apo jo popullsi indoeuropiane dhe sa të vjetër duhet të kenë qenë ata në Ballkan. Veç kësaj, është e nevojshme të sqarohet nëse këtyre të ashtuquajturve pellazgë nuk u kanë paraprirë popullsi të tjera në Ballkan. Dhe po e nisim me këtë çështjen e fundit.

2. Të dhënat arkeologjike dhe historike dëshmojnë se Gadishulli Ballkanik ka qenë i banuar nga popuj të ndryshëm edhe para ardhjes së tribuve indoeuropiane, që e kanë “indoeuropianizuar” atë prej kohësh të hershme. Popullimi i hershëm i këtij gadishulli është mundësuar edhe nga pozicioni i tij gjeografik si një urë ndërlidhëse midis Europës dhe Azisë së Vogël. Ky pozicion gjeografik u ka dhënë shkas gjithashtu dyndjeve të herëpashërme të popujve e fiseve të ndryshme që, edhe kur janë asimiluar nga banorët më të hershëm, apo edhe kur kanë qëndruar për një kohë të kufizuar në Gadishullin Ballkanik, prapë kanë lënë herë më shumë e herë më pak gjurmë në gjuhët e folura të këtij gadishulli. Por në gjendjen e sotme të hulumtimeve është e pamundur t’i jepet një përgjigje e argumentuar pyetjes se ç’popuj kanë pasë banuar në këtë gadishull para ardhjes së tribuve indoeuropiane aty nga mijëvjeçari i dytë para erës së re. E kjo vërejtje vlen edhe për popullsinë a popujt paragrekë të trevave greke, megjithëse të dhënat arkeologjike dhe historike-letrare për ata popuj janë relativisht më të shumta se për popujt paraindoeuropeanë të trevave të tjera të Ballkanit. Sidoqoftë, siç u vu në dukje pak më sipër, duke pasur parasysh pozicionin gjeografik të këtyre trevave në afërsi të Mesdheut dhe si urë ndërlidhëse midis dy kontinenteve, mund të pohohet me siguri se ato kanë qenë të banuara qysh herët, d.m.th. qysh shumë kohë para dyndjes së tribuve indoeuropiane në Gadishullin Ballkanik. Por qysh në fillim do mbajtur parasysh se, siç u prek edhe pak më sipër, në gjendjen e sotme të hulumtimeve është shumë e vështirë të sqarohet se ç’popuj a popullsi kanë pasë banuar në trevat ballkanike para dyndjes së tribuve indoeuropiane. Megjithatë, mund të pohohet se popujt paraindoeuropeanë të këtij gadishulli duhet

të kenë qenë ndikuar nga qytetërimi i lashtë i vendeve të Lindjes së Afërt dhe se ata popuj paraindoeuropeanë duhet të kenë ushtruar ndikim mbi tributë indoeuropiane, që shtegtuan në trevat ballkanike, duke përfshirë edhe tributë e hershme greke të vendosura afër brigjeve dhe nëpër ishuj të Egjeut. Për praninë e një popullsie të tillë paragreke në viset jugore të Ballkanit dëshmojnë jo vetëm zbulimet arkeologjike, por edhe një numër i konsiderueshëm toponimesh prej burimi jogrek ose të ndërtuara me prapashtesa të burimit jogrek. Të tilla janë sidomos në trevat greke toponimet e formuara me prapashtesat /-nth-/ ,/s(s)/-tt-/ ,/-n-/ ,/-m-/ ,/-mn-/ ,/-l-/ ,/-r-/ ,/-th-/ , si: *Zákynthos*, *Kórinthos*, *Labýrinthos* etj., *Knossós*, *Lárisa*, *Parnassós* etj., *Athēnai*, *Alpēnós* etj. (shih *Katiçiq*: 1976, 42 vv. - me literaturën përkatëse). Ky gjuhëtar vë në dukje gjithashtu në f. 53 vv.: “Elementet prapashtesore, që janë karakteristike për toponimet paragreke dhe që u përgjigjen tipave fjalëformues të Anatolit, ndeshen edhe në shumë fjalë greke, që nuk mund të shpjegohen me anë të etimologjisë greke dhe zakonisht emërtojnë bimë, kafshë dhe objekte materiale, që u përkasin florës, faunës dhe kulturës materiale të Egjeut”. Dhe këtu ai përmend, ndër të tjera, edhe: μίνθη “ment-a”, θάλασσα “det”, κέρασος “qersh”, κυάρισσος “qiparis, selvi”, δάφνη “dafinë”, θάλαμος “dhome”, κυθάρα “kitarë”, λάπαθον “lërpjetë” etj. Dhe si vë në dukje (f. 55) se midis emrave gjeografikë paragrekë nuk ka vetëm oronime (emra malesh) dhe hidronime (emra lumenjsh etj.), por edhe një numër të konsiderueshëm me emra qytetesh, ky autor shton: “Nga ky fakt mund të nxirret përfundimi se greqishtfolësit gjetën në kohën e mbërritjes së tyre një urbanizim egjean me zhvillim të plotë. Kjo vërejtje përputhet me përfundimet nga të dhënat arkeologjike, sipas të cilave kulmi i parë i jetës urbane (qytetare) në botën egjeane ishte arritur qysh në periudhën e hershme të bronzit, ndërsa tributë greqishtfolëse vërshuan në këtë zonë vetëm në fillim të periudhës së mesme të bronzit”.

Gjithsesi, duhet pranuar pa asnjë mëdyshje që edhe trevat e banuara nga shqiptarët para ardhjes së tribuve indoeuropiane kanë qenë të banuara nga popullsi, të cilat qysh në kohë të lashta janë asimiluar nga tributë indoeuropiane, që erdhën e u vendosën në Ballkanin Perëndimor.

3. Por cilët kanë qenë stërgjyshërit e shqiptarëve? Kësaj pyetjeje, siç dihet,

i janë dhënë përgjigje të ndryshme, që të interesuarit mund t'i lexojnë në veprën tonë *Prejardhja e shqiptarëve në bazë të dëshmimeve të gjuhës shqipe* (1999). Në atë vepër (faqe 39 v. dhe 72 v.) është parashtruar edhe hipoteza e prejardhjes pellazgjike të shqiptarëve, por në mënyrë të përmbledhur. Prandaj është e nevojshme të ndalemi pak më gjatë në çështjen e pellazgëve, aq më shumë sepse kjo është bërë objekt diskutimesh dhe lidhet edhe me problemin themelor të kësaj vepre kushtuar të ashtuquajturit Epir. Natyrisht, kjo çështje paraqitet tepër e vështirë, sepse për pellazgët ka një literaturë të gjerë me mendime nga më të ndryshmet edhe për shtrirjen e tyre gjeografike. Gjithsesi, të dhënat e para për ta i kemi nga autorët e vjetër grekë, prandaj këtu po japim përmbledhtas më parë të dhënat kryesore që kemi prej tyre.

Sipas të dhënave të autorëve të vjetër grekë del që tributë e para greke gjetën në trevat pranë detit Egje një popullsi më të vjetër, por për përkatësinë etnike dhe gjuhën e asaj popullsie mendimet e dijetarëve nuk përputhen. Disa studiues si *Kretschmer-i*, *Budimir-i*, *Georgiev-i*, *van Windekens-i* etj. mendojnë se është fjala kryesisht për një popullsi paragreke, që i përkiste familjes së tribuve indoeuropiane, por ka edhe nga ata që mendojnë se popullsia më e lashtë e kësaj treve i përkiste një shtrese autoktone mesdhetare, pra joindoeuropiane. Madje, disa nga ata që kanë menduar për origjinën indoeuropiane të asaj popullsie paragreke, e kanë pagëzuar atë edhe me ndonjë emër si: “protoindoeuropianë” (*Kretschmer*), “pellazgë” (*Georgiev* etj.), “pelastë” (*M. Budimir*) etj.¹ Por do pasur parasysht se më i hershëm dhe më i përhapur ka qenë emërtimi *pellazg* i cili dëshmohet qysh te Homeri (shih § 5).

4. Siç shihet, pra, është më se e sigurt që trevat, ku erdhën e u vendosën fiset greke në mijëvjeçarin e dytë para erës sonë, kanë qenë të banuara qysh në periudha më të hershme. Është plotësisht e mundshme që para fiseve greke atje të kenë shtegtuar edhe fise të tjera indoeuropiane nëpërmjet Danubit ose nëpërmjet Anolisë, ku gjatë mijëvjeçarit të dytë e të parë para erës sonë dëshmohen edhe popuj me origjinë indoeuropiane si *hititët*, *luvianët* etj. (shih Cowgill: 1986, 17 v.).

¹ Shih më hollësisht për të gjitha këto *Katiçiq*: 1976, 55 vv.

Por, nga ana tjetër, siç u vu në dukje pak më sipër, edhe para vërshimit të fiseve indoeuropiane, viset e Egjeut duhet të kenë qenë të banuara nga një popullsi më e lashtë joindoeuropiane. Ç’popull a ç’popuj kanë qenë ata dhe ç’gjuhë flisnin, këto mbeten sot për sot çështje të pandriçuara, megjithëse edhe në këtë rast nuk kanë munguar hipoteza, për të cilat nuk po ndalemi, sepse dalin jashtë caqeve të këtij punimi. Megjithatë, duke qenë se për prejardhjen e shqiptarëve është shprehur edhe supozimi që këta janë pasardhës të *pellazgëve*, po ndalemi pak në mendimet e ndryshme mbi *pellazgët*.

5. Etonimi *pellazg* dëshmohej së pari në *Iliadën e Homerit*, ku paraqiten si banorë “të Larisas pjellore” etj., madje ai i quan edhe *pellazgë hyjnorë*². Herodoti (shek. V para erës sonë) thotë se ata banonin, ndër të tjera, në *Atikë* dhe u bënëin fli perëndive çdo gjë; madje, duke folur për helenët, ai thotë se këta, “pasi u ndanë nga *pellazgët*, në krye qenë të dobët...”. Ai shton se më vonë athinasit i dëbuan *pellazgët* nga *Atika* dhe këta atëherë u vendosën në (ishullin) *Lemr*³. Edhe Tukididi (shek. V) i përmend *pellazgët*, të cilët, sipas tij, kanë qenë ndër të parët që i quajtën grekët me emrin *helen*⁴. *Pellazgët* i përmend shkurt edhe Aristoteli (shek. IV para erës sonë) për në ishujt *Elektride*⁵, Skymni (shek. III-II para erës sonë) i cili thotë se *pellazgët* ishin themeluesit e tempullit të *Dodonës*⁶, Diodori (shek. I para erës sonë) i cili thotë se *pellazgët* qenë të parët banorë që u vendosën në ishullin *Lesbo*⁷ etj. Por të dhëna disi më të plota për *pellazgët* jep në kapërcyell të erës sonë gjeografi i madh grek Straboni, i cili thotë:

“Për *pellazgët* pothuaj të gjithë janë të mendimit se ishin një fis i vjetër i përhapur në gjithë Helladën e sidomos në vendin e eolëve afër Thesalisë. Por sipas

² Shih *ilirët dhe Iliria*, f. 9.

³ Shih *po aty*, f. 16, 20.

⁴ Shih *po aty*, f. 24.

⁵ Shih *po aty*, f. 42.

⁶ Shih *po aty*, f. 73.

⁷ Shih *po aty*, f. 136.

Eforit ishin me prejardhje nga Arkadia [krahinë në Peloponez - Sh. D.], të dhënë pas jetës luftarake dhe, duke u shtuar nga ata të cilët morën anën e tyre dhe të cilëve u dhanë edhe emrin, u bënë të famshëm edhe ndër helenët, si edhe në gjithë vendet ku vajtën. Me të vërtetë, shohim pellazgë të vendosur në Kretë, sikurse dëshmon Homeri, duke i vënë në gojë Odiseut këto fjalë, që ai i thotë Penelopës: “Në këtë ishull, ku banojnë akejtë, eteokretët trima, kydonët, dorët trefish dhe *pellazgët hyjnorë*, secili ka gjuhën e tij”.

Pastaj Straboni thotë se dikur pellazgët kishin qenë zotër të Thesalisë dhe se “shumë autorë të vjetër edhe fiset epirote i kanë quajtur pellazgjike, sepse ata shtriheshin deri atje [në Epir]. Dhe me që këta autorë të vjetër kanë cilësuar si pellazgë një numër të madh heronjsh, autorët e mëvonshëm u kanë dhënë emrin pellazg fiseve që kishin udhëheqës këta heronj...”. Më tej Straboni jep disa të dhëna mbi përhapjen e dikurshme të pellazgëve⁸.

6. Nuk po zgjatemi më tej me të dhënat e autorëve të vjetër mbi përhapjen e dikurshme të pellazgëve, të dhëna që mbulohen edhe nga njëfarë mjegulle mitologjike. Po përmendim vetëm edhe të dhënat e historianit romak Justin, të periudhës së Augustit. Sipas tij, edhe populli i Maqedonisë së vjetër quhej *pellazg*⁹. Gjithashtu vlen të shënohet se në përgjithësi pranohet që edhe ishulli i Lemnos i detit Egje (jo shumë larg brigjeve të Gadishullit të Anadollit) në kohë të lashta ka qenë i banuar nga pellazgë, para se ai ishull të pushtohej nga athinasit në shekullin VI para erës së re. Madje, atje është zbuluar edhe një mbishkrim në një gjuhë të ndryshme nga greqishtja dhe me pika takimi me etruskishten (shih, ndër të tjerë, Pallottino: 1949, 66v., 70). Për këtë mbishkrim do të ndalemi pak më poshtë (§ 9).

7. Gjithsesi, çështja e pellazgëve dhe e gjuhës së tyre paraqitet shumë e vështirë për t’u ndriçuar si duhet, sepse për ta nuk kemi dëshmi gjuhësore të drejtpërdrejta prej vetë atyre, me përjashtim të mbishkrimit të ishullit Lemnos që, edhe sikur të zbërthehet saktë, nga vetë përmasat e tij, është i pamjaftueshëm për të

⁸ Shih *po aty*, f. 151v.

⁹ Shih *po aty*, f. 291.

ndriçuar sa dhe si duhet gjuhën, në të cilën është shkruar. Ata studiues që janë marrë me këtë çështje, janë mbështetur kryesisht në disa të dhëna të autorëve të vjetër grekë, si edhe në disa toponime paragreke dhe në disa huazime të vjetra të greqishtes, që nuk shpjegohen dot nëpërmjet rregullsiive të evolucionit të sistemit gjuhësor të vetë greqishtes. Ndër studiuesit që u përpoqën të shpjegonin gjuhën e pellazgëve nëpërmjet disa huazimeve të vjetra të greqishtes, që nuk shpjegohen dot nëpërmjet rregullsiive të evolucionit të kësaj gjuhe, duhen përmendur sidomos gjuhëtari bullgar Vladimir Georgiev, autor i veprës *Vorgriechische Sprachwissenschaft I - II* (Sofje 1941-1945) dhe i disa punimeve të tjera¹⁰, si edhe profesori i universitetit të Louvain-it, A.J. van Windekens, autor i veprës *Le Pélasgique* (1952). Ky i fundit në përgjithësi e miraton mendimin e Georgievit për origjinën indoeuropiane të pellazgëve, megjithëse në faqen VII v. pohon: “Nga rreth 180 krahasimet e emrave të propozuar [nga Georgievi] në veprën e tij *Vorgriechische Sprachwissenschaft* dhe në veprat e tij më të reja vetëm ndonja njëzet i qëndrojnë përfundimisht çdo kritike.”

8. Pra, sipas këtyre autorëve, pellazgjishtja ka qenë një gjuhë indoeuropiane e cila, gjithnjë sipas tyre, ndryshonte nga greqishtja. Dhe ata mbi bazën e materialit të analizuar, kanë vënë në dukje edhe tiparet dalluese kryesore të pellazgjishtes, që të interesuarit mund t’i shqyrtojnë në veprën *Le Pélasgique* të van Windekens-it. Nga këto tipare dalluese mund të përmenden këtu disa, sa për ilustrim:

1. Pellazgjishtja, ashtu si gjuhët e tjera indoeuropiane, ka pasur edhe zanore të shkurtra edhe të gjata, por nga zanoret e shkurtra vetëm /-o/-ja ka evoluar në /a/, ashtu si në gjuhët gjermanike [dhe në shqipe], kurse zanoret e tjera të shkurtra dhe të gjitha zanoret e gjata janë ruajtur të pandryshuara (shih van Windekens: 1952, 3-6).

2. Ajo, si në armenishte, i ka çaspiruar bashkëtingëlloret mbylltore të zëshme të aspiruara dhe mbylltoret e zëshme i ka shndërruar në të pazëshme, kurse mbylltoret e pazëshme i ka kthyer në të aspiruara. “Pellazgjishtja jep vetëm një shembull të një indoeuropianishteje të pazëshme të aspiruar: th, e cila ruhet si e tillë ashtu si në

¹⁰ Të dhënat për punimet e Georgievit i kemi nxjerrë nga vepra e Katiçiq-it, *Ancient languages of the Balkans* (1976, faqe 71-87) si edhe nga vepra e van Windekens-it e vitit 1952.

armenishte” (po aty, f. 13).

3. Ajo ka qenë një gjuhë e tipit *satem* (po aty, f. 14), d.m.th. mbylltoret qiellzore indoeuropiane i ka shndërruar në tinguj fishkëllues (sibilantë), kurse buzore-grykoret indoeuropiane i ka shndërruar në grykore të thjeshta. E në këtë rast ajo dallohet nga greqishtja, latinishtja etj. dhe afrohet me dukuritë e ngjashme të shqipes.

4. Edhe leksiku i pellazgjishtes mbetet në përgjithësi i panjohur. Megjithatë, duke u mbështetur në disa fjalë të greqishtes së vjetër, që në bazë të disa tipareve gjuhësore duket se janë të huazuara nga një gjuhë tjetër, që sipas tyre ka qenë pellazgjishtja, studiuesit kanë veçuar një numër të konsiderueshëm fjalësh të tilla me burim jogrek. Ndër këto mund të përmenden, sa për shembull, βασιλεύς “mbret”, δαίμων “zot, fuqi hyjnore etj.”, θύραξ “mburojë, gjoks etj.”, λαβύρινθος “labyrinth” etj. (shih van Windekens: 1952, 76, 85, 93, 118v. - me literaturën përkatëse).

9. Natyrisht, këto përfundime dhe të tjera të ngjashme për pellazgjishten duhen marrë me njëfarë rezerve, përderisa janë nxjerrë mbi bazën e një materiali të dokumentuar në greqishte, ku vështirë se mund t’i kenë shpëtuar njëfarë përshtatjeje ndaj sistemit fonologjik të kësaj gjuhe. E kjo vërejtje vlen edhe për toponimet paragreke të Greqisë. Në këtë drejtim do të ndihmonte shumë mbishkrimi pellazgjik i ishullit Lemnos, që u përmend shkurt pak më sipër (§ 7). Ai është mbishkrimi i një guri varri të shekullit VI para erës së re, i zbuluar në vitin 1885 në ishullin e Lemnosit. Ky mbishkrim është shkruar në një alfabet të ngjashëm me alfabetin e mbishkrimeve etruske, i cili, nga ana e tij, ka pika takimi me alfabetin e greqishtes së vjetër (shih § 25). Ky mbishkrim, megjithëse është bërë objekt hulumtimesh nga disa specialistë të njohur, ende nuk është ndriçuar si duhet. Por ata që janë marrë me këtë mbishkrim, që mbahet për pellazgjik, kanë vënë re disa bashkëpërkime midis gjuhës së tij dhe etruskishtes (shih për këtë § 25). Por në rast se gjuha e tij ka pika takimi me etruskishten, atëherë edhe për atë mund të vlejné po ato vërejtje, që do të bëhen më poshtë për lidhjet e supozuara midis etruskishtes dhe shqipes.

Nga të dhënat e atij mbishkrimi del se gjuha, në të cilën ai është shkruar, kishte 4 zanore: /a, e, i, o/, kurse në etruskishte dëshmohen /a, e, i, u/ dhe në të dyja rastet ato janë shkruar në alfabetet e ngjashme me atë të greqishtes së vjetër. Në

mbishkrim dalin dy bashkëtingëllore fishkëlluese /s, s/, si edhe dy tinguj dhëmborë /t, tʰ/ (shih Steinbauer: 1999, 363). Në atë mbishkrim dëshmohen edhe formulat *mav sial veisχavis* si edhe *avis sialχvis* (“në moshën prej dyzet (?) vjeç”). Të krahasohen këto dy formula me atë të etruskishtes *avils maxs sealχs* (“në moshën prej dyzet e pesë (?) vjeç”). Mjafton të kihet parasysh kuptimi i *mav* dhe i *max*, që në gjuhën luvishite të Anatolit janë të krahasueshme me *maua* = katër (shih Steinbauer 1999, 439).

10. Lidhur me pellazgët është me interes të dihet me njëfarë sigurie edhe prejardhja dhe përhapja e tyre tokësore. Për sa i takon prejardhjes së tyre, po të pranohet karakteri i tyre indoeuropian, atëherë ata duhet ta kenë burimin nga ato treva, prej nga janë shpërngulur edhe tributë e tjera indoeuropiane, por një çështje e tillë i tejkalon synimet e këtij punimi. Ajo që vlen të ritheksohet, është se ata ndodheshin qysh më parë në viset ku erdhën e u vendosën tributë greke gjatë mijëvjeçarit të dytë para erës sonë, si edhe në të ashtuquajturin Epir. Edhe më shumë interes ka të sqarohet se në ç’ treva të tjera të Ballkanit ishin të përhapur ata. Por në këtë rast është me rëndësi të sqarohet edhe nëse para tyre në brigjet e Egjeut dhe të Jonit dhe gjetkë në Ballkan kanë pasë banuar popuj të tjerë paraindoeuropeanë.

Dhe po e nisim nga çështja e fundit. Siç u vu në dukje edhe më sipër, pozicioni gjeografik i Gadishullit Ballkanik, ku bëjnë pjesë edhe trevat greke, si edhe i ashtuquajturi Epir, nuk mund të kenë qenë të pabanuara para ardhjes së tribuve indoeuropiane, pra edhe para ardhjes së pellazgëve. E një gjë të tillë e kanë pranuar, dikush hapur e dikush heshturazi, edhe studiues të ndryshëm. Dhe, në të vërtetë, nuk mund të mendohet që, të paktën, një trevë e tillë si ajo e Ballkanit Jugor në afërsi të qytetërimeve të tilla si ai i Lindjes së Afërt dhe ai i Egjiptit përballë, të mos kenë tërhequr prej kohësh të hershme vëmendjen e ndonjë popullsie paraindoeuropiane, aq më tepër kur edhe vendosja e pellazgëve në Greqi mendohet të mos jetë shumë e hershme (shih van Windekens: 1952, f. 158) dhe, gjithsesi, ata nuk duhet të jenë vendosur në një truall të pabanuar nga një a disa popuj më të hershëm.

11. Por pyetjes se në ç’ treva kanë qenë përhapur pellazgët, është vështirë

t' i jepet një përgjigje e argumentuar bindshëm, aq më shumë sepse për këtë çështje ka pasur mendime të ndryshme, jo vetëm ndër studiuesit shqiptarë por edhe ndër të huajt. Dhe po e nisim me një nga këta të fundit dhe pikërisht me van Windekens-in, i cili në veprën e tij *Le Pélasgique*, faqe 154, duke u mbështetur edhe në ndonjë bashkëpërkim toponimik në Kretë dhe në Lacio, arrin në përfundimin: “Pra, pellazgjishtja ka pushtuar një hapësirë, që shtrihet prej pjesës perëndimore dhe jugperëndimore të Azisë së Vogël deri në veri të Italisë.” Kurse në faqe 155 ai shton: “Fakti që fjalori grek paraqit numrin më të madh të emrave pellazgjikë, që toponimet pellazgjike (etimologjikisht të interpretuara ose jo) janë më të shumta në krahinat greke sesa gjetkë dhe që antroponimet dhe emrat e perëndive pellazgë nuk gjenden veçse në greqishte, të bën të pranosh që dendësia e popullsisë që fliste pellazgjisht ishte më e madhe në Greqi.” Por pak më poshtë ai pohon: “Sikur ilirishtja të ishte ruajtur si greqishtja, ndoshta do të ishte konstatuar se ajo përmbante më shumë emra dhe më shumë toponime të burimit pellazgjik sesa greqishtja e kjo do të na kishte detyruar ta ndryshonim përfundimin tonë mbi dendësinë e popullsisë [pellazgjike - Sh. D.]. Sigurisht, është fjala për një hipotezë, por kjo duhet mbajtur parasysh.”

12. Dhe kështu erdhëm në diskutimin e problemit aq të rrahur sidomos gjatë shekujve të fundit ndër disa qarqe intelektuale jo vetëm shqiptare mbi lidhjen, a më saktë mbi prejardhjen e shqiptarëve nga pellazgët. Por duhet thënë që në fillim se ky problem është trajtuar jo duke u mbështetur në argumente konkrete historike dhe gjuhësore, por duke u nisur kryesisht nga paramendimi që shqiptarët janë një nga popujt më të vjetër të Ballkanit (në mos më i vjetri) dhe që ata janë pasardhësit e pellazgëve dhe, si rrjedhim, për të njohur gjuhën e pellazgëve, duhet nisur nga gjuha shqipe, e cila duhet konsideruar si një gjuhë e përftuar nga evolucioni i pellazgjishtes. Madje, siç do ta shtjellojmë më poshtë, gjatë shekujve të fundit nuk kanë munguar përpjekje për ta lidhur këtë problem edhe me atë të etruskishtes, gjithnjë duke u mbështetur edhe në të dhënat e shqipes. Por, para se t' i trajtojmë këto çështje, do të ndalemi edhe pak mbi popullsitë e lashta të Ballkanit në përgjithësi.

Siç u vu në dukje edhe më sipër, prania e një popullsie të lashtë

indoeuropiane, madje edhe paraindoeuropiane, duhet pranuar edhe për trevat e tjera të Ballkanit, të cilat në bazë të zbulimeve arkeologjike duhet të ketë qenë banuar, të paktën, qysh në periudhën e neolitit të hershëm (6000 vjet para erës sonë).¹¹

13. Por ç'popull a ç'popuj kanë qenë ata dhe ç'gjuhë flisnin, për këto edhe në këtë rast nuk mund të jepet një përgjigje e argumentuar. Gjithsesi, mund të supozohet se në një hapësirë të tillë gjeografike vështirë se mund të përfytyrohet një popullsi krejt homogjene për nga prejardhja, gjuha dhe traditat. Madje, mund të pohohet se edhe sikur ajo popullsi në krye të herës të ketë qenë homogjene për nga gjuha, kjo në rrjedhën e shekujve nuk mund të kishte mbetur e tillë, por do të ishte degëzuar në dialekte dhe më pas në gjuhë të veçanta. Prandaj, në përputhje edhe me synimet e këtij punimi, po e kufizojmë diskutimin në shqyrtim për trevat perëndimore të Gadishullit Ballkanik, ku jeton populli shqiptar me gjuhën e tij, që bën pjesë në familjen e gjuhëve indoeuropiane.

Edhe këto treva për arsye të pozitës gjeografike duhet të kenë qenë të banuara qysh shumë kohë përpara ardhjes së tribuve indoeuropiane, d.m.th. të stërgjyshërve të popullit shqiptar. Për popullimin e hershëm të këtyre trevave nga një popullsi paraindoeuropiane dëshmojnë, ndër të tjera, edhe disa zbulime arkeologjike, që kanë nxjerrë në dritë praninë e dikurshme të një vargu vendbanimesh si ato në *Maliq*, *Vashtëmi*, *Burimas*, *Podgorie*, *Barç* e *Dërsnik* të rrethit të Korçës, në *Kamnik* të Kolonjës, në *Blaz* e *Nezir* të Matit, në *Cakran* të Fierit, në *Burim*, *Gradec* e *Cetush* të Dibrës, në *Kolsh* të Kukësit, në *Rashtan* të Librazhdit etj.¹² Por në gjendjen e sotme të studimeve është shumë e vështirë të jepet një mendim i argumentuar mbi përkatësinë etnike-gjuhësore të popullsisë paraindoeuropiane të trevave perëndimore të Gadishullit Ballkanik. Në këtë rast, vështirësitë shtohen edhe më shumë se në rastin e popullsisë paraindoeuropiane të brigjeve të Egjeut, për

¹¹ Shih edhe § 2.

¹² Për më shumë hollësi shih Ceka-Korkuti: 1993, 33 v. Ata pohojnë (f. 29 v.) se në Shqipëri janë gjetur gjurmë jete njerëzore për periudha më të hershme.

arsye se njohuritë për gjuhën e stërgjyshërve indoeuropianë të shqiptarëve janë shumë të kufizuara, nga që prej gjuhës së tyre (ashtu si edhe prej gjuhëve indoeuropiane të Ballkanit Lindor) kemi në dispozicion një lëndë gjuhësore shumë të paktë.

14. Në këto rrethana, sytë duhen drejtuar nga gjuha shqipe për të hulumtuar se mos ka mbetur ndonjë relike nga ndonjë tip gjuhësor i ndryshëm prej tipit të gjuhëve indoeuropiane. Një mbeturinë e tillë prej burimi paraindoeuropean, sipas *Jokl-it* (shih *Çabej*: 1970, f.45), *Bariq-it* (1955, f.58) etj., duhet kërkuar në sistemin e numërimit, ku krahas sistemit të numërimit indoeuropean me *dhjetëshe*, si *tridhjetë*, *pesëdhjetë* etj., ndeshen edhe gjurmë të sistemit *vigesimal* (me *njëzetëshe*), si *njëzet*, *dy-zet* e tek arbëreshët e Greqisë e të Italisë edhe *tre-zet* (= 60) e *katër-zet* (= 80).¹³ Një sistem i tillë numërimi ndeshet edhe në gjuhën e baskëve,¹⁴ e cila është një gjuhë jo-indoeuropiane, që ka mundur t'i shpëtojë romanizimit. Gjithashtu, gjurmë të sistemit *vigesimal* ndeshen edhe në frëngjishte, si p.sh. *quatre-vingts* (= katër njëzetëshe), e në frëngjishten popullore ndeshen edhe gjurmë të tjera të këtij sistemi numërimi. Khs. edhe danezishten *tresindstyve* "60" (= tri herë njëzet), *firsindstyve* "80" (= katër herë njëzet) etj. (shih *B. Demiraj*: 1997/a, f.120 - me literaturë). Vlen të theksohet se shqipja është e vetmja gjuhë ballkanike, ku ndeshen numërorë të tillë: *dyzet*, *trezet*, *katërzet*¹⁵.

¹³ P.sh. te Matrënga (1592), folio 48: Shejti atë Papë Piu i pesëti dha-*katërzet* dit ndëljesë...; te Dara i Riu (në parathënien e veprës *Kënka e sprasëme e Balës*, f. 28):... pse e shkruamëja ngë sillej tjetër se *trizet* vjershe e të parës pjes...". *Katërzet* është shënuar edhe nga *Giordano* (1963, 185). Kurse Scutari (1997, 64 vv.) për të folmen arbëreshe të *San Constantino Albanese* jep: *dizet*, *trezet* (m.) dhe *trizet* (f.), *katërzet*, si edhe rreshtorët *i dizet-ï/e dizet-a*, *i trezet-ï/e trezet-a*, *i katërzet-ï/e katërzet-a*.

Edhe tek arbëreshët e Greqisë krahas *dizet* ndeshen *trezet* e *katërzet* si, edhe rreshtorët *i dizetëtë*, *i trezetëtë*, *i katërzetëtë* (shih Sasse: 1991, 136 v.).

¹⁴ Baskishtja flitet në vise të Spanjës Veriperëndimore dhe të Francës Jugore.

¹⁵ Etimologjia e fjalës *-zet* mbetet e errët. Shpjegimet e mëparshme që e bien të zhvilluar atë nga një trajtë më e hershme **dk̑it* etj., si edhe shpjegimi i *Çabejt* (1976/a, II. 318 v.), që e bie të ardhur nga një **ieuk-t*, nuk kanë gjetur mbështetje (shih *Huld*: 1984, 133 v.; *B. Demiraj*: 1997, f. 425; shih edhe *Demiraj*: 1996, f. 215).

15. Por çështja e pranisë së një popullsie paraindoeuropeane në viset e banuara nga shqiptarët nuk mund të ndriçohet më tej, të paktën sot për sot. E, po kështu, siç u vu në dukje edhe pak më sipër, edhe çështja e pellazgëve nuk është aspak e qartë, qoftë për përhapjen e tyre, qoftë për përkatësinë etnike - gjuhësore. Sipas autorëve të vjetër grekë, ata ishin një popull i vjetër me banim në treva të ndryshme të Greqisë, si edhe në Epir e Maqedoni. Për më tepër, edhe përkatësia e tyre indoeuropiane nuk është fort e argumentuar. Në këto rrethana, mund të pohohet vetëm se kur stërgjyshërit e shqiptarëve të sotëm erdhën e u vendosën në trevat perëndimore të Ballkanit, ata kanë gjetur aty me siguri edhe një popullsi më të vjetër, nga gjuha e të cilëve do të kenë mbijetuar disa mbreturina si ajo e sistemit të numërimit me *njëzetëshe*. Por në gjendjen e sotme të hulumtimeve nuk mund të thuhet asgjë me suguri se çfarë popullsie ka qenë ajo, mbi të cilën erdhën e u mbishtresuan stërgjyshërit e drejtpërdrejtë të shqiptarëve, një popullsi joindoeuropiane apo indoeuropiane e hershme me emrin *pellazgë*.

16. Gjithsesi, duke qenë se shqipja është një gjuhë indoeuropiane, stërgjyshërit e drejtpërdrejtë të shqiptarëve të sotëm duhen kërkuar tek ajo popullsi indoeuropiane, që erdhi e u vendos në Gadishullin Ballkanik në periudhën e dyndjes së tribuve indoeuropiane në këtë gadishull, natyrisht duke iu mbishtresuar një popullsie më të hershme indoeuropiane apo paraindoeuropiane. Por cilët kanë qenë stërgjyshërit e drejtpërdrejtë të shqiptarëve? Siç dihet, kësaj pyetjeje i janë dhënë përgjigje të ndryshme, që ne i kemi përmbledhur në veprën tonë *Prejardhja e shqiptarëve në dritën e dëshmimeve të gjuhës shqipe* (1999), e cila është botuar edhe anglisht më 2006 me titullin *The origin of the Albanians linguistically investigated*. Në atë vepër është parashtruar shkurt edhe hipoteza e paraqitur nga disa studiues shqiptarë dhe të huaj, sipas të cilëve stërgjyshërit e shqiptarëve kanë qenë pellazgët dhe si rrjedhim shqipja është zhvilluar nga evolucioni i gjuhës së pellazgëve. Prandaj në paragrafët ndjekës do të ndalemi pak më gjatë mbi këtë hipotezë, së cilës sidomos gjatë këtyre shekujve të fundit i kanë kushtuar vëmendje mjaft studiues. Ndër autorët, që i kanë kushtuar vëmendje të posaçme kësaj çështjeje, nuk mungojnë edhe studiues të huaj, si Hahn-i. Në f. 213 të vëllimit I të veprës së tij

Albanesische Studien Hahn-i vëren: "... duke qenë se shqiptarët nuk janë sllavë dhe nuk kanë afri me asnjë popull tjetër të njohur, duke qenë se burimet sigurisht të varfra, përveç atij të sllavëve nuk tregojnë ndonjë shtegtim tjetër që të ishte mjaft i rëndësishëm për të formuar një popull të madh, atëherë duhet pranuar që shqiptarët e sotëm janë pasardhësit e banorëve të lashtë parasllavë të vendit". Këta "banorë të lashtë parasllavë" ai i quan *pellazgë*, dhe këta ai i barazon me *ilirët*. Në f. 215 ai shënon: "4. Ilirisht = pellazgisht në kuptimin më të gjerë". Madje, ai (f. 224) shton se shqiptarët meritojnë të quhen "pellazgë të rinj". Ai shton po aty se "Epirotët, maqedonasit dhe ilirët ishin farefis". Në f. 219 ai pohon gjithashtu: "Në hulumtimin e mësipërm ne kemi arritur në përfundimin se epirotët dhe maqedonasit, të cilët ishin farefis midis tyre, duket se formojnë një degë të madhe të mëvetësishme të trungut ilir". Nga sa del prej shtjellimeve të mëtejshme të këtij autori, ai i mendonte këta popuj më të vjetër se grekët në Ballkan (shih *vep. e përmendur*, f. 224).

Një mendim të ngjashëm për origjinën pellazgjike të shqipes e kanë shprehur edhe disa autorë të tjerë të huaj, nga të cilët po përmendim sidomos francezin Robert d'Angely, i cili në vëllimin e parë të veprës së tij shtatëvëllimshe *L'énigme* (1962) është përpjekur të shpjegojë disa fjalë të pellazgjishtes me anë të shqipes, duke nënkuptuar kështu burimin pellazgjik të kësaj të fundit.¹⁶

Një hipotezë të tillë e ka përmendur edhe autori amerikan Edwin Jacques në librin e tij të vitit 1995 me titullin *The Albanians, an ethnic history from pre-historic times to the present*, përkthyer e botuar edhe shqip. Por ky autor për këtë problem vetëm përmend mendimet e disa autorëve të tjerë, kurse për gjuhën e pellazgëve mbështetet sidomos në veprën e van Windekens-it, *Le pélasgique*, për të cilën u dhanë disa shënime të përmbledhura këtu më sipër në § 8.

17. Hipoteza, sipas së cilës shqiptarët janë pasardhësit e pellazgëve të vjetër

¹⁶Nuk po ndalemi në shqyrtimin kritik të shpjegimeve të këtij autori tashmë të kapërcyera. Mjafton të përmendim konceptimin e tij themelor, sipas të cilit "... pellazgë, arianë, etruskë, shqiptarë etj., janë sinonime dhe shënjtojnë, në të vërtetë, të njëjtin element racial nën kualifikime të ndryshme..." (vëll. I, f. 5)

dhe, si rrjedhim, edhe gjuha shqipe është vazhdimi i evoluar i “pellazgjishtes”, ka gjetur përhapje sidomos ndër autorët arbëreshë dhe shqiptarë të shekujve të fundit. Ndër këta duhen përmendur sidomos Nikollë Keta nga arbëreshët e Italisë dhe Sami Frashëri. Një mendim i tillë është shprehur edhe nga autorë të tjerë arbëreshë¹⁷ dhe shqiptarë sidomos të shekullit XIX si *Naim Frashëri*, *Jani Vretoja* etj. Por, me sa duket, këta e kanë përdorur emrin “pellazg” me një kuptim të ngjashëm me atë të *Hahn-it* (shih § 16). Këtu, sa për ilustrim, po riprodhojmë shkurt vetëm mendimin e Nikollë Ketës dhe atë të Sami Frashërit.

Nikollë Keta (1742-1803) në veprën e tij dorëshkrim *Tesoro di notizie intorno all'origine dei Macedoni* ka shprehur mendimin se pellazgët ishin “stërgjyshërit e lashtë” të maqedonasve, të epirotëve dhe të shqiptarëve¹⁸

Edhe Sami Frashëri flet për *pellasgët* në kreun e parë të veprës së tij *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë* (1899). Aty ai, pasi pohon se prindërit tanë quheshin *arbënë/arbërë*, shton: “Më të vjetërtë prindërit tanë bota i quajnë *pelasgë*, fjal'e mbeturë nga prindrët tanë më të pastajmë, të cilët i quanin më të parët e tyre *Plak a Pleq...*”. Sipas Samiut, *pelasgët* a “shqiptarët e vjetër” ishin të përhapur në të gjithë Gadishullin Ballkanik e më tej në veri dhe në lindje, madje edhe në Itali. Kjo ide e *Samiut* mbi *pellazgët* ka qenë mjaft e përhapur në disa qarqe të së shkuarës.

18. Madje, ka edhe sot ithtarë të këtij mendimi ndër disa intelektualë shqiptarë. Mjafton të përmendim këtu, sa për shembull, Spiro Kondën, autorin e veprës *Shqiptarët dhe problemi pellazgjik* (1997), Dhimitër Pilikën, autorin e veprës *pellazgët - origjina jonë e mohuar* (2005) etj. Për më tepër, te disa autorë shqiptarë (dhe jo vetëm shqiptarë) bie në sy edhe prirja, apo më saktë mëtimi, për ta paraqitur shqipen si një gjuhë, nëpërmjet së cilës mund të shpjegohen edhe mjaft emra të lashtë vendesh të Ballkanit, si edhe të asaj pjese të Italisë, ku kanë pasë banuar

¹⁸ Shih Mandalà: 2003, 75v. - me sqarimet përkatëse. Siç shihet, ky autor, ashtu si edhe disa të tjerë, i mendonte *pellazgët* me një përhapje të gjerë.

¹⁷ Një mendim të tillë e gjejmë p.sh. tek *Giovanni Schirò* (1844), tek *De Rada (Divinazioni pelasgiche - 1840, Pelasgi ed Albanesi - 1820)*, te *Camarda* (1866, f. LIII) etj. (shih më hollësisht *Petrota* (1931, 6 vv.).

etruskët. Dhe ajo që të bën më shumë përshtypje në këtë rast, është se disa nga këta autorë kanë pasur një përgatitje filologjike të mirë dhe një kulturë të përgjithshme të gjerë, siç ishin helenisti Spiro Konda, apo dijetari Dhimitër Pilika. Madje, Spiro Konda është përpjekur të shpjegojë me anë të shqipes edhe mjaft emra të lashtë vendesh të Greqisë, duke përfshirë edhe emrin paragrek të *Athinës*, që ai (në f. 141) e shpjegon me anë të fjalës shqipe *than-a* (me nyjën shquese të prapme të gjinisë femërore /-a/), së cilës më vonë grekët i shtuan nyjën e tyre të përparme /A-/ , duke u sajuar kështu emri *Athana*, së cilës më vonë i shtuan përsëri nyjën e përparme greke. Shpjegime të tilla etimologjike të pasakta ka mjaft në veprën e Spiro Kondës. Natyrisht, ky autor nuk është as i pari, as i fundit që ka bërë orvatje të tilla, por po kufizohem tek ai, duke pasur parasysh që ai ishte një helenist i formuar dhe një njohës i mirë i literaturës klasike greke e latine. Për emrin e qytetit të *Athinës* në përgjithësi pranohet se është paragrek (shih van Windekens: 1952, 148),¹⁹ pra është i një kohe të lashtë, kur nuk ishin shfaqur ende as nyjat e prapme të shqipes dhe as nyjat e përparme të greqishtes. Veç kësaj, lidhja e emrit të atij qyteti të lashtë me emrin *thanë* të shqipes është e papërfytyrueshme, aq më tepër kur tingulli nistor /th-/ i fjalës së vjetër *thanë* të shqipes nuk ka qenë i tillë në krye të herës²⁰; edhe në greqishte të vjetër shkronja *theta* shqiptohej dikur si një mbylltore e aspiruar /tʰ/ (shih edhe shënimin ²²).

19. Edhe mjaft emra perëndish të grekëve të vjetër Spiro Konda dhe disa autorë të tjerë janë përpjekur t'i zbërthejnë me anë të gjuhës shqipe, që prej tyre konsiderohet si bijë e pellazgjishtes. Dhe për të mos mbetur në fushën e një vërejtjeje

¹⁹ Madje, ky autor e nxjerr emrin e këtij qyteti prej burimi pellazgjik, duke e lidhur me indoeuropianishten *at-, "një fjalë përkëdhelie që ndeshet në disa gjuhë indoeuropiane; krahaso latinisht *atta*, shqip *at*, greqisht *atta* dhe sllavishte e vjetër *отць*, që kanë kuptimin 'baba'; sanskritisht *atā* 'nënë, motra e madhe'. Dihet se në Elide 'Αθήνη merr epitetin Μήτηρ 'nënë'. Sipas tij, pellazgjishtja 'Αθήνη e ka burimin tek indoeuropianishtja *at(t)ā-n- (krahaso dorishten 'Αθάνα. Edhe ky shpjegim duket i diskutueshëm.

²⁰ Për etimologjinë e diskutueshme të kësaj fjale të shqipes shih Çabej; 2006, f. 141 v.

të përgjithshme, po ndalem shkurt në shpjegimin e dhënë prej Spiro Kondës për emrat e perëndive *Zeus*, *Dhmetra* dhe *Afërdita*.

Duke trajtuar etimologjinë e fjalës *Zeus*, S. Konda (1997, f. 285v.) shkruan: “Ne qëndrojmë në prejardhjen e fjalës *Zeus* nga De = Dhe, që është pellasgjike, duke u mbështetur në teorinë kozmogonike të pellasgëvet...” Dhe shton (f. 286): “Zhvillimi i fjalës *Zeus* është si vijon:

Tek akejtë: Deus = (ΔΕΥΣ).

Tek latinët Deu pater = Dejupiter = Jupiter.

Tek pellasgët: Deu, Dheu (shkrimi i sotëm shqip), Zeus.

Nga rasa gjindore dhe dhanore e fjalës shqipe Zeus (d.m.th. Zeut) erdhi trajta Zot....”

Pa dashur të hyjmë në hollësira rreth etimologjisë së diskutueshme të emrit *Zot*, për çka mund të shihet literatura përkatëse te B. Demiraj (1997, 431v.), këtu po shënojmë vetëm se forma rasore /-t/ e nyjës së prapme të shqipes së dokumentuar i takon një periudhe kohore shumë më të vonë se ajo kur duhet të jetë shfaqur fjala *Zot* në nënën e gjuhës shqipe dhe nuk ka asnjë lidhje me tingullin fundor të këtij emri. Gjithashtu do pasur parasysht se tingulli nistor te fjala *dhe* dhe te fjala *Zot* nuk mund të kenë pasur të njëjtin burim.

20. Përkundrazi, shpjegimi i emrit të perëndeshës *Demetr-a* nga një *Dēmētēr* (Δημήτηρ) në kuptimin “dheu nënë”, që jep Konda (f. 279v.), shpjegim që gjendet qysh te Hahn-i si edhe tek autorë të tjerë, është pranuar nga mjaft studiues (shih Çabej: 1996, 17v.). Sipas këtij të fundit emri Δημήτηρ Δαμάτηρ e bën të besueshme “praninë dikur të *dā ‘dheu’ në disa gjuhë të Ballkanit të epokës antike”. Por a jemi të sigurtë që elementi *dē* në këtë rast të ketë qenë me të vërtetë pellazgjik? Edhe po të pranohej një gjë e tillë, do të duhej sqaruar se si duhet të ketë tingëlluar në pellazgjishte nistorja /Δ-/ , si një bashkëtingëllore mbylltore /d-/ apo fërkimore /dh-²¹ dhe si duhet të ketë qenë kuptimi i mirëfilltë i elementit të parë të emrit të kësaj

²¹ Siç dihet, shkronja delta dikur në greqishte të vjetër shqiptohej si mbylltore e zëshme /d/ por në atë gjuhë ajo është shndërruar qysh herët në bashkëtingëllore fërkimore të zëshme /dh/ (shih Rix: 1976, f. 83).

perëndeshe. Gjithsesi, për lidhjen etimologjike të elementit të parë të emrit të kësaj perëndeshe me fjalën shqipe *dhé* duhen bërë hulumtime të mëtejshme të karakterit fonetik dhe leksikor. Për më tepër, elementi i dytë i këtij emri të dëshmuar në greqishte paraqitet në trajtën *mētēr*, së cilës në latinishte i përgjigjet trajta *māter* dhe në shqipe trajta *motër* (me kuptim të ndryshuar, por dikur në shqipen e lashtë a në para-shqipen duhet të ketë pasur kuptimin e ‘nënës’ si në gjuhët e tjera indoeuropiane). Pra, te kjo fjalë me burim indoeuropian zanorja e theksuar e rrokjes së parë në greqishte ka evoluar në /-ē-/ , ndërsa në shqipe ka evoluar në /-o-/ , në përputhje me rregullsitë e sistemeve fonetike të këtyre dy gjuhëve. Por si duhet të ketë tingëlluar ajo zanore e theksuar në pellazgjishte? Sipas rindërtimit të sistemit fonetik të pellazgjishtes, që ka bërë A. J. van Windekens-i (1952, f.6), zanoret e gjata indoeuropiane në pellazgjishte nuk kanë ndryshuar timbër dhe e kanë ruajtur gjatësinë, por natyrisht përfundimet e këtij studiuesi nuk janë të padiskutueshme. E kjo vërejtje vlen edhe për sa pohon ky autor për reflekset e zanoreve të shkurtra indoeuropiane në pellazgjishte. Sipas tij (f. 3vv.), edhe zanoret e shkurtra indoeuropiane në pellazgjishte nuk kanë ndryshuar timbër, me përjashtim të /o/-së së shkurtër që ka dhënë /a/ dhe të zanores së ashtuquajtur *schwa primum* /*ə/, që ka dhënë /a/.

Këtu është rasti të vihet në dukje se, po të jenë të sakta përfundimet e van Windekens-it për reflekset e zanoreve indoeuropiane në pellazgjishte, atëherë del se ajo gjuhë në këtë pikë ndryshon jo vetëm nga greqishtja, por edhe nga shqipja.

21. Dhe së fundi po ndalemi pak edhe në emrin e perëndeshës *Afërdita*, që jo vetëm Spiro Konda por edhe mjaft studiues të tjerë, para dhe pas tij, janë përpjekur ta shpjegojnë me anë të fjalëve shqipe *afër* dhe *ditë*. Madje, Spiro Konda (f. 297), i cili e përfshin emrin e kësaj perëndeshe ndër hyjnitë pellazge, pjesën e parë të emrit të saj (Afër-) e krahason me greqishten e vjetër *áfar*, “që do të thotë: menjëherë, në çast” dhe me shqipen *afër*. Kurse elementin e dytë (-dita) ai e lidh me fjalën e kretasve *dia*, së cilës, sipas tij, në shqipe i është shtuar një /-t-/ për analogji me *nat-a* (f. 298). Një shpjegim i tillë etimologjik është shkencërisht i pambështetur. Në radhë të parë, duhej saktësuar se si ka qenë shqiptuar ndër grekët e lashtë tingulli i dytë /-φ-/ i këtij emri, sepse në kohë të lashta ata e shqiptonin atë si

një mbylltore dybuzore të pazëshme të aspiruar /p^h/,²² kurse në greqishte të re ajo shqiptohet si një bashkëtingëllore fërkimore buzore-dhëmbore e pazëshme /-f-/. Por në këtë rast lind vetiu pyetja se si duhej të ishte shqiptuar kjo bashkëtingëllore e aspiruar në pellazgjishte. Sipas van Windekens-it (1952, f.19), për atë gjuhë dëshmohet vetëm një rast i një mbylltoreje të pazëshme të aspiruar indoeuropiane dhe pikërisht /*t^h/ te fjala *part^henos* “e virgjër, vajzë e re”, kurse mbylltoret e aspiruara indoeuropiane, sipas tij (f. 15v.), e kanë bjerrë aspirimin e në këtë pikë kemi të bëjmë me një dukuri të ngjashme me shqipen (shih Demiraj: 1996, f. 180v., me literaturën përkatëse). Por natyrisht edhe në këtë rast dyshimi mbi saktësinë e pohimit për pellazgjishten është gjithnjë i pranishëm. Për më tepër, do pasur parasysh se emrin e perëndeshës *Afrodita* ne e njohim nëpërmjet shkrimeve të vjetra greke e greqishtja e vjetër, siç u vu në dukje pak më sipër, ka pasur bashkëtingëllore mbylltore të aspiruara të pazëshme, që në greqishten e re kanë evoluar në fërkimore të pazëshme. Dihet gjithashtu se në huazimet e shqipes nga greqishtja e vjetër mbylltoret e pazëshme të aspiruara të asaj gjuhe janë reflektuar me mbylltore të pazëshme, siç na dëshmojnë, ndër të tjera, huazimet nga greqishtja e vjetër *mókēn(ē)/mókēr(ē) < mākh^hanā́, shkarpë < skorip^hos* etj. (shih Thumb: 1910).

Për emrin e perëndeshës *Afrodita* në shqipe nuk kemi dëshmi të hershme. Pasqyrimi i saj në trajtën *Afërdita* është relativisht i vonë dhe, siç u vu në dukje më sipër, i detyrohet një interpretimi popullarizues. Por fatmirësisht emrin e kësaj perëndeshe e gjejmë të dokumentuar në mbishkrimet e mesapishtes, e cila në përgjithësi mbahet si një dialekt ilirësh të shpërngulur në Italinë e Jugut gjatë shekujve të parë të mijëvjeçarit të fundit para erës së re. E te mesapët emri i kësaj perëndeshe del në trajtën (Ana-n) *Aprodita-n*, d.m.th. me një mbylltore të paaspiruar, ashtu siç do të kishte dalë në “nënë” e gjuhës shqipe (shih për këtë Demiraj në “*Studime filologjike*”, 3-4/2000, f..98v.). Prandaj, në rast se emri i kësaj perëndeshe do të kishte hyrë në gjuhën “nënë” të shqipes nga greqishtja e vjetër, ajo në shqipen e

²²Siç dihet, bashkëtingëlloret mbylltore të aspiruara të pazëshme/p^h, t^h/ të greqishtes së vjetër kanë evoluar prej kohësh në greqishte në fërkimoret e pazëshme/f, th/ (shih Schwyzer: 1959³, I, 207v.; Rix: 1976, 84v.)

sotme do të dilte me tingullin /-p-/ të përftuar nga /-p^h-/. Të kihet parasysh se gjuha “nënë” e shqipes, duke e gjykuar edhe nga mënyra se si i ka përshtatur mbylltoret e aspiruara të greqishtes së vjetër, duhet t’i ketë mënjanuar qysh herët këto bashkëtingëllore të aspiruara indoeuropiane (shih pak më sipër).

Por në këtë rast lind edhe pyetja nëse emri i kësaj perëndeshe ka qenë me të vërtetë në përdorim ndër stërgjyshërit e shqiptarëve dhe në ç’trajtë fonetike duhej të kishte kumbuar. Duke u mbështetur në praninë e kësaj perëndeshe te mesapët (me origjinë ilire), mund të pohohet se ajo duhet të ketë qenë e njohur ndër tributë e pjesës perëndimore të Gadishullit Ballkanik dhe, ashtu si te mesapët, duhet të jetë shqiptuar me /-p-/. Por për prejardhjen e saj nga grekët apo nga ndonjë burim tjetër është e vështirë të jepet një mendim i argumentuar. Gjithsesi, me përhapjen e hershme të krishtërit ndër shqiptarët, emrat e shumë perëndive pagane vështirë se mund të kenë mbetur në përdorim popullor. Veç kësaj, një perëndeshë e tillë e ngjashme, natyrisht me tjetër emër, ka qenë e njohur edhe ndër popuj të tjerë, si p.sh. ndër romakët (*Venus-i*), si edhe ndër popujt e Lindjes së Afërt. Por diskutimi i një çështjeje të tillë i kapërcen synimet e këtij punimi.

22. Në përfundim të këtyre shënimeve për emrat e disa perëndive të lashta, që ne i njohim kryesisht nëpërmjet dëshmive të grekëve të vjetër, por që disa studiues i paraqisin prej burimi pellazg, nuk është pa interes të shënohet se edhe emrat e disa perëndive kanë shtegtuar midis popujve fqinjë, të cilët natyrisht ia kanë përshtatur ata mentalitetit të tyre të kohës, duke u bërë edhe përshtatjet fonetike e gramatikore në përputhje me sistemet gjuhësore përkatëse.

23. Siç del edhe nga kjo paraqitje e përmbledhur, në shkrimet për lidhjet midis shqipes dhe gjuhës së ashtuquajtur pellazgjishte janë trajtuar një varg çështjesh të vështira dhe të pazgjdhura deri sot. Më duket e tepërt të përmend të gjitha shkrimet e botuara kohët e fundit për këtë çështje. E ky problem ndërlikohet edhe më tej, sepse disa autorë janë përpjekur të vërtetojnë që edhe *etruskët* kishin prejardhje pellazge, duke u orvatur kështu të sqarojnë një të panjohur me një tjetër edhe më të panjohur. Dhe në të vërtetë, ndërsa për etruskët dhe gjuhën e tyre diçka dihet, për pellazgët, siç u vu në dukje më sipër, vazhdon të mbizotërojë një errësirë

e plotë. Për më tepër, disa autorë janë përpjekur të deshifrojnë shkrimet e vjetra etruske dhe t'i shpjegojnë ato me anë të shqipes. Mjafton të përmendim këtu dietarin francez Zaharia Majani, autor i veprës *Fundi i misterit etrusk* (1973) dhe i disa veprave të tjera të këtij lloji, si edhe dietaren me origjinë shqiptare Nermin Falaschi Vlora, autore e veprës *Antiche civiltà mediterranee - Pelasghi- Iliri - Etruschi-Albanesi* (1984) dhe e disa punimeve të tjera kushtuar kësaj çështjeje. Por, që të kuptohen më mirë përfundimet e arritura nga këta autorë për lidhjet e mundshme midis shqipes dhe etruskishtes, është e nevojshme të thuhet nja dy fjalë për atë popull të lashtë të Italisë Qendrore, që njihet me emrin *etrusk*.

24. Për origjinën e etruskëve njohuritë tona, sot për sot, janë të kufizuara. Gjithsesi, në përgjithësi ka qenë shumë i përhapur mendimi, sipas të cilit etruskët kanë shtegtuar në Italinë qendrore (Etruri) rreth vitit 800 para erës së re dhe aty kanë themeluar disa qytete dhe kanë zhvilluar një qytetërim, që ka zgjatur disa shekuj, derisa u gllabëruan dhe u asimiluan nga romakët në shekullin I para erës së re. Por disa studiues të tjerë mendojnë se etruskët janë vendosur në Itali më herët. Gjithsesi, për vendin prej nga mund të jenë shpërngulur, nuk dihet asgjë me siguri, megjithëse në përgjithësi është menduar të kenë mërguar nga Azia e Vogël (ndoshta nga Lydia) për arsye sot për sot të panjohura. Një supozim i tillë, që e ka burimin te historiani grek Herodoti, është bërë objekt diskutimi dhe kritike. Këtu nuk është rasti të ndalemi gjatë në këtë çështje, për të cilën të interesuarit mund të shqyrtojnë përfundimet e arritura nga etruskologu i mirënjohur italian M. Pallottino në veprën e tij *La civilisation étrusque*, faqe 52-79. Ai aty paraqit qartë tri hipotezat e parashtruara deri sot për prejardhjen e etruskëve dhe pikërisht 1) prejardhjen orientale (egjeane ose nga Azia e Vogël), 2) prejardhjen nga viset veriore përtej Alpeve dhe 3) prejardhjen vendëse, duke parashtruar edhe vërejtjet përkatëse për secilën hipotezë. Gjithsesi, ai anon nga mendimi se etnosi etrusk, pavarësisht nga prejardhja e të parëve të tij, është formuar në Gadishullin Italik, ku ka pësuar edhe ndikime nga Orienti, si rrjedhim i marrëdhënieve me popujt e Lindjes dhe me grekët (f. 79).

25. Edhe për gjuhën e etruskëve sot për sot nuk mund të thuhet asgjë e sigurt, megjithëse ata kanë lënë një varg mbishkrimesh në përgjithësi të shkurtra, të

shkruara me një alfabet pjesërisht të ngjashëm me alfabetin grek. Me përpjekjet e një vargu dijetarësh ato mbishkrime janë bërë të lexueshme, por ose përmbajnë vetëm emra të përveçëm (mbishkrime varresh) ose, kur janë pak a shumë të gjata, paraqiten të vështira për t'u deshifruar, sepse në mjaft raste janë shkruar pa u ndarë fjalët njëra nga tjetra (*scriptum continuum*), ose edhe kur janë veçuar e lexuar fjalët, kuptimi i një pjese të mirë të tyre nuk ka qenë e mundur të zërthehet. Si rrjedhim, nuk mund të pohohet me siguri të plotë se në ç'familje gjuhësore bënte pjesë etruskishtja, megjithëse disa dijetarë mendojnë se ajo nuk ka qenë një gjuhë indoeuropiane²³, siç janë shqipja, greqishtja, latinishtja, gjuhët gjermanike, sllave, armenishtja etj. Por disa autorë të tjerë mendojnë se ajo ka qenë një gjuhë indoeuropiane. Nga ky mendim duket se anon, p.sh., Steinbauer-i (1999, 366vv.), i cili vë në dukje disa bashkëpërkime midis etruskishtes dhe gjuhëve anatolike, si lydishtja, hetitishtja etj. Gjithsesi, nga materiali i deshifruar deri sot bien në sy edhe pika takimi edhe pika ndryshimi midis etruskishtes dhe gjuhëve të njohura indoeuropiane. Nga pikat e ndryshimit mund të përmenden, ndër të tjera: 1. Mungesa e zanoreve të gjata; 2. mungesa e dallimit midis formave të rasave emërore dhe kallëzore; 3. mungesa e dallimit midis gjinive të emrave (mashkullorë, femërorë dhe asnjans) dhe prania e një dallimi dy klasash të emrave (shih Steinbauer: 1999, 183v.), i cili shpreh rezerva për mungesën e kategorisë së gjinisë në etruskishte, duke vënë në dukje dallimin midis emrave të klasës *-ca* dhe atyre të klasës *-ta*. 4. Ndryshime të dukshme në sistemin e zgjedhimit të foljeve, por për këtë dukuri nuk ka informata të mjaftueshme, sepse në mbishkrimet e varreve del kryesisht koha e shkuar, çka është e kuptueshme në mbishkrime të tilla (shih për të gjitha këto Steinbauer: 1999 *passim*). Gjithsesi, duke u mbështetur në ato pak fjalë, që janë lexuar e shpjeguar me siguri, mund të anohet më fort nga mendimi i parë. Kështu p.sh. për disa emra kryesorë të pjesëtarëve të familjes në etruskishte dëshmohen fjalë, që nuk ndeshen në asnjë gjuhë indoeuropiane, si *klan* 'bir', *sek*, *sek^h* 'bijë',

²³ Kështu p.sh. e kanë konsideruar etruskishten si gjuhë joindoeuropiane, ndër të tjerë, edhe Pallottino (1949, 35) dhe Vineis në kapitullin *Le lingue italiche* të veprës *Le lingue indoeuropee* të botuar më 1994 nga Anna Giacalone Ramat dhe Paolo Ramat, f. 350.

pui, *puia* 'nuse', *prumat^hs* 'stërnip', *lautn*, *lavtn* 'familje, gjini' etj. Po kështu edhe nga fusha të tjera janë zberthyer disa fjalë, që ndryshojnë nga fjalët gjegjëse të gjuhëve indoeuropiane. Mjafton të përmendim numërorët themërorë *t^hu* = një, *zal* = dy, *ki* = tre, *sa* = katër, *mak^h* = pesë, *hut^h* = gjashtë (shih Pallottino: 1949, 238v.). Për më shumë të dhëna rreth fjalëve etruske të deshifruara shih veprën e përmendur të Pallottino-s, f.246-249, si edhe Steinbauer-in: 1999, f.391-503.

26. Siç dihet, nuk kanë munguar orvatje për t' i deshifruar disa mbishkrime etruske me anë të gjuhës shqipe, duke i ndarë fjalët përbërëse të atyre mbishkrimeve sipas dëshirës në mënyrë që të mund të shpjegoheshin me anë të shqipes. Ata që kanë bërë orvatje të tilla, në përgjithësi kanë qenë të mendimit se etruskishtja ishte një gjuhë pellazgjike dhe kishte lidhje me shqipen. Por në këtë rast ata nuk kanë mbajtur parasysh, të paktën në vija të trasha, trajtën fonetike që duhet të kenë pasur fjalët shqipe, që janë parashtruar për krahasim, në kohën e etruskëve, d.m.th. para më shumë se dy mijë vjetësh, sepse, siç dihet, sistemi fonetik i shqipes, ashtu si sistemi fonetik i çdo gjuhe tjetër, ka pësuar ndryshime të mëdha gjatë shekujve. Një të metë të tillë nuk i kanë shpëtuar disa autorë, edhe kur janë përpjekur të lidhin emrin e krahinës së Toskanës, të banuar nga etruskët a *tuskët*, me emrin e *toskë-ve* të Shqipërisë së Jugut, duke mos mbajtur parasysh, të paktën, se grupi bashkëtingëllor /-sk-/ tek emri *toskë* nuk mund të jetë shumë i vjetër, sepse, përndryshe, do të kishte evoluar në /-shk-/ , siç ka ndodhur, ndër të tjera, me emrin e Shkodrës < *Scodra*, ose në huazimet latine *shkamb/shkëmb* < *scamnum*, *eshkë* < *esca* etj.²⁴ Të kihen parasysh edhe dallimet e tjera të shumta midis etruskishtes dhe shqipes. Kurse, nga ana tjetër, siç do të vihet në dukje në Kreun VIII § 8, midis mesapishtes dhe shqipes ka mjaft bashkëpërkime, megjithëse edhe mesapët kanë shtegtuar në Italinë Juglindore qysh nga fillimi i mijëvjeçarit të fundit para erës së re. Mjafton të kihet parasysh, ndër të tjera, se për fjalët *bir* dhe *bijë* < *bilë* mesapishtja ka gjithashtu trajta të ngjashme *bili/bilio* dhe *bilia*, kurse etruskishtja ka *klan* 'bir', *šek*, *sek^h* 'bijë'.

²⁴ Gjithashtu, rindërtimi *Tosk* < *Tosk-a* < *Toska* + *n* < *Tok(s)* *an* < *Tokan* < *Toka* < *Tok* që bën Konda në veprën e tij (f. 250), nuk ka asnjë mbështetje historike-gjuhësore.

27. Vërejtja e fundit është e mjaftueshme për t' u bindur se çdo krahasim midis shqipes së sotme dhe çdo fjale të një gjuhe tjetër të lashtë nuk mund të jetë shkencërisht i mbështetur, në qoftë se nuk mbahen parasysh rregullsitë e evolucionit të sistemit fonetik të gjuhës shqipe. Por, për t' u bindur edhe më shumë për pasaktësinë e rrugës së ndjekur nga disa studiues në orvatjet e tyre për ta deshifruar etruskishten me anë të shqipes, po riprodhojmë nja dy fragmente nga veprat e Z. Majanit dhe të Nermin Falaskit:

Nga Majani (1973, f. 222): **Zivas cerixu tesamsa** (fjalën e fundit e ndan në *tesam sa*), që ai e shpjegon me shqipen: “jetën [që e] deshi aq shumë...”. Ai shton: “Fragmenti i mësipërm, pra, ka këtë kuptim: “jetën e tij që kaq shumë e desh, (duke qenë) e prerë (ai zbriti në varrin e të parëve të tij).” Nuk është e vështirë të vihet re se në këtë fragment nuk ka asnjë element që mund të dëshmojë për ndonjë lidhje gjuhësore midis etruskishtes dhe shqipes, për sa u takon fjalëve të veçanta si, edhe treguesve gramatikorë. Mjafton të kihet parasysh qoftë edhe vetëm mungesa e mbaresës së rasës kallëzore tek emri *zivas*, që sipas Majanit ka kuptimin “jetë-n”. Le të krahasohet kjo me shembullin *Ana-n Aprodita-n* të mesapëve, që u përmend pak më sipër (§ 21).

Po riprodhojmë edhe nja dy shembuj nga Falaski (1984, 21): etruskisht: **LA FISI FARI LA**. Shqip: *La fisi fari la* (d.m.th. *La fisin, la farën* (tribunë)). Etruskisht: **LAN VETIN LANE URIA**. Shqip: *Lan vetin lane uria* (d.m.th. *Lanë veten, lanë urinë*). Për pasaktësinë e këtyre deshifimeve mjafton të kihet parasysh qoftë edhe vetëm fjala e fundit, *Uria* e toskërishtes me rotacizmin e saj, që është një dukuri dialektore jo aq e hershme, dhe me nyjën e prapme */-a/* të rasës emërore, që gjithashtu është një zhvillim i brendshëm jo fort i hershëm i shqipes.

Në këto rrethana, nuk po ndalem më gjatë në përpjekjet e bëra deri sot për të vendosur lidhje burimore midis etruskishtes dhe shqipes, aq më shumë kur etruskishtja nuk është përfshirë në qerthullin e hulumtimeve të mia kërkimore. Gjithsesi, edhe përpjekjet për t' i lidhur etruskët me pellazgët më duken, të paktën, të paargumentuara bindshëm, megjithëse, siç u vu në dukje më sipër, etruskologët kanë gjetur pika takimi midis etruskishtes dhe gjuhës së mbishkrimit të ishullit të

Lemnos, të banuar dikur nga pellazgë (shih § 9).

28. Duke përfunduar këtë punim kushtuar kryesisht problemit pellazgjik, mund të ritheksohet:

1. Ky problem, që ka tërhequr vëmendjen e një vargu studiuesish të huaj dhe shqiptarë, vazhdon të mbetet i pazgjidhur përfundimisht jo vetëm për mungesë të dhënash të sigurta për gjuhën dhe përhapjen e pellazgëve, por edhe për arsye të ndërlikimeve të tij të mëtejshme me probleme të tjera, siç janë lidhjet e mundshme midis pellazgëve dhe etruskëve dhe etnogjeneza e shqiptarëve.

2. Ndër çështjet e pandriçuara në mënyrë të argumentuar janë edhe ato që kanë të bëjnë me shtrirjen gjeografike të pellazgëve dhe me gjuhën e tyre. Një pjesë e mirë studiuesish janë të mendimit që pellazgët ishin një popull indoeuropian i vendosur në Ballkan para ardhjes së tribuve të tjera indoeuropiane, përfshirë këtu edhe tributë e para greke. Madje, disa studiues kanë shprehur mendimin se ata ishin vendosur edhe në disa ishuj të Egjeut dhe në disa vise të bregdetit egjean të Anadollit, si edhe në Itali (etruskët). Një mendim i tillë jo vetëm që mbetet i paargumentuar, por, edhe sikur të pranohej pa asnjë rezervë, do të dilte i diskutueshëm, sepse një popullsi me një përhapje gjeografike kaq të gjerë, nuk do të kishte mundur të mbetej e padiferencuar etnikisht dhe gjuhësisht në rrymë të kohës. Të kihet parasysh se trevat e lartpërmendura, nga vetë pozicioni i tyre gjeografik, duhet të kenë qenë të populluara qysh shumë kohë para ardhjes së të ashtuquajturve pellazgë, të cilët nuk mund të mbeteshin të pandikuar edhe gjuhësisht prej popujve paraardhës. Gjithsesi, më i dokumentuar del mendimi i përhapjes së pellazgëve në trevat e banuara nga grekët e vjetër, si edhe në Epir, ku mendohet se ata themeluan edhe tempullin e Dodonës me orakullin e tij të famshëm paragrek. Por kjo nuk do të thotë që fise pellazge të mos kenë qenë përhapur edhe në vise të tjera të banuara nga shqiptarët e sotëm.

3. Për sa i takon gjuhës së pellazgëve, disa studiues kanë mbrojtur tezën që ajo ka qenë një gjuhë indoeuropiane, por e ndryshme nga greqishtja, të paktën në sistemin fonologjik. Gjithsesi, mungesa e dokumenteve të shkruara nuk lejon që të bëhet një rindërtim pak a shumë i argumentuar i sistemit fonologjik dhe gramatikor si, edhe i fjalorit të gjuhës së pellazgëve.

4. Në këto rrethana, nuk dalin të mbështetura në argumente përpjekjet e bëra sidomos gjatë shekujve të fundit, për ta konsideruar gjuhën shqipe si bijë të pellazgjishtes. Të tilla përpjekje, që pjesërisht e kanë burimin edhe te një supozim i Hahn-it, i cili në një vend të veprës së tij e ka barazuar pellazgjishten me ilirishten, duhej të ndriçonin më parë nëse fise pellazge kanë pasë banuar dikur edhe në trevat, ku historikisht dëshmohen fise shqiptarësh dhe ku dikur kanë pasë banuar fise ilire. Barazimi pellazg-ilir nuk del i argumentuar as historikisht, as gjuhësisht. Për më tepër, tashmë është e qartë se etnosi shqiptar a arbëresh, siç quhej dikur, është formëzuar herët në brigjet lindore të Adriatikut dhe të Jonit, për çka dëshmojnë, ndër të tjera, huazimet nga greqishtja e vjetër dhe nga latinishtja në gjuhën shqipe (shih Demiraj: 1999, f. 122-128 me literaturën përkatëse). Gjithsesi, edhe po të pranohej prejardhja e shqiptarëve nga pellazgët, duhej sqaruar se kur mund të jenë mbishtresuar tributë ilire mbi fiset e mëparshme pellazge dhe çfarë gjurmësh mund të kenë lënë këto të fundit në gjuhën shqipe.

5. Përpjekjet e disa studiuesve të huaj dhe shqiptarë për t' i lidhur etnikisht dhe gjuhësisht etruskët me pellazgët, nuk kanë arritur ta argumentojnë një hipotezë të tillë, aq më shumë kur një pjesë e mirë etruskologësh kanë arritur në përfundimin që etruskishtja nuk ishte një gjuhë indoeuropiane, kurse për pellazgjishten anohet më fort për karakterin e saj indoeuropian. Gjithsesi, orvatjet e disa studiuesve për ta shpjeguar gjuhën e etruskëve me anë të shqipes, nuk e kapërcejnë pragun e fantazisë së thjeshtë, çka del jashtë hulumtimit shkencor të mirëfilltë.

6. Çështja e përmendur në pikën 5 ndërlikohet më tej nga të dhënat gjuhësore, që janë nxjerrë nga analiza e gjuhës së mbishkrimit të Lemnos, ku vihen re disa bashkëpërkime me gjuhën e etruskëve. Por kjo çështje kërkon hulumtime të mëtejshme.

Kreu i dytë

Gjuha amtare e banorëve të të ashtuquajturit *Epir* gjatë shekujve

I. Hyrje²⁵

1. Emri *Epir*, siç dihet, qysh nga lashtësia, është përdorur për të emërtuar atë trevë e cila në kuptimin më të ngushtë, shtrihej që nga Saranda deri në Gjirin e Artës (Ambrakias) (shih Métais: 2005, f.109), por në një kuptim më të gjerë Epiri shtrihej më në veri deri te Malet e Vetëtimës (Llogara a Gadishulli i Karaburunit) (shih Islami: 1992, f.5; Hammond: 1997, f.12v.). Kurse në lindje “kufirin e asaj treve me Maqedoninë dhe Thesalinë e shënonin malet e Pindit.” (shih Métais: 2005, f.5). Për sa i takon kufirin jugor të Epirit në lashtësi, në përgjithësi është pohuar që caku më jugor i tij ishte bregu i sipërm i Gjirit të Ambrakias. E për këtë dëshmon qartë edhe gjeografi grek Straboni, i cili ka jetuar në kapërcyell të erës së re. Në veprën e tij *Geografia* (Libri 7) ai pohon: “Më poshtë vjen gryka e Gjirit të Ambrakisë; gryka e këtij gjiri është pak më e madhe se katër stade, ndërsa rrethi i tij arrin deri në treqind stade dhe i gjithi ka limane të mira. Kur lundron [në të], më të djathtë banojnë akamanët, fis grek Nga ana e majtë ndodhen Nikopoli dhe një fis epirotësh, kasiopët, që shtrihen deri në Gjirin e Ambrakisë...” (shih Straboni: 1549, f.314v.; shih edhe *Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë*, f.159).

Në trevën e Epirit, sipas Strabonit, banonin katërmëdhjetë fise, si *kaonët*, *molosët*, *thesprotët*, *amfilokët*, *atintanët* etj.

²⁵ Ideja për të shkruar këtë punim më lindi, pasi rilexova përgjigjen që Jani Vretoja i dha në vitin 1878 një “epirotasi” grek të Janinës (shih: Sevdai Kastrati, *Lufta e penave*. Tiranë 2002, faqe 97-118). Pra, ky punim është shkruar edhe për të nderuar kujtimin e atij atdhetari të ndritur të Rilindjes sonë Kombëtare.

Në një kuptim edhe më të gjerë emri *Epir* nga disa qarqe greke gjatë shekujve të fundit është përdorur për të gjithë Shqipërinë Jugore deri në Shkumbin. Madje, në ndarjen administrative të perandorit romak Dioklecian të fundit të shekullit III të erës së re është përdorur edhe termi *Epiri i Ri*, që përfshinte krahinat midis Vjosës dhe Matit (shih Islami: 1992, f.6). Emërtimi i fundit lidhet me ndarjet administrative të herëpashershme të Perandorisë Romake. Të kihet parasysh se viset e Shqipërisë së Mesme në një nga ndarjet administrative të asaj perandorie përfshiheshin në Provincën e Maqedonisë. Prandaj në të dyja rastet kemi të bëjmë me ndarje administrative të Perandorisë Romake, por kjo nuk do të thotë se të gjithë banorët në ato ndarje administrative atëherë e quanin veten *epirotë*, përkatësisht *maqedonas*.

Për më tepër, në mesjetë në disa qarqe europiane emri *epirot-ë* është përdorur edhe për të emërtuar arbëreshët a shqiptarët në përgjithësi, por ata atëherë zakonisht njiheshin me emrin *arbanese* a *albanese*, që e ka burimin tek emri i fisit ilir të *arbanëve* a *albanëve* të Shqipërisë së Mesme, që e përmend edhe Ptolemeu në shekullin II të erës sonë. E një përdorim të tillë të emrit Epir e gjejmë edhe te Barleci dhe Frang Bardhi. Kështu, Barleci Gjergj Kastriotin - Skënderbeun e quan "princ i epirotëve". Edhe Frang Bardhi fjalorin e tij latinisht-shqip të vitit 1635 e titullon "Diksioner latinisht-epirotisht".²⁶ Gjithashtu në *Apologjinë* e tij për Skënderbeun të vitit 1636²⁷ Frang Bardhi e quan atë "epirot" ose "princ i epirotëve". Përdorimi i emrit *epirot* nga Bardhi mund të shpjegohet me ndikimin e veprës së Barlecit, por për Barlecin nuk dimë me saktësi se nga mund të jetë ndikuar në përdorimin e kësaj fjale, megjithëse mund të mendohet që ai për këtë duhet të jetë ndikuar nga ndarja

²⁶ Për Barlecin Skënderbeu ishte Princeps *Epirotarum*. Po kështu Frang Bardhi Fjalorin e tij latinisht-shqip të vitit 1635 e emërton "Dictionarium Latino - Epiroticum".

²⁷ Ja titulli i kësaj vepre latinisht të Bardhit: *Georgius Castriotes, vulgo Scanderbeg, Epirotarum princeps fortissimus ac invincitimus*. Siç dihet, këtë vepër, që është një traktat shkencor i mirëfilltë, Frang Bardhi e shkroi për të mbrojtur prejardhjen shqiptare a arbëreshe të Skënderbeut, duke hedhur poshtë me argumente përpjekjet e një peshkopi boshnjak bashkëkohës me emrin Joan Tomku, për ta nxjerrë familjen e Kastriotëve me prejardhje boshnjake.

administrative romake që u përmend pak më sipër. Gjithsesi, mund të pohohet se fjalët *Epir* dhe *epirot* në shekujt e Barlecit dhe të Bardhit nuk kanë qenë përdorur nga popullsia shqiptare a arbëreshe. Për këtë mjafton të përmendim këtu faktin që arbëreshët e Italisë, të mërguar pas vdekjes së Skënderbeut, nuk i njohin këto fjalë. Edhe arbëreshët e Greqisë nuk e kanë quajtur veten *epirotë*, por *arbëreshë* e në kohë më të vona, nën ndikimin e grekëve, ata kanë përdorur trajtën *arvanit* (me ndryshimin e njohur /b/ > /v/ të greqishtes: **Arban-itis* > *Arvan-itis*). Të kihet parasysh gjithashtu se fjalët *Epir* dhe *epirot* nuk ndeshen as në veprën e Buzukut, as në veprat e Budit e të Bogdanit e të Kazazit dhe as në vendimet e Kuvendit të Arbënit të vitit 1705.

2. Emri *Epir* e ka burimin te fjala greke *Épeiros* “tokë (kontinentale)” (anglisht “mainland”) në kundërvënie me ishullin a ishujt përballë. Ky emërtim është përdorur nga grekët për ta dalluar këtë trevë nga ishujt përballë e sidomos nga ishulli i Korfuzit²⁸. Termi *Epir* është përdorur nga grekët qysh disa shekuj para erës sonë, si p.sh. nga Tukididi i shekullit V para erës sonë (shih Katiçiq-in: 1976, f.120). Por ne nuk dimë se si e quanin veten dhe vendin e tyre në lashtësi banorët e të ashtuquajturit *Epir* (në kuptimin e mirëfilltë). Në histori flitet për një *Lidhje të epirotëve* (232-168 para erës së re) (shih Islami: 1992, 5v. - me vërejtjet përkatëse), por ky emërtim, pas gjithë gjasash, i detyrohet ndikimit të kulturës dhe të gjuhës greke mbi drejtuesit politikë të kohës dhe nuk mund të merret si një dëshmi që banorët jogrekë të kësaj treve atëherë (ose edhe më vonë) ta kenë quajtur veten *epirotë*. Në kohët e njohura historike banorët shqipfolës të kësaj treve e quajnë veten, sipas viseve të tyre, përkatësisht *çamë*, *labë* a *arbëreshë* dhe *toskë*, kurse viset përkatëse ata i quajnë përkatësisht *Çamëri*, *Labëri* dhe *Toskëri*²⁹. Nuk ka

²⁸ Sipas Métais: 2005, 109, “ka pasur edhe rajone të tjera përballë ishujsh, që janë quajtur gjithashtu *Epeiros*, sidomos Azia e Vogël”. Por në rastin tonë është fjala për Epirin e Ballkanit Jugperëndimor.

²⁹ Siç dihet, *labë* a *leb-ër* quhen banorët në perëndim të lumit Vjosa, kurse *toskë* të mirëfilltë janë banorët në lindje të atij lumi. Por me kalimin e kohës emërtimet *toskë* dhe *Toskëri* janë përdorur edhe për të gjithë shqiptarët në jug të Shkumbinit, duke përfshirë edhe *lebërit*.

asnjë dëshmi që emërtimet *Epir* dhe *epirot* të jenë përdorur nga banorët shqipfolës të këtyre viseve në marrëdhëniet e tyre të përditshme. Natyrisht, në disa qarqe të shkolluara emërtimi *Epir* nuk ka qenë i panjohur, siç na dëshmojnë letra drejtuar Papës Gregori XIII më 1577 prej disa përfaqësuesve "nga Himara, d.m.th. nga *Epiri i shqiptarëve*" (shih Nilo Borgia: 1935, f.13), si edhe letra drejtuar careshës Elizabeta Petrovna të Rusisë në vitin 1759 nga përfaqësuesit e krahinës së *Himarës së Epirit* (shih *Buletin për Shkencat Shoqërore* II/1955, f. 159).

3. Termat *Epir* dhe *epirot* janë shfaqur në një periudhë të caktuar historike, megjithëse nuk mund të thuhet asgjë me siguri se nga cili shekull para erës së re kanë nisur të përdoren këto emërtime ndër grekët e vjetër. Por mund të pohohet se në botën greke emërtimi *Epir* duhet të jetë shfaqur jo më vonë se shekulli V para erës së re, kur dëshmohet te Tukididi. Sipas Hammond-it (1967, f.461), "Duket e mundshme që asnjë shkrimtar grek i shekullit V nuk e ka përdorur termin "epirotë" për popujt e zonës së përcaktuar nga Straboni dhe se ata popuj nuk e kanë quajtur veten kështu deri vonë në shekullin IV". Gjithsesi, një gjë është e sigurt dhe pikërisht që ajo zonë me pozicionin e saj afër brigjeve të Jonit dhe afër Mesdheut duhet të ketë qenë e banuar qysh në periudha të hershme parahistorike dhe duhet të ketë pasur edhe emërtimin përkatës si nga banorët vendas, ashtu edhe nga popujt fqinjë. Sipas Hammond-it (1967, f.394), "thuhet se emri i mëparshëm i Epirit ka qenë *Aesa*". Por autori nuk e jep burimin e këtij njoftimi dhe nuk sqaron më tej se sa dhe deri kur është përdorur ky emërtim. Gjithashtu mund të pohohet se zona e Epirit, falë pozicionit të saj gjeografik, ka shërbyer edhe si urë kalimi tribush të ndryshme për në viset mesdhetare dhe në ishujt e Greqisë. Madje, në përgjithësi pranohet që edhe tributë greke, sidomos ato të dorasve, para se të vendoseshin në viset e banuara nga grekët e lashtë, kanë kaluar nëpër viset e të ashtuquajturit *Epir*, ku edhe duhet të kenë qëndruar për njëfarë kohe (shih Hammond-it: 1967, 369vv. dhe 1997, 40vv.). Madje, po ky autor (1997, f.36) shpreh mendimin se tributë e para greqishtfolëse gjatë dyndjeve të tyre drejt viseve të tyre të sotme pranë detit Egje për njëfarë kohe janë ndalur edhe në Shqipërinë Qendrore etj. Pasi thotë se ato arritën në Epirin Verior në periudhën midis vjetëve 1900 -1600 para erës së re, ai

shton: “Por baseni i popujve greqishtfolës, prej të cilit u kryen ky dhe invazione të tjera, ishte Maqedonia Perëndimore, Shqipëria Qendrore dhe Epiri Verior. Pikërisht atje, me një ekonomi kryesisht blegtorale, në periudhën e mesme helladike praktikoheshin institucionet patriarkale dhe fisnore të popullit grek, dialektet e tyre dhe ritet e tyre, duke përfshirë edhe varrimin e herojve në tuma...” Natyrisht, atje ata kanë gjetur një popullsi paragreke, për çka dëshmon, ndër të tjera, edhe tempulli paragrek i Dodonës, që grekët e vjetër e bënë të tyrin, duke vendosur edhe greqishten si gjuhë të orakullit të famshëm të atij tempulli (shih Kreun I, § 1). Por, duke qenë se synimi i këtij kapitulli është të trajtojë çështjen e gjuhës amtare të popullsisë së të ashtuquajturit *Epir* gjatë periudhës së njohur historike të lashtësisë dhe të mesjetës, këtu nuk do të ndalemi në çështjen e rrugës dhe të ndalesave të ndërmjetme të tribuve greqishtfolëse gjatë dyndjeve të tyre drejt trevave të sotme në brigjet e detit Egje dhe as në çështje që kanë të bëjnë me gjuhën a gjuhët e popujve paraindoeuropeanë, që kanë pasë banuar në këto treva. Nuk do të ndalemi as në çështjen e të ashtuquajturve pellazgë, që është trajtuar si temë më vete në Kreun I të këtij libri.

II. Gjuha amtare e të ashtuquajturit Epir në lashtësi

4. Por ç’gjuhë flisnin banorët e të ashtuquajturit *Epir* në lashtësi? Në këtë rast është fjala për periudhën, kur zona e Epirit erdhi e u indoeuropianizua me dyndjen e tribuve indoeuropiane, që asimiluan dalngadalë edhe popullsinë paraindoeuropiane që banonte atje. Mungesa e dëshmive të shkruara në këtë rast (dhe jo vetëm në këtë rast³⁰) u ka lënë shteg edhe hamendjeve dhe spekulimeve të nxitura, ndonjëherë, nga arsye jashtëshkencore. Si rrjedhim, në këtë rast janë shprehur mendime të

³⁰ Një problem i ngjashëm është shfaqur edhe për gjuhën e maqedonasve të lashtë, që flitej në rrjedhën e poshtme të lumit Vardar në veri të malit Olimp, në lindje të malit Gramoz dhe të liqenit të Ohrit. Sipas disa studiuseve, maqedonishtja e vjetër ka qenë një gjuhë e veçantë, kurse disa të tjerë mendojnë se ajo ka qenë një degëzim i greqishtes (shih më hollësisht për këtë Demiraj: 2004. 51 v. - me literaturën përkatëse).

ndryshme. Kështu p.sh. disa albanologë të huaj dhe shqiptarë si Hahn-i (1854, 216 v.), Kretschmer-i (1896, 254 v.), Nilson-i³¹, Çabej³², Métais-i (2005, f.118) etj. kanë arritur në përfundimin që fiset "epirote" flisnin një gjuhë të ndryshme nga greqishtja, pra ishin një popullsi jogreke. Madje, disa prej tyre kanë mbrojtur tezën që ata kanë folur një gjuhë të njëjtë ose të afërt me gjuhën që flisnin në lashtësi stërgjyshërit e shqiptarëve që, sipas tyre, kanë qenë ilirët.

Kurse për disa studiues të tjerë, kryesisht grekë, *epirotët* ishin një fis grek ose i helenizuar, pra flisnin një dialekt grek. Një qëndrim i tillë mbahet edhe në botimin *EPIRUS - 4000 years of Greek history and civilization* (1997), ku bëhet fjalë për trevën e Epirit në kuptimin e gjerë të tij, që përfshin edhe viset në veri të kufirit shtetëror grek, deri në gadishullin e Karaburunit. Çështja ndërlikohet edhe më tej, po të kemi parasysh hipotezën e Kostandin Jireçekut (1984, 19v.), sipas të cilit pas pushtimit romak të Gadishullit Ballkanik në gjysmën veriore të tij erdhi e mbizotëroi latinishtja, ndërsa në gjysmën jugore, ku bëjnë pjesë edhe treva të banuara nga shqiptarët, u përhap greqishtja. Por pavarësisht nga pasaktësia e hipotezës së Jireçekut, që mbështetet në përhapjen e mbishkrimeve latine në pjesën veriore të Ballkanit, përkatësisht të mbishkrimeve greke në pjesën jugore të tij, ndikimi i greqishtes mbi banorët fqinjë veriorë të grekëve nuk mund të mohohet. E në rastin e banorëve të *Epirit*, ku ndodhej edhe tempulli i *Dodonës*³³, ky ndikim i greqishtes duhet të ketë qenë patjetër i madh. Por a ishin të helenizuar apo jo banorët e lashtë të *Epirit*, kësaj pyetjeje, siç u përmend edhe pak më sipër, i janë dhënë dy përgjigje të kundërta. Dhe kuptohet vetiu që kjo çështje, në mungesë dokumentesh të shkruara

³¹ M. P. Nilson, *Studien zur Geschichte des alten Epeiros* (Lund: Oblson), 1909, 7. i mban epirotët për ilirë (shih Katiçiq-in: 1976. 124).

³² Çabej (1987, 82) pranon edhe mendimin e Leake-ut (1814, 13), sipas të cilit emri *çam* është vazhdimi jogrek i emrit të lumit *Thyamis* (sot Kallama), duke nënkuptuar kështu evolucionin/tj- />ç-/ në pajtim me ligjet fonetike të shqipes". Por Hamp-i (1966, 104) vëren se grupi nistor (tj-) duhej të kishte dhënë (s-). Sidoqoftë, mendimi i Çabejt meriton të hulumtohet më tej.

³³ Për themelimin e tempullit të famshëm të *Dodonës* dhe për lashtësinë e tij shih sqarimet e dhëna në fillim të temës për pellazgët në Kreun I, § 1 të këtij libri.

nga gjuha e të ashtuquajturve *epirotë* në lashtësi, paraqitet shumë e vështirë për t' u ndriçuar si duhet. Çështja ndërlikohet edhe më tej, po të mbahet parasysh se në kohë të vjetra nëpër viset e Epirit kanë kaluar edhe popuj të tjerë. Mjafton të përmendim këtu se gjatë shekujve VI - VII viset e Epirit u pushtuan nga tribu sllave ose avaro-sllave, që qëndruan atje për njëfarë kohe, natyrisht jo pa lënë gjurmë (shih Chrysos: 1997, f.182). Siç dihet, në periudha të mëvonshme, sidomos gjatë shekullit XIV, kanë ndodhur edhe shtegtime arbëreshësh drejt Greqisë. Por këto shtegtime, për të cilat do të flitet më poshtë (shih §§ 20 dhe 23), janë tashmë të njohura, ashtu si shtegtimet e shumta të shqiptarëve drejt Greqisë gjatë këtyre shtatëmbëdhjetë vjetëve të fundit. Prandaj për shtegtimet e mëparshme apo të kohëve më të reja në të dy krahët e kufirit shtetëror, që ndan shqiptarët nga grekët, nuk do të ndalemi më gjatë në këtë punim kushtuar gjuhës amtare të të ashtuquajturve epirotë gjatë shekujve. Por, natyrisht, nuk mund të anashkalojmë faktin që në një pjesë të viseve të të ashtuquajturit Epir të lashtësisë në periudhën e njohur historike flitet shqip e në një pjesë tjetër greqisht. Cila nga këto dy gjuhë është historikisht parësore në këtë trevë? Gjithashtu, siç do të shtjellohet më tutje, gjatë shekujve të fundit, sidomos pas shpalljes së pavarësisë së shtetit grek më 1821, dëshmohet një përhapje e vazhdueshme e greqishtes dhe një tkurrje e hapësirës së shqipes në viset në jug të kufirit shtetëror greko-shqiptar.

5. Për sqarimin e çështjes në shqyrtim, si edhe në raste të tjera të ngjashme, studiuesit, në mungesë të dhënash të shkruara në gjuhën e banorëve të lashtë të Epirit, janë përpjekur të shfrytëzojnë burime të tjera, si: mbishkrimet e tempullit të *Dodonës* dhe të viseve të tjera të Epirit, emrat e njerëzve, të fiseve e të viseve të *Epirit*, dëshmitë e autorëve të vjetër grekë etj. Por, para se t' i shqyrtojmë këto burime brenda caqeve të këtij kapitulli, është e nevojshme të vihen në dukje këto tri konsiderata të përgjithshme: 1) Duhet mbajtur gjithnjë parasysh dallimi midis gjuhës së folur nga masa e popullsisë së Epirit dhe gjuhës greke të mbishkrimeve, si edhe të administratës së disa qarqeve drejtuese të tij, si pasojë e ndikimit të kulturës së grekëve mbi popujt fqinjë gjatë shekujve. Me fjalë të tjera, duhet pasur gjithnjë parasysh dallimi midis përhapjes së greqishtes dhe ndikimit të kulturës greke. Vërejtja

e fundit vlen jo vetëm për kohët e lashta, por edhe për periudhat e mëpastajme, kur greqishtja, sidomos pas ndarjes së Perandorisë Romake në dy pjesë më 395 të erës sonë, erdhi e u bë dalngadalë gjuha zyrtare jo vetëm e administratës bizantine, por edhe e kishës ortodokse në vendet ballkanike. 2) Një trevë e tillë si Epiri, që ndodhej në kufi me grekët e mirëfilltë, nga njëra anë, dhe me popullsi jogreke, nga ana tjetër, nuk mund të mendohet që në lashtësi, si edhe më pas, të ketë qenë e banuar e tëra nga një popullsi etnikisht homogjene. Për më tepër, si njëjdhim i ngjarjeve të ndryshme historike dhe i ndikimeve të jashtme, përbërja etnike e një treve të tillë si Epiri nuk mund të mos pësonte ndryshime gjatë shekujve. 3) Do pasur parasysh gjithashtu se ndjenja e përkatësisë etnike ka qenë disi e ndryshme ndër popujt e lashtë, te të cilët mbizotëronte më fort ndjenja e përkatësisë fisnore a e fisit. Madje, edhe ndër grekët e vjetër për njëfarë kohe ka mbizotëruar një ndjenjë e tillë, siç dëshmojnë, ndër të tjera, antagonizmat dhe luftërat midis athinasve dhe spartanëve. Një vërejtje e ngjashme për popujt e Ballkanit Jugor vlen edhe për periudhën e mesjetës, sidomos pas pushtimeve osmane, kur i mëshohej më fort ndjenjës së përkatësisë fetare dhe kisha ortodokse në disa qarqe me ndikim konsiderohej si kishë greke.

Prandaj edhe në shqyrtimin e gjendjes etnike të Epirit gjatë shekujve nuk mund të arrihet në përfundime të sakta, në rast se nuk mbahen parasysh tri konsideratat e mësipërme. Por në mjaft studime për këtë çështje janë bërë pohime historikisht të pambështetura, sidomos sepse nuk është mbajtur parasysh dallimi midis përhapjes së greqishtes dhe ndikimit grek a helenistik ndër popujt jogrekë të Ballkanit, duke përfshirë këtu në radhë të parë fqinjët veriorë të grekëve, epirotët dhe maqedonasit e vjetër. E një qëndrim i tillë, sikurse u përmend pak më sipër, vihet re edhe në botimin *Epirus - 4000 years of Greek history and civilization* (1997), sidomos në disa artikuj të atij botimi, si p.sh. në artikullin *The boundaries of hellenism in Epirus during Antiquity* nga M. B. Hatzopoulos-i. Në atë artikull, ku (f. 145) parashtrohet teza se kufiri verior i helenizmit shtrihej edhe mbi kufirin verior të Epirit, vihen në dukje disa të dhëna të karakterit më fort kulturor, që do të dëshmonin për përhapjen e ndikimit të qytetërimit grek (shih § 6).

6. Siç dihet, ata që mbrojnë tezën se epirotët e lashtë nuk kanë qenë grekë,

mbështeten, ndër të tjera, në pohimet e disa shkrintarëve të vjetër grekë si Tukididi i shekullit V para erës së re, Straboni në kapërcyell të erës së re dhe Stefan Bizantini i shekullit VI të erës së re. Ata i kanë quajtur banorët e të ashtuquajturit *Epir* “barbarë”, në kuptimin “jogrekë”. E kjo merret si një dëshmi që grekët e vjetër i konsideronin të ashtuquajturit epirotë si të huaj, jogrekë (shih, ndër të tjerë, Katiçiq-in: 1976, 120v.). Mirëpo disa studiues, kryesisht grekë, si p.sh. M. B. Hatzopoulos-i (*Epirus*: 1997, f. 140v.), mendojnë se termi *barbar* nga disa autorë të vjetër grekë në këtë rast nuk është përdorur në kuptimin “jogrek”, por në kuptimin “i pagdhendur, i pazhvilluar”. Si rrjedhim, ata mbrojnë tezën se epirotët e vjetër ishin grekë dhe këtë tezë e mbrojnë me argumente të ndryshme, ndër të cilat janë edhe ato që përmenden në artikullin e cituar të Hatzopoulos-it, ku vihen në dukje, ndër të tjera: 1) Prania e mbishkrimeve greke jo vetëm në tempullin e lashtë të Dodonës dhe në “kolonitë” greke të Epirit si Apolonia, Oriku, Bylisi, Nikaia³⁴, por edhe në vise të tjera të kësaj treve (f. 141, 144). 2) Emra njerëzish prej burimi grek, si: *Aleksandros, Andriskos, Arkelaos, Kebbas* etj., dëshmojnë “në Byllis, Nikaia dhe në krahinat e tyre” dhe paraqiten “jo si emra lokalë të kolonive korintiane, por si emra tribush të Greqisë Veriore, d.m.th. të Epirit dhe të Maqedonisë”. Por pas këtyre përmenden edhe emra ilirë si *Preuratos, Triteutas dhe Trasos*. Gjithashtu aty përmenden edhe disa emra të tjerë si *Praugos, Praugissos dhe Praugimmas*, që nuk ndeshen në vise të tjera të Ilirisë jashtë Byllisit dhe krahinës së tij, si edhe jashtë qyteteve të afërta *Amantia dhe Dimale*, por që etimologjikisht nuk shpjegohen me anë të greqishtes, si edhe disa emra me etimologji të dyshimtë si *Aspimmas, Paton* etj. Dhe shtohet se emra si këta, as ilirë as grekë, që ndeshen edhe në vise më jugore në periudha më të hershme, “u japin një përmasë të re pohimeve rreth tribuve të përziera dhe popullsive dygjuhëshe, midis të cilëve Straboni përfshin jo vetëm banorët e Byllisit, por edhe taulantët, partinët, brygasit dhe enkeleasit, si edhe pas gjithë gjasave edhe

³⁴ Por në këtë artikull (f. 144) pohohet se *Bylisi* dhe *Nikea* nga Straboni dhe Stefan Bizantini mbaheshin si ilire. Aty thuhet gjithashtu se edhe *Nikea* nga Stefan Bizantini përmendet si një qytet “në Iliri”.

dasaretët.” (f.144). 3) Banorët e Epirit “... praktikonin të njëjtin besim si gjithë grekët e tjerë. Zoti suprem i epirotëve ishte *Zeusi* dhe tempulli i tyre në Dodona tërhiqte besimtarë nga e gjithë bota greke. Perëndi të huaja nuk dëshmohen para përhapjes së kulteve lindore në të gjithë Greqinë në periudhën helenistike”. Por sipas dëshmisë së Plutarkut vihet në dukje se “epirotët adhuronin edhe një perëndi barbare.” (f. 141v.). “Kultet në Amantia janë tipikisht greke (*Zeus, Aphrodite, Pandemos, Pan* dhe *Nymfat*)” (f. 143). 4) Prania e monumenteve kulturore të stilit grek, si p.sh. stadiumi në Amantia (në Ploçë të Vlorës) (f. 143). 5) Administrata e drejtuesve politikë të molosëve të Epirit përdorte greqishten si gjuhë zyrtare (f. 141). Dhe, si përfundim, në atë artikull (f. 145) pohohet: “... kufiri verior i helenizmit në Epir në antikitetin klasik shtrihej deri në luginën e lumit Aaos [= Viosa]”. Dhe në fund, duke cituar Hammond-in (1967, 131-32), shtohet: “Është krejt rastësi që sot fshatrat greqishtfolëse më veriore janë Arta dhe Zvërneci në gjirin e Vlorës - mbeturina të izoluarra të të moçmëve Horikioi dhe Balaiitai”.

7. Duke qenë se në artikullin e porsapërmendur të Hatzopoulos-it janë pasqyruar argumentet kryesore në mbështetje të tezës mbi origjinën greke të banorëve të lashtë të Epirit, është e nevojshme të ndalemi pak më gjatë në shqyrtimin e tyre, duke nisur me kuptimin e termit *barbar* të përdorur prej disa autorëve të vjetër grekë, si historiani i mirënjohur Tukididi i shekullit V para erës sonë, gjeografi i famshëm Straboni në kapërcyell të erës së re dhe Stefan Bizantini i shekullit VI të erës sonë. Ata, siç u përmend edhe pak më sipër, i kanë cilësuar epirotët e vjetër si “barbarë” dhe shumica e studiuesve këtë term të përdorur edhe për popuj të tjerë të lashtë, si: maqedonasit, trakasit, ilirët etj., e kanë interpretuar si “të huaj apo jogrekë”. Por a ka qenë ky kuptimi burimor i fjalës greke “barbaros”, apo kuptimi burimor i kësaj fjale ka qenë “i pagdhendur, i pazhvilluar”? Në gjendjen e sotme të njohuri ve tona nuk mund të jepet një mendim i prerë për këtë, megjithëse është vështirë të mendohet që Straboni dhe Stefan Bizantini t’i kenë konsideruar të pagdhendur e të pazhvilluar edhe maqedonasit e vjetër, nga të cilët doli Aleksandri i Madh. Një vërejtje e tillë vlen edhe për vlerësimin e epirotëve, në gjirin e të

cilëve ndodhej edhe Dodona, për të cilën grekët e vjetër kishin një nderim të posaçëm. Prandaj ka më shumë mundësi që kuptimi “i pagdhendur, i pazhvilluar, i egër etj.”, që ka marrë fjala greke “barbar”, të jetë dytësor dhe të jetë përftuar më vonë, sidomos pas dyndjeve të tribuve të ndryshme, kryesisht gjermanike, që sulmuan egërsisht trevat e ndryshme të Perandorisë Romake në shekujt e parë të erës së re.

Edhe fakti që në viset e Epirit të lashtë dëshmohen emra personash, që mbahen me prejardhje greke, duhet vështruar me kujdes, sepse është një gjë e njohur që emrat e njerëzve jo vetëm në kohë më të reja, por edhe në kohë më të vjetra kanë shtegtuar shpesh nga një popull në tjetrin. Madje, mund të pohohet se edhe vetë grekët e vjetër kanë shtënë në përdorim emra të huazuar nga popuj të tjerë. P.sh. emri *Aléksandros* është prej burimi jogrek. Kjo çështje do të meritonte një studim më vete, që i kalon synimet e këtij punimi. Gjithsesi, bie në sy më fort prirja që popujt më pak të zhvilluar të huazojnë emra të përveçëm njerëzish nga popuj më të zhvilluar ose me një prestigj të njohur. Mjafton të kujtojmë këtu përdorimin e mjaft emrave prej burimi grek apo hebraik nga romakët e vjetër, si para ashtu edhe pas përhapjes së krishtëritimit. Por në raste të tilla çdo popull ia përshtat emrin e huazuar sistemit fonetik dhe strukturës gramatikore të gjuhës së vet. P.sh. emri i *Aleksandrit*, që në greqishte në rasën emërore del në trajtën *Aléksandros* dhe lakohet ashtu si emrat e tjerë në /-os/, në latinishte del në trajtën *Alexándrus* dhe lakohet ashtu si emrat e lakimit të parë në /-us/ (si *domin-us* ~ *domin-i* etj.). Ky emër i përveçëm ka hyrë prej kohësh edhe ndër të parët e shqiptarëve (pas gjithë gjasash nëpërmjet romakëve) dhe përdoret ashtu si emrat e tjerë të lakimit të parë, si në trajtën e pashquar edhe në të shquarën. Madje, në shqipen popullore ky emër nga përdorimi i hershëm ndeshet më fort në trajtën e shkurtuar *Lekë* ~ *Lek-a*, që haset jo vetëm në viset veriore (krahaso: *Lekë Dukagjini*), por edhe në viset jugore (krahaso *Gjoleka* < Gjon *Leka*). Prania e emrave prej burimi grek apo prej ndonjë burimi tjetër në mbishkrimet e gjetura në viset e Epirit të lashtë do të shërbente shumë për çështjen në shqyrtim, sikur këto të ishin shkruar jo në gjuhën greke, sepse vetëm atëherë mund të jepej një mendim

më i saktë rreth mënyrës se si ata kanë qenë përshtatur në gjuhën e epirotëve të lashtë.

8. Vërejtjet e mësipërme vlejné edhe për emrat e perëndive, që ndeshen në mbishkrimet e gjetura në viset e Epirit të lashtë. Madje, këtu ndikimi i grekëve duhet të ketë qenë edhe më i madh. Në këtë rast vlen të theksohet se emrat e perëndive me kultet përkatëse në botën e lashtë mund të shtegtonin edhe më lehtë nga një popull në tjetrin. Kështu p.sh., sipas Pouqueville-it (1826, f.189), Zeusi në kuptimin e Kryezotit në tempullin e Dodonës është me prejardhje egjiptiane. Edhe ndër vetë grekët e lashtë disa nga perënditë kanë prejardhje jogreke. Kështu p.sh. kulti i *Aresit*, Zotit të luftës, që i përgjigjet *Marsit* të romakëve, dhe kulti i *Dionisit*, Zotit të verës e të epsheve, që i përgjigjet *Bakusit* të romakëve, kanë prejardhje trakase (shih Katiçiq-in: 1976, 129). Edhe *Afrodita* (më saktë, *Ap^hroditë*), perëndesha e dashurisë dhe e pjellorisë, që i përgjigjet *Venusit* të romakëve, mbahet si me prejardhje nga Lindja e Afërt. Gjithsesi, çështja e shtegtimit të emrave të perëndive nga një popull në tjetrin në botën e lashtë do të meritonte një trajtim më vete, që i kapërcen synimet e këtij punimi. Por ajo që do të na interesonte më shumë edhe në këtë rast, është të dinim se si i shqiptonin dhe si i lakonin emrat e këtyre perëndive banorët e Epirit të lashtë, që ne i njohim vetëm nëpërmjet mbishkrimeve greke, ku natyrisht janë paraqitur sipas gjedheve të greqishtes së kohës. Të kihet parasysh se edhe emrat e huazuar të perëndive, ashtu si çdo huazim, i janë përshtatur sistemit fonetik dhe strukturës gramatikore të gjuhës huazuese. Mjafton të përmendim këtu, sa për shembull, se mesapët e Italisë Jugore, prej të cilëve janë zbuluar mjaft mbishkrime në gjuhën e tyre, emrin e perëndeshës *Afrodita* (më saktë, *Ap^hroditë*) të grekëve të vjetër e shqiptonin *Aprodita* (p.sh. Ana-n *Aprodita-n*), duke qenë se, ashtu si shqipja, me sa duket, edhe mesapishtja nuk e kishte bashkëtingëlloren mbylltore të aspiruar /p^h/ të greqishtes së vjetër dhe e shndërroi atë në një mbylltore të thjeshtë /p/ (shih Demiraj: 2000, f.98).

9. Për sa u takon monumenteve të tilla të kulturës, si teatrot, stadiumet etj. në Epirin e lashtë, ngjashmia e madhe e ndërtimit të tyre me ato të grekëve është pa

dysim pasojë e ndikimit të madh kulturor të fqinjëve grekë. E nëpërmjet ndikimit të fuqishëm kulturor të grekëve dhe të gjuhës së tyre duhet shpjeguar edhe përdorimi i greqishtes si gjuhë e administratës së shteteve epirote. Një gjë e tillë nuk është e papritur, po të kihet parasysh prestigji i greqishtes si gjuha e Platonit, Aristotelit, Eskilit, Sofokliut, Euripidit, Tukididit etj., gjë që e kishte bërë atë, si të thuash, një gjuhë “ndërkombëtare” të vetme në Europën e asaj kohe, kur latinishtja ishte ende në hapat e parë të përhapjes së saj. Prandaj ishte e natyrshme që në kushte të atilla greqishtja të përdorej si gjuhë “zyrtare” e kancelarive të qarqeve drejtuese epirote sidomos në marrëdhëniet me popuj të tjerë. Një dukuri e ngjashme ka ndodhur edhe shumë shekuj më vonë, në kohën e Skënderbeut, i cili nëpërmjet kancelarisë së tij në marrëdhëniet me popuj të tjerë, në vend të gjuhës amtare, ishte i detyruar të përdorte latinishten, italishten ose sllavishten. Edhe fakti që disa udhëheqës politikë epirotë mund të jenë ndier krenarë të paraqiteshin me prejardhje fisnike greke, meqenëse popullsia e vendit të tyre konsiderohej barbare, nuk është i papritur (shih për këtë edhe Katiçiq-in: 1976, f.121). Por këto të dhëna nuk dëshmojnë që popullsia e Epirit në lashtësi fliste greqisht, apo e ndjente veten greke. E kjo vërejtje vlen edhe për maqedonasit e vjetër, mbretërit e të cilëve paraqiteshin me prejardhje fisnike greke, por kjo nuk do të thotë që populli i tyre fliste greqisht, apo e ndjente veten grek³⁵.

Megjithatë, greqishtja nuk ka qenë e panjohur në viset kufitare, siç ishin p.sh. Epiri, Maqedonia etj., sidomos në disa qarqe më të ngritura e ndoshta edhe më gjerë. E për këtë një rol të rëndësishëm kanë luajtur jo vetëm marrëdhëniet e zakonshme midis popujve fqinjë, por edhe “kolonitë” greke të lashtësisë, për të cilat do të bëhet fjalë në një temë të veçantë në Kreun III të kësaj vepre. Por, sa ka qenë e përhapur greqishtja në viset jогреке të bregdetit të Adriatikut dhe të Jonit në periudhën e lashtësisë para pushtimeve romake, nuk mund të thuhet asgjë me siguri. Megjithatë, duke pasur parasysh që huazimet nga greqishtja e vjetër në gjuhën shqipe, duke përfshirë këtu edhe viset më jugore të banuara nga shqiptarët, janë relativisht

³⁵ Për më shumë hollësi për këtë çështje shih Katiçiq-in: 1976, 104 vv., 112 vv.

të pakta³⁶, mund të pohohet se Epiri, sidomos në viset e brendshme të tij, në periudhën e lashtësisë nuk ishte helenizuar.

10. Natyrisht, një mendim i tillë qëndron, në rast se banorët shqipfolës të periudhës së njohur historike të Epirit janë me të vërtetë pasardhës të drejtpërdrejtë të banorëve të lashtë jogrekë të asaj treve. Përndryshe, do të duhej pranuar që ata janë vendosur atje në një periudhë të mëvonshme, por, siç u vu në dukje pak më sipër, për këtë nuk ka asnjë dëshmi historike. Megjithatë, siç dihet, disa dijetarë si H. Hirti, G. Weigand-i, H. Bariqi, V. Georgievi, G. Schramm-i etj. janë përpjekur të vërtetojnë që stërgjyshërit e shqiptarëve në përgjithësi, duke përfshirë edhe ata të viseve jugore të banuara prej tyre, kanë qenë me origjinë trakase, pra kanë shtegtuar nga viset lindore në viset perëndimore të Ballkanit, pa u vënë re, në një periudhë relativisht të hershme. Mjafton të përmendim këtu studiuesin e njohur gjerman Gustav Weigand i cili në vitin 1927 parashtrroi 12 argumente për të mbrojtur një hipotezë të tillë³⁷. Këtu nuk është

³⁶ Në përgjithësi, pranohet që numri i huazimeve nga greqishtja e vjetër në gjuhën shqipe është i kufizuar. A. Thumb-i (1910) shënoi 20 huazime të tilla, por dijetarë të tjerë më vonë i kanë shtuar këtij numri edhe rreth dhjetë të tjera. Natyrisht, nuk duhet përjashtuar mundësia që një pjesë e huazimeve nga greqishtja e vjetër të jenë zhdukur nga përdorimi në gjuhën shqipe gjatë shekujve, ashtu siç janë zhdukur edhe fjalë të tjera të vjetra të trashëguara indoeuropiane. ose të huazuara nga gjuhë të tjera. Por do pasur parasysh se numri i huazimeve nga greqishtja e mesme dhe sidomos nga greqishtja e re në të folmet e shqipes, veçanërisht në të folmet më jugore, është mjaft i madh.

³⁷ Ja, argumentet e Weigand-it: 1. Emrat latinë të vendeve në Shqipëri nuk kanë pësuar ndryshime të tilla, që të dëshmojnë praninë e hershme të shqiptarëve në trojet e tyre të sotme. 2. Termet e lundrimit dhe të peshkimit në shqipe janë kryesisht prej burimi të huaj. 3. Mungesa e ndikimit nga dalmatishtja e vjetër në shqipe. 4. Në gjuhën shqipe ka disa fjalë prej burimi trak. 5. Disa emra personash dhe visesh në Traki e Daki shpjegohen me anë të shqipes. 6. Emrat e vjetër të vendeve në Shqipëri nuk kanë pësuar ndryshime fonetike karakteristike të shqipes. 7. Shqiptarët nuk përmenden para shekullit XI. 8. Lidhjet e vjetra gjuhësore rumune-shqiptare të burimit jolatin. 9. Në rumanishte ka disa elemente latine, që duket se kanë depërtuar nëpërmjet shqipes. 10. Elementet latine të shqipes e të rumanishtes përkojnë në mënyrë shumë të dukshme. 11. Folklori i shqiptarëve dhe ai i rumunëve kanë disa bashkëpërkime të veçanta. 12. Edhe mënyra e këndimit të këngëve paraqit bashkëpërkime të dukshme.

rasti t' i rishqyrtojmë argumentet e Weigand-it, që i kemi shqyrtuar gjerësisht në veprën e vitit 1999 me titullin *Prejardhja e shqiptarëve në dritën e dëshmimeve të gjuhës shqipe*, faqe 76 vv. dhe 94 vv. Por nuk mund të mos ritheksojmë se sidomos prania e një numri të konsiderueshëm fjalësh të lashta (paralatine) të përbashkëta në shqipe dhe në rumanishte³⁸, të vëna në dukje nga Weigand-i dhe nga studiues të tjerë, dëshmon që stërgjyshërit e shqiptarëve duhet të kenë qenë dikur fqinjë me stërgjyshërit e rumunëve, pra duket të kenë banuar edhe në vise më lindore të Ballkanit. Por fjalët e tilla të vjetra jolatine në shqipe dhe në rumanishte, siç e kemi vënë në dukje edhe më parë (shih Demiraj: 1999, 95), mund të jenë pjesërisht një trashëgimi e përbashkët e këtyre dy gjuhëve nga gjuha nënë e shqipes, përkatësisht nga substrati parlatin i rumanishtes, dhe pjesërisht mund të jenë pasojë e marrëdhënieve të vjetra (paraslave) midis këtyre dy gjuhëve të moçme në Gadishullin Ballkanik. Gjithsesi, gjuha “nënë” e shqipes dhe substrati i rumanishtes dikur kanë qenë gjuhë gjeografikisht të afërta dhe fqinjësia e dikurshme e tyre u ndërpre pas dyndjes së tribuve sllave në Ballkan gjatë shekujve VI-VII të erës sonë. E, kur kanë qenë në fqinjësi të pandërprerë, s'përrjashtohet mundësia e huazimit nga njëra gjuhë fqinje në tjetrën. Gjithashtu si dy gjuhë indoeuropiane ato duhet të kenë pasur edhe elemente leksikore të përbashkëta, përkatësisht të afërta. Mjafton të përmendim emrin *mal*, që në rumanishte përdoret me një kuptim disi të ndryshëm në krahasim me shqipen (shih shënimin 38), por që në përgjithësi është pranuar si një fjalë e vjetër e trashëguar në këto dy gjuhë. Kjo fjalë ndeshet edhe në lituanishte dhe në keltishte dhe s'përrjashtohet mundësia që të jetë e fondit paraindoeuropean (shih Solta: 1980, f.20, 48 v. - me literaturë). Fjalë të lashta të përbashkëta të fondit para-indoeuropean janë ruajtur si në shqipe e rumanishte ashtu edhe në greqishte. E kjo çështje do të meritonte një

³⁸ Të tilla janë, ndër të tjera, fjalët *brin-i/brir-i* (rumanisht *brîu*), *kulpën/kulpër* (rum. *kurpen*), *avull* (rum. *abure*), *mugull* (rum. *mugur*), *niegull/mjegull* (rum. *negure*), *dhallë* (rum. *zarā*), *kurth* (rum. *cursă*), *nepërkë* (rum. *năpîrcă*), *shtrep* (rum. *strepede*), *shtrungë* (rum. *strungă*), *mal* (rum. *mal* = breg lumi), *përrua* (rum. *pîrîu*), *urlë* (rum. *urdă*), *gurmaz* (rum. *grumază*), etj. Sipas Brâncus-it (1983, f. 130), numri i fjalëve të tilla të përbashkëta shqiptare-rumune arrin në rreth 89 njësi.

hulumtim të posaçëm.

11. Por edhe sikur të pranohej pa asnjë rezervë një shtegtim i dikurshëm i stërgjyshërve të shqiptarëve nga vise më lindore të Ballkanit në trevat e tyre të sotme gjatë bregdetit të Adriatikut dhe të Jonit, një shtegtim i tillë duhet të jetë kryer shumë herët, shumë kohë para dyndjeve të legjioneve romake në Ballkan, dhe jo në kohë relati visht më të vona, siç mendojnë disa studiues si Bariqi (1955, f.50), sipas të cilit një shpërngulje e tillë ka ndodhur gjatë shekujve II - III të erës sonë, dhe Schramm-i (1994, 81v), sipas të cilit një shpërngulje e tillë ka ndodhur aty nga fillimi i shekullit IX të erës sonë³⁹. Përkundrazi, prania e disa huazimeve nga greqishtja e vjetër dhe sidomos e një numri të madh huazimesh të vjetra latine në të gjitha të folmet e shqipes, duke përfshirë edhe ato të skajit më jugor të trevave shqipfolëse, dëshmon qartë që stërgjyshërit e shqiptarëve kanë pasë banuar në pjesën perëndimore të Ballkanit, të paktën, qysh mjaft shekuj para erës sonë. Një përfundim i tillë është edhe më i qartë për periudhat më të pastajme, kur u krye ndarja dialektore e gjuhës shqipe. Ajo, siç do të shtjellohet pak më poshtë (shih § 21), dëshmon që të folmet e dialektit jugor në përgjithësi, përfshirë këtu edhe çamërishtja, janë zhvilluar herët në viset përkatëse

12. Por ndikimi i gjuhës dhe i kulturës greke mbi popullsinë e asaj treve duhet të ketë qenë i dukshëm. Mjafton të kihet parasysh se mbishkrimet e zbuluara në ish-tempullin e *Dodonës* janë në gjuhën greke dhe emrat e njerëzve atje janë të tipit grek (shih edhe Katiçiq-in: 1976, f.123). Një gjë e tillë nuk është e papritur për një zonë që ishte aq afër grekëve të lashtë dhe aq e ndikuar nga kultura greke dhe, si rrjedhim atje, siç u vu në dukje edhe pak më sipër, greqishtja duhet të ketë qenë, si të thuash, gjuha "zyrtare" e qarqeve drejtuese dhe fetare. Por kjo nuk dëshmon që shtresat e gjera të popullsisë rreth e rrotull flisnin greqisht. Të kihen parasysh

³⁹ Sipas këtij dijetari gjerman, një pjesë e fisit trakas të besëve (disa mijëra veta) në fillim të shekullit IX, nën kërcënimin e hanit të fisit të bullgarëve, për të ruajtur fenë e krishterë dhe identitetin e tyre, u detyruanin të shtegtonin në Tëmën e Durrësit, në viset e Arbanonit të dikurshëm dhe kështu, sipas tij, u ngjiz etnosi arbëresh.

edhe mbishkrimet greke të zbuluara në “kolonitë” greke të Adriatikut, të Detit të Zi etj., që ishin të rrethuara nga popullsi vendëse të cilat nuk flisnin greqisht. Megjithatë, nuk duhet përjashtuar mundësia e ndonjë enklave grekësh edhe në zonën e të ashtuquajturit *Epir* në kohë të lashta, sepse lëvizjet e popullsi në periudha të ndryshme, sidomos të lashtësisë, kanë qenë të zakonshme edhe në trevat ballkanike, veçanërisht midis popujsh fqinjë.

13. Siç u vu në dukje pak më sipër, për rastin në shqyrtim studiuesit kanë shfrytëzuar edhe burime të tjera, si emrat e fiseve, të personave dhe të vendeve. Një pjesë e mirë e këtyre studiuesve, kanë arritur në përfundimin që banorët e Epirit në lashtësi kanë qenë të ndryshëm nga grekët. Por disa studiues të tjerë, duke vendosur lidhje etimologjike të disa emrave vendesh, fisesh dhe personash të viseve “*epirote*” me fjalë greke⁴⁰, kanë mbrojtur tezën që në trevën në shqyrtim flitej një gjuhë e afërt me greqishten. Mirëpo kjo tezë në përgjithësi nuk i ka qëndruar kritikës. Për këtë unë po mjaftohem të përmend përfundimin e studiuesit anglez Hammond, i cili në veprën e tij *Epirus* të vitit 1967, f. 423, pohon: “Dëshmitë arkeologjike tregojnë se kultura greke, siç shfaqet në poçeri dhe objekte të tjera, nuk depërtoi në Epirin e brendshëm, me përjashtim të Dodonës dhe atje vetëm në një masë të kufizuar, deri në shekullin VI. Dëshmitë historike në përgjithësi dhe përshkrimi i tribuve të Epirit të brendshëm si barbarë nga Tukididi, Straboni dhe Stefan Bizantini janë në harmoni me dëshmitë arkeologjike. Prandaj nuk mund të merret seriozisht ideja që gjuha greke u përhap prej qyteteve greke në bregdet dhe zëvendësoi një gjuhë jogreke gjatë shekullit të pestë ose të gjashtë. Iliria qendrore ishte gjeografikisht shumë më e hapur për depërtim nëpërmjet Epidamnit, Apolonisë dhe Bylisit, por gjuha greke nuk e zëvendësoi gjuhën ilire atje në shekullin IV ose më vonë.”

14. Por, edhe sikur të pranohej pa rezerva një “ide” e tillë, është shumë e vështirë, për të mos thënë e pamundur, të argumentohet që popullsia e dikurshme e trevave të të ashtuquajturit *Epir*, të banuara nga shqiptarët në periudhën historike,

⁴⁰ Kështu p.sh. Georgievi është përpjekur të shpjegojë të gjithë emrat gjeografikë kryesorë të Epirit me anë të greqishtes (shih Katiçiq-in: 1976, 122 v.).

të ketë qenë greke apo e helenizuar në kohët e lashta. Një gjë e tillë do të parakuptonte që një popullsi e helenizuar apo e ndikuar fuqishëm nga kultura greke është çhelenizuar në rrymë të shekujve. Mirëpo në këtë rast lind vetiu pyetja: Në ç' rrethana duhet të ketë ndodhur një proces i tillë, që do të parakuptonte dyndjen e një popullsie jogreke në viset e të ashtuquajturit *Epir*? Është e vërtetë se nuk janë të pakta rastet që një popullsi, në rrethana të caktuara, është asimiluar nga një popullsi tjetër, duke humbur identitetin etnik të mëparshëm dhe duke zëvendësuar kështu gjuhën amtare të mëparshme me një gjuhë tjetër. Historia na jep mjaft shembuj të tillë. Mjafton të përmendim këtu romanizimin e vendeve të tilla, si: Franca (Galia e dikurshme), Spanja, Portugalia, Rumania (Dakia e dikurshme), Dalmacia (Iliria Veriore e dikurshme, që më vonë u sllavizua), ose arabizimin e Afrikës Veriore etj., apo sllavizimin e një pjese të madhe të Ballkanit pas dyndjeve sllave të shekujve VI-VII. Vendet ballkanike, që erdhën e u sllavizuan pas shekujve VI-VII, nuk kanë qenë toka të shkreta, por të banuara nga popuj të tillë si trakasit, ilirët etj. Pra, në raste të tilla është fjala për asimilimin e popullsisë të mëparshme nga popuj ushtarakisht e politikisht më të organizuar dhe me një përbërje numerike jo të vogël. Historia na dëshmon gjithashtu edhe raste që një popullsi pushtuese, pra ushtarakisht e organizuar, është asimiluar nga popullsia e pushtuar, kur kjo e fundit ka qenë më e madhe për nga numri dhe e një niveli më të ngritur kulturor. I tillë është p.sh. rasti i fisit gjermanik të frankëve që pushtuan Galinë e romanizuar në shekullin V. Vetë frankët u romanizuan, megjithëse i lanë gjurmët e tyre me ndryshimin e emrit të vendit dhe të banorëve të *Galisë* në *Francë*, përkatësisht *francez*, si edhe me pak fjalë nga gjuha e tyre në frëngjishte, e cila mbetet një gjuhë romane. Një gjë e ngjashme ka ndodhur edhe me fisin turko-tatar të bullgarëve, që në shekullin VII pushtuan trevat e sllavizuara të Bullgarisë së sotme, duke u asimiluar gjuhësisht nga popullsia e sllavizuar e atyre trevave, e cila nën ndikimin e pushtuesve mori emrin e këtyre, si edhe një numër të vogël fjalësh. Raste të tilla janë të dokumentuara historikisht, kurse për një dyndje fisesh arbëreshe a shqiptare në trevat e *Epirit* në lashtësi dhe në mesjetën e hershme nuk ka asnjë dëshmi. Për më tepër, as kushtet historike - politike nuk e favorizonin një asimilim të tillë, sidomos pas pushtimeve romake në Ballkan e veçanërisht pas ndarjes së

Perandorisë Romake në dy pjesë në vitin 395 të erës së re. Përkundrazi, siç do të vihet në dukje më poshtë (§ 22), të gjitha rrethanat mundësonin një proces të përkundërt.

III. Epiri nën Perandorinë Romake (dhe Bizantine)

15. Pushtimet romake në Gadishullin Ballkanik filluan qysh në vitin 228 para erës së re me zbarkimet në Iliri dhe vazhduan më tej në vendet e tjera të këtij gadishulli. Viset e Epirit, ashtu si ato të bregdetit perëndimor të Gadishullit Ballkanik, u pushtuan herët nga legjionet romake, gjithsesi jo më vonë se fillimi i shekullit II para erës së re. Banorët e Epirit duhet t'u kenë bërë një qëndresë të fortë pushtuesve romakë, përderisa konsulli romak Paul Emili në vitin 167 para erës së re dogji e shkatërroi shumë vendbanime të asaj treve dhe mori si skllëvër rreth 150 000 epirotë (shih Cabanes në *Epirus*: 1997, f.116). Të kihet parasysh se romakët ushtruan një ndikim të fuqishëm romanizues si në Epir ashtu edhe në vendet e tjera ballkanike. Në këtë rast mund të shtrohet më fort pyetja nëse banorët e Epirit iu nënshtruan procesit të romanizimit, apo mundën ta mënjanonin, qoftë edhe pjesërisht, një proces të tillë, ashtu si grekët e vjetër dhe një pjesë e ilirëve. Në kushtet e sotme të njohurive tona, duke pasur parasysh, nga njëra anë, romanizimin e një pjese të mirë të popujve të Gadishullit Ballkanik dhe, nga ana tjetër, mbijetesën e stërgjyshërve të shqiptarëve në përgjithësi, mund të pohohet që procesi i romanizimit duhet t'i ketë përfshirë vetëm pjesërisht banorët e lashtë të Epirit, sidomos në viset bregdetare, ashtu siç duhet të ketë ndodhur edhe në vise të tjera të banuara nga ilirët jugorë. Kurse për të ashtuquajturit ilirë veriorë tashmë është një gjë e njohur që ata u romanizuan duke zëvendësuar gjuhën e tyre të mëparshme me një gjuhë romane, që njihet me emrin dalmatishte, e cila pas pushtimeve sllave erdhi e u zëvendësua dalngadalë nga sllavishtja.⁴¹

⁴¹ Dalmatishtja si gjuhë romane u shua përfundimisht në shekullin XIX (shih Solta: 1980, 142 v. - me literaturë): Mbeturinat e fundit të asaj gjuhe i mblodhi dhe i botoi gjuhëtari italian M. G. Bartoli më 1906 në Vjenë me titullin *Das Dalmatische*.

16. Do pasur parasysh se në zonën e Epirit romakët duhet të kenë ndeshur edhe në ndikimin e greqishtes që gëzonte prestigjin e qytetërimit të mirënjohur grek. Gjithsesi, për shkallën e romanizimit të popullsisë së Epirit nuk kemi të dhëna. Por mund të pohohet se procesi i romanizimit në Epir, ashtu si në pjesën jugore të bregdetit perëndimor të Adriatikut dhe të Jonit në përgjithësi, erdhi e u dobësua sidomos pas ndarjes së Perandorisë Romake në dy pjesë në vitin 395, kur *Epiri* dhe i gjithë Ballkani jugor i takuan Perandorisë Lindore a Bizantine, e cila për njëfarë kohe si gjuhë zyrtare përdori latinishten, por sidomos qysh nga fundi i shekullit VI e zëvendësoi atë me greqishten (shih Mihăescu: 1978, 55). Për më tepër, greqishtja u bë edhe gjuha zyrtare e kishës ortodokse që, siç dihet, ka luajtur dhe luan një rol aq të madh ndër popujt e Ballkanit. Mjafton të kujtojmë këtu se shumë emra njerëzish të ortodoksëve shqiptarë, si: *Jani, Jorgji, Thanas, Pavli, Perikli, Petro, Sotir, Vasil, Irena a Irini, Vasilika* etj. janë prej burimi grek dhe paraqiten me trajta fonetike shumë të ngjashme me ato të grekëve, prej të cilave dallohen kryesisht nga format lakimore dhe nga nyjat shquese që janë të ndryshme në këto dy gjuhë. Të kihet parasysh edhe se disa nga këta emra të krishterë, që kanë depërtuar nëpërmjet latinishtes, paraqiten me trajta fonetike të ndryshme të përfutuara gjatë evolucionit historik të shqipes. P.sh. të krahasohen *Jani* me *Gjon* e *Gjin*, që e kanë burimin të latinishtja *Ioannes* e kjo nga hebraishtja *Jochanan/Johanna*; po kështu të krahasohen *Jorgo* me *Gjergj*, që të dyja nga *Georgius* etj.

17. Në këto rrethana, lindin vetiu pyetje të tilla si: Cila ka qenë gjuha amtare e popullsisë së Epirit gjatë mesjetës së hershme dhe të vonë? A janë banorët e periudhës së dokumentuar historike të Epirit pasardhës të drejtpërdrejtë të banorëve të lashtë të kësaj treve, apo janë pasardhës të një popullsie të vendosur atje pas periudhës së lashtësisë?

Siç dihet, për periudhat e lashtësisë dhe të mesjetës së historisë së popullit shqiptar në përgjithësi, duke përfshirë edhe Epirin, dëshmitë historike pothuajse mungojnë fare. Megjithatë, studiuesit janë përpjekur që këtë mungesë ta plotësojnë me të dhëna të tërthorta dhe me të dhëna nga historia e evolucionit të gjuhës shqipe.

Këtu po përmendim shkurt disa nga këto të dhëna⁴². Nga të dhënat e tërthorta kryet e vendit e zë pohimi i bërë së pari nga Thunmann-i (1774, 215v.), sipas të cilit "... në historinë e tyre unë nuk kam gjetur asnjë gjurmë të ndonjë shtegtimi të tyre të mëvonshëm; gjuha e tyre ka dhënë dëshmi të tilla nga fatet e popullit, që unë në këtë nuk mund të mos njoh fqinjët e stërmoçëm të grekëve dhe nënshtetasit e Romës së vjetër ...". E një fakt i tillë është pohuar edhe nga dijetarë të tjerë më pas. Por, siç dihet, ka pasur edhe dijetarë që kanë menduar ndryshe. Prandaj ia vlen të ndalemi pak në këtë çështje, aq më shumë për të vënë në dukje nëse përfundimet për gjuhën shqipe mund të vlejné apo jo edhe për Epirin.

18. Në përgjithësi, ata që janë marrë me problemet e historisë së gjuhës shqipe, kanë pranuar që në këtë gjuhë ndeshen edhe huazime nga greqishtja e vjetër dhe këto kanë karakter mbarëshqiptar, d.m.th. ndeshen si në të folmet jugore, ashtu edhe në të folmet veriore. Vjetërsia e këtyre huazimeve duket qartë sidomos nga disa dukuri të lashta karakteristike të shqipes, siç është, ndër të tjera, evolucioni /ā/ >/o/, që ka përfshirë si fjalët e trashëguara indoeuropiane, si p.sh. **māter* > *motër* etj., ashtu edhe huazimin mbarëshqiptar nga greqishtja e vjetër μᾶχωνᾶ > *mokën/ mokër*. E huazimet nga greqishtja e vjetër në shqipe dëshmojnë se të parët e shqiptarëve kanë qenë fqinjë veriorë të grekëve.

Por që ata kanë pasë banuar qysh herët në pjesën perëndimore të Ballkanit, në brigjet e Jonit dhe të Adriatikut, këtë na e vërteton edhe më mirë prania e huazimeve shumë të vjetra latine në mbarë shqipen, çka dëshmon se trojet ku banonin stërgjyshërit e shqiptarëve, ishin ndër të parat, që u pushtuan nga romakët qysh para erës së re. E një gjë të tillë e kanë vënë në dukje edhe një varg studiuesish të shquar të huaj, nga të cilët unë po përmend vetëm zviceranin W. Meyer-Lübke dhe rumunin H. Mihăescu. Meyer-Lübke-ja (1914, 32) pohon, ndër të tjera, se "... elementi latin në shqipe paraqit një gjendje gjuhësore më të vjetër se çdonjëra prej gjuhëve romane".

⁴² Për sqarime më të plota të interesuarit mund të konsultojnë veprën tonë *Prejardhja e shqiptarëve në dritën e dëshmive të gjuhës shqipe*, faqe 73 v.

Ndërsa Mihăescu në studimin e tij të vitit 1966, *Les éléments latins de la langue albanaise*, f. 30 v., ka arritur në përfundimin se në gjuhën shqipe janë ruajtur edhe një numër i konsiderueshëm huazimesh latine (rreth 85 fjalë) që nuk kanë mbijetuar në asnjë gjuhë romane, si: *bujk*<*bubulcus*, *mërrajë*<*hibernalia*, *shelqëror*<*sarcinarius*, *tërfurk*<*trifurcus* etj. Madje, sipas tij (po aty), rreth 151 huazime latine të shqipes nuk ndeshen në rumanishte, si: *mik*<*amicus*, *anmik/armik*<*inimicus*, *bekoj*<*benedicere*, *qelq*<*calic-em*, *kështjellë*<*castellum*, *qind*<*centum*, *gjel*<*gall-us*, *gjymtyrë*<*iunctura*, *mjek*<*medicus*, *nulli*<*molinum*, *rjetë*<*rete*, *shërbej*<*servire*, *shpërej* (sot *shpresoj*<*shpresë*)<*sperare*, *vullnet*<*voluntas* (*voluntat-em*) etj.

Gjithsesi, për vjetërsinë e madhe të huazimeve latine të shqipes dëshmojnë edhe disa veçori gjuhësore, nga të cilat unë po përmend vetëm nja dy.

Në latinishte bashkëtingëlloret mbylltore grykore /k-/ (shkruar /c-/) dhe (g-/), të ndjekura nga një zanore e përparme /-i/ ose /-e/, në një fazë të vjetër, të paktën deri aty nga shekujt IV-V të erës së re (ndoshta edhe më herët), e kishin ruajtur shqiptimin grykor (shih Tekavçi: 1972, f.152 dhe Mihăescu: 1978, 199 vv.). Në gjuhën shqipe ka disa huazime latine, që i përkasin asaj periudhe të lashtë të latinishtes. Të tilla janë, ndër të tjera, huazimet *peshk*<*pisc-is*, *qiell*<*cael-um*, *qytet*<*civitat-*, *qepë*<*cepa*, *fqinj*<*vicin-us*, *shëgjetë*<*sagitta*⁴³. Të krahasohen këto me trajtat gjegjëse rumune *peste*, *cer*, *cetate* 'kështjellë', *ceap*, *vecin*, *sit* (arumanisht) (shih Mihăescu: 1966), si edhe me italishten *pesce*, *cielo*, *città*, *cip-olla*<**cep-ula*, *vicino*, *saetta*. Duke u mbështetur në këtë fakt gjuhësor, Kopitari (1945, I, f.254) nxori me mprehtësi përfundimin që në këtë rast kemi të bëjmë me huazime të lashta të shqipes që, sipas tij, pasqyrojnë "shqiptimin romak të kohës së Augustit".⁴⁴ Ka edhe dukuri të tjera, që dëshmojnë për lashtësinë e disa huazimeve latine të mbarë shqipes, si

⁴³ Në gjuhën shqipe më pas bashkëtingëlloret /k-/ dhe /g-/ të ndjekura nga një zanore e përparme, kanë evoluar në /q-/ përkatësisht /gj-/; krahaso edhe format e shumësit (*mik* ~) *miq*, (*zog* ~) *zogj* etj., ku qiellzorëzimi i grykoreve është shkaktuar nga mbaresa e dikurshme e rasës emërore shumë **-/i/*.

⁴⁴Të krahasohet edhe huazimi i lashtë gjerman *Kaiser*<*Caesar*.

evolucioni i lashtë /ō/>/e/ në fjalë të tilla si *pemë*<*pōmun*, *herë*<*hōra* etj. E duke u mbështetur edhe në fakte të tjera gjuhësore, në përgjithësi është arritur në përfundimin që ndikimi i latinishtes mbi gjuhën “nënë” të shqipes ka nisur mjaft herët, pas gjithë gjasash, jo më vonë se shekulli II para erës së re (shih Mihescu: 1966, f.33, Çabej: 1974, 14vv., Pellegrini: 1982, f.101 etj.)

19. Por për rastin e Epirit mund të parashtrohet dyshimi që popullsia shqipfolëse e asaj treve mund të jetë e ardhur dhe të ketë zëvendësuar një popullsi të mëparshme greqishtfolëse a të helenizuar. Një dyshim i tillë gjen njëfarë mbështetjeje në pozicionin gjeografik të Epirit shumë afër trevave greke, pra shumë të ekspozuar ndaj ndikimit të fuqishëm grek. Mjerisht, edhe në këtë rast mungojnë dëshmitë historike, që mund të hidhnin dritë për ndonjë shpërngulje të tillë popullsie në trevën e Epirit, apo që mund ta përgënjeshtrojnë një mundësi të tillë. Megjithatë, nuk kanë munguar pohime për një dyndje shqiptarësh edhe në zonën e Epirit. Kështu, D. Nicol-i (1997, 211v.), duke bërë fjalë për arsyet e dyndjes së arvanitëve (a më saktë të arbëreshëve) në trevat greke në shekullin XIV pohon se ato ishin pasojë e politikës së Stefan Dushanit për të zgjeruar mbretërinë e tij edhe më në jug dhe për këtë qëllim “inkurajoi shqiptarët që ta kryenin këtë punë për të, duke u futur në Epir dhe Thesali”. Në përgjithësi, dihet se në shekullin XIV, si edhe më herët e më vonë, kanë ndodhur shtegtime shqiptarësh në viset greke, sidomos në Thesali, Atikë, Beoti e Peloponez, si edhe në disa ishuj grekë të Egjeut, si: Eubea, Hidra, Salamina etj. Arsyet e atyre shtegtimeve, që si të tilla dalin jashtë synimeve të këtij studimi, janë trajtuar bindshëm në veprën e P. Xhufit, *Dilema e Arbërit* (2006, f. 357-369), ku vihen në dukje edhe zonat greke, ku u vendosën shtegtarët arbëreshë dhe veprimtaria e tyre atje.

20. Ajo që ka rëndësi të trajtohet në rastin tonë, është të sqarohet nëse viset e të ashtuquajturit Epir u populluan apo u çpopulluan nga arbërishtfolësit gjatë atyre shtegtimeve të shekujve XIV - XV. Nga artikulli i porsacituar i D. Nicol-it të krijohet përshtypja sikur gjatë sundimit të Stefan Dushanit shqiptarët u inkurajuan të vendoseshin, ndër të tjera, edhe në Epir. Por ngjarjet historike të shekullit XIV, sikurse i ka sqaruar P. Xhufi (2006, 358v. - me dokumentimin përkatës), dëshmojnë se Epiri dhe vise të tjera të Shqipërisë Jugore në vitet 20-30 të atij shekulli, si rrjedhim

i kryengritjeve kundër pushtetit bizantin, u ballafaquan me një varg masash të rënda ndëshkimore, që shkaktuan, ndër të tjera, edhe emigrimin e masave të gjera të popullsisë shqipfolëse drejt trevave greke. Për prejardhjen e masave shtegtuese të asaj periudhe nga viset e Shqipërisë Jugore, duke nënkuptuar në radhë të parë viset e të ashtuquajturit Epir, përveç të dhënave historike (shih Xhufi: 2006, 314v.), dëshmojnë edhe veçoritë gjuhësore të të folmeve të arbëreshëve të Greqisë, që janë shumë të ngjashme me të folmet jugore në përgjithësi dhe me nëndialektin e çamërishtes në veçanti. Mjafton të përmendim këtu faktin e njohur që si në të folmet e arbëreshëve të Greqisë, ashtu edhe në çamërishte ruhen ende grupet bashkëtingëllore /kl/ e /gl/ në fjalë të tilla, si: *klunësht* = qumësht/, *klëshë* = qeshë/, *gluhë* = gjuhë/ etj., ashtu edhe /-l-/ ndërzanore në fjalë të tilla, si: *golël* = gojë/, *bilël* = bijël/, *malël* = majël/ etj.

21. Gjithsesi, çështja e përkatësisë etnike të popullsisë së Epirit në mesjetën e hershme dhe të vonë nuk mund të ndriçohet me pohime apo supozime të paargumentuara. E në këtë rast gjithashtu mungesa e dëshmive historike mund të plotësohet me dëshmitë e vetë gjuhës shqipe. Është fjala për vjetërsinë e ndarjes dialektore të shqipes, që parakupton edhe hapësirat gjeografike ku janë zhvilluar dialektet dhe nëndialektet e kësaj gjuhe. Siç dihet dialekti jugor i shqipes (me nëndialektet e tij, ndër të cilët edhe çamërishtja e skajit më jugor) është zhvilluar në jug të lumit Shkumbin. Ai dallohet nga dialekti verior nëpërmjet disa dukurive, nga të cilat mund të përmenden, sa për shembull, evolucioni i /a-/ së së theksuar para një bashkëtingëllores hundra në /-ë/ vetëm në fjalë të trashëguara si: *hanë* > *hënë*, *e am-a* > *e ëm-a*, *banj* > *bënj* etj.. ose të huazuara nga latinishtja si *dam* > *dëm* < *damn-um*, *shkamb* > *shkëmb* < *scamn-um* etj, si edhe evolucioni /-n-/ > /-r-/ (rotacizmi) gjithashtu vetëm në fjalë të trashëguara si *venë* > *verë*, *ban-a* > *bër-a* etj. ose të huazuara nga latinishtja si *ranë* > *rërë* < *arena*, *mun(ë) g* > *mur(ë) g* < *monac-us*, *Vlonë* > *Vlorë*, *Fanari* > *Frari* etj. Këto dy dukuri të vjetra (parasllave) karakteristike të dialektit jugor nuk mund të zhvilloheshin veçse në trevat e sotme shqipfolëse. Përndryshe, do të duhej të pranonim që folësit e tyre duhet t'i kenë bartur ato me vete nga vise të tjera, prej nga duhej të ishin shpërngulur, çka duhej vërtetuar.

22. Pra, a janë banorët e të ashtuquajturit Epir, sidomos ata që dëshmojnë

prej kohësh si shqipfolës, pasardhës të shpërngulurish arbëreshë gjatë shekullit XIV apo më herët a më vonë? Po të pranohej një hipotezë e tillë, kjo do të parakuptonte asimilimin e një popullsie greke a të helenizuar nga arbëreshët e shtegtuar atje. Mirëpo, po të mbahen parasysh rrethanat historike-shoqërore, që u vunë në dukje këtu më sipër, atëherë del e qartë se nuk ka pasur dhe as nuk mund të kishte kushte për ndonjë asimilim të pretenduar të popullsisë “greke a të helenizuar” të të ashtuquajturit *Epir* nga arbëreshët a shqiptarët. Përkundrazi, faktet historike dëshmojnë një proces të kundërt. Mjafton të kemi parasysh helenizimin e shkallëshkallshëm të banorëve shqipfolës të Epirit, sidomos pas shpalljes së pavarësisë së Greqisë e në mënyrë të veçantë helenizimin e Çamërisë pas vitit 1912 me shpërnguljen e detyruar të çamëve myslimanë për në Turqi sidomos gjatë vjetëve 1923 - 1925, si edhe më vonë nën preteksin se ata ishin turq, ose me shpërnguljen e tyre të dhunshëm në Shqipëri pas vitit 1945 (shih Meta: 2002, 141 vv., 183v.). Për më tepër, edhe ata çamë të krishterë, që kanë mbetur në trojet e veta, kanë ardhur duke e humbur identitetin e tyre etnik nën ndikimin e kishës dhe të shkollës greke. Por, pas gjithë gjasash, Epiri në shekujt XIV - XV për shtegtarët shqiptarë a arbëreshë, që mund të kenë qenë edhe të kësaj zone, ka shërbyer si urë kalimi për në trevat greke më në jug, ku kanë mbijetuar deri në ditët tona të ashtuquajturit arvanitë, të cilët e kanë ruajtur në njëfarë mase gjuhën amtare, shqipen a arbërishten arkaike. Sipas karakteristikave të të folmeve të tyre arkaike⁴⁵, ata duhet të jenë shpërngulur nga vise të Shqipërisë Jugore, me sa duket, kryesisht për arsye ekonomike, pak a shumë siç ndodhi në kohën tonë sidomos pas vitit 1990.

⁴⁵ Të folmet arkaike të arvanitëve (a më saktë, të arbëreshëve të Greqisë) kanë tërhequr prej kohësh vëmendjen e studiuesve që kanë botuar një material të mirë të mbledhur në vend. Botimi i parë, që kemi prej tyre, është ai i anglezit C. H. T. Reinhold me titullin *Noctes Pelasgicæ*, Athenis 1854, ribotuar, i transkriptuar në Tiranë më 2005 nga Ardian Klosi. Midis botimeve të shumta për gjuhën e arvanitëve, duhen përmendur sidomos Phurikë (=Furiqi) P. A. *Pothen to ethnikon Arbanites?* Athinë 1931; po ai, *Hē en Attikē Hellen Albanikē dialektos*, Athinë 1933. Haebler, Claus. *Grammatik der albanischen Mundart von Salamis*, Wiesbaden 1965. Sasse, Hans-Jürgen, *Arvanitika. Die albanischen Sprachreste in Griechenland*, Wiesbaden 1991. Bellusci, Antonio. *Ricerche e studi tra gli arbërori dell'Ellade*, Cosenza 1994.

Gjithsesi, banorët shqiptarë në viset e të ashtuquajturit *Epir* në jug apo në veri të kufirit të sotëm shtetëror të Shqipërisë nuk mund të kenë qenë aty ardhacakë dhe të kenë asimiluar një popullsi të mëparshme greke a të helenizuar, që pa dyshim do të ishte e një niveli më të ngritur kulturor dhe që për më tepër kishte edhe mbështetjen e autoriteteve qeveritare bizantine dhe më pas të qeverisë greke, si edhe të kishës ortodokse greke. Në një përfundim të tillë arrihet edhe po të kihet parasysh gjendja demografike e Epirit në periudhën e hershme të pushtimit osman që, siç do të vihet në dukje këtu më poshtë, del se kishte një përbërje etnike kryesisht shqiptare, që nuk mund të ishte rezultat i ndonjë shpërnguljeje pak a shumë të hershme.

23. Por, edhe sikur të mendohej që në kohë të shkuara disa shtegtarë shqiptarë a arbëreshë nga vise më veriore të kenë qëndruar ndonjëherë në Epirin e mirëfilltë midis popullsisë shqipfolëse, ata nuk kanë sjellë ndonjë ndryshim në përbërjen etnike të asaj popullsie, e cila, siç do të vihet në dukje më poshtë, në defterët osmanë të shekullit XVI paraqitet me disa emra tipikë mbarëshqiptarë, që dëshmojnë qartë përkatësinë e tyre etnike jogreke. E kjo përbërje etnike nuk mund të jetë rezultat i shtegtimeve arbëreshe të shekullit XIV (apo më parë a më pas), që nuk mund të sillnin ndryshime të tilla rrënjësore në një trevë, ku ndikimi sidomos i kishës greke ishte shumë i madh.

Natyrisht, gjatë shekujve kanë ndodhur shtegtime të ndërsjella midis popullsive të vendeve fqinje. Mjafton të kujtojmë "kolonitë" greke në *Epidamn* a *Durrës*, *Apoloni*, *Lissus* (Lezhë), *Orik* dhe *Aulona* (Vlorë) në kohë të lashta (shih temën mbi kolonitë greke etj. në Kreun III), apo enklavat greqishtfolëse të *Dropullit* dhe të *Vurgut* të Delvinës të krijuara në kohë më të reja (shih temën për *Dropullin* në Kreun VII). Gjithashtu greqishtja është përhapur edhe në disa katunde të bregdetit jugor (shih temën përkatëse për bregdetin jugor në Kreun V). Por, me sa duket, shtegtimet e popullsisë kanë ndodhur më fort drejt jugut (Greqisë) për arsye të ndryshme, kryesisht ekonomike, siç është rasti i arvanitëve apo i emigrimeve të masave të gjera shqiptarësh pas vitit 1990. Gjithsesi, këto emigrime nuk kanë shkaktuar ndonjë çhelenizim të popullsisë greke. Kështu p.sh. arvanitët nuk kanë

luajtur dhe nuk mund të luanin ndonjë rol asimilues ndaj popullsisë greke të viseve, ku shkuan e u vendosën. Përkundrazi, ata kanë ardhur duke e humbur identitetin e tyre etnik, sidomos brezi i ri gjatë dy shekujve të fundit, jo vetëm nga mungesa e kontakteve me shqiptarët dhe nga mungesa e shkollave në gjuhën amtare, por edhe nga kontaktet e shpeshuara dhe nga përzierja me grekët, si edhe nga përhapja e opinionit se ata si ortodoksë gjithçka i bashkon me grekët. Ne nuk e dimë se sa arvanitë kanë shtegtuar për në viset greke⁴⁶, ku ata gjatë shekujve kanë bërë një jetë në përgjithësi të mbyllur midis tyre, të paktën deri në kohën e luftës së grekëve për pavarësi nga Turqia, luftë në të cilën ata kanë luajtur një rol të rëndësishëm, të njohur edhe nga historianët grekë. Si rrjedhim i faktorëve që u prekën shkurt pak më sipër, numri i arvanitëve që flasin shqipen e tyre arkaike është pakësuar shumë.

24. Gjithsesi, është një fakt i pakundërshtueshëm që popullsia e viseve më jugore të Epirit, si rrjedhim i ndikimit të fuqishëm të greqishtes, i është nënshtruar një procesi të vazhdueshëm helenizimi, që ka marrë përmasa gjithnjë e më të mëdha gjatë shekujve të fundit. E këtë na e dëshmon qartë fakti që, siç do të vihet në dukje këtu më poshtë, në kohën e pushtimit osman gjendja demografike e atyre viseve paraqitet ndryshe nga ç'është sot. E ndryshimi i kësaj gjendjeje demografike në viset më jugore të Epirit të lashtë tregon qartë se në këtë ndërkohë, si rrjedhim i faktorëve, që u prekën shkurt këtu më sipër, është kryer helenizimi i vazhdueshëm i një pjese të mirë të banorëve të mëparshëm autoktonë të atyre viseve

IV. Epiri pas pushtimit osman

25. Njohuritë tona për gjendjen demografike të të ashtuquajturit Epir për periudhën pas pushtimeve osmane të Ballkanit janë më të sakta, pasi fatmirësisht janë ruajtur defterët e regjistrimeve të popullsisë të vendeve të pushtuara, që administrata turke për qëllimet e saj i kryente në ato vende. Të dhënat e atyre

⁴⁶ Sipas Hahn-it (1854, f. 32), në shekullin XIX në Greqi jetonin 173 000 arvanitë, shumica e të cilëve flisnin shqip.

regjistrimeve ndihmojnë edhe për të njohur gjendjen demografike të Epirit dhe të trevave të tjera të banuara nga shqiptarët në periudhën paraturke, sepse defterët osmanë të shekujve të parë të pushtimit turk pasqyrojnë një gjendje demografike të këtyre trevave, që ishte përfunduar gjatë shumë shekujve të mëparshëm. E, siç e kemi vënë në dukje edhe më sipër, rrethanat historike-shoqërore si në periudhën e lashtësisë ashtu edhe gjatë mesjetës së hershme nuk ndihmonin për përhapjen e elementit shqiptar në këto treva, por për të kundërtën.

Në regjistrat osmanë, siç dihet, zakonisht janë shënuar emrat e kryefamiljarëve (ose të beqarëve) meshkuj e aty-këtu edhe femra, kur këto ishin gra të veja. Gjithsesi, nga emrat e kryefamiljarëve mund të kuptohet pa vështirësi edhe përkatësia etnike e gjithë familjeve që ata përfaqësonin. Siç do të vihet në dukje më poshtë, në regjistrimet osmane të shekujve të parë të pushtimit të Epirit mbizotërojnë emra tipikë shqiptarë, megjithëse nën ndikimin e kishës ortodokse nuk mungojnë edhe trajta emrash të tipit grek, gjë që është e kuptueshme për një zonë të tillë kufitare me grekët, siç ishte Epiri. Shqyrtimi i të gjithë onomastikës së pasqyruar në regjistrat osmanë për këtë zonë, do të kërkonte shumë hapësirë. Por një punë e tillë do të meritonte më shumë vëmendje se deri sot, sidomos për të parë ndryshimet e vërtetuara në onomastikën e popullsisë së viseve dikur shqipfolëse, që pas vitit 1912 mbetën brenda kufijve të shtetit grek. Kështu p.sh. në vendin tonë nuk janë botuar ende të dhënat onomastike të defterëve osmanë të shekujve të parë pas pushtimit turk të vendbanimeve të tilla si *Arta* a *Narta*, *Preveza*, *Janina* etj. Vetëm kohët e fundit u botua në revistën "Studime historike" 1-2/2007 një studim i Ferit Dukës për kazatë çame të Ajdonatit (Paramithisë) dhe të Mazrakut, me të dhëna edhe për onomastikën e atyre kazave sipas defterëve osmanë të vjetëve 1551 dhe 1583. Më parë janë botuar të dhëna onomastike të defterëve osmanë të shekujve të parë të pushtimit turk për disa vise të Epirit, që kanë mbetur brenda kufijve të shtetit shqiptar, si p.sh. për kazanë e Delvinës e të Vlorës. Por këto të dhëna janë bërë objekt shqyrtimi në tema të veçanta kushtuar zonës së Vlorës (shih Kreun VI) dhe viseve të Dropullit e të Vurgut (shih Kreun VII), ku sot flitet greqisht, si edhe viseve të Bregdetit Jugor, ku në disa fshatra krahas shqipes gjatë shekujve të

fundit është përhapur edhe greqishtja, sidomos midis meshkujve (shih Kreun V). Prandaj këtu poshtë do të ndalemi kryesisht në onomastikën e *Ajdonatit* (Paramithisë) dhe të *Mazrakut* dhe të viseve më jugore të Epirit, ashtu siç na dëshmojnë defterët e hershëm osmanë të regjistrimit të popullsisë. Siç do të dalë nga analiza e mëposhtme, edhe në ato treva në defterët e shekujve të parë të pushtimit osman ndeshen disa emra tipikë shqiptarë, që dëshmohen edhe në treva të tjera shqiptare.

26. Dhe po e nisim me *Ajdonatin*, qendër qytetare që, sipas regjistrimit osman të vitit 1583, kishte rreth 600 shtëpi, d.m.th. kishte një popullsi prej rreth 4500-5000 frymësh (shih Duka 2007, f. 3).

Ndër emrat e shumtë të kryefamiljarëve të këtij vendbanimi atëherë bien në sy edhe disa emra tipikë, që ndeshen në të gjitha trevat shqipfolëse të asaj kohe. Këtu do të ndalemi kryesisht në emrat *Lekë*, *Gjon*, *Gjin*, *Pal* e *Pjetër*, që paraqisin më shumë interes, sepse dalin me forma, që nuk ndeshen në gjuhë të tjera, ballkanike ose joballkanike, pra dëshmojnë se i janë nënshtruar prej kohësh të hershme një evolucioni të pandërprerë në gojën e shqipfolësve gjatë shekujve.

Emri *Lekë*, që është një trajtë e shkurtuar e emrit të lashtë *Aleksandër* prej burimi epiroto-maqedonas, siç shihet, në gojën e shqipfolësve ka pësuar ndryshime të mëdha, që në vështrim të parë të lënë përshtypjen sikur këto dy trajta nuk kanë lidhje midis tyre. Rënia e tingullit nistor dhe e tingujve fundorë është pasojë e theksit dinamik të shqipes, i cili ka rënë mbi rrokjen e dytë /-lé-/ . Trajta *Lekë* ka qenë e përhapur si në trevat veriore, ashtu edhe në trevat jugore të shqipes, siç na dëshmojnë, ndër të tjerë, emra të tillë si *Lekë* Dukagjini, *Gjoleka* < *Gjon Leka* (i Kuçe) etj. Ky emër për viset jugore dëshmohet edhe në defterët osmanë të shekujve XVI - XVII. Por këtu do të ndalemi pak vetëm për viset më jugore të Epirit, që tashti bëjnë pjesë në shtetin grek⁴⁷. Kështu, në defterin e shekullit XVI për *Ajdonatin* dhe *Mazrakun* gjejmë, ndër të tjerë: *Mensh Leka* (beqar), *Dhimo Leka* dhe *Pal Leka* nga Dragani, *Leka Duka* nga Gllavica, *Nika Leka*, *Leka Çero*, *Leka Vlashi*, *Leka Llazari*, *Deda*

⁴⁷ Për Bregdetin Jugor, Dropullin dhe Vurgun, si edhe për Vlorën shih temat përkatëse në këtë libër dhe pikërisht Kreun V, përkatësisht VI, VII.

Llaq *Leka*, *Leka* Meçari, Nika *Leka* (2 herë), *Leka* Llaqi, Jani *Leka*, Janji *Leka*, Ilija *Leka*, Reç *Leka*, Kalir (?) *Leka*, Asti *Leka*, *Leka* Kondi, *Leka* Gjini, *Leka* Deda, *Leka* Nika, Gjin *Leka*, *Leka* Gjini, Gjon *Leka*, Jorgo *Leka*, *Leka* Jani, Thanas *Leka*, Andria *Leka*, *Leka* Mosira si, edhe Hasan *Leka* e Ahmed *Leka*.

Emri *Lekë* ndeshet, megjithëse më pak, edhe në defterin osman të vitit 1582-83 për vilajetin e *Janinës*. Kështu p.sh për vetë qytetin e *Janinës* në atë regjistër gjejmë: *Lekë* Dhijaku. Por disi më dendur ai ndeshet nëpër fshatrat e atij vilajeti, si p.sh. në fshatin *Vishtaveci* i *Madh* gjejmë: *Lekë* Kordili, *Lekë* Goride, *Lekë* Golari. Po në këtë fshat është regjistruar edhe Jani *Lakra*. Kurse për qytetin e *Prevezës*, që sipas atij defteri paraqitet me rreth 70 banorë, sepse, me sa duket, në atë kohë popullsia nga ai vendbanim do të kenë qenë larguar, emri *Lekë* del vetëm një herë: *Lekë* Kuqino, si edhe Jorgji *Leka*, Jani Martini, *Leka* i biri, *Lekë* Ishtamani etj. nëpër fshatra. Po kështu edhe për zonën e *Artës* a të *Nartës*: *Lekë* Baboçi, Petri *Leka* etj.

27. Edhe te trajta shqipe *Gjon*, në përjasje me trajtën latine *Joánnes* (dhe kjo nga hebraishtja *Johannas*), bien në sy disa ndryshime të mëdha fonetike: shpërngulja e theksit mbi rrokjen e parë, rënia e zanores /-a/, mbetur e patheksuar, dhe e fundores /-es/, si edhe evolucioni /j-/>/gj-/. Nga këto dukuri duhet veçuar sidomos zhvendosja e theksit mbi rrokjen e parë, gjë që vihet re në disa huazime të vjetra të shqipes, si te *mókën(ë)/mókër(ë)* nga greqishtja e vjetër *māk^hanā*⁴⁸; të kihet parasysh edhe theksimi i rrokjes nistore te *Durrës* përkundrejt trajtës latine *Dyrráchium*⁴⁹. Edhe evolucioni /j-/>/gj-/, si te huazimet latine *gjymtyrë*<*iunctura*, *gjyq*<*iudicium* etj., dëshmon gjithashtu për vjetërsinë e depërtimit të emrit *Gjon* ndër stërgjyshërit e shqiptarëve⁵⁰. E ky evolucion e bën edhe më të qartë ndryshimin e madh, që ka pësuar ky emër në gojën e shqiptarëve gjatë shekujve e një gjë e tillë

⁴⁸ Shih për këtë dukuri Demiraj: 1996, 38.

⁴⁹ Shih për këtë Demiraj, *vep. e përmendur*, f. 130vv.

⁵⁰ Të kihet parasysh edhe emri i zogut *gjon* (= qokth), që e ka burimin tek emri i përveçëm *Gjon* (shih E. Çabej, *Stud. Etim.*, vëll. IV. Tiranë 1996, f. 335).

bie edhe më tepër në sy, po të krahasohet trajta *Gjon* e shqipes me gjeçjëset e saj në gjuhë të tjera. Kështu, emri *Gjon*, që në shqipë ka hyrë si një emër i krishterë prej burimi latin, në greqishte del në trajtën *Jani(s)*, në rumanishte del në formën *Ioan*, në gjuhët sllave del në trajtat *Ivan* e *Jovan*, në italishte *Giovanni*, në frëngjishte *Jean* [= Zhâ], në spanjishte *Juan* [= Huan], në anglishte *John* [Xho:n] etj.

Për përdorimin e hershëm të emrit *Gjon* ndër stërgjyshërit e shqiptarëve të sotëm dëshmon, ndër të tjera, prania e tij e dikurshme mjaft dendur në të gjitha trevat shqiptare, pra si në Veri edhe në Jug, si ndër katolikë edhe ndër ortodoksë. Mjafton të kujtojmë nga veriu manastirin e *Shën Gjonit* (afër Elbasanit), si edhe emrin e të parit shkrimtar shqiptar, Don *Gjon Buzukut*, në veprën e të cilit gjejmë edhe Shenjti *Gjon* e Pal, Shenjti *Gjon* Baptista, Shenjti *Gjon* Evangjelista etj. Për trevat veriore emri *Gjon* dëshmohet edhe në dokumente më të vjetra, si p.sh. në Krisobullat e Deçanit të shekullit XIV, ku përmenden, ndër të tjerë, emrat shqiptarë *Gjon* Bushat, *Gjon* Mëhill.⁵¹ Ky emër del dendur edhe në Defterin e Regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485, si p.sh. *Gjon* Deda, *Gjon* Andrija, *Gjon* Gjini, Pal *Gjoni* etj.⁵² Emri *Gjon* ka qenë vazhdimisht në përdorim ndër shqiptarët katolikë të Veriut. Mjafton të kujtojmë Dedë *Gjo*-Lulin, *Gjon* Marka *Gjonin* etj.

Emri *Gjon* ka pasur një përdorim të gjerë edhe ndër shqiptarët jugorë, për çka dëshmojnë, ndër të tjerë, jo vetëm emra të tillë si *Gjon* Muzaka, *Gjon* Zenebishi etj., kalaja e *Gjon* Boçarit (afër Tragjasit të Vlorës), por edhe defterët e parë të regjistrimeve osmane, si ato për zonën e Dropullit e të Vurgut, për zonën e Bregdetit Jugor etj. (shih temat përkatëse). Por këtu do të ndalemi pak vetëm në defterët osmanë për viset më jugore, siç janë vendbanimet e *Ajdonatit* dhe të *Mazrakut* si edhe të *Janinës*, të *Prevezës* dhe të *Artës* a *Nartës*.

28. Sipas defterëve osmanë të shekullit XVI (shih F. Duka: “Studime

⁵¹ Shih R. Ismajli, “Disa çështje të onomastikës mesjetare”. Në: *Onomastika e Kosovës*. Prishtinë, 1979, f. 52, 53.

⁵² Shih S. Pulaha, *Defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485*. Tiranë, 1974, *passim*.

historike" 1-2/2007), në *Ajdonat* emri *Gjon* ndeshet mjaft dendur jo vetëm si emër personi, por edhe si llogar. Për të mos e rënduar pa nevojë punimin, po rendisim këtu vetëm disa shembuj nga fshatrat *Karbunarë* dhe *Kurtes*. Nga fshati *Karbunarë* në regjistrimin e vitit 1551: *Gjon* Llaqi, *Gjon* Tupe, *Gjon* Nika (2 herë), *Gjon* Koleci, *Gjon* Çero, Pal *Gjoni*, Gjini *Gjoni*, Nika *Gjoni*, *Gjon* Kondi etj. Po kështu në fshatin *Kurtes*: *Gjon* Bustra, Pollo ((Bulo?) *Gjoni*, Sino *Gjoni*, Andria *Gjondhima*, Nika *Gjoni*, Pal *Gjoni*, *Gjon* Reçi, *Gjon* Dhimo, Deda *Gjoni*, Nika *Dedagjoni*, *Gjon* Dade (Daka?), Stamad *Gjoni*, Ahmed *Gjoni*. Po kështu në regjistrimin e vitit 1583: Pal *Gjoni*, Gjini *Gjoni* (2 herë), *Gjon* Nika (2 herë), Dhimo *Gjoni*, Kushe *Gjoni*, *Gjon* Pone, *Gjon* Pali, Nika *Gjoni*, *Gjon* Kondi, *Gjon* Mamazhupa, Duka *Gjoni*, *Gjon* Lala, Llaq *Gjoni* (shih F. Duka: 2007, f. 10-14).

Emri *Gjon* del dendur edhe në fshatin *Kurtes* të *Mazrakut*. Kështu në regjistrimin e vitit 1551: Dhima *Gjoni*, Andria *Gjoni* (3 herë), Kosta *Gjoni*, *Gjon* Jani (2 herë), Menksh *Gjoni*, *Gjon* Menkshi, Pal *Gjoni* (2 herë), *Gjon* Deda (2 herë), *Gjon* Nini, Leka *Gjoni*, Tupe *Gjoni*, *Gjon* Tupe, *Gjon* Leka, Gjini *Gjoni*, Nika *Gjoni*. Edhe në regjistrimin e vitit 1583 emri *Gjon* në këtë fshat del dendur: Andria *Gjondhima*, Pollo (Bulo?) *Gjoni*, Gjirko *Gjoni*, *Gjon* Bustra, Jorgo *Gjoni*, Nika *Gjoni* (2 herë), Sino *Gjoni*, Pal *Gjoni*, Ahmed *Gjoni*, *Gjon* Reçi, *Gjon* Dhimo, Deda *Gjoni* (2 herë), *Gjon* Pollo (Bulo?), Mehmed *Gjon-sino*, Stamad *Gjoni* (shih F. Duka: 2007, f. 14-15).

Në viset më jugore të Epirit, sipas defterëve osmanë të vitit 1582-83⁵³, emri *Gjon* shfaqet gjithnjë e më rrallë, sepse është zëvendësuar gjithnjë e më shumë nga trajta e ndikuar prej greqishtes *Jani*. Kështu p.sh. në qytetin e *Janinës* emri *Gjon* del vetëm nja katër herë, si: *Gjon* Laskari, *Gjoni* Halika, Niko *Gjon-ç-i*, Dimo *Gjoni*, ndërsa nëpër fshatrat e *Janinës* del disi më dendur, por jo edhe aq shumë.

Për qytetin e *Prevezës* me shumë pak banorë në atë kohë, sipas atij defteri, emri *Gjon* nuk del fare. Por del në fshatin *Koka -Kandan*: Atanas *Gjoni*, Apostol

⁵³ Për onomastikën e qyteteve dhe të krahinave të *Janinës*, të *Prevezës* dhe të *Artës* a *Nartës* jemi mbështetur në materialin përkatës të transkriptuar nga Vexhi Buharaja pranë Arkivit të Institutit të Historisë në Tiranë.

Gjoni. Po kështu në fshatin *Pigodolje*: Todor *Gjoni* etj. Edhe më rrallë del emri *Gjon* në qytetin e *Artës*, ku gjejmë: *Gjon* Tabani.

29. Një problem më vete përbën emri *Gjin* i cili ndeshet vetëm në trevat shqipfolëse. Ky emër në përgjithësi mbahet si një variant i emrit *Gjon*, për çka do të dëshmonte fakti që emri i skelës së *Shëngjinit* [<Shën Gjin] në italishte është përkthyer *San Giovanni di Medua*⁵⁴. Por rruga dhe koha e shfaqjes së emrit *Gjin* nuk janë të qarta. Të kihet parasysh edhe vërejtja e Çabejt⁵⁵: “Nuk është e qartë lidhja historike midis dy trajtave shqiptare të këtij emri: *Gjon* e *Gjin*.” Gjithsesi, duhet pranuar që emri *Gjin* duhet të jetë shfaqur mjaft herët, për çka dëshmon prania e tij në të gjitha trevat shqiptare si një emër i ndryshëm nga *Gjon*. Madje, nuk janë të pakta rastet që nëpër dokumente një person mban emrin *Gjin* dhe mbiemrin *Gjon*, apo anasjelltas, siç do të dalë edhe nga shembujt më poshtë.

Lidhur me përhapjen relativisht të hershme të këtij emri në Shqipërinë Veriore mjafton të kemi parasysh jo vetëm skelën e *Shëngjinit*, por edhe krahinën e *Dukagjinit*, si edhe emrin e fikut *shëngjin-ës*, që piqet në qershor. Emri *Dukagjin*, që është përfutur nga bashkimi i togut *Duka Gjini*, del si emër etnik qysh në shekullin VII, por si emër i derës feudale të *Dukagjinëve* në Shqipërinë Veriore dokumentohet qysh nga shekulli XIV⁵⁶. Për vjetërsinë e emrit *Gjin* dëshmon përhapja e tij e gjerë në të kaluarën si në trevat veriore, ashtu edhe në trevat jugore të banuara nga shqiptarët. Për trevat veriore le të kujtojmë edhe përmendjen e këtij emri në Defterin e Regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485, ku gjejmë, ndër të tjera: *Gjini*, i biri i Kovaçit, *Gjini*, i biri i Valindit etj., *Leka Gjini*, *Leka* i biri i *Gjinit*, *Gjoni*, i biri i *Gjinit*, *Gjini*, i biri i *Gjinit* etj.⁵⁷ Por këtë emër e ndeshim edhe më herët; ai

⁵⁴ Toponimi *Shëngjin* del edhe në zonën e Shëngjergjit (Tiranë); ai dëshmohet edhe në Defterin Osman të vitit 1431 dhe në atë të vitit 1467 (shih D. Luka, *Studime gjuhësore*, VI, Shkodër 2001, f. 132, 155).

⁵⁵ Shih E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, IV. Tiranë, 1996, f. 336.

⁵⁶ Shih E. Çabej, *Studime etim.*, III, 346 (me literaturën përkatëse).

⁵⁷ Shih S. Pulaha, *vep. e përmendur*, f. 145, 146.

përmendet edhe në Krisobulat e Deçanit të shekullit XIV: *Gjin*, *Gjin Qerasoviq*⁵⁸. Të kihet parasysh se emri *Gjin* është ende në përdorim ndër katolikët e Shqipërisë Veriore, sidomos ndër mbiemra (Ilagape).

Emri *Gjin* ka qenë mjaft i përhapur edhe në viset e Shqipërisë Jugore, siç na dëshmojnë, ndër të tjera, emrat e *Gjin Bua Shpatës*, *Gjin Fratit* dhe *Gjin Zenevisit* të shekullit XIV⁵⁹. Edhe i ati i Gjon Muzakës quhej *Gjin* [shkruar *Ginno*]⁶⁰. Ky emër ka qenë i përdorur edhe ndër arbëreshët e Greqisë, ku ndeshet ende, megjithëse rrallë, sepse është zëvendësuar me trajta të tjera gjegjëse, si *Janj-i*, *Jano-a*, *Janko-a* etj.⁶¹ Kurse tek arbëreshët e Italisë nuk përdoret më, por gjurmët e tij ndeshen në kujtimet e tyre, siç na dëshmon vepra e Gavril Darës (të Riut), ku përmenden *Gjin Muzaqi*⁶², *Gjin Manëzi*⁶³, Nik e Pal *Dukagjini*⁶⁴. Për përhapjen e hershme të këtij emri ndër shqiptarët e Jugut dëshmon edhe dokumentimi i tij mjaft i dendur në regjistrat e hershëm osmanë për zonat e Dropullit dhe të Vurgut (shih Kreun VII), si edhe për Bregdetin Jugor, duke përfshirë edhe Vlorën (shih Kreun V dhe Kreun VI).

30. Emri *Gjin* del shumë dendur edhe në defterët osmanë të shekullit XVI për *Ajdonautin* dhe *Mazrakun*, siç dëshmojnë materialet e botuara nga F. Duka (1-2/2007, f. 11-16): *Gjin Jorga*, *Gjin Gjoni*, *Gjin Kemexhiu*, *Gjin (I) Steri* nga Gjuri, *Gjin Nikolla*, *Gjin Moçare*, *Gjin Gjurka*, *Gjin Nika*, *Gjin Mirali*, *Gjin-aq Tupe*, *Gjin Todri*, *Tupe Gjin Todri*, *Gjin Ngjevi*, *Ngjevi Gjini*, *Deda Gjini*, *Nika Gjini*, *Martin Gjini*, *Gjin-lala Marushi*, *Martin Gjini Lala*, *Llaq Gjini*, *Niko Gjini*, *Gjin Lapa*, *Gjin Dhimaqi*, *Gjin Jani*, *Dhimo Gjini*, *Nika Gjini*, *Thanas Gjini*, *Gjin Andria*, *Ahmed Gjini*, *Hasan Gjini*, *Osman Gjini-leka*.

⁵⁸ Shih R. Ismajli, *vep. e përmendur*, f. 52, 53.

⁵⁹ Shih *Burime tregimtare bizantine*, f. 240, 243, 249.

⁶⁰ Shih Ch. Hopf, *Chroniques gréco-romanes, inédites ou peu connues*, Berlin, 1873, f. 273.

⁶¹ Shih H. J. Sasse. *Arvanitika. Die albanischen Sprachreste in Griechenland*. Wiesbaden, 1991, f. 118.

⁶² Shih *Kënga e sprasme e Balës*, f. 174, 188.

⁶³ *Po aty*, f. 188.

⁶⁴ *Po aty*, f. 256.

Por, sipas Defterit osman të vitit 1582-83, në viset më jugore të Epirit emri *Gjin*, ashtu si emri *Gjon*, del më rrallë, megjithëse diçka më shumë se emri *Gjon*, sidomos nëpër fshatra. Kështu në atë defter për qytetin e *Janinës* emri *Gjin* del rreth katër herë, si: *Lagja Alqije Gjini*, *Gjin Rijosomat*, *Gjini Halika*, *Gjin Iskobri*. Por nëpër fshatra del disi më dendur. Kështu p.sh. në fshatin *Sadovica* del tri herë: *Jorgo Gjini*, *Paskal Gjini*, *Todor Gjini*. Po kështu në fshatin *Servijanie* del pesë herë: *Gjin Dimo* (2 herë), *Gjin Colje*, *Gjin Jorgo*, *Kommen Gjini*.

Edhe në qytetin e *Prevezës*, sipas atij defteri, emri *Gjin* del në dy raste: *Gjin Marko*, *Lekë Kuqino*, *Gjini* i biri.

Pak a shumë e njëjtë paraqitet gjendja për emrin *Gjin* edhe në zonën e *Artës* a *Nartës*, si p.sh. në qytetin e *Nartës*: *Gjin Mutafi* (2 herë), *Dimo Gjini*, *Gjin Ishtamadi*.

Do pasur parasysh se emri *Gjin*, ashtu si emri *Gjon*, del edhe i zgjeruar me prapashtesën *-kë*: *Gjikë*<*Gjin-kë*. Edhe kjo trajtë e zgjeruar dëshmohet qysh herët si në trevat shqipfolëse veriore, ashtu edhe në ato jugore. Por, ndërsa trajta *Gjo-kë*<*Gjon-kë* ndeshet më fort në të folmet veriore, trajta *Gjikë* është përhapur kryesisht në të folmet jugore, sidomos në ato të Labërisë, ku ndeshet edhe si emër familjeje a fisi jo vetëm ndër të krishterë, por edhe ndër myslimanë, si p.sh. në rrethin e Vlorës. Por trajta e zgjeruar *Gjikë*, ashtu si *Gjokë*, nuk del në materialet e botuara nga F. Duka (1-2/2007) për viset çame të *Ajdonatit* dhe *Mazrakut* gjatë shekullit XVI. Vetëm në një rast ndeshet emri *Llaq Gjink-o* (f. 14) në fshatin *Kurtes*. Pak a shumë e njëjtë paraqitet gjendja edhe për vilajetin e *Janinës* por, sipas defterit osman të lartpërmendur, emri *Gjikë* ndeshet edhe në *Lagjen Hamam* të *Janinës*: *Gjikë Mutafi*.

Prania gjithnjë më e paktë e emrave *Gjon*, *Gjin* e *Gjikë* në viset më jugore të Epirit është pasojë e përhapjes së trajtës së ndikuar nga greqishtja *Jani* në ato vise. E ky ndikim i kishës greke bëhet gjithnjë e më i madh sa më shumë shkohet drejt jugut. Nuk mungojnë edhe raste të pranisë së trajtave *Gjin* e *Gjon* dhe *Jani* tek i njëjti person, natyrisht si emër e mbiemër, si p.sh. *Jani Gjini* në qytetin e *Janinës*.

31. Edhe emri *Gjergj* nga latinishtja *Geórgius* në gojën e shqipfolësve ka pësuar ndryshime të dukshme fonetike, po të krahasohet me trajtat që ka marrë në gjuhët e tjera, si p.sh. greqisht *Jorgo-s*, rumanisht *Jorg*, por edhe *Gheorghe*, italisht *Giórgio*, frëngjisht *Geórg* etj. Te trajta shqipe *Gjergj* bie në sy jo vetëm shpërngulja e theksit mbi zanoren /-e-/ të rrokjes së parë, por edhe shndërrimi i /g/-së në fillim dhe në fund në fërkimoren /-gj-/ e këto dëshmojnë për vjetërsinë e përdorimit të këtij emri ndër shqiptarët si në Veri edhe në Jug, çka duket qartë edhe nga toponimi i *Shën Gjergjit*, si në Veri edhe në Jug. Përdorimi i këtij emri në trevat veriore është tashmë mjaft i dokumentuar. Të kihet parasysh, ndër të tjera, emri i baladës *Gjergj Elez Alia*. Por ai ka qenë i përhapur edhe në viset jugore, siç na dëshmon, ndër të tjera, edhe dita mbarëshqiptare e *Shën Gjergjit*. Mirëpo në viset jugore, nën ndikimin e kishës ortodokse, ka ardhur duke u përhapur më fort trajta greke *Jorgo* (ose e zgjeruar *Jorg-aq*) ose *Jorgji*, megjithëse ndeshet jo rrallë edhe trajta *Gjergj*. Kështu në Defterin osman të vitit 1520 për Sanxhakun e Vlorës, krahas trajtës së re *Jorgo* ndeshet edhe *Gjergj Deniqi*, *Gjin Gjergji* (f.179, 196). Edhe në defterët osmanë të shekullit XVI për *Ajdonatin* dhe *Mazrakun* ndeshet në pak raste vetëm trajta *Jorgo* ose *Jorgji*, si: *Papa Jorgji*, *Jorgji Mirali*, *Deda Jorgji*, *Pal Jorgo*, *Jorgo Menksh-i*. Edhe në viset më jugore të Epirit nën ndikimin e greqishtes del gjithnjë e më dendur trajta *Jorgo*. Kështu p.sh. në qytetin e *Janinës*, sipas regjistrit të vitit 1582-83, mbizotëron trajta *Jorgo*, kurse trajta shqiptare *Gjergji* nuk ndeshet.

32. Dhe së fundi dy fjalë edhe për emrat *Pāl* e *Pjetër*. Edhe këta dy emra të vjetër të krishterë dëshmohen herët si në Veri edhe në Jug me trajta arkaike në përputhje me rregullsitë e evolucionit fonetik të gjuhës shqipe. Kështu, emri *Pāl* nga latinishtja *Paulus* (a më fort *Paullus*) dëshmohet me /-a-/ të gjatë të përftuar nga evolucioni i diftongut të dikurshëm /-au-/>/-a-/, dukuri kjo që është shfaqur në fjalë të vjetra të trashëguara si *qaj*<*klau*- etj., si edhe në huazime të vjetra latine të shqipes si *ār*<*aurum*, *gaz*<*gaudium*, *pak*<*paucus* etj., por jo në huazime më të vona latine, si *kafshë*<*causa*, *lavd*<*laud*- etj. Trajta e vjetër *Pāl* të krahasohet me italishten *Paolo*, me frëngjishten *Paul* [Pol], me rumanishten *Pavël/Paul*, me serbo-kroatishten *Pavle/Pavao* dhe me greqishten *Pavl(l)o-s*. Kjo e fundit nën ndikimin

e kishës ortodokse është përhapur mjaft në trevat jugore shqiptare në trajtat *Pavël*, *Pavlo*. Por trajta e vjetër është e dokumentuar më herët si në trevat veriore edhe në jugoret. Mjafton të përmendet emri i *Shën Palit*, që përdoret kështu ndër të gjithë shqiptarët e krishterë. Trajta e vjetër *Pal* sot përdoret më fort në Shqipërinë Veriore, ku dëshmohet qysh herët. Mjafton të përmendim emrat e *Pal Engjëllit* e të *Pal Dukagjinit*. Në këtë trajtë dëshmohet ky emër edhe në Defterin e Regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485, si p.sh.: *Pali*, i biri i Nikollës, *Pali*, i biri i Shirgjit, Gjon *Pali*, Petr *Pali*, *Pal* Marku, *Pal* Gjergji, *Pal* Gjoni etj.⁶⁵ Edhe autorët e vjetër veriorë (Buzuku, Budi etj.) përdorin rregullisht trajtën *Pal* ose *Pāl*, si p.sh. gjejmë te Buzuku: *Pāl*, përse ti më bdon ...⁶⁶, shenjtji Gjon e *Pal*.

Edhe në trevat jugore shqiptare trajta e vjetër *Pal* ndeshet ende në disa krahina, si në Myzeqe, Korçë etj. Për më tepër, kjo trajtë e vjetër mbijeton edhe nëpër mikrotoponime të fshatrave të bregdetit jugor, si p.sh. në Qeparó: Buza e *Pale*, Bishti i *Kopalit*, Kroi i *Kopalit* [*ki Kostë Palit*]⁶⁷. Të kihet parasysh edhe mbiemri *Gjipali*<*Gjin Pali* në Çorraj të Kurveleshit dhe në Dukat. A. Dhrimoja⁶⁸ përmend edhe mikrotoponimin *Vij-e Pale* (Fterrë).

Trajta *Pal* ndeshet edhe në defterët osmanë të shekullit XVI për *Ajdonatin* dhe *Mazrakun*, si p.sh.: Nika *Pali* nga Dragani, Llaq *Pali*, *Pal* Kolaci, *Pali* Bitri, *Pali* (Jani?) Kaliri, Istamad *Pali*, Deda *Pali*, *Pal* Gjoni, Gjon *Pali*, Kond *Pali*, *Pal* Andria. Por ndeshet aty-këtu edhe trajta e ndikuar nga greqishtja *Pavlo*: *Pavlo* Llazari, *Pavlo* Maleqi (?) (shih F. Duka: 2007, 12 v.). Kurse në viset më jugore të Epirit mbizotëron trajta *Pavlo* si p.sh. në Janinë etj.

Edhe emri *Pjetër*<lat. *Petrus* në trajtën e vjetër me diftongimin /-e-/>/-ie-/ dëshmohet për të gjithë Shqipërinë. Mjafton të përmendet këtu emri mbarëshqiptar i *Shën Pjetrit*. Por në viset jugore, gjithnjë nën ndikimin e kishës ortodokse, ka

⁶⁵ Shih S. Pulaha, *vep. e përmendur, passim*.

⁶⁶ Shih f. LXXXIII/2 = 93/2.

⁶⁷ Shih N. Sotiri, *vep. e përmendur*, f. 254, 252, 263.

⁶⁸ Shih A. Dhrimo, *vep. e përmendur*, f. 44.

ardhur duke u përhapur më fort trajta greke *Petro* dhe forma e zgjeruar *Petr-aq*. Gjithsesi, në defterët osmanë të shekullit XVI për *Ajdonatin* dhe *Mazrakun* nuk del trajta arkaike *Pjetër*, por *Petro*. E kjo gjendje paraqitet në defterët osmanë të vitit 1582-83 edhe për Janinën, Prevezën dhe Nartën.

33. Prania e elementit shqipfolës edhe në viset më jugore të Epirit dëshmohet edhe nëpërmjet disa emrave të tjerë tipikë shqiptarë, si: *Bardhi*, *Dreri*, *Buzëmadhi*, *Bukëvala* etj., që ndeshen në defterët osmanë të Vilajetit të Janinës për vitin 1582-83, si p.sh.: Niko *Bardhi*⁶⁹ në një lagje të *Janinës*, Jorgji *Bardhi* në qytetin e *Prevezës*, Nikolla *Dreri* në Lagjen *Karade* të qytetit të *Janinës*, Niko *Bukuvale*, Nikolla *Buzuvako*, *Petro Prifti*, *Andon Prifti*, *Todor Bezhani*, *Petro Bezhani* në Lagjen *Kribësi* të fshatit *Kostagjor* të *Kazasë së Nartës*.

34. Por përveç emrave tipikë shqiptarë, si ata që u përmendën këtu më sipër, prania e elementit shqipfolës në viset më jugore të Epirit dëshmohet edhe nëpërmjet emrash të tjerë, që kanë në përbërjen e tyre disa tinguj bashkëtingëllorë, që i mungonin greqishtes së periudhës, kur është bërë regjistrimi osman. Është fjala për emrat, që përmbajnë zanoren /ë/, si edhe tingujt bashkëtingëllorë /b/, /d/, /g/, /c/, /x/, /ç/, /xh/, që i mungojnë greqishtes së re. Madje, katër bashkëtingëlloret e fundit i mungonin edhe greqishtes së vjetër, prandaj edhe në alfabetin grek mungojnë shkronjat përkatëse për këta tinguj. E grekët fjalët prej burimi jogrek, që përmbajnë këta tinguj, i pasqyrojnë me anë dyshkronjësash, ashtu siç veprojnë edhe për bashkëtingëlloret të fundit në greqishte e kanë ndryshuar shqiptimin prej kohësh, duke marrë dy të parat vlerën e bashkëtingëlloreve fërkimore /v/, /dh/ e një evolucion

⁶⁹ Sipas një shënimi në f. 29 të dorëshkrimit të Vexhi Buharasë për Defterin e Janinës të vitit 1580-1581 (në Arkivin e Institutit të Historisë), emrin *Bardh*'' (gjithmonë në formën *Bard* ose *Bardi*), që e ndeshim dendur në regjistrat kadastrorë turko-osmanisht, si edhe në burime të tjera joturke (në format *Bard*, *Bardus*, *Bardes*) s'kemi veçse emrin thjesht shqip *Bardhi*...'' Ai shton se ky emër në defterët osmanë ndeshet edhe në trajtën e shquar të rasës emërore *Bardhi*.

⁷⁰ Shih Triandafilidhis: 1995, f. 12.

të ngjashëm ka pësuar edhe *gamma* e greqishtes së vjetër⁷¹. Nga ana tjetër, edhe regjistruesisit osmanë që, siç dihet, kanë përdorur alfabetin arab, kanë pasur vështirësi për të pasqyruar tingujt bashkëtingëllorë /c/, /ç/, /zh/, /p/ dhe /ll/. Ata janë përpjekur t' i pasqyrojnë në njëfarë mënyre edhe këta tinguj, natyrisht jo gjithnjë me sukses. Gjithsesi, ata emra banorësh, që në defterët osmanë kanë në përbërjen e tyre bashkëtingëlloret **b, c, ç, d** (në vend të *dh*), përfaqësojnë banorë jogrekë. Të tillë janë, ndër të tjerë: *Baboçi*, që del shpesh në defterët osmanë të vitit 1582-83, si p.sh. *Todor Baboçi, Dimo Baboçi, Jani Baboçi, Thoma Baboçi Shimi Baboçi, Lekë Baboçi, Nikolla Baboçi* në lagje të ndryshme të qytetit të *Nartës*, ku janë regjistruar edhe *Jani Bashmakçiu, Jani Begadje, Nikolla Banja, Nikolla Bakalli, Niko Lumbarda, Jani Brankandi, Todor Pobroni, Miho Samarxhiu* e të tjerë, që përmbajnë tinguj të pazakontë për greqishten e asaj periudhe. Emra me një përbërje të tillë tingullore dëshmojnë në këtë regjistër edhe për vise të tjera të vilajetit të Janinës, por këtu u përqendruam në qytetin e *Nartës*, i cili përfaqëson vendbanimin më jugor të Epirit. Për më tepër, ky vendbanim paraqit interes edhe për vetë emrin dhe historinë e tij.

35. Në përgjithësi, mendohet se *Arta*, ish-*Ambrakia*, ishte një koloni e themeluar nga korinthisit në vitin 657 para erës së re (shih Hammond, 1967, f.425). Dhe, siç dihet, grekët e vjetër themelonin “koloni” tregtare në vende të banuara nga popullsi jogreke⁷². Emri *Arta* a *Artë* prej kohësh del në trajtën *Nartë*, ku elementi i parë burimisht ka qenë një parafjalë, që kishte në përbërjen e saj tingullin /n-/. Pas gjithë gjasash, ky tingull lidhet me parafjalën shqipe *në*, që ndërtohet me rasën kallëzore, e cila në një rast të tillë, kur emri nuk prihet apo ndiqet nga ndonjë përcaktor, është kuptimisht i shquar, megjithëse nuk e merr formantin e kallëzores së shquar. Pra, *Nartë* ka dalë nga togu (Po shkoj) *në Artë*. Ka më pak gjasë që në këtë rast tingulli protetik /n-/ të lidhet me parafjalën greke *en* “në”, që ndërtohet me rasën dhanore dhe në përgjithësi ka pasur dhe ka një përdorim më të kufizuar se parafjala

⁷¹ Shih Schwyzer: 1959, I, 207v., Rix: 1976, 183.

⁷² Shih temën mbi “kolonitë” greke etj. në Kreun III të këtij libri.

eis a *'s* (= në, drejt). Të kihet parasysh se te trajta e dokumentuar e emrit të këtij vendbanimi nuk dëshmohet ndonjë gjurmë e mbaresës së rasës dhanore të greqishtes. Të kihet parasysh gjithashtu se në një rast të ngjashëm grekët kanë përdorur parafjalën *eis* "në, drejt", që ndërtohet me rasën kallëzore, siç del nga emri i (I) *stambulit*, që ka dalë nga evolucioni i togfjalëshit (*pygáinō*) *'s* (<*eis*) *tēn polin* [= *'s tin polin* "(po shkoj) në qytet a drejt qytetit"]. Një dukuri e ngjashme bie në sy edhe tek emri i fshatit të *Nartës* afër Vlorës (shih Kreun VI, §§ 21-23), që banohet nga një popullsi greqishtfolëse, e sjellë, me sa duket, prej popullsisë greqishtfolëse në zonën e *Artës* së Greqisë në një të kaluar jo edhe aq shumë të largët, ashtu siç ka ndodhur edhe në fshatrat e *Dropullit* e të *Vurgut* të Delvinës (shih Kreun VII).

36. Nga sa u parashtrua shkurt këtu më sipër, del e qartë se në shekullin XVI, d.m.th. pas pushtimit turk, banorët e *Ajdonatit* dhe të *Mazrakut* mbanin në përgjithësi emra shqiptarë, pra i përkisnin etnosit shqiptar. Por natyrisht për atë zonë atëherë është vështirë të mendohet një popullsi krejt homogjene, e papërzier me elementë greqishtfolës. E njëjta gjë duhet menduar për atë periudhë edhe për shumicën e viseve të Epirit më në jug të trevave të lartpërmendura. Është fjala për viset e vilajetit të *Janinës*, duke përfshirë këtu edhe *Prevezën* e *Nartën*, por në ato vise ndikimi grek ka qenë edhe më i fuqishëm e kjo duket qartë nga mbizotërimi i trajtave të emrave të ndikuar nga greqishtja *Jani*, *Jorgo*, *Pavlo*, *Petro* etj. Gjithsesi, do mbajtur parasysh se gjatë shekujve pasardhës greqishtja ka ardhur duke u përhapur dalngadalë në viset kufitare jogreke falë disa faktorëve, që u vunë në dukje edhe gjatë këtij punimi. E ky proces mori përmasa më të mëdha sidomos pas shpalljes së pavarësisë së shtetit grek më 1821, kur administrata dhe kisha ortodokse greke filluan një fushatë sistematike për këtë qëllim, duke i mëshuar gjithnjë e më shumë faktorit fetar në vend të faktorit etnik, d.m.th. duke e barazuar ortodoksizmin me kombësinë greke. Natyrisht, sqarimi i kësaj dukurie kërkon hulumtime që i kapërcejnë synimet e këtij punimi. Prandaj le të kthehemi në temën tonë, për të diskutuar nëse banorët shqipfolës të Epirit kanë qenë të vendosur atje pas pushtimit osman, apo kanë qenë pasardhës të pandërprerë të të parëve të tyre vendës. Edhe për sqarimin e kësaj çështjeje, në mungesë dokumentesh historike, mund të mbështetemi vetëm

në shqyrtimin e rrethanave historike-shoqërore, që mund të përliqjnin një të tjetër apo të tjetër zgjidhje. Po të kemi parasysh karakterin e shtetit feudal turk, në asnjë mënyrë nuk mund të mendohet që pushtuesit turq të kenë mbështetur elementin shqiptar në dëm të elementit grek, sepse të dyja palët në shekujt XV -XVI për turqit ishin "kaurë". Islamizimi i çamëve, ashtu si i shqiptarëve të tjerë, në përgjithësi është kryer pas shekullit XVI. Në rastin konkret, të kihet parasysh se edhe sot në viset çame brenda shtetit grek ka shqiptarë të krishterë, që nuk janë helenizuar ende. Prandaj duhet pranuar që në kohën e pushtimit turk një pjesë e mirë e banorëve të Epirit flisnin shqip dhe këtë gjuhë amtare e kishin trashëguar qysh nga periudhat paraturke kur, siç u vu në dukje edhe më sipër, të gjitha rrethanat historike-shoqërore ndihmonin (dhe në të vërtetë ndihmuan) për përhapjen e gjuhës greke dhe jo të shqipes. Madje, greqishtja gjatë shekujve të fundit është përhapur edhe në vise të tjera, që sot janë brenda kufijve të shtetit shqiptar. Këtu është fjala për fshatrat greqishtfolëse të luginës së *Dropullit* dhe të *Vurgut* të Delvinës ku, siç do të sqarohet në temën përkatëse (Kreu VII), popullsia para pushtimit turk si gjuhë amtare kishte shqipen. Të kihet parasysh edhe fakti që në disa vendbanime të bregdetit jugor (Himarë, Dhërmi e Palasë) krahas shqipes flitet edhe greqisht (shih temën përkatëse në Kreun V).

V. Përfundime

37. Nga sa u shtjellua në këtë kapitull lidhur me çështjen e gjuhës amtare në viset e të ashtuquajturit *Epir* gjatë shekujve, duke nisur nga periudha e lashtësisë klasike, mund të arrihet në disa përfundime të mbështetura në të dhëna jo vetëm të karakterit gjuhësor por edhe historik. Ndër këto përfundime veçojmë:

1. Emri *Epir* me burim nga greqishtja *Epeiros* është përdorur kryesisht nga grekët për të emërtuar viset në veriperëndim të trevave të mirëfillta greke. Ky emërtim është përdorur edhe ndër disa qarqe perëndimore, si edhe nga disa shqiptarë të shkolluar në të kaluarën, por popullsia vendëse (jogreke) nuk e ka përdorur këtë emërtim në marrëdhëniet e përditshme.

2. Viset e të ashtuquajturit *Epir*, nga pozicioni i tyre gjeografik, duhet të kenë qenë të banuara qysh herët. Ndër të tjera, atje duhet të ketë banuar edhe një popullsi më e lashtë, që zakonisht njihet me emrin pellazg (shih temën mbi pellazgët

në Kreun I). Nëpër ato vise duhet të kenë kaluar edhe tributë greke, sidomos dorasit, para se të vendoseshin përfundimisht në trevat greke të lashtësisë, si edhe në ishujt e detit Egje dhe të detit Jon. Nëpër ato vise kanë shtegtuar edhe popuj të tjerë para dhe pas vendosjes së banorëve të mirëfilltë të *Epirit*.

3. Banorët e kësaj zone në lashtësi nga grekët konsideroheshin si "barbarë", d.m.th. të huaj. Pra, ata flisnin një gjuhë të ndryshme nga greqishtja. Mendimi i disa dijetarëve, sidomos grekë, që ata flisnin një dialekt të greqishtes, nuk del i mbështetur. Përndryshe, do të duhej pranuar që stërgjyshërit e banorëve shqipfolës të kësaj zone kanë zëvendësuar një popullsi të mëparshme greqishtfolëse, çka nuk mbështetet as historikisht dhe as nga rrethanat e njohura, që gjatë periudhës së Perandorisë Bizantine greqishtja kishte edhe mbështetjen e fuqishme të administratës shtetërore dhe të kishës ortodokse greke.

4. Mendimi i Jireçekut që në lashtësi në pjesën jugore të Ballkanit u përhap greqishtja, ndërsa latinishtja mbizotëroi në pjesën veriore të këtij gadishulli, nuk është i mbështetur. Në këtë rast duhet folur për mbizotërimin e mbishkrimeve greke, përkatësisht latine, çka dëshmon për mbizotërimin e ndikimit të kulturës greke, përkatësisht latine. Edhe gjatë periudhës së sundimit romak-bizantin banorët e trevës së *Epirit* mundën t'i rezistonin procesit të helenizimit, megjithëse përhapja e greqishtes në ato vise kish nisur qysh në kohë të lashta dhe kish zëvendësuar pak nga pak gjuhën amtare të banorëve vendës. Ky proces, që ka vazhduar gjatë shekujve, ka marrë përpjesëtime më të mëdha sidomos pas krijimit të shtetit grek dhe ende më shumë pas vitit 1912 në ato vise të banuara nga popullsi shqiptare, që mbetën brenda kufijve të shtetit grek.

5. Nuk dëshmohet ndonjë shpërngulje shqiptarësh a arbëreshësh gjatë shekujve për në viset e të ashtuquajturit *Epir*. Përkundrazi, dëshmohen shpërngulje të tilla, sidomos nga viset e *Epirit*, kryesisht gjatë shekulli XIV, për në vise të ndryshme të Greqisë dhe në More, ku ka edhe sot një numër relativisht të madh arvanitësh a më saktë arbëreshësh, që veçanërisht gjatë dy shekujve të fundit kanë ardhur duke e humbur gjuhën amtare të trashëguar brez pas brezi.

6. Onomastika e vendbanimeve të viseve jugore shqiptare, sipas regjistrimeve

osmane të shekujve XVI-XVII, dëshmon se banorët e atyre vendbanimeve në atë kohë mbartnin në përgjithësi emra me trajta të vjetra shqiptare, siç ishin sidomos emrat tipikë shqiptarë *Lekë, Gjon, Gjini, Gji-kë, Gjergj, Pal* etj.

Por në një zonë kufitare me një ndikim të fuqishëm nga ana e kishës ortodokse greke ishte e natyrshme që midis tyre të ishin përhapur edhe trajta emrash grekë si *Jani, Jorgo, Pavllo* etj., gjithsesi edhe këta të përshtatur sipas strukturës gramatikore të shqipes. Pra, banorët më të hershëm të atyre vendbanimeve nuk kanë qenë grekë.

7. Shqiptarët e sotëm, duke përfshirë edhe ata të skajit më jugor, janë pasardhësit e drejtpërdrejtë të atyre fiseve a tribuve, që në lashtësi banonin në trevat, ku sot fliten dialektet e ndryshme të shqipes, të cilat janë zhvilluar nëpërmjet evolucionit të atyre të folmeve, që fliteshin dikur në trevat e tyre të sotme në Ballkanin Perëndimor. Mundësia që shqiptarët e sotëm të jenë pasardhësit e një popullsie tjetër të vendosur në këto treva dikur më vonë, para apo pas dyndjeve sllave në Ballkan, siç mendonin Selishçevi dhe ndonjë tjetër⁷³, nuk ka asnjë mbështetje historike dhe gjuhësore. E një mendim i tillë gjen mbështetje jo vetëm nga të dhënat e dialektologjisë historike të gjuhës shqipe, por edhe nga huazimet e hershme prej greqishtes së vjetër dhe prej latinishtes, që janë të përbashkëta për të gjitha të folmet e shqipes, duke përfshirë edhe ato të skajit më verior e më jugor.

8. Duke u mbështetur në gjithë sa u vu në dukje në këtë kapitull, mund të pohohet se gjuha amtare në të ashtuquajturin *Epir* gjatë shekujve, duke përfshirë edhe periudhën e lashtësisë, nuk ka qenë e ndryshme nga ajo e stërgjyshërve të arbëreshëve a shqiptarëve në përgjithësi. Natyrisht, e folmja e asaj treve, duke qenë më pranë të folmeve greke, ka qenë më shumë e ekspozuar ndaj ndikimit të greqishtes e cila, sidomos gjatë shekujve të fundit, ka ardhur duke e zëvendësuar shqipen në viset më jugore, veçanërisht në viset përtej kufirit shtetëror greko - shqiptar.

⁷³ Kohët e fundit një hipotezë të tillë e ka parashtruar dijetari gjerman G. Schramm (1994), sipas të cilit një pjesë e fisit trakas të besëve në fillim të shekullit IX është shpërngulur në temën e Durrësit dhe prej tyre është zhvilluar etnosi shqiptar; për më shumë hollësi për këtë shih Demiraj: 1999, f. 85.

Kreu i tretë

“Kolonitë” greke, romake dhe romane në brigjet e Jonit dhe të Adriatikut

1. Në historiografinë e popujve të Gadishullit Ballkanik bëhet fjalë edhe për themelimin e “kolonive” greke, romake dhe romane në periudha të ndryshme dhe në vende të ndryshme të këtij gadishulli, si edhe për rolin që ato duhet të kenë luajtur për helenizimin, përkatësisht për romanizimin e banorëve të hershëm të tij. Dhe është një gjë e njohur që themelimi i “kolonive” të tilla ka luajtur një rol të madh për helenizimin, përkatësisht për romanizimin e disa zonave të gjera, sidomos në lashtësi. Mjafton të përmendet këtu, sa për shembull, themelimi i “kolonive” greke në Italinë e Jugut, që ndikuan aq shumë për helenizimin e asaj treve, e cila në lashtësi nga romakët quhej “Magna Graecia” (“Greqia e Madhe”). Gjithashtu të kihet parasysh edhe roli i madh i “kolonëve” romakë për romanizimin e Dakisë (Rumanisë së sotme), ku flitet një gjuhë romane, rumanishtja, si edhe të bregdetit dalmat, ku deri dy shekuj më parë flitej gjithashtu një tjetër gjuhë romane, dalmatishtja, e cila erdhi e u shua dalngadalë me përhapjen e sllavishtes⁷⁴. Madje, sipas gjuhëtarit çek Konstandin Jireček, pas pushtimit romak të Ballkanit në pjesën veriore të këtij gadishulli erdhi e mbizotëroi latinishtja, kurse në pjesën jugore të tij mbizotëroi greqishtja⁷⁵. Natyrisht, kjo hipotezë e Jirečekut, e cila mbështetej në përhapjen e mbishkrimeve latine në trevat veriore, përkatësisht greke në trevat jugore të Ballkanit, nuk i ka qëndruar kritikës, sepse përhapja e mbishkrimeve latine dhe greke ishte e kushtëzuar nga

⁷⁴ Dalmatishtja si gjuhë romane u shua përfundimisht në shekullin XIX (shih Solta: 1980, 142v. - me literaturë). Mbeturinat e fundit të asaj gjuhe i mblodhi gjuhëtari italian Matteo Bartoli, i cili i botoi në Vjenë më 1906 në veprën me titullin *Das Dalmatische*.

⁷⁵ Shih K. Jireček, *L'eredità di Roma nelle città della Dalmazia durante il Medioevo*. A cura di Mario Capaldo. Roma 1984, f. 19v.

fakti që latinishtja dhe greqishtja në kohë të lashta ishin të vetmet gjuhë të shkruara në Ballkan. Por popujt e ndryshëm të këtij gadishulli në marrëdhëniet e tyre të përditshme përdomin gjuhët e veta amtare, disa prej të cilave me kalimin e kohës, sidomos pas dyndjeve sllave të shekujve VI-VII, janë zhdukur. E një dëshmi të qartë për këtë na e jep gjuha shqipe, e cila ka mundur t'i qëndrojë si helenizimit ashtu edhe romanizimit. Gjithsesi, ndikimi i greqishtes dhe i latinishtes mbi gjuhët e ndryshme të Ballkanit në periudha të ndryshme të historisë së tyre ka qenë i madh dhe një gjë e tillë është pranuar nga të gjithë studiuesit.

2. Çështja e përmasave të përhapjes së greqishtes dhe të latinishtes në Gadishullin Ballkanik në lashtësi do të kërkonte një trajtim të gjerë, që i kapërcen caqet e këtij kapitulli, nëpërmjet të cilit synohet të trajtohet çështja e “kolonive” greke, romake dhe romane në trojet e banuara nga stërgjyshërit e shqiptarëve në kohët e lashta dhe në periudhat e mëpastajme. Një vëmendje të posaçme do të kërkonte hulumtimi i rolit, që mund të kenë luajtur në përhapjen e greqishtes “kolonitë” e themeluara nga grekët e vjetër para erës së re në bregdetin e Adriatikut dhe të Jonit në qendra të tilla si *Epidamnos-i* (626 para erës së re), që njihet më fort me emrin *Durrës* < *Dyrrhachium*, *Apolonia* (shek. VI para erës sonë), *Oriku* (shek. VI para erës sonë), *Aulona* (para shek. II të erës sonë) *Lissos-i* (385 para erës sonë) *Ragusa* (shekulli VII para erës sonë) etj. Në radhë të parë, do mbajtur parasysht se themelimi i këtyre “kolonive” ishte në vazhden e traditës, që grekët e lashtë krijuan qysh nga shekulli VIII para erës së re, për të themeluar “koloni” tregtare në shumë qendra bregdetare të Mesdheut dhe të Detit të Zi⁷⁶, duke zëvendësuar kështu rolin e ngjashëm, që kishin luajtur më parë fenikasit⁷⁷. Në përgjithësi, është pranuar se

⁷⁶ Të kihet parasysht edhe kolonia e *Massalias* (sot *Marseille*) në Francën Jugore, e themeluar nga kolonë jonas të Azisë së Vogël aty nga viti 600 para erës sonë. Edhe Nisa (Nice) në Francën Jugore mbahet si e themeluar nga grekët e lashtë.

⁷⁷ Fenikasit e Azisë së Vogël kishin themeluar koloni në brigje të ndryshme të Mesdheut etj.; një ndër to ishte edhe *Kartagjena* në Afrikën Veriore, e themeluar aty nga fillimi i shekullit IX para erës sonë.

është fjala për qendra burimisht tregtare të themeluara pranë vendbanimeve të popujve të tjerë, me të cilët tregtarët grekë kanë pasur kontakte gjithnjë e më të shumta deri edhe në martesë midis tyre. Pra, ato të ashtuquajtura “koloni” greke nuk janë themeluar në vise të shkreta, të pabanuara nga një popullsi aloglote (shih për këtë edhe Islami: 1992, 7v.). Për më tepër, “kolonët” grekë duhet të kenë qenë relativisht të paktë në numër. P.sh. zona e *Apolonisë* (Pojanit) ishte e banuar nga një popullsi ilire, kur erdhën e u vendosën atje një grup prej rreth 200 “kolonistësh” grekë nga Korinti aty nga fillimi i shekullit VI para erës së re (shih Hammond-in: 1967, f.426 - me literaturën përkatëse). Po kështu, sipas Hammond-it (1967, f.425), “vendi [ku u themelua Epidamnusi] ishte tashmë i pushtuar nga ilirët. Korkyrasit u thirrën nga disa prej taulantëve, që ishin dëbuar nga ai vend prej liburnëve, dhe kolonia në fillim ishte një koloni e përzier grekësh dhe ilirësh”. E kjo vërejtje vlen edhe për “kolonitë” e tjera greke të Adriatikut e të Jonit, duke përfshirë edhe Orikun, Aulonën⁷⁸, Ambrakian (Artën) etj. të themeluar nga korintasit, si edhe “kolonitë” eleanë, d.m.th. ato qendra tregtare të themeluara nga grekët e Italisë në Epirin Jugor (shih për këto të fundit Hammond-in: 1967, f.425, 427). Pra, në përgjithësi është fjala për grupe relativisht të vogla “kolonistësh”, sepse Greqia e lashtësisë, kur u themeluan “kolonitë” e shumta greke në bregdetet e ndryshme të Adriatikut, Jonit, Mesdheut dhe Detit të Zi pas shekullit VIII para erës së re, nuk kishte një popullsi aq të madhe, sa të dërgonte grupe të mëdha “kolonistësh” gjithandej. Gjithsesi, duhet pranuar që “kolonistët” grekë pa dyshim kanë vendosur marrëdhënie me popullsitë vendëse rreth e rrotull, me të cilat edhe duhet të jenë përzier, duke luajtur kështu një rol të madh edhe në përhapjen e gjuhës greke midis vendësve. Këta pjesërisht edhe do të jenë helenizuar me kalimin e kohës, por pjesërisht edhe mund t’i kenë asimiluar “kolonistët” grekë. Një proces i tillë helenizimi duhet të ketë qenë edhe më i fuqishëm në viset më jugore të Epirit, ku ka vazhduar edhe në kohë më të reja, sidomos pas shpalljes së pavarësisë së Greqisë më 1821 dhe akoma më shumë me shpërnguljen e çamëve pas vjetëve 1923 dhe 1944. Prania e atyre “kolonive” grekësh ka luajtur një rol të rëndësishëm edhe për zhvillimin kulturor të vendbanimeve,

⁷⁸ Për Orikun dhe Aulonën (Vlorën) shih Kreun VI në këtë vepër.

ku ato u themeluan, siç na dëshmojnë p.sh. monumentet e zbuluara sidomos në Pojan dhe në Durrës, që pjesërisht i përkasin edhe periudhës romake. Por do pasur parasysh se në zonën e Epirit në kohë të lashta kishte lulëzuar edhe *Butrinti* (*Buthrotó-*), që në përgjithësi pranohet se ka qenë një vendbanim i hershëm i themeluar qysh para shekullit VII para erës së re⁷⁹. Në përgjithësi, është pranuar që *Butrinti* nuk është themeluar nga grekët. Madje, sipas Hammond-it (1967, f.474), “Nuk ka ndonjë traditë për themelimin e ndonjë kolonie greke këtu.” Vlen të përmendet se emri i *Butrintit* (*Buthrotó-*) pranohet se është një emër i lashtë, i periudhës së Bbronxit (shih Hammond-in: 1967, f.394) e kjo do të ishte një tjetër dëshmi e karakterit burimisht jogrek të Epirit.

Gjithsesi, siç u prek më sipër, nuk kanë munguar edhe enklava greqishtfolësish në vise të banuara nga fise jogreke si në Epir, ashtu edhe në treva të tjera të bregdetit të Jonit dhe të Adriatikut. Nën ndikimin e atyre “kolonive” dhe enklavave greke, si edhe nëpërmjet kontakteve midis popullsive fqinje, greqishtja i kishte të gjitha mundësitë që të bëhej e njohur dhe të përvetësohej dalngadalë nga një pjesë e mirë e popullsisë sidomos të viseve të Epirit, që ishin më afër viseve të banuara nga grekët. Por sa ka qenë e përhapur greqishtja në viset jogreke të bregdetit të Jonit dhe të Adriatikut në periudhën e lashtësisë para pushtimeve romake, nuk mund të thuhet asgjë me siguri. Megjithatë, duke pasur parasysh që huazimet nga greqishtja e vjetër në gjuhën shqipe, duke përfshirë këtu edhe viset më jugore të banuara nga

⁷⁹ Edhe mbishkrimet greke të zbuluara në atë vendbanim të lashtë të Epirit nuk janë më të hershme se shekulli III para erës së re. Përdorimi i greqishtes në këtë rast është i shpjegueshëm, po të kihet parasysh se greqishtja në atë kohë ishte bërë, si të thuash, një gjuhë e përdorimit ndërkombëtar, të paktën në Ballkan, në Italinë e Jugut dhe në Lindjen e Afërt. Për themelimin e Butrintit kanë qarkulluar prej kohësh legjenda të ndryshme. Sipas një legjende të periudhës romake, themeluesi i Butrintit ka qenë Heleni, i biri i Priamit të Trojës, i cili paskësh vajtur atje pas Luftës së Trojës (shih më hollësisht për këtë dhe për ndonjë legjendë tjetër të këtij lloji veprën e Ugolinit të përkthyer shqip (2000, faqe 69, 74), si edhe Hammond-in (1967, 385 dhe 474).

shqiptarët, janë relativisht të pakta⁸⁰, mund të pohohet se Epiri, sidomos në viset e brendshme të tij, në periudhën e lashtësisë nuk ishte helenizuar.

3. Natyrisht, një mendim i tillë qëndron, në rast se banorët shqipfolës të periudhës së njohur historike të Epirit janë me të vërtetë pasardhës të drejtpërdrejtë të banorëve të lashtë jogrekë të asaj treve. Përndryshe, do të duhej pranuar që ata janë vendosur atje në një periudhë të mëvonshme, por për këtë nuk ka asnjë dëshmi historike. Megjithatë, siç dihet, disa dijetarë si H. Hirti, G. Weigand-i, H. Bariqi, V. Georgievi, G. Schramm-i etj. janë përpjekur të vërtetojnë që stërgjyshërit e shqiptarëve në përgjithësi, duke përfshirë edhe ata të viseve jugore të banuara prej tyre, kanë qenë me origjinë trakase, pra kanë shtegtuar nga viset lindore në viset perëndimore të Ballkanit, pa u vënë re, në një periudhë relativisht të hershme. Mjafton të përmendim këtu studiuesin e njohur gjerman Gustav Weigand, i cili në vitin 1927 parashtroi 12 argumente për të mbrojtur një hipotezë të tillë⁸¹. Këtu nuk është rasti t' i rishqyrtojmë argumentet e Weigand-it, që i kemi shqyrtuar gjerësisht në veprën e vitit 1999 me titullin *Prejardhja e shqiptarëve në dritën e dëshmimeve të gjuhës shqipe*, faqe 76vv. dhe 94vv. Por nuk mund të mos ritheksojmë se sidomos prania e një numri të konsiderueshëm fjalësh të lashta (paralatine) të përbashkëta në shqipe dhe në

⁸⁰ Në përgjithësi, pranohet që numri i huazimeve nga greqishtja e vjetër në gjuhën shqipe është i kufizuar. A. Thumb-i (1910) shënoi 20 huazime të tilla, por dijetarë të tjerë më vonë i kanë shtuar këtij numri edhe rreth dhjetë të tjera. Natyrisht, nuk duhet përjashtuar mundësia që një pjesë e huazimeve nga greqishtja e vjetër të jenë zhdukur nga përdorimi në gjuhën shqipe gjatë shekujve, ashtu siç janë zhdukur edhe fjalë të tjera të vjetra të trashëguara indoeuropiane, ose të huazuara nga gjuhë të tjera. Gjithsesi, do pasur parasysh se numri i huazimeve nga greqishtja e mesme dhe sidomos nga greqishtja e re në të folmet e shqipes, veçanërisht në të folmet më jugore, është mjaft i madh.

⁸¹ Për argumentet e Weigand-it shih Kreun II, shënimin 37 në këtë veper me temën *Gjuha amtare e banorëve të të ashtuquajturit Epir gjatë shekujve*.

rumanishte⁸², të vëna në dukje nga Weigand-i dhe nga studiues të tjerë, sikur dëshmon që stërgjyshërit e shqiptarëve duhet të kenë qenë dikur fqinjë me stërgjyshërit e rumunëve, pra duhet të kenë banuar (edhe) në vise më lindore të Ballkanit. Por fjalët e tilla të vjetra jolatine në shqipe dhe në rumanishte, siç e kemi vënë në dukje edhe më parë (shih Demiraj: 1999, f.95), mund të jenë pjesërisht një trashëgimi e përbashkët e këtyre dy gjuhëve nga gjuha “nënë” e shqipes, përkatësisht nga substrati paralatin i rumanishtes, dhe pjesërisht mund të jenë pasojë e marrëdhënieve të vjetra midis këtyre dy gjuhëve të moçme të Gadishullit Ballkanik, të cilat para dyndjeve sllave në Ballkan kanë pasur kontakte fqinjësie. Gjithsesi, gjuha “nënë” e shqipes dhe substrati i rumanishtes dikur kanë qenë gjuhë gjeografikisht të afërta dhe fqinjësia e dikurshme e tyre u ndërpre pas dyndjes së tribuve sllave në Ballkan gjatë shekujve VI-VII të erës sonë. E, kur kanë qenë në fqinjësi të pandërprerë, pa dyshim kanë ndodhur huazime nga njëra gjuhë fqinje në tjetrën. Gjithashtu si dy gjuhë indoeuropiane ato duhet të kenë pasur edhe elemente leksikore të trashëguara të përbashkëta, përkatësisht të afërta. Mjafton të përmendim emrin *mal*, që në rumanishte përdoret me një kuptim disi të ndryshëm në krahasim me shqipen (shih shënimin 81), por që në përgjithësi është pranuar si një fjalë e vjetër e trashëguar në këto dy gjuhë. Kjo fjalë ndeshet edhe në lituanishte dhe në keltishte dhe s’përrjashtohet mundësia që të jetë e fondit paraindoeuropean (shih Solta: 1980, f.20, 48v. - me literaturë). Fjalë të lashta të fondit paraindoeuropean janë ruajtur si në shqipe e rumanishte ashtu edhe në greqishte. E kjo çështje do të meritonte një hulumtim të posaçëm.

4. Një problem më vete përbën edhe sqarimi i pyetjes se në ç’përmasa ka vazhduar ndikimi i greqishtes dhe i kulturës greke gjatë periudhës së sundimit romak

⁸² Të tilla janë, ndër të tjera, fjalët *brin-i/brir-i* (rumanisht *brîu*), *kulpën/kulpër* (rum. *kurpen*), *avull* (rum. *abure*), *mugull* (rum. *mugur*), *niegull/mjegull* (rum. *negure*), *dhallë* (rum. *zară*), *kurth* (rum. *cursă*), *nepërkë* (rum. *năpîrcă*), *shtrep* (rum. *strepede*), *shtrungë* (rum. *strungă*), *mal* (rum. *mal* = breg lumi), *përrua* (rum. *pîrîu*), *urlë* (rum. *urdă*), *gurmaz* (rum. *grumază*), etj. Sipas Brăncus-it (1983, f. 130), numri i fjalëve të tilla të përbashkëta shqiptare-rumune arrin në rreth 89 njësi.

mbi trojet e banuara nga stërgjyshërit e shqiptarëve. Natyrisht, këtu është fjala në radhë të parë për periudhën para ndarjes së Perandorisë Romake në dy pjesë në vitin 395 të erës sonë, d.m.th. gjatë periudhës kur latinishtja ishte gjuha zyrtare e administratës, e ushtrisë dhe e kishës së krishterë në trevat e banuara nga stërgjyshërit e shqiptarëve. E kjo vlen edhe për njëfarë periudhe pas shekullit IV, derisa greqishtja e zëvendësoi latinishten përfundimisht si gjuhë zyrtare e administratës dhe e kishës ortodokse në trevat shqiptare.

Gjithsesi, sundimi i gjatë romak në trevat e banuara nga shqiptarët e sotëm ushtri gjithnjë e më shumë një ndikim të fuqishëm mbi popullsinë e këtyre trevave si edhe në gjithë Gadishullin Ballkanik. Dhe duket si shumë e papritur që popullsia e trevave të sotme shqiptare nuk u romanizua në një kohë kur u romanizuan Dalmacia dhe Dakia (Rumania e sotme). Madje, nuk do të ishte e gabuar të pohohej se procesi i romanizimit duhet të ketë marrë përmasa edhe më të gjera, që ne nuk i njohim, sepse me ardhjen e fiseve sllave në Ballkan gjatë shekujve VI - VII shumë treva të këtij gadishulli, që pjesërisht do të kenë qenë të romanizuara, dalngadalë erdhën e u sllavizuan, ashtu siç u sllavizua Dalmacia e romanizuar. Por për këtë çështje si edhe për faktorët, që kanë ndikuar në mosromanizimin e plotë të të parëve të shqiptarëve këtu nuk do të ndalemi, sepse këto janë trajtuar në një kapitull të veçantë të këtij libri (Kreu IV) kushtuar procesit të romanizimit në Gadishullin Ballkanik. Këtu do të theksojmë vetëm se romakët edhe në trevat e banuara sot nga shqiptarët patjetër që kanë themeluar koloni, duke zëvendësuar pjesërisht edhe “kolonitë” greke sidomos në qendra të tilla të banuara, si: Durrësi, Aulona, Apolonia, Byllisi etj. Por procesi i romanizimit në trevat e banuara nga të parët e shqiptarëve nuk mundi të depërtonte thellë në këto treva, sepse, siç do të sqarohet në kapitullin IV kushtuar romanizimit të Ballkanit, Perandoria Romake, e shqetësuar për mbrojtjen e kufijve të saj shumë të përhapur, ishte e detyruar t’i përqëndronte forcat e saj kryesore në vendet periferike, ku ishte gjithnjë i pranishëm kërcënimi nga tributë “barbare”. Kurse trevat shqiptare dhe ato greke, që nuk ndodheshin në zonat periferike të perandorisë, nuk kanoseshin nga një kërcënim i tillë.

5. Por edhe në këtë rast shtrohet pyetja nëse të parët e shqiptarëve kanë

ardhur në trevat e tyre të sotme në një periudhë relati visht të vonë, siç kanë menduar disa dijetarë si Weigand-i, Bariqi, Schramm-i etj. dhe kanë asimiluar edhe gjuhësisht popullsinë e mëparshme pjesërisht apo tërësisht të romanizuar. Për një pyetje të tillë vlejné të njëjtat vërejtje, që u parashtuan më sipër (§ 1) lidhur me mendimin e Jireçekut për helenizimin e Ballkanit Jugor, duke përfshirë edhe viset e Shqipërisë Jugore. Gjithashtu do pasur parasysh se për praninë e hershme dhe të vazhdueshme të stërgjyshërve të shqiptarëve sidomos në viset e brendshme dhe për lidhjet e tyre edhe me qendrat bregdetare pak a shumë të romanizuara dëshmon edhe fakti që emrat e këtyre qendrave në gojën e popullsisë vendëse u janë nënshtruar një evolucioni fonetik në përputhje me rregullsitë e evolucionit fonetik të gjuhës shqipe. Natyrisht, këtu është fjala për ato qendra të banuara, që i kanë qëndruar kohës, si *Durrësi*, *Pojani*, *Vlora* etj. Këto ne i kemi shtjelluar në veprën tonë *Prejardhja e shqiptarëve* (1999). Prandaj këtu po ndalemi shkurt vetëm për emrat e *Durrësit* dhe të *Pojanit*.

6. Siç dihet, për vendbanimin e vjetër të *Durrësit* në lashtësi ka pasur dy emra: *Epidamnus* dhe *Dyrrachium*. Emri *Epidamn-os*, në përgjithësi, ka qenë i përdorur nga grekët dhe disa studiues e mbajnë këtë vendbanim të vjetër si të themeluar nga grekët aty nga viti 626 para erës së re. Këtu do të ndalemi pak në emrin e dytë të këtij vendbanimi të vjetër dhe pikërisht. në atë të *Durrës-it*, që pasqyron fazën e fundit të evolucionit të trajtës së dokumentuar latine *Dyrrhachium*. Edhe ky emërtim gjeografik, ashtu si *Epidamnus-i*, në përgjithësi, është mbajtur prej burimi grek dhe është shpjeguar si i evoluar nga *Dys-rachium*. Por, siç e kemi vënë në dukje edhe më parë (shih Demiraj: 1999, 133v.), në këtë rast nuk është e qartë se përse për të njëjtin vendbanim bregdetar, të jenë përdorur dy emërtime prej burimi grek, çka nënkupton që këto dy emërtime të jenë sajuar nga të njëjtët “kolonistë” grekë, të cilët nuk duhet të kenë qenë edhe aq të shumtë në numër dhe, për më tepër, duhet të kenë qenë në krye të herës të përzier edhe me banorë jogrekë (shih edhe Hammond-in: 1967, f.425). Në këtë rast duhet marrë në vështrim edhe mendimi i gjuhëtarit rumun Mihăescu (1978, f.81), sipas të cilit gadishulli, ku ndodhet Durrësi, “mbante emrin ilir Dyrrachium dhe qyteti u quajt Epidamnus nga grekët”. Një mendim të ngjashëm e gjejmë edhe tek disa autorë të vjetër si Appian-i dhe

Stefan Bizantini (shih Demiraj: 1999, f.133).

Lidhur me evolucionin e emrit të *Durrësit* do pasur parasysh se evolucioni i supozuar *Dys-rak^hia⁸³* > *Dyrrachion*, që parakupton reduktimin e togut /-sr-/ > /-rr-/ , ka qenë një dukuri e pazakontë në greqishten e vjetër (shih Schwyzer: 1959, f.311). Prandaj, ne i përmbahemi mendimit që burimi grek i emrit të *Durrësit* mbetet i dyshimtë, për të mos thënë i pasaktë. Por edhe sikur të pranohet si i saktë një shpjegim i tillë, evolucioni i mëtejshëm i këtij emri në trajtën e dokumentuar shqiptare *Dúrrës* dëshmon se një evolucion i tillë është kryer nga përdorimi prej një popullsie, që ua ka përshtatur atë rregullsi fonetike të një gjuhe të ndryshme nga greqishtja dhe nga latinishtja apo nga gjuhët romane. E në këtë rast vjen në vështrim, në radhë të parë, theksimi i rrokjes nistore të këtij emri gjeografik, ashtu si tek *Íshëm* < *Ísamnus* e *Drisht* < *Drívastum*. Po të pranohet që rrokja e parë e këtij emri ta ketë burimin te parashtesa privative greke *dys-*, pritej që në greqishte në këtë rast theksi më fort të binte mbi rrokjen e parë të fjalës *-rak^hion*. Gjithsesi, theksimi i rrokjes nistore të emrit *Dúrrës* dëshmon se ky emër ka qenë në përdorim të hershëm ndër stërgjyshërit e shqiptarëve, të cilët e kanë theksuar atë mbi rrokjen nistore, ashtu siç kanë theksuar edhe shumë emra shumërokësh të trashëguar si *émën(ë)/émër(ë)*, *dímën(ë)/dímër(ë)* etj., si edhe disa emra të huazuar nga greqishtja e vjetër si *mókën(ë)/mókër(ë)* < *māk^haná´*, *lákën(ë)/lákër(ë)* < *lák^hanon*, apo nga latinishtja, si *fémën(ë)/fémër(ë)* < *fémína*, *qelq* < *calic-em* etj.

7. Pra, edhe sikur të mendohej që stërgjyshërit e shqiptarëve ta kenë marrë emrin e *Dúrrësit* nga romakët⁸⁴, ata e kanë theksuar atë mbi rrokjen e parë, pra ndryshe nga romakët, që nuk mund ta theksonin atë mbi rrokjen e parë, por mbi të

⁸³ Në këtë rast elementi i parë do të ishte parashtesa privative greke *dys-*, që mund të përkthehej me parashtesën privative shqipe /ç-/, ndërsa emri pas saj do të kishte kuptimin “tallaz. bregdet me shkëmbinj etj.”.

⁸⁴ Sipas gjeografit romak Pomponius Mela dhe shkrimtarit Plini (të shekullit të parë të erës sonë), ky qytet më parë quhej *Epidamn*, por romakët ia ndryshuan emrin, për arsye se pjesa e dytë e atij emri (khs. latinishten *damnum* = dëm) u dukej se sillte të keqen (shih më hollësisht për këtë Demiraj: 1999, f. 132).

dytën, në përputhje me rregullsitë e theksimit të latinishtes (krahaso edhe trajtën italiane *Durázzo*). E vetmja vështirësi, që paraqitet si në trajtën shqipe *Durrës* ashtu edhe në trajtën latine *Dyrrati-um* apo *Durrati-um*, ka të bëjë me sqarimin e tingullit fundor të temës së këtij emri. Në gjuhën shqipe emri i këtij qyteti dëshmohet edhe me fundoren /-c/, si p.sh. te Bardhi e Bogdani. Të kihet parasysh se edhe në latinishte togu fundor /-ti/ shqiptohet zakonisht /-c-/. E tingulli fundor i temës së këtij emri si në latinishte edhe në shqipe hedh një tjetër hije dyshimi mbi burimin grek të këtij emri, sepse një tingull i tillë del si i papritur nga evolucioni i bashkëtingëllores së aspiruar greke /-χ-/(-k^h), të ndjekur nga gjysmëzanorja /iii/. Prandaj është më e arsyeshme të mendohet që emri i *Durrësit* nuk duhet të jetë prej burimi grek, por duhet të ketë një tjetër burim, që mbetet për t' u hulumtuar, ashtu siç mbetet për t' u hulumtuar edhe burimi i shumë toponimeve të vjetra jo vetëm në Shqipëri por edhe në vende të tjera. Ajo që mund të thuhet me siguri në këtë rast është se emri i këtij qyteti ka qenë në përdorim të pandërprerë nga shqiptarët dhe stërgjyshërit e tyre, të cilët e kanë shqiptuar atë gjatë shekujve në përputhje me rregullsitë e evolucionit fonetik të gjuhës së tyre. Vërejta e fundit vlen edhe për “kolonitë” e tjera greke (dhe romake) të bregdetit shqiptar, si *Oriku*, *Aulona*⁸⁵, *Apolonia* etj., ndonjë prej të cilave është çpopulluar ose zhdukur gjatë shekujve.

8. Këto që u thanë për evolucionin e disa toponimeve të lashta nga përdorimi i pandërprerë i tyre prej të parëve të shqiptarëve, është një tjetër dëshmi, që tregon qëndresën e tyre për të mbijetuar gjatë shekujve. Megjithatë, duhet pranuar se gjatë sundimit disashekullor romak disa vise, sidomos bregdetare, të trojeve të banuara nga stërgjyshërit e shqiptarëve të sotëm kanë qenë romanizuar nëpërmjet kolonëve romakë ose nëpërmjet romanizimit të një pjese të popullsisë vendëse. Por pas mbarimit të sundimit të drejtpërdrejtë romak, d.m.th. pas vitit 395 të erës sonë, popullsia e romanizuar e atyre viseve dalngadalë u çromanizua edhe nga dyndja e popullsisë vendëse sidomos të fshatrave rreth e rrotull. Natyrisht, ky proces çromanizimi i popullsisë së romanizuar të viseve kryesisht bregdetare shqiptare, për

⁸⁵ Për Aulona>Vlonë/ Vlorë shih temën përkatëse në këtë vepër (Kreu VI).

të cilin nuk kemi të dhëna konkrete, ka zgjatur disa shekuj dhe duhet të ketë njohur pjesërisht edhe faza ndërprerjeje të përkohshme gjatë periudhave të ndërhyrjes së mbretërisë së Anzhuinëve dhe të pushtimit venecian të disa qendrave bregdetare shqiptare⁸⁶. Por, në rast se është i saktë mendimi i atyre dijetarëve, sipas të cilëve vllahët e Ballkanit (pra, edhe të Shqipërisë) janë pjesërisht mbeturina të kolonëve të vjetër romakë, atëherë duhet supozuar që çromanizimi i popullsisë romane apo të romanizuar në trevat shqipfolëse nuk ka qenë tërësor. Mirëpo disa studiues të tjerë kanë mbrojtur mendime të tjera mbi prejardhjen e arumunëve. Kështu, një grup studiuesish mendojnë se ata janë rumunë të shkëputur prej trungut rumun rreth shekullit X të erës sonë. Ka edhe mendime të tjera për këtë çështje.⁸⁷

9. Gjithsesi, është një gjë e ditur që prej shekujsh në trevat shqipfolëse ka pasur enklava dhe grupe endacake, që si gjuhë amtare nuk kanë pasur shqipen, por një gjuhë romane. Është fjala për atë pjesë të popullsisë, që njihen me emrin *arumun-ë*, ose *vllah-ë*, ose *çoban-ë*. Këta nuk gjenden vetëm në Shqipëri, por edhe në vende të tjera të Ballkanit Jugor, sidomos në Greqi e Maqedoni (shih për këtë edhe Kreun IV. § 8). Prania relativisht e hershme e arumunëve a vllahëve në trevat shqipfolëse dëshmohet, ndër të tjera, edhe nga gjurmët toponimike, siç janë p.sh. emri i fshatit *Armen* në krahinën e Vlorës, emri i fshatit *Rëmënj* në rrethin e Pogradecit, si edhe emri i zonës së *Kolonjës* në krahinën e Korçës dhe emri i fshatit të *Kolonjës* në rrethin e Lushnjës, që e kanë burimin të fjala arumune-latine *colonia*. Edhe vetëm këto raste do të mjaftonin për të dëshmuar se arumunët a vllahët në viset e banuara nga shqiptarët nuk kanë bërë vetëm jetë endacake, por edhe janë vendosur nëpër qendra banimi pak a shumë të mëdha. E për këtë dëshmojnë edhe vendbanime të tilla si *Voskopoja*, e cila pati një zhvillim kulturor sidomos gjatë shekullit XVIII,

⁸⁶ Për këto shih Xhufi: Dilemat e Arbërit (2006), kapitujt: *Shqipëria dhe Mbretëria e Sicilisë në kohën e Manfredit Hohenshtaufen dhe të Karlit I e II Anzhu* (f. 89-172), *Durrësi mes ekspansionit të mbretërisë së Napolit dhe Republikës së Venetikut* (shek. XI-XV) (f. 209-224) dhe *Venetiku dhe shqiptarët* (f. 225-250).

⁸⁷ Shih Bërxolli: 2005, 110v.

Selenica e Vlorës, ku më parë banonin kryesisht vlllehë, që punonin në minierën e serës, *Kuçova* në krahinën e Beratit, për të mos përmendur blloqe të tëra fshatrash në rrethet e Mokrës, të Lushnjës e të Fierit dhe gjetkë. Por do pasur parasysh se vlllehët gjatë shekujve e sidomos gjatë shekullit XX kanë banuar jo vetëm nëpër fshatra, por edhe nëpër qytetet kryesore të Shqipërisë, si: Elbasani, Tirana, Korça, Berati, Fieri, Vlora etj.

Këto grupe etnokulturore e kanë quajtur veten zakonisht *aromënë*, që lidhet me emrin e Romës dhe të Romanisë, kurse nga shqipfolësit ata njihen kryesisht me emrin *vllah*, shumës *vllah-ë* (me ndërrimin metafonik /-a-/>/-e-/ si te *djalë ~ dje(l) m, plak ~ pleq* etj.). Emri *vllah*, që sot në përgjithësi përdoret në kuptimin *arumun*, sipas Mihăescu-t (*Influența grecească asupra limbii române* (faqe 163), në vendet ballkanike në kohën e Perandorisë Bizantine ka hyrë nëpërmjet sllavëve dhe gjermanëve. Gjithnjë sipas këtij studiuesi, ky emër e ka burimin te fjala keltike (e Galisë) *volkae*, e cila në gjermanishten primitive ka depërtuar në trajtën **walxa-*, kurse në gjuhët gjermanike dëshkohet në këto trajta: në gjermanishten e vjetër dëshkohet në trajtat *walch, walah, wal(a) hisch* me kuptimin “roman, kelt, i huaj”, në gjermanishten e mesme *walsch, walhe* në kuptimin “roman, italian ose francez”. Ai shton se gjermanët e vjetër në krye të herës me këtë emër kanë kuptuar keltët e romanizuar në përgjithësi dhe më pas të gjithë fqinjët e romanizuar. Gjithnjë sipas këtij studiuesi rumun, emri *vllah* në Ballkan është përdorur me kuptimin e popullsisë së romanizuar në jug të Danubit. Për më shumë hollësira rreth historisë së vlllehëve shih veprën e përmendur të këtij autori, f.163-168.

10. Por vlen të shënohet se në një pjesë të mirë të trevave shqiptare ata quhen me emrin *çoban* dhe *çoban-kë* (për femrat) e kjo shpjegohet me faktin se vlllehët a arumunët në zonat fshatare dikur bënë më fort jetën e bariut shtegtar. Emri *çoban* në kuptimin *barí (dhensh)* e ka burimin te persishtja *çupán* (a *shebán*). Kjo fjalë, e cila ka hyrë nëpërmjet turqishtes si në shqipe edhe në gjuhët e tjera ballkanike, me kuptimin e *vllahut* nuk përdoret në asnjë gjuhë tjetër, duke përfshirë këtu edhe persishten e turqishten. Në gjuhën shqipe kjo fjalë duhet të ketë hyrë relativisht herët, për çka dëshmon jo vetëm përhapja e saj e gjerë në të gjitha të folmet e kësaj

gjuhe, si në veri ashtu edhe në jug, por edhe fakti që Frang Bardhi e ka përfshirë në fjalorin e tij të vitit 1635, në f. 78: *opilio, pecoraio = Cioban*. Por në f. 84 Bardhi ka edhe fjalën *barí (barij)* për latinishten *pastor*. Të kihet parasysh se Buzuku dhe Budi nuk e kanë përdorur fjalën *çoban*. Buzuku përdor trajtën e vjetër shqipe *bëruo*, si edhe trajtën e re *barí*, kurse Budi përdor vetëm trajtën e re *barí*. Të kihet parasysh se fjala *barí*, që është formuar nga zgjerimi i trajtës më të hershme *bëruo*, ka qenë dhe është ende shumë e gjallë në të gjitha të folmet e shqipes. Prandaj mbetet e paqartë se si krahas saj hyri në përdorim edhe huazimi turk, me burim persian, *çoban*, që është integruar plotësisht në sistemin gjuhësor të shqipes. Nga ana fonetike bie në sy sidomos që trajta shqipe përkon me atë të turqishtes, ku tingujt /-up-/ të persishtes *çupan* janë shndërruar në /-ob-/: *çoban*. Veç kësaj, në turqishte ai lakohet ashtu si emrat e tjerë të këtij tipi dhe e formon shumësin me formantin *-lar*: *çoban-lar*, kurse në shqipe lakohet si emrat mashkullorë të lakimit të parë dhe e formon shumësin me formantin /-ël/: *çoban-ë* (por edhe *çoben-ë*), pra krejt ndryshe nga ç’ndodh në turqishte dhe në persishten e re, ku emrat e kanë humbur lakimin dhe e formojnë shumësin me formante të tjera; në rastin konkret *çupan-ha* ose *çupan-an*. Vlen të shënohet se emri *çoban (cioban)* në kuptimin e bariut përdoret edhe në rumanishte.

11. Pyetjes se sa ka qenë dhe sa është numri i përgjithshëm i arumunëve në trevat e shtetit shqiptar, është e vështirë t’i jepet një përgjigje e prerë⁸⁸, jo vetëm për mungesë statistikash të sigurta, por edhe për faktin se një pjesë e konsiderueshme e tyre tashmë janë asimiluar, të paktën, gjuhësisht. Gjuhën e tyre amtare, arumanishten, e përdorin kryesisht brezi i vjetër dhe pothuaj vetëm në rrethin familjar. Për më tepër, deri sot nuk është arritur të krijohet një arumanishte standarde për arumunët e Ballkanit në përgjithësi ose për ata të secilit vend ballkanik në veçanti. Si rrjedhim, brezi i ri edukohet nëpër shkollat shtetërore, në të cilat përdoret gjuha standarde e vendit, ku ata jetojnë. Megjithatë, arumunët në Shqipëri, sidomos midis tyre, janë të

⁸⁸ Për numrin e përgjithshëm të arumunëve në Ballkan shih temën *Romanizimi i Ballkanit*,

vetëdijshëm se i përkasin një grupi etnokulturor të ndryshëm nga shqiptarët. Por numri i përgjithshëm i vllahofonëve “prej mbi 112 000 vetësh”, që jep Bërxolli (*vep. e përmendur*, f. 121), mbetet për t’u saktësuar më tej, nëse të gjithë ata e flasin dhe e përdorin rregullisht vllahishten, apo është fjala për banorë me prejardhje arumune, një pjesë e mirë e të cilëve në përdorimin e përditshëm e kanë zëvendësuar gjuhën e tyre amtare me shqipen. Për më tepër, do pasur parasysh se shumë prej tyre kanë marrë pjesë gjallërisht në problemet kombëtare, shoqërore dhe kulturore të popullit shqiptar, sidomos gjatë shekujve të fundit.

12. Nga sa u parashtrua përmbledhtas këtu më sipër, del pak a shumë e qartë se “kolonitë” greke dhe romake duhet të kenë luajtur dikur njëfarë roli në përhapjen e greqishtes, përkatësisht të latinishtes, midis popullsisë vendëse në viset e banuara nga stërgjyshërit e shqiptarëve, por pa arritur që t’i asimilonin ata plotësisht. Helenizimi i një pjese të popullsisë vendëse në Epirin Jugor, sidomos pas periudhës së lashtësisë, është rezultat i disa faktorëve të tjerë, që janë shqyrtuar në temën kushtuar Epirit (Kreu II).

Kreu i katërt

Romanizimi në Europën Juglindore - kohëzgjatja, përmasat dhe pasojat

1. Europa Juglindore, që zakonisht njihet me emrin Gadishulli Ballkanik⁸⁹, nga vetë pozicioni gjeorafik si urë ndërlidhëse midis Europës dhe Azisë, ka tërhequr vëmendjen e popujve të ndryshëm qysh prej kohëve të mugëta parahistorike. Të dhënat arkeologjike, historike dhe gjuhësore dëshmojnë se kjo pjesë e Europës, ashtu si edhe gjithë Europa, ka qenë e banuar nga popuj të ndryshëm, edhe para ardhjes së tribuve të ndryshme indoeuropiane, që e kanë indoeuropianizuar atë qysh prej kohësh të hershme. Indoeuropeanizimi i kësaj pjese të Europës duhet të ketë nisur, të paktën, aty nga fillimi i mijëvjeçarit të dytë para erës sonë⁹⁰ me ardhjen e tribuve të para greke, që më në fund u vendosën në brigjet e detit Egje⁹¹. Për kohën e lashtë dëshmohet edhe prania e popujve të tjerë indoeuropeanë, si trakasit në pjesën lindore, ilirët në pjesën perëndimore dhe maqedonasit në pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik. Natyrisht, ka pasur edhe popuj të tjerë indoeuropeanë, që kanë pasë banuar në këtë pjesë të Europës (shih Katiçiq-in: 1976), e cila, siç u përmend pak më sipër, ka qenë e banuar edhe para ardhjes së tribuve indoeuropiane.

⁸⁹ Nga pikëpamja gjeografike, Gadishulli Ballkanik përfshin vendet në jug të lumenjve Sava dhe Danub, d.m.th. pjesën më të madhe të ish-Jugosllavisë, Bullgarinë, Maqedoninë, Shqipërinë dhe Greqinë. Por ai përdoret shpesh edhe në kuptimin e Europës Juglindore, duke përfshirë kështu edhe Rumaninë. Emrin Ballkan ky gadishull e ka marrë relativisht vonë, aty nga mesi i shekullit XIX, pikërisht nga fjala turke *Ballkan*, që do të thotë “malësi”. Në këtë rast kemi të bëjmë me përkthimin turqisht të emrit të vargmalit *Stara Planina* në Bullgarinë veriore. Në lashtësi ky vargmal njihej me emrin *Haemus*.

⁹⁰ Sipas Martinet-it (1986, 19), valët e para të fiseve indoeuropiane drejt Danubit dhe Ballkanit janë edhe më të hershme.

⁹¹ Fiset greke kanë shtegtuar drejt Ballkanit në dy valë kryesore. Vala e parë është kryer aty nga fillimi i mijëvjeçarit të dytë para erës sonë, kurse vala e dytë, ajo e dorasve, është kryer aty nga shekulli XII para erës sonë (shih Martinet-në: 1986, f. 40).

Por nga ç'popuj ka qenë banuar, s'mund të thuhet asgjë me siguri. Nuk kanë munguar edhe përpjekjet për t'i emërtuar ata me emrin *pellazgë* a me ndonjë emër tjetër, si edhe për të bërë hipoteza mbi gjuhën a gjuhët e tyre (shih Kreun I). Gjithsesi, duke marrë parasysh gjerësinë dhe rrethanat gjeografike të Europës Juglindore, mund të pohohet se vështirë që ajo popullsi të ketë qenë homogjene. Madje, edhe sikur në krye të herës të ketë pasë qenë homogjene, me kalimin e kohës nuk do të mund të kishte mbetur e tillë, por do të ishte degëzuar në njësi më të vogla, ku secila etni do të kishte zhvilluar gjuhën e vet.

2. Pozicioni gjeografik i Europës Juglindore u ka dhënë shkas gjithashtu edhe dyndjeve të herëpashershme të tribuve dhe të popujve të ndryshëm që, edhe kur kanë qëndruar për një kohë të kufizuar në këtë pjesë të Europës, prapë kanë lënë këtu, herë më shumë e herë më pak, gjurmë. Natyrisht, këto gjurmë mund të hulumtohen e të diktohen më lehtë për periudha historike pak a shumë të njohura, siç është p.sh. rasti i gjurmëve që ka lënë në gjuhën bullgare gjuha e fisit turko-tatar të protobullgarëve⁹², të cilët erdhën e u mbishtresuan mbi popullsinë e sllavizuar të Bullgarisë [dikur Trakisë] në vitet tetëdhjetë të shekullit VII të erës sonë, duke i dhënë asaj, ndër të tjera, edhe emrin etnik *bullgar*.

3. Prandaj nuk ishte aspak e papritur që Europa Juglindore, ose thënë ndryshe Gadishulli Ballkanik, të mos tërhiqte edhe vëmendjen e sundimtarëve të Romës së lashtë, kur ata i vunë vetes si synim zgjerimin e vazhdueshëm të kufijve të shtetit të tyre edhe jashtë Gadishullit Italik. Dhe arsyet për të pushtuar njërin pas tjetrit vendet e Europës Juglindore, nuk ishte e vështirë të gjendeshin, ose të sajoheshin. Këtu nuk është rasti të shqyrtohen ato ngjarje historike, që në Europën Juglindore lanë gjurmë aq të shumta, të cilat për nga thellësia dhe shtrirja gjeografike u kapërcyen vetëm nga sa ndodhi në Europën Perëndimore me romanizimin jo vetëm të Italisë, por

⁹² Sipas Stojanovit (1977, f. 20 - me literaturë), në bullgarishte kanë mbijetuar vetëm 11 fjalë nga gjuha e protobullgarëve të Asparuhut (me origjinë turko-tatare), që u mbishtresuan mbi popullsinë e sllavizuar në vitet 80 të shekullit VII të erës sonë. Siç dihet, edhe emrin *bullgar* kjo popullsi e sllavizuar e mori nga fisi turko-tatar i protobullgarëve, ashtu si popullsia e romanizuar e Galisë e mori emrin e ri nga fisi gjerman i *frankëve*, që u mbishtresua mbi të.

edhe të Spanjës, të Portugalisë, të Francës e pjesërisht edhe të disa krahinave të Zvicrës e të Belgjikës. Pushtimet romake të Europës Juglindore nisën qysh nga viti 228 para erës së re në Iliri dhe vazhduan më tej në Dardani më 75 para erës së re, në Mezinë e Sipërme më 29 para erës së re, në Traki më 46 pas erës së re dhe në Daki më 107 pas erës së re (shih Solta: 1980, f.65, 67). Ata pushtuan edhe Greqinë përfundimisht aty nga fillimi i shekullit të fundit para erës sonë, por pushtimet romake në viset e banuara nga grekët kishin nisur qysh një shekull më parë dhe vazhduan më pas edhe përtej Bosforit.

4. Por me ç'popuj erdhën në kontakt romakët, kur pushtuan vendet e ndryshme të Europës Juglindore? Kësaj pyetjeje mund t'i jepet vetëm një përgjigje e përafërt, duke qenë se njohuritë tona për përbërjen etnike të kësaj zone në atë kohë nuk janë të plota. Në përgjithësi, pranohet që në jug të gadishullit banonin fise greke, në pjesën lindore banonin fise që njihen me emrin trakas, në pjesën perëndimore banonin fise që njihen me emrin ilirë, kurse në pjesën qendrore banonin maqedonasit (e lashtë). Por përveç këtyre, ka pasur edhe etni më të vogla, nga të cilat mjafton të përmendim atë të keltëve të ardhur në këtë zonë aty nga fillimi i shekullit III para erës së re; ata themeluan edhe vendbanimin e njohur me emrin *Singidunum*, të cilin sllavët më vonë e pagëzuan me emrin *Belgrad* (shih, ndër të tjerë, Katiçiq-in: 1976: f.159, 162). Por edhe disa nga etnitë e mëdha, që u përmendën këtu më sipër, sipas disa dijetarëve, nuk kanë qenë homogjene për nga përbërja. Kështu p.sh. për pjesën lindore ata dallojnë trakasit e mirëfilltë në jug nga dakët a dako-mizët në veri të lumit Danub. Po kështu, disa studiues epirotët i mbajnë për një etni më vete, por në përgjithësi duket më i mbështetur mendimi, sipas të cilit epirotët ishin një degëzim i ilirëve (shih Kreun II, § 4).

5. Tashmë dihet se kudo që romakët vendosën pushtetin e tyre, arritën suksese të mëdha edhe në zbatimin e një politike asimilimi të popullsiive të ndryshme nën sundimin e tyre. Mjafton të kujtojmë përmasat e mëdha të romanizimit të krejt Gadishullit Italik dhe të pjesës më të madhe të Europës Perëndimore. Edhe në Gadishullin Ballkanik romanizimi i popujve të pushtuar prej romakëve duhet të ketë marrë përmasa më të mëdha nga sa është dokumentuar. Përveç romanizimit në

pjesën lindore (rumunët me degëzimet e tyre të arumunëve etj.), dihet që u romanizuan edhe dalmatët në pjesën perëndimore të këtij gadishulli. Gjuha e këtyre të fundit, e cila ndryshonte nga rumanishtja⁹³, me kalimin e kohës doli jashtë përdorimit nën trysninë e serbokroatishtes. Gjurmët e fundit të asaj gjuhe vazhduan deri aty nga fundi i shekullit XIX, kur gjuhëtari italian Matteo Bartoli mbledhi lëndë gjuhësore nga personi i fundit, që e fliste ende atë gjuhë dhe i botoi ato më 1906 në Vjenë me titullin *Das Dalmatische*.

6. Pra, në gjendjen e sotme demografike të Gadishullit Ballkanik i vetmi popull i romanizuar mbeten rumunët me degëzimet e tyre, arumunët, meglenorumunët dhe istrorumunët⁹⁴. Rumunët përbëjnë një popullsi prej afër 21 000 000 frymësh, shumica e të cilëve jetojnë në Republikën e Rumanisë, por ka edhe pakica rumanishtfolëse në shtete të tjera fqinje. Gjuha e rumunëve, rumanishtja, është përftuar nga evolucioni i latinishtes popullore të Ballkanit Lindor, çka parakupton që stërgjyshërit e rumunëve të sotëm janë pasardhësit e romanizuar të banorëve të dikurshëm të asaj treve, ku pushtuesit romakë ushtruan një ndikim të fuqishëm asimilues nëpërmjet përhapjes së latinishtes me anë të administratës, ushtrisë dhe kolonëve romakë. Të kihet parasysh se për shkak të pozicionit gjeografik të Dakisë në skanjin verilindor të Perandorisë Romake, të ekspozuar ndaj sulmeve të popujve “barbarë”, romakët ishin të detyruar të përqendronin atje forca të shumta ushtarake, si edhe një numër relativisht të madh kolonësh romakë, gjë që ka ndikuar së tepërmi në romanizimin e popullsisë autoktone të asaj treve. Shndërrimi i shkallëshkallshëm i latinishtes vulgare lindore në një gjuhë cilësisht të re, në rumanishten, duhet të ketë zgjatur disa shekuj. Në përgjithësi mendohet që ky shndërrim është kryer brenda shekujve V-VIII të

⁹³ Mjafton të përmendim këtu faktin që ndërsa rumanishtja, ashtu si shqipja, bullgarishtja dhe maqedonishtja, e prapavendos nyjën shquese, dalmatishtja nyjën shquese e ka të paravendosur, ashtu si gjuhët romane perëndimore.

⁹⁴ Meglenorumunët dhe istrorumunët, në thelb, janë degëzime të arumunëve, që gjenden të parët në të dyja anët e kufirit midis Greqisë e Maqedonisë dhe të dytët në gadishullin e Istriës në pjesën veriore të Dalmacisë. Këto dy grupime të vogla janë gati në çromanizim të plotë (shih Çerniak: 1990/a, f. 221, përkatësisht Suhaçev: 1990, 143v.).

erës sonë. Në këtë shndërrim cilësor një rol të rëndësishëm ka luajtur pa dyshim edhe gjuha e mëparshme e kësaj popullsie, që u romanizua, për çka dëshmon, ndër të tjera, edhe prania e një numri të konsiderueshëm fjalësh të vjetra jolatine, që kanë mbijetuar në rumanishte dhe që në një pjesë të madhe kanë edhe gjegjëset e tyre në gjuhën shqipe.⁹⁵

7. Por pyetjes se ku është kryer ky evolucion, i janë dhënë tri përgjigje të ndryshme. Për një palë dijetarësh ky evolucion është kryer në viset në jug të lumit Danub. Si rrjedhim, sipas tyre, në kohë më të vona, përafërsisht pas shekullit X të erës sonë, stërgjyshërit e rumunëve u shpërngulën në trevat e sotme të Rumanisë në veri të Danubit. Ata që mbrojnë këtë hipotezë, mbështeten në faktin historik që perandori Aurelian në vitin 271 nën trysninë e gotëve e tërhoqi popullsinë e romanizuar nga viset e pushtuara në veri të Danubit dhe e vendosi në jug të atij lumi. Sipas disa dijetarëve të tjerë, Aureliani nuk arriti t'i tërhiqte të gjithë banorët e romanizuar nga Dakia, ku mbetën një pjesë e vogël syresh, kryesisht nëpër fshatra. E këta banorë të mbetur atje, sipas këtyre dijetarëve, kanë përbërë bërthamën e rumunëve të sotëm. Dhe së fundi, disa dijetarë të tjerë, duke e gjykuar të pambështetur si hipotezën e parë ashtu edhe të dytën, kanë mbajtur një qëndrim të ndërmjetëm që duket edhe më i mundshëm. Sipas këtyre dijetarëve, rumunët e sotëm janë ngjizur si popull si në veri ashtu edhe në jug të lumit Danub. Dhe në të vërtetë, duket e pamundshme që në kushtet historike të shekullit III të erës sonë Aureliani të ketë pasur mundësi t'i tërhiqte të gjithë banorët e romanizuar të Dakisë. Por, nga ana tjetër, vetëm banorët e romanizuar, që mbetën në Daki pas tërheqjes së vitit 271, vështirë se mund të përbënin bërthamën e popullit rumun me një shtrirje aq të gjerë në veri të Danubit, aq më shumë po të kemi parasysh se Dakia dhe trevat në jug të Danubit pas shekullit III janë bërë objekt sulmesh nga popuj

⁹⁵ Sipas Brâncus-it (1983, 130), fjalët e vjetra të përbashkëta midis shqipes dhe rumanishtes arrijnë në 89 njësi. Të tilla janë: *baltë* - *baltā*, (*i*) *bardhë* - *barz* (= lejlek), *bredh-i* - *brad*, *mal-mal* "breg lumi", *qafë* - *ceafă* etj. Po sipas këtij autori (1983, 131vv.), në rumanishte mbijetojnë edhe mjaft fjalë të tjera të substratit, që nuk ndeshen në gjuhën shqipe, si: *brânz* "djathë", *strugure* "rrush" etj.

të ndryshëm. Prandaj është më afër mendsh të pranohet që një pjesë e mirë e popullsisë së shpërngulur nga Aureliani pas disa kohësh ta ketë kaluar përsëri Danubin dhe të jetë bashkuar me popullsinë e romanizuar të mbetur në Daki. Dhe të gjithë këta së bashku kanë përbërë bërthamën, nga e cila u formua populli rumun. Do pasur parasysh se shtegtime nga njëra anë e Danubit në tjetrën janë vërtetuar edhe në mjaft raste të tjera.

8. Një pjesë e popullsisë së romanizuar të Europës Juglindore aty nga shekujt e fundit të mijëvjeçarit të parë të erës sonë, me sa duket, nën trysninë e tribuve sllave dhe të fisit të bullgarëve, që vërshuan drejt Gadishullit Ballkanik, u shtrënguan të shpërnguleshin në vende të ndryshme të këtij gadishulli dhe nisën të bënin një jetë shtegtare, duke u marrë kryesisht me blegtori me kullota malore në verë dhe kullota fushore në dimër. Është fjala për arumunët a vllahët⁹⁶. Gjuha e tyre ishte e ngjashme me rumanishten, natyrisht duke pësuar edhe ndryshime jo të parëndësishme me kalimin e kohës edhe nën trysninë e gjuhëve të popujve, me të cilët ata ishin në kontakt të vazhdueshëm. Arumunët a vllahët dëshmohen në vende të ndryshme të Ballkanit e sidomos në Traki, në Maqedoni, në Thesali, në Shqipëri e më pas edhe në Dalmaci. Sipas Th. Kapidanit, në vitin 1932 numri i përgjithshëm i arumunëve arrinte në rreth 300 000-350 000 veta (cituar sipas Fr. Di Miceli: 1999, f.170). Një shifër të tillë edhe më të detajuar na e jep edhe Çerniaku (1990/193), ku pohohet se numri i përgjithshëm i arumunëve sot paraqitet mjaft më i vogël. Gjithsesi, numri i përgjithshëm i tyre sot është vështirë të përcaktohet, duke qenë se një pjesë e mirë e tyre, sidomos nëpër qytete, me kalimin e kohës e kanë bjerrë gjuhën amtare dhe flasin gjuhën e popullit me të cilin janë në kontakt, d.m.th. bullgarisht, maqedonisht, greqisht, shqip ose serbokroatisht, pra, në thelb shumë prej tyre janë çromanizuar. Deri sot nuk ka një mendim të përbashkët lidhur me vendin prej nga janë shpërngulur të parët e arumunëve. Gjithsesi, afëria e madhe e gjuhës së tyre me rumanishten është një tregues i qartë se vendi prej nga ata janë shpërngulur në krye të herës, duhet të ketë qenë brenda perimetrit të zonës, ku u

⁹⁶ Por për prejardhjen e arumunëve ka edhe mendime të tjera (shih temën: “Kolonitë” greke, romake dhe romane, Kreu III, §§ 9-11.

formua etnosi rumun.

9. Të dhëna të tjera për romanizimin e popujve ballkanikë nuk kemi. Veçse merret me mend që dikur edhe pjesë të tjera të popullsisë së kësaj treve duhet të kenë qenë romanizuar, por pas dyndjeve sllave janë sllavizuar. Një vërejtje e tillë vlen sidomos për popullsinë e qyteteve, ku edhe trysnia e latinishtes ka qenë më e madhe. Madje, mund të pohohet që procesi i romanizimit, ndonëse në një masë më të kufizuar, duhet të ketë vepruar edhe mbi popullsinë greqishtfolëse, e cila në përgjithësi e ruajti më mirë gjuhën e vet amtare. Pra, mund të pohohet që pjesa më e madhe e popullsisë në pjesën lindore dhe perëndimore të Europës Juglindore ishte e romanizuar para dyndjeve sllave në këto treva. Por s' mund të thuhet asgjë me siguri se sa thellë kishte përparuar procesi i romanizimit në trevat qendrore të gadishullit.

Procesi i romanizimit të popullsisë në trevat ballkanike duhet të ketë pësuar njëfarë ngadalësimi, përkatësisht ndërprerjeje, sidomos pas ndarjes së Perandorisë Romake në dy pjesë në vitin 395 të erës sonë, kur trevat ballkanike kaluan nën pushtetin e Perandorisë Romake të Lindjes me qendër Bizantin, quajtur ndryshe edhe Perandoria Bizantine. Sado që edhe në Perandorinë Bizantine për njëfarë kohe (deri aty nga fundi i shekullit VI - shih Mihăescu: 1978, f.55) gjuha latine mbeti në përdorim si gjuhë zyrtare në administratë, si edhe në ushtri, ajo erdh e u zëvendësua dalngadalë nga greqishtja. Për më tepër, procesi i romanizimit pësoi një goditje të rëndë pas dyndjeve të tribuve sllave, që u përhapën në shumë treva të Ballkanit Verior, Lindor dhe Perëndimor, duke sllavizuar pak nga pak një pjesë të mirë të popujve të atyre trevave. Gjithsesi, nuk duhet menduar që popullsia e trevave ballkanike të sllavizuara ishte e tëra e romanizuar në kohën e dyndjeve sllave. Dihet p.sh. që fisi trakas i besëve (në pjesën perëndimore të Bullgarisë) mbijetonte ende në shekullin VI të erës sonë. Një tjetër dëshmi e mbijetesës së një pjese të popullsisë trakase në kohën e dyndjeve sllave është edhe fakti që këta, ashtu siç vuri në dukje Katiçiqi (1976, 136v.), “erdhën në kontakt të drejtpërdrejtë me trakas, të cilët flisnin ende gjuhën e tyre: krahaso emrin e qytetit *Plovdiv* nga trakishtja *Pulpudeva* dhe jo nga greqishtja *Philippópolis*”.

10. Mungesa e të dhënave për mesjetën e hershme e bën shumë të vështirë të përshkruhet gjendja etnike e Gadishullit Ballkanik në kohën e dyndjeve sllave në shekujt VI-VII të erës sonë. Por mund të pohohet se në atë kohë edhe etni të tjera kishin mundur t'i shpëtonin procesit të romanizimit. E një dëshmi bindëse për këtë pohim na e jep pa dyshim prania jo vetëm e grekëve por edhe e popullit shqiptar. Për sa u takon grekëve, në përgjithësi mendohet se ata i bënë ballë procesit të romanizimit, në radhë të parë, falë epërsisë së tyre kulturore, që ushtroi një ndikim të fuqishëm mbi vetë romakët, ashtu siç pohon Horaci në një nga epistulat e tij: "Graecia capta ferum victorem cepit." Problemore paraqitet mungesa e romanizimit të etnosit arbëresh [shqiptar] i cili, me gjithë trysnitë e ndryshme, që ka pësuar jo vetëm gjatë sundimit romak por edhe gjatë sundimeve të tjera të huaja, ka mundur ta ruajë gjuhën dhe identitetin e vet. Prania e popullsisë shqipfolëse në Ballkanin Perëndimor dëshmon jashtë çdo dyshimi se romakët nuk arritën t'i romanizonin të gjithë të parët e shqiptarëve të sotëm. Në këtë përfundim arrihet pavarësisht nga diskutimi i njohur mbi origjinën dhe atdheun e lashtë të stërgjyshërve të shqiptarëve në Gadishullin Ballkanik. Edhe sikur të pranoheshin hipotezat mbi prejardhjen trake apo dako-mize të shqiptarëve, të mbrojtura nga disa dijetarë ballkanas dhe joballkanas⁹⁷, prapëseprapë nuk mund të mohohet që stërgjyshërit e shqiptarëve në kohën e pushtimit dhe të sundimit romak banonin diku në këtë gadishull, pra ishin të ekspozuar ndaj ndikimit të latinishtes, d.m.th. ndaj procesit të romanizimit. E aq më pak mund t'i shpëtonin ata këtij procesi në bazë të tezës në përgjithësi më të argumentuar, sipas të cilës shqiptarët janë pasardhësit e drejtpërdrejtë të ilirëve të jugut⁹⁸. Gjithsesi, prania e stërgjyshërve të shqiptarëve në Ballkan në kohën e pushtimit romak të këtij gadishulli, d.m.th. para ardhjes së sllavëve këtu, dëshmohep nëpërmjet një sërë argumentesh të karakterit historik dhe sidomos gjuhësor.

⁹⁷ Për mbrojtësit e kësaj hipoteze dhe për argumentet që ata sjellin në mbështetje të saj shih Demiraj: 1999, 75vv. - me literaturën përkatëse

⁹⁸ Për mbrojtësit e kësaj teze dhe për argumentet që ata sjellin në mbështetje të saj shih Demiraj: 1999, 73vv. - me literaturën përkatëse.

11. Për sa u takon argumenteve të karakterit historik, mjafton të përmendim këtu faktin e vënë në dukje nga historiani suedez J. Thunmann (1774) dhe nga disa dijetarë të tjerë, që nëpër kronikat e autorëve të ndryshëm të lashtësisë dhe të mesjetës nuk përmendet gjëkund ndonjë imigrim i stërgjyshërve të shqiptarëve në trojet e tyre të sotme. Të kihet parasysh se vëmendjes së atyre kronikanëve nuk u kanë shpëtuar as inkursione më pak a më shumë të gjata, si ato të keltëve, të ostrogotëve, të visigotëve, të hunëve, të avarëve etj., që nuk kanë lënë gjurmë të dukshme në Ballkan. Kurse në rastin e stërgjyshërve të shqiptarëve do të kishim të bënim me një shpërngulje mjaft të gjerë, që nuk mund të kishte mbetur pa u vënë re e pa u përmendur nga historianët dhe kronikanët e kohës, kur mund të ishte vërtetuar një shpërngulje e tillë. E pikërisht duke u mbështetur në këtë fakt, Thunmann-i dhe disa dijetarë të tjerë pas tij kanë mbrojtur mendimin për një prani relativisht të hershme të stërgjyshërve të shqiptarëve në brigjet lindore të Adriatikut, d.m.th. në vendbanimet e sotme të shqiptarëve. Sa për ilustrim unë po përmend këtu vetëm pohimin e Thunmann-it dhe atë të dijetarit kroat R. Katiçiq.

12. Thunmann-i (1774, 245v.), siç u vu në dukje edhe në Kreun II, § 17, pohoi se në historinë e shqiptarëve nuk kishte gjetur asnjë gjurmë të ndonjë shtegtimi të tyre të mëvonshëm dhe se gjuha e tyre ka dhënë dëshmi të tilla nga fatet e popullit, që në këtë ai nuk mund të mos njihte fqinjët e stërmoqëm të grekëve dhe nënshtetasit e Romës së vjetër. Dhe të dyja këto atij i tregonin ilirët e vjetër. Një pohim të ngjashëm e gjejmë edhe te Katiçiqi (1976, 184v.): “Në burimet historike nuk përmendet ndonjë migrim shqiptar. Prandaj është e natyrshme të pranohet që qysh prej kohësh të lashta shqipja është folur pak a shumë në të njëjtën trevë, ku flitet sot.”

Gjithsesi, prania e shqiptarëve në Ballkan para sllavëve nuk është vënë në dyshim nga shumica dërrmuese e studiuesve. Mjafton të përmendim këtu edhe mendimin e gjuhëtarit tjetër kroat, Henrik Bariq, dhe të gjuhëtarit amerikan Eric P. Hamp. Kështu, Bariqi (1955, 50v.), i cili mbron hipotezën e prejardhjes trakase të shqipes dhe si rrjedhim parakupton një shpërngulje të stërgjyshërve të shqiptarëve në trevat e tyre të sotme nga vise më lindore të Ballkanit, mendonte se një shpërngulje

e tillë duhet të ketë ndodhur para ardhjes së sllavëve dhe pikërisht në shekujt II-III të erës sonë. Edhe sipas Hamp-it (1966, 106), “Natyrisht në çdo rast ne do të mund të provonim që shqiptarët u kanë paraprirë [preceduar] sllavëve, dhe kurrë të kundërtën.”

Pra, studiues të ndryshëm në përgjithësi e kanë pranuar praninë e stërgjyshërve të shqiptarëve në Ballkan qysh nga kohëra relati visht të vjetra. Por, siç dihet, ata nuk kanë pasur që të gjithë të njëjtin mendim mbi prejardhjen e shqiptarëve, duke qenë se disa prej tyre (Thunmann-i: 1774, Meyer-i: 1888, I, f.804 etj.) kanë mbrojtur hipotezën që stërgjyshërit e këtyre kanë qenë ilirë, kurse disa të tjerë kanë mbrojtur hipotezën që ata kanë qenë trakas (Weigand-i: 1927, Bariqi: 1955, 31 vv. etj.), përkatësisht dako-mizë (Georgievi: 1960, 18v.). Gjithashtu disa prej studiuesve të shqipes janë përpjekur të vërtetojnë që shqiptarët në trevat e tyre të sotme ndodhen qysh nga kohëra relativisht të lashta, kurse disa të tjerë kanë menduar për një shpërngulje të stërgjyshërve të shqiptarëve në trevat e tyre historike në kohë relativisht të vona. Madje, kohët e fundit studiuesi gjerman G. Schramm (1994) është përpjekur të vërtetojë që stërgjyshërit e shqiptarëve kanë qenë nga fisi trakas i *besëve* dhe janë shpërngulur në trevat e sotme aty nga shekulli VI i erës sonë (shih Demiraj: 1999, f.85).

13. Siç dihet, kundër një shpërnguljeje relativisht të vonë të stërgjyshërve të shqiptarëve në brigjet lindore të Adriatikut janë shprehur një varg studiuesish (shih Demiraj: 1999, 89vv.) dhe argumenti kryesor, që kanë sjellë ata, ka qenë fakti që të dhënat e historisë nuk bëjnë fjalë për ndonjë shpërngulje të tillë. Por mungesa e të dhënave historike mbi ndonjë shtegtim relativisht të vonë të stërgjyshërve të shqiptarëve në brigjet lindore të Adriatikut është një *argument ex silentio*. Prandaj në këtë rast kjo çështje duhet vështruar edhe në lidhje të ngushtë me argumente konkrete. Dhe për çështjen, që është objekti i këtij kapitulli, argumentin thelbësor në të mirë apo kundër pranisë së hershme të stërgjyshërve të shqiptarëve në brigjet lindore të Adriatikut, mund të na e japë vetë gjuha shqipe. Pavarësisht nga mendimet e ndryshme mbi prejardhjen ilire apo trake ose dako-mize të shqiptarëve (shih për këto Demiraj: 1999, 69vv. -me literaturën përkatëse), të gjithë studiuesit e historisë

së gjuhës shqipe kanë pranuar që në këtë gjuhë ka një numër relativisht të madh huazimesh latine. Prania e këtyre huazimeve është një dëshmi e qartë e kontakteve të hershme dhe të gjata të stërgjyshërve të shqiptarëve me romakët, që erdhën e i vunë ata nën sundimin e tyre. *Ku* janë zhvilluar ato kontakte, *kur* kanë nisur dhe *sa* kanë zgjatur? Sqarimi i këtyre pyetjeve paraqit një varg vështirësish për mungesë dokumentimesh historike, prandaj edhe dijetarë të ndryshëm kanë mbrojtur mendime të ndryshme edhe për çështje të tilla thelbësore si prejardhja e shqiptarëve dhe vendbanimi i hershëm i stërgjyshërve të tyre në Gadishullin Ballkanik. Këtu do të ndalemi pak vetëm në pyetjen se *ku* janë zhvilluar dhe *sa* kanë zgjatur kontaktet midis romakëve dhe stërgjyshërve të shqiptarëve, sepse sqarimi i këtyre pyetjeve mund të hedhë më shumë dritë mbi arsyet përse gjuha shqipe, ndonëse mjaft e ndikuar nga latinishtja, sidomos në fjalor, mundi të ruante identitetin e saj dhe si rrjedhim folësit e saj nuk u romanizuan ashtu si të parët e rumunëve të sotëm.

14. Në mungesë të dhënash historike edhe në këtë rast mund të na vijë në ndihmë vetë gjuha shqipe nëpërmjet sqarimit historik të huazimeve latine, që ajo ka integruar në sistemin e saj. Në rast se ato janë shumë të vjetra dhe kanë nisur të depërtojnë në të qysh para erës sonë, atëherë kjo do të dëshmonte se kontaktet midis pushtuesve romakë dhe stërgjyshërve të shqiptarëve kanë nisur shumë herët, çka do të parakuptonte që ato kontakte duhet të jenë zhvilluar në ato treva të Gadishullit Ballkanik, ku romakët vendosën më herët pushtetin e tyre, d.m.th. në brigjet lindore të Adriatikut. Një mendim i tillë është shprehur ose nënkuptuar nga ata dijetarë, që kanë pranuar se në gjuhën shqipe ka edhe një shtresë huazimesh latine të periudhës para erës së re. Këtu nuk është rasti të përmenden të gjithë ata dijetarë, që kanë shprehur një mendim të tillë. Prandaj po kufizohem duke përmendur vetëm njërin prej tyre dhe pikërisht gjuhëtarin e njohur me origjinë zvicerane, Wilhelm Meyer-Lübke. Ky (1914, f.32) pohon se “elementi latin në shqipe paraqit një gjendje gjuhësore më të vjetër se çdonjëra prej gjuhëve romane.” Në këtë përfundim ai arriti duke u mbështetur në faktin që në elementin e vjetër latin të kësaj gjuhe bashkëtingëllorja /k-/, e ndjekur nga një zanore e përparme (/e-/, ose /i-/), nuk është qiellzorëzuar. Një dukuri të tillë, që e patën vënë re së pari Kopitari (1829)

dhe Meyer-i (1888, f.805), e kanë vënë në dukje edhe gjuhëtarë të tjerë më pas, sidomos Çabej (1974, 16vv.), i cili ka parashtruar edhe elemente të tjera arkaike të huazimeve latine të shqipes. Për më tepër, studiues të ndryshëm kanë vënë në dukje se në gjuhën shqipe ndeshen edhe disa fjalë prej burimi latin, që nuk hasen në rumanishte, madje disa sosh nuk ndeshen as në gjuhët romane perëndimore. Kështu p.sh. Mihăescu (1966, 30v.) ka vënë në dukje se në gjuhën shqipe janë ruajtur 85 fjalë prej burimi latin, që nuk kanë mbijetuar në asnjë gjuhë romane. Nga këto ai përmend, ndër të tjera, *bujk*<*bubulcus*, *mërrajë*<*hibernalia*, *shelqëror*<*sarcinarius*, *tërfurk*<*trifurcus* etj. Po ky gjuhëtar (1966, 21vv.) ka vënë në dukje se 151 huazime latine të shqipes nuk ndeshen në rumanishte. Ndër këto ai përmend: *mik*<*amicus*, *anmik/armik*<*inimicus*, *bekoj*<*benedicere*, *qelq*<*calix/calic-is*, *gjel*<*gallus*, *mjek*<*medicus*, *shërbej*<*servire*, *shpërej*<*sperare* etj. Ai (f. 125vv.) përmend edhe 39 fjalë latine, që ndeshen vetëm në shqipe dhe në rumanishte, si *krushk*, rum. *cuscru*<lat. *consocer*, *mbret*, rum. *împărat* < lat. *imperator*- etj., dhe 270 fjalë latine që ndeshen edhe në të gjitha gjuhët romane, përfshirë këtu edhe rumanishten.

15. Pra, mendimi që stërgjyshërit e shqiptarëve u gjendën shumë herët nën sundimin e Romës, gjen mbështetje të plotë nga vetë karakteri arkaik i huazimeve latine të shqipes, çka parakupton që ata duhet të kenë pasë banuar në treva, që u pushtuan më herët nga romakët, d.m.th. afër brigjeve të Adriatikut.. Mirëpo një rrethanë tjetër duket sikur nuk e mbështet një mendim të tillë. Siç dihet, romakët arritën të romanizonin stërgjyshërit e rumunëve, megjithëse vendbanimi i këtyre, Dakia, qëndroi shumë më pak kohë nën sundimin romak dhe pikërisht qysh nga viti 107 deri më 271 të erës sonë, kur perandori Aurelian, nën trysninë e gotëve, tërhoqi nga viset e pushtuara në veri të Danubit pjesën më të madhe të popullsisë së romanizuar dhe e vendosi atë në jug të atij lumi (shih Demiraj: 1994, 60 - me literaturë). Prandaj në këtë rast lind vetiu pyetja: Si mund të shpjegohet që stërgjyshërit e shqiptarëve nuk u romanizuan, megjithëse sipas tezës së porsapërmendur ata duhet të kenë qendruar nën sundimin romak për një kohë relativisht shumë më të gjatë se stërgjyshërit e rumunëve? Kjo pyetje, në një vështrim të parë, hedh një hije të fortë

dyshimi mbi praninë e stërgjyshërve të shqiptarëve në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik në lashtësi. Por, nga ana tjetër, praninë e tyre në afërsi të Adriatikut e vërtetojnë edhe dëshmi të tjera e një nga këto është edhe prania e një numri jo të vogël huazimesh nga greqishtja e vjetër (me burim dorik) në gjuhën shqipe, siç janë, ndër të tjera: *mokën(ë)/mokër(ë)* < *māk^hanā*, *lakën{ë}/lakër{ë}* < *lak^hanon* (shih Thumb-in: 1910, Demiraj-n: 1999, 125vv. - me literaturë). Mbi këtë bazë Huld-i (1985, f.246) pohon: "Prania e huazimeve nga greqishtja e vjetër perëndimore në shqipe dëshmon se në lashtësinë klasike pararendësit e shqiptarëve ishin një tribu ballkanike në veri dhe në perëndim të grekëve". Por këtu do të ndalemi vetëm në dëshmitë prej burimi latin.

16. Lidhur me pyetjen për çështjen e romanizimit të stërgjyshërve të shqiptarëve, do pasur parasysh se këtu është fjala për mungesën e romanizimit të plotë të tyre, sepse një romanizim i pjesshëm i tyre, sidomos nëpër zonat bregdetare dhe qytetare, ka qenë i pashmangshëm. Procesi i romanizimit duhet të ketë marrë përmasa më të mëdha sidomos në zonat qytetare afër bregdetit, ku edhe trysnia e pushtetit romak ka qenë më e fuqishme. Por fakti që stërgjyshërit e shqiptarëve e ruajtën gjuhën e tyre, ndonëse të ndikuar mjaft nga latinishtja, tregon qartë se ata mundën t'i shpëtonin procesit të romanizimit të plotë, të cilit iu nënshtruan stërgjyshërit e rumunëve si edhe dalmatët e vjetër dhe ndonjë pjesë tjetër e popullsisë së Gadishullit Ballkanik, që erdhën e u sllavizuan pas dyndjeve të tribuve sllave gjatë shekujve VI-VII të erës sonë. Por cilët do të kenë qenë faktorët dhe rrethanat, që kanë bërë të mundur mbijetesën e etnosit arbëresh?

Një ndër faktorët kryesorë në këtë rast duhet të ketë qenë karakteri i theksuar konservues i etnosit arbëresh (shqiptar), i cili ka qenë shumë i lidhur me gjuhën amtare dhe me doket e traditat e tij dhe ka bërë gjatë shekujve të lashtësisë dhe të mesjetës një jetë të mbyllur pa u përzier me elementë etnish të tjera, që jetonin pranë tij. Një dëshmi për këtë na e japin edhe arbëreshët e Greqisë e të Italisë, të cilët gjatë shekujve të kaluar kanë bërë një jetë të mbyllur midis tyre, duke i shpëtuar kështu procesit të helenizimit, përkatësisht të italianizimit. Por, kur jeta e tyre filloi të ndryshonte nën ndikimin e ndryshimeve të mëdha ekonomike e shoqërore të kohëve

moderne, sidomos gjatë shekujve XIX e XX, atëherë edhe procesi i helenizimit, përkatësisht i italianizimit të tyre u bë i pashmangshëm jo vetëm nëpërmjet integritimit të tyre në veprimtaritë ekonomike, shoqërore dhe politike të mjedisit rrethues helen, përkatësisht italian, por edhe nëpërmjet shkollimit në gjuhën greke, përkatësisht italiane. E po të mbahet parasysh kjo dukuri e arbëreshëve të Greqisë dhe të Italisë, atëherë nuk është e vështirë të kuptohet që karakteri konservues i etnosit arbëresh duhet të ketë qenë faktori kryesor, që ka bërë të mundur ruajtjen e identitetit të etnosit arbëresh në trojet e veta amtare edhe pas pushtimit romak të këtyre trojeve, ku ai duhet të ketë përbërë shumicën e popullsisë dhe në përgjithësi ka bërë një jetë të mbyllur, pothuaj “të pavarur”, pa u përzier me të huajt dhe pa iu nënshtuar plotësisht atyre. Por natyrisht ai nuk mund t’i shpëtonte ndikimit të tyre të shumanshëm, për çka dëshmon edhe prania e huazimeve të shumta dhe të ndryshme latine në gjuhën shqipe.

17. Për ruajtjen e identitetit etnik të të parëve të shqiptarëve gjatë pushtimit romak një rol të rëndësishëm kanë luajtur edhe faktorë të tjerë. Ndër këta duhen përmendur sidomos viset kryesisht malore, ku ata u detyruan të strehoheshin për të mbijetuar, sistemi primitiv i jetesës i një shoqërie të pazhvilluar me rrugë të pakta komunikimi dhe pozicioni gjeografik i trojeve të tyre. Pushtuesit romakë e kishin shumë më të lehtë të vendoseshin e të sundonin nëpër viset bregdetare dhe fushore, sidomos nëpër qytetet, por e kishin shumë më të vështirë të depërtonin e aq më pak të nguleshin nëpër viset malore. Prandaj fshatrat, ku erdhi e u përqendrua shumica e popullsisë autoktone arbëreshe, gjatë sundimit romak kanë bërë një jetë primitive “të pavarur”, të rregulluar sipas traditave të trashëguara brez pas brezi, dhe pa lidhje të ngushta me sunduesit e huaj. Megjithatë, kontaktet e kësaj popullsie, të grumbulluar kryesisht nëpër fshatra malore, me pushtuesit romakë dhe me popullsinë e romanizuar nuk mund të ndërpriteshin plotësisht e për këtë, siç u prek pak më sipër, dëshmon edhe prania e huazimeve të shumta latine në të folmet e ndryshme të shqipes. Numri i përgjithshëm i këtyre huazimeve është vështirë të përcaktohet me saktësi, sepse mungon një studim i plotë i tyre me statistika shteruese. Sot për sot mund të pohohet me siguri që në gjuhën shqipe kanë mbijetuar një numër relativisht i madh huazimesh

latine nga fusha të ndryshme të jetës. Madje, bashkë me këto huazime kanë depërtuar edhe disa elemente fjalëformuese si prapashtesa dhe parashtesa. Gjithsesi, huazimet latine, ashtu si edhe huazimet nga gjuhë të tjera, i janë përshtatur sistemit fonetik dhe strukturës gramatikore të gjuhës marrëse [shqipëse].⁹⁹

18. Ndër faktorët që kanë penguar romanizimin e plotë të stërgjyshërve të shqiptarëve, nuk mund të lihet pa përmendur edhe një rrethanë tjetër e rëndësishme dhe pikërisht pozicioni gjeografik i trevave të banuara prej tyre në kuadrin e përgjithshëm të Perandorisë Romake. Shtrirja aq e madhe e asaj perandorie e bënte të domosdoshëm zbatimin e një strategjie politike-ushtarake, që të bënte të mundur ruajtjen e kompaktësisë së saj. Një strategji e tillë kërkonte patjetër që t'i kushtohej më shumë rëndësi ruajtjes së kufijve të gjatë dhe të largët të perandorisë. Si rrjedhim, në Gadishullin Ballkanik, sidomos gjatë shekujve të parë të erës sonë, kur u shfaqën edhe kërcënimet e para të dyndjeve të popujve “barbarë”, duheshin përforcuar ushtarakisht dhe administrativisht sidomos kufijtë verilindorë të perandorisë. Kështu shpjegohet edhe përqëndrimi më i madh i forcave ushtarake dhe i kolonëve romakë në atë pjesë të perandorisë, çka solli si pasojë edhe romanizimin pothuaj të plotë të Dakisë së dikurshme, ku u zhvillua etnosi rumun (shih për këtë dukuri edhe Mansakun: 1995, 169 v.). Lidhur me këtë faktor, nuk më duket pa vend të përmend këtu një mendim të H. Mihaescu-t (1966, f.33) për arsyet e mosromanizimit të Greqisë: “Fakti që gjuha latine nuk mundi të hedhë rrënjë në trevat e gjuhës greke në jug të Gadishullit [Ballkanik - Sh. D.], shpjegohet jo vetëm me epërsinë e qytetërimit helenik, por edhe me rrethanën që Greqia nuk u bë kurrë një tokë kufiri [e Perandorisë Romake - Sh. D.], ku të ishte nevoja për një përqendrim të vazhdueshëm trupash romake.”

19. Gjithsesi, kur trysnia e pushtetit romak dhe e gjuhës latine nisi të dobësohej, atëherë edhe popullsia autoktone arbëreshe filloi të rigjallërohej. E atëherë edhe përbërja etnike e popullsisë së viseve bregdetare dhe fushore nuk mund të mbetej e pandryshuar nën trysninë e popullsisë arbëreshe rreth e rrotull. Një ndryshim i tillë ka nisur me siguri pas ndarjes së Perandorisë Romake në dy pjesë në vitin 395 të

⁹⁹ Për më shumë hollësira shih Çabej: 1974.

erës sonë, kur viset e banuara nga stërgjyshërit e shqiptarëve u caktuan të mbeteshin nën pushtetin e Perandorisë Romake të Lindjes, ku ato ishin në një zonë periferike dhe ku edhe latinishtja si gjuhë zyrtare erdhi duke e humbur dalngadalë rëndësinë e saj, duke u zëvendësuar gjithnjë e më shumë nga greqishtja. Si rrjedhim, me dobësimin e vazhdueshëm të pushtetit qendror romak dhe me rigjallërimin e popullsisë autoktone arbëreshe edhe përbërja etnike e viseve bregdetare dhe fushore të *Dheut të Arbërit* filloi të ndryshonte. Në rrethanat e reja, një pjesë e mirë e popullsisë arbëreshe të fshatrave të mbipopulluar erdhi e u shpërngul nëpër qytetet dikur plotësisht apo pjesërisht të romanizuar, duke ua ndryshuar kështu dalngadalë përbërjen demografike. Si rrjedhim, në rrethanat e reja edhe ajo pjesë e popullsisë romane apo të romanizuar në viset bregdetare të *Dheut të Arbërit* erdhi e u shqiptarizua apo u rishqiptarizua. E një dukuri e tillë do të përsëritet më vonë edhe për atë pjesë të popullsisë sllave apo të sllavizuar, që jetonte nëpër enklava sllave të rrethuara nga një popullsi shqiptare.

20. Pra, një varg faktorësh, të brendshëm dhe të jashtëm, bënë të mundur që etnosi arbëresh t'i rezistonte procesit të romanizimit, që ka qenë një nga proceset asimiluese më të fuqishme, që ka njohur historia botërore. Natyrisht, faktorët e vënë në dukje këtu më sipër duhen marrë në lidhje të ngushtë midis tyre, sepse asnjëri prej tyre, marrë i shkëputur pa bashkëveprimin e faktorëve të tjerë, nuk mund të kishte bërë që etnosi arbëresh të mbijetonte pa u romanizuar. Megjithatë, sundimi i gjatë romak ka lënë gjurmë të shumta në gjuhën e këtij etnosi e me siguri edhe në fusha të tjera, që mbeten për t'u hulumtuar. Duhet pasur parasysh se ndikimi romak mbi etnosin arbëresh do të kishte pasur pasoja edhe më largvajtëse, sikur të mos kishte ardhur duke u dobësuar sidomos pas shpërbërjes së Perandorisë së Romës.

21. Gjithsesi, sundimi i gjatë romak në Europën Juglindore solli pasoja të dukshme jo vetëm në përbërjen etnike të kësaj treve me romanizimin e një pjese të mirë të popullsisë, por edhe me gjurmët e shumta, që ka lënë edhe në gjuhët e popujve, që i qëndruan procesit të romanizimit. Këto gjurmë janë më të dukshme në gjuhën shqipe, ku, sipas përlllogaritjeve të Mihăescu-t, kanë mbijetuar mbi 540 huazime latine (shih më sipër § 14). Natyrisht, në rrymë të shekujve një pjesë e huazimeve latine të shqipes kanë dalë jashtë përdorimit, kështu që numri i tyre dikur ka qenë

edhe më i madh. Gjithsesi, përpjesëtimi i elementit roman (kryesisht latin) ndaj elementit leksikor vendës të shqipes nuk duhet të ketë qenë ashtu siç e ka paraqitur Meyer-i në *Fjalorin* e tij të vitit 1891 (f. IX), ku ndër 5140 fjalë bazë të shqyrtuara 1420 i nxjerr prej burimi roman, 540 prej burimi sllav, 1180 prej burimi turk, 840 prej greqishtes së re, përkundrajt rreth 400 njësi ve prej burimi indoeuropian, ndërsa 780 të tjera i lë pa shpjegim. Ky mendim i Meyer-it është kritikuar nga studiues të ndryshëm, sidomos nga Çabej në *Studimet* e tij etimologjike. Edhe mendimet e Meyer-it që latinishtja ka ndikuar në krijimin e disa formave gramatikore të shqipes, si p.sh. në formimin e së kryerës së thjeshtë të tipit *këndo-v-a*: sipas modelit të së pakryerës së tipit *canta-ba-m* (shih Meyer: 1886, f.108), në formimin e dëshirores së shqipes sipas gjedhes së më se të kryerës latine të tipit *cantavisse*m (shih Meyer: 1888/b: 41), nuk dalin të mbështetura, ashtu siç nuk del i mbështetur as mendimi i disa gjuhëtarëve të tjerë për një ndikim latin në formimin e së kryerës analitike të tipit *kam kënduar* (shih Demiraj (1986, 794, 798vv.). Në përgjithësi, mund të pohohet me Pedersenin (1905, f.212) që ndikimi i latinishtes mbi eptimin e shqipes “është baras me zero”.

22. Gjurmë të ndikimit të latinishtes ndeshen edhe në një gjuhë të tillë me tradita kulturore si greqishtja, ku në literaturën bizantine janë regjistruar rreth 3000 huazime latine (duke përfshirë këtu edhe fjalët e prejardhura dhe të përbëra), por në greqishten e re kanë mbijetuar rreth 207 fjalë prej burimi latin, si: *pukámiso*<*camisia* “këmishë”, *kapístri*<*capistrum* “kapistër”, *saíta*<*sagitta* “shigjetë” etj. etj. (shih Mihăescu: 1978, 31 vv. dhe Solta: 1980, 163vv.). Për më tepër, greqishtja në disa raste ka shërbyer edhe si ndërmjetëse për përhapjen e disa latinizmave në gjuhë të tjera ballkanike, si p.sh. në bullgarishte huazimet me burim latin *furna* “furr”, *kandilo* “kandil” etj., që kanë depërtuar në atë gjuhë nëpërmjet greqishtes së mesme (shih Solta: 1980, f.162 - me literaturë). Por si në bullgarishte, ashtu edhe në gjuhët e tjera sllave të Ballkanit kanë hyrë edhe një numër jo aq i vogël fjalësh prej burimi latin nga kontaktet e tyre të drejtpërdrejta me popullsinë e romanizuar të Ballkanit dhe nëpërmjet marrëdhënieve me Perandorinë Bizantine (shih Mihăescu: 1978, 34vv.).

23. Pra, përbërja etnike e Europës Juglindore pësoi ndryshime të rëndësishme

si rrjedhim i sundimit të gjatë romak nëpërmjet romanizimit të një pjese relativisht të madhe të popullsisë së këtij rajoni. E popullsia e romanizuar e kësaj pjese të Europës sot do të ishte pa dyshim më e madhe, sikur në këto anë pas shekujve VI-VII të erës sonë të mos ishte kryer një tjetër proces i fuqishëm asimilimi dhe pikërisht procesi i sllavizimit të një popullsie pjesërisht të romanizuar. Gjurmët e sundimit të gjatë romak në Europën Juglindore ndeshen edhe në huazimet latine, që kanë mbijetuar sidomos në gjuhën shqipe, por që nuk mungojnë edhe në gjuhë të tjera të kësaj treve. Për më tepër, sundimi i gjatë romak në këtë pjesë të Europës ka lënë gjurmë jo të pakta edhe në fusha të tjera të jetës, që mbeten jashtë vështrimit të këtij punimi.

Kreu i pestë

Gjuha amtare në bregdetin jugor shqiptar gjatë shekujve

1. Edhe sqarimi i kësaj çështjeje paraqitet mjaft i vështirë kryesisht për shkak të mungesës së dëshmive shkrimore të drejtpërdrejta apo të tërthorta mbi banorët e kësaj treve në rrymë të shekujve. Por një gjë mund të pohohet me siguri dhe pikërisht që kjo trevë me pozicionin e saj buzë detit Jon, që lidh Adriatikun me detin Mesdhe, dhe përballë ishullit të Korfuzit dhe Gadishullit Apenin, me gjithë karakterin e saj kryesisht malor, duhet të ketë qenë banuar qysh prej kohësh të hershme. Në këtë përfundim arrihet jo vetëm nga zbulimet arkeologjike në qendra të tilla si *Butrinti*, *Oriku* etj., por dhe nga vetë klima e butë dhe reliefi i pastër bregdetar, që nuk mund të mos kenë tërhequr vëmendjen e njerëzve, për t'u vendosur në këto vise qysh në lashtësi të thellë. Mirëpo, në pamundësi që të depërtojmë në shekujt e errët të parahistorisë¹⁰⁰, për të ndriçuar përkatësinë etnike të banorëve më

¹⁰⁰ Supozimi i F. C. H. L. Pouqueville-it, *Voyage dans la Grèce*. Tome I, Paris, 1820, f. 250, mbi mundësinë që Homeri të ketë pasur parasysh malet *Akrokeraun*, kur tek *Odisea*, XI, vargjet 11-20, thotë se hyjnesha *Circe* në ishullin *Ajaja* e këshilloi *Odiseun* të drejtohej për në hyrjen e *Tartarit* (Aornin), për të pyetur hijen e falltarit *Tiresia* nëse do të arrinte në ishullin e *Itakës* apo jo, nuk është fort i qartë. Këtë supozim e mbështet Spiro Rusha, *Himara në stuhinë e shekujve*. Tiranë, 2001, f. 22 v., i cili vë në dukje se Homeri në ato vargje përmend edhe emrin e *Himarës* (*Himera*). Të kihet parasysh se edhe G. Dara (i Riu) në një shënim të vargut 71 të pjesës II (*Plaku*) të veprës së tij *Kënka e sprasme e Balës* pohon se emri i *Himarës* del qysh te Homeri. Përkundrazi, i sigurt është njoftimi i shkrimtarit romak, Plinit të Dytë (shekulli i parë i erës sonë), i cili në veprën e tij *Naturalis historiae*, Libri IV, 1, shkruan: “Në bregdetin e Epirit kështjella e *Himerës*, mbi malet e *Akrokeraunit*” (shih ilirët dhe Iliria tek autorët antikë, vëll. I, f. 195). Kjo parakupton që *Himara* duhet të jetë më e hershme se shekulli i Plinit. Për përmendjen e *Himarës* në shekujt e mëvonshëm shih Bartl, *Zur Topographie und Geschichte der Landschaft Himara in Südalbanien*. Në: “Münchner Zeitschrift für Balkankunde”, 1991, 7. und 8. Band., f. 340vv., dhe R. Memushaj, *Himara në dritën e të dhënave historike, gjuhësore dhe etnologjike*. Tiranë 2004, f. 32vv.

të hershëm të kësaj treve, nëpërmjet këtij studimi do të synohet të hidhet sadopak dritë mbi përbërjen etnike të popullsisë së trevës në shqyrtim, të paktën, qysh nga periudha klasike greke-romake.

Natyrisht, edhe për këtë periudhë, sidomos për fazën më të hershme të saj, vështirësitë në një vështrim të parë duken të pakapërcyeshme, jo vetëm për mungesë dëshmish historike të drejtpërdrejta, por edhe për shkak të disa çështjeve të vështira ende të pasqaruara bindshëm. Një nga këto çështje është pa dyshim ajo që ka të bëjë me të ashtuquajturën “vija Jireçek”. Është fjala për supozimin e historianit çek K. Jireçek, sipas të cilit në një fazë të dhënë pas pushtimeve romake në Ballkan në pjesën veriore të këtij gadishulli u përhap latinishtja, kurse në pjesën jugore ishte përhapur greqishtja¹⁰¹. Por ky supozim, siç është vënë në dukje edhe në temën kushtuar *Epirit* (Kreu II, § 4), nuk i ka qëndruar kritikës. Një çështje tjetër jo më pak e vështirë ka të bëjë me sqarimin historik të gjendjes së sotme etnike të viseve të Bregdetit Jugor të Shqipërisë, ku krahas vendbanimeve shqipfolëse, që përbëjnë shumicën dërrmuese, ka edhe tri vendbanime (*Himara, Dhërmiu dhe Palasa*), ku krahas shqipes gjatë këtyre shekujve të fundit është përhapur edhe greqishtja. Përveç këtyre çështjeve kryesore ka pa dyshim edhe disa çështje të tjera, që mbeten për t’u sqaruar, siç janë p.sh. këto: A janë banorët shqipfolës të këtyre viseve bregdetare autoktonë, të paktën, qysh nga periudha klasike greke-romake? Sa e vjetër është dygjuhësia në vendbanimet *Himarë, Dhërmi* dhe *Palasë* dhe si duhet shpjeguar kjo dukuri?

2. Siç shihet, këto çështje, në analizë të fundit, janë të lidhura drejtpërdrejt me problemin e përgjithshëm të prejardhjes së vetë etnosit arbëresh [= shqiptar] dhe me kufijtë e shtrirjes së tij, të paktën, qysh nga lashtësia greke-romake e këtej. Mirëpo, duke qenë se ky problem u shqyrtua në temën e këtij libri kushtuar *Epirit* (Kreu II), këtu nuk do ta rimarrim përsëri. Prandaj këtu do të ndalemi vetëm në ato

¹⁰¹ Jireçeku është cituar këtu sipas Kristian Sandfeldit, *Linguistique balkanique, problèmes et résultats*, Paris, 1930, f. 16v. dhe Emanuele Banfi-t, *Linguistica balcanica*. Bologna: 1985, f. 132v., 189. si edhe sipas Jireçek, *L’eredità di Roma nelle città della Dalmazia duranrte il Medioevo*. A cura di Mario Capaldo. Roma, 1984, f. 19v.

çështje që lidhen më drejtpërsëdrejti me popullsinë e Bregdetit Jugor të Shqipërisë.

Në radhë të parë, do pasur parasysh se, siç do të vihet në dukje pak më poshtë (§§ 8-15), në regjistrimet e para osmane të popullsisë, banorët e Bregdetit Jugor, ashtu si ata të gjithë Shqipërisë Jugore, janë shënuar me emra vetjakë karakteristikë shqiptarë e kjo është një dëshmi e qartë se ata i përkisnin etnosit shqiptar a arbëresh. Në këtë rast, në rrethanat e njohura të sundimit bizantin nuk mund të mendohet për një çhelenizim të popullsisë së besimit ortodoks. Për më tepër, në atë peridudhë nuk ka asnjë dëshmi historike për një çhelenizim të trevave të Shqipërisë Jugore në përgjithësi dhe të Bregdetit Jugor shqiptar në veçanti. Madje, për sa i takon bregdetit jugor shqiptar tashmë është një gjë e njohur që as në lashtësi grekët atje nuk kishin vendosur “koloni” apo më fort enklava tregtare përveçse në Orik dhe në Apoloni (Pojan). Për “koloni” greke të themeluara në Bregdetin Jugor shqiptar nuk bëhet fjalë gjëkund as në shekujt pasardhës të mesjetës apo më vonë. Si rrjedhim, as që mund të mendohet për një çhelenizim të banorëve të mëparshëm të atyre trevave në rrethana historike, që do të presupozonin të kundërtën. Mjafton të kihet parasysh fakti i mirënjohur që greqishtja pas ndarjes së Perandorisë Romake në dy pjesë në vitin 395 të erës sonë u bë dalngadalë jo vetëm gjuha zyrtare e Perandorisë Bizantine¹⁰², por edhe gjuha e kanonizuar e kishës ortodokse, e cila ka luajtur një rol aq të fuqishëm mbi popullsinë e krishterë të Shqipërisë Jugore gjatë shekujve. Siç dihet, greqishtja ashtu si latinishtja, u bë qysh herët një nga gjuhët kryesore, me të cilat kryheshin shërbesat fetare në vendet ballkanike. Madje, sidomos pas ndarjes së kishës në katolike dhe ortodokse në vitin 1054 greqishtja mbizotëroi si gjuhë kishtare në pjesën ortodokse të Ballkanit dhe më gjerë.

3. Gjithsesi, mungesa e dëshmive historike-gjuhësore e bën shumë të vështirë sqarimin e pyetjes nëse popullsia autoktone e dikurshme e të ashtuquajturit Epir në përgjithësi dhe e Bregdetit Jugor shqiptar në veçanti ka mundur ta ruajë identitetin

¹⁰² Sipas H. Mihăescu-t, *La langue latine dans le sud-est de l'Europe*. Bucuressti - Paris, 1978, f. 55, greqishtja e zëvendësoi latinishten si gjuhë e administratës dhe e ushtrisë në Perandorinë e Lindjes sidomos pas shekullit VI të erës sonë.

etnik në rrymë të shekujve, sidomos pas pushtimit të hershëm romak të trevave të banuara sot nga një popullsi shqipfolëse. Pushtimi dhe sundimi disashekullor romak në trevat ballkanike ka pasur pasoja largvajtëse me romanizimin e një pjese të mirë të popullsisë të mëparshme të Ballkanit. Procesit të romanizimit iu ekspozuan qysh herët sidomos qendrat qytetare bregdetare të Adriatikut dhe të Jonit. Por nuk mund të thuhet e njëjta gjë edhe për viset malore-shkëmbore të bregdetit jugor shqiptar, si edhe të viseve të brendshme të Shqipërisë në përgjithësi, ku sunduesit romakë e kishin të vështirë të qëndronin për një kohë të gjatë. Për sa i takon zonës së Bregdetit Jugor të Shqipërisë, mund të pohohet se procesi i romanizimit duhet të ketë përfshirë vetëm qendra të tilla si *Butrinti*. Gjithsesi, mund të pohohet se ajo zonë, ashtu si edhe trevat fqinje të Shqipërisë Jugore të sotme dhe mbarë viset, ku sot flitet shqip, ka qenë e banuar nga një popullsi, që iu nënshtrua një ndikimi të fuqishëm romak.

4. Por çfarë gjuhe amtare fliste ajo popullsi dhe a mundi të mbijetonte duke mënjanuar procesin e romanizimit? Siç u vu në dukje edhe pak më sipër, mungesa e dëshmive të shkruara të kësaj popullsie qysh nga lashtësia e bën shumë të vështirë sqarimin e këtyre pyetjeve. Megjithatë, disa të dhëna të rëndësishme, që mund të nxirren nga gjuha shqipe, mund të ndihmojnë për një ndriçim të kënaqshëm të tyre. Këtu është fjala për dy fakte gjuhësore, që dëshmojnë për praninë e hershme dhe të pandërprerë të stërgjyshërve të shqiptarëve në trevat ku sot flitet shqip. Në radhë të parë, do pasur parasysh këtu ndarja dialektore e shqipes, që është një dukuri mjaft e vjetër, sepse veçoritë më karakteristike të dialektit jugor janë shfaqur mjaft herët (jo më vonë se gjysma e parë e mijëvjeçarit të parë të erës sonë) dhe pikërisht në ato vise, ku flitet sot ky dialekt.

5. Siç dihet, një tjetër dëshmi e rëndësishme për praninë e hershme dhe të pandërprerë të stërgjyshërve të shqiptarëve në trojet e tyre të sotme, duke përfshirë edhe Bregdetin Jugor, është prania e hershme e një numri të madh huazimesh latine në të gjitha të folmet e shqipes. Por në këtë rast lind vetiu pyetja se si kanë mundur banorët e vjetër të trevave të shqiptarëve të sotëm t'i shpëtonin procesit të romanizimit, kur dihet se një procesi të tillë nuk mundën t'i shpëtonin as popuj, trevat e të cilëve u pushtuan më vonë dhe nuk qëndruan aq gjatë nën sundimin

romak, siç është p.sh. rasti i stërgjyshërve të rumunëve, që u romanizuan, megjithëse vendi i tyre, Dacia, u pushtua nga romakët vetëm në vitin 106 të erës së re dhe qëndroi nën pushtimin romak për një kohë relativisht të shkurtër, deri në vitin 271. Një pyetje e tillë është edhe më e natyrshme për viset bregdetare të Shqipërisë, që kanë qenë edhe më të ekspozuara ndaj ndikimit latin për një kohë relativisht të gjatë. Por kjo çështje, që u trajtua te tema mbi Romanizimin (Kreu IV), këtu nuk do të rishqyrtohet. Këtu do të vihet në dukje vetëm se ç' u tha atje për trevat e banuara nga stërgjyshërit e shqiptarëve në përgjithësi, vlen edhe më shumë për viset bregdetare jugore, ku për shkak të reliefit malor, sunduesit romakë vështirë se mund të kenë depërtuar thellë. Do të ritheksojmë gjithashtu se gjatë pushtimit disashekullor romak edhe viset e Bregdetit Jugor të Shqipërisë nuk mund t'i kenë shpëtuar krejt procesit të romanizimit.

6. Por me dobësimin e shkallëshkallshëm të ndikimit romak perëndimor pas vitit 395 dhe si rrjedhim edhe me ndërprerjen e procesit të romanizimit në trevat e banuara nga stërgjyshërit e shqiptarëve, në rrethanat e reja filloi të ndryshonte përsëri përbërja etnike edhe në viset bregdetare, duke u ripopulluar me të ardhur nga viset e brendshme kryesisht malore. Duke marrë parasysh faktin që në periudhën e dokumentuar historike banorët e atyre viseve ishin të etnosit arbëresh, është e natyrshme të pranohet që kjo lëvizje popullore ka ndodhur mjaft herët kryesisht nga viset e brendshme të të njëjtit etnos arbëresh. Por në traditën gojore të katundeve të bregdetit jugor shqiptar bëhet fjalë edhe për imigrime familjesh nga Kruja apo nga ndonjë krahinë tjetër veriore sidomos pas vdekjes së Skënderbeut. Një mundësi e tillë nuk duhet përjashtuar për raste të kufizuara, megjithëse dokumentimi i migrimeve të tilla paraqitet i vështirë për t'u vërtetuar me saktësi. Gjithsesi, lëvizje njerëzish ka pasur edhe në fshatrat e Bregdetit Jugor sidomos *prej* apo *drejt* katundeve rreth e rrotull për arsye të ndryshme e sidomos gjatë ekspeditave ndëshkimore osmane¹⁰³.

7. Por ç'gjuhë është folur në këto katunde gjatë shekujve? Të dhënat e fazës së dokumentuar të historisë së këtyre katundeve mund të hedhin dritë edhe

¹⁰³ Shih R. Memushaj, *vep. e përmendur*, f. 117 vv.

për periudhat e mëparshme. Siç pranohet nga të gjithë, në këto katunde, pavarësisht nga përkatësia fetare, si gjuhë amtare e familjes është shqipja; vetëm në *Himarë*, *Dhërmi* e *Palasë*, krahas shqipes, përdoret edhe greqishtja. Në këtë rast mund të shtrohet me të drejtë pyetja se cila nga këto dy gjuhë ka qenë parësore gjatë shekujve në këto tri katundet e fundit? Sqarimi i kësaj pyetjeje mund të bëhet edhe vetëm duke pasur parasysh rrethanat, që mund të ndikonin më shumë në përhapjen e njëres gjuhë apo të tjetres si gjuhë e dytë. Po të kemi parasysh faktin që këto tri katunde të krishtera ndodhen përballë ishullit të Korfuzit dhe kanë qenë në kontakt të vazhdueshëm me botën greke dhe shërbesat fetare dhe arsimimin në të kaluarën i kanë kryer në gjuhën greke, nuk do të ishte e vështirë të pohohej që greqishtja s' mund të ketë qenë burimisht gjuhë parësore e banorëve të atyre tri katundeve. Asnjë rrethanë historike apo shoqërore nuk do të kishte mundësuar që gjuha shqipe në këto tri katunde të ketë depërtuar si gjuhë e dytë në një popullsi greqishtfolëse. Por për argumentimin e duhur të këtij mendimi, duhen shqyrtuar disa të dhëna konkrete nga e kaluara dhe e sotmja e këtyre katundeve. Në pamundësi që në kufijtë e një studimi të shkurtër të shqyrtohen të gjitha të dhënat e mundshme, këtu do të kufizohemi vetëm në shqyrtimin e disa emrave vetjakë të vjetër, karakteristikë për të kaluarën në mbarë shqipen, si edhe në dëshmitë e disa të huajve që kanë pasur rastin t' i vizitojnë e t' i njohin këto katunde në të shkuarën. E në fund do të prekim edhe ndonjë argument të karakterit shoqëror-zakonor, që lidhet me gjuhën burimore të familjes. Me shumë interes në këtë rast është edhe vështrimi historik i shtresës së vjetër të toponimeve të këtyre viseve, por kjo çështje, për arsye hapësire, në këtë studim nuk do të trajtohet.¹⁰⁴

8. Nga emrat vetjakë, për të mos u zgjatur pa nevojë, po shqyrtojmë vetëm emrat *Gjon*, *Gjokë* < *Gjon-kë*, *Gjin*, *Gjikë* < *Gjin-kë* (me prapashtesën e përkëdhelisë *-kë*)¹⁰⁵ dhe *Pal* që, siç dihet, janë nga emrat e krishterë më të vjetër të përdorur dendur dikur në të gjitha trevat e banuara nga shqiptarët dhe si të tillë

¹⁰⁴ Shih për këtë çështje, ndër të tjerë: R. Memushaj, *vep. e përmendur*, 155vv., ku jepen mjaft të dhëna mbi emrat e njerëzve dhe të vendeve në këtë zonë

¹⁰⁵ Shih Xhuvani-Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*. Tiranë, 1962, f. 64.

paraqiten me disa trajta fonetike, që i dallojnë ata nga të njëjtët emra në përdorim ndër popuj të tjerë, duke përfshirë edhe grekët. Për trajtat fonetike të këtyre emrave të vjetër të krishterë ndër shqiptarët shih temën kushtuar Epirit (Kreu II). Por do pasur gjithnjë parasysh se nën ndikimin e kishës ortodokse Greke është përhapur shumë ndër ortodoksët e Shqipërisë Jugore trajta *Jani* sidomos gjatë shekujve të fundit, duke zëvendësuar trajtën më të vjetër vendëse *Gjon*. Një zëvendësim i tillë bie në sy për Beratin qysh në Regjistrimin Osman të vitit 1520, ku jo vetëm trajta *Gjon*, por edhe varianti *Gjin* ndeshen relativisht mjaft më pak se trajta *Jani*¹⁰⁶. Për përdorimin e dendur dikur të emrit *Gjon* në trevat jugore shqiptare dëshmojnë, ndër të tjerë, edhe defterët e regjistrimeve osmane, si ai i Sanxhakut të Arvanidit i vitit 1457, botuar nga Inalçiku më 1987 e sidomos defteri i Sanxhakut të Vlorës i vjetëve 1519-1520¹⁰⁷. Për të mos e ngarkuar punimin pa nevojë, mjafton të kujtojmë se sipas artikullit të F. Dukës¹⁰⁸ në lidhje me defterin në shqyrtim, në katundin Goranxi e Sipërme (Dropull) emri *Gjon* del 27 herë, si p.sh. *Gjon* Sima, *Leka Gjoni*, *Gjon* Gjini, *Gjon* Leka, *Gjon* Pali etj. Emri dhe mbiemri *Gjon* del mjaft dendur edhe në Defterin e Sanxhakut të Delvinës të vitit 1583, si p.sh.: *Gjon* Thoma, *Gjon* Gjini Llani, *Gjon* Lalati, *Dedë Gjoni*, *Niko Gjoni*, *Pali Gjoni* etj.¹⁰⁹

9. Emri *Gjon* dëshmohet edhe në vendbanimet *Himarë*, *Dhërmi* dhe *Palasë* dhe në fshatrat fqinje. Kështu në Defterin e Regjistrimit Osman të Sanxhakut të Delvinës të vitit 1583 (f. 66)¹¹⁰ në *Himarë* janë regjistruar 137 kryefamiljarë, nga të

¹⁰⁶ Shih F. Duka, *Berati në kohë osmane*. Tiranë, 2001, f. 220vv.

¹⁰⁷ Shih F. Duka, *Realiteti etnik i Dropullit në burimet historike të shekullit XVI (Defteri osman i regjistrimit të pronave dhe të popullsisë së sanxhakut të Vlorës i vitit 1520)*. Studime Historike 1991, nr. 3-4, f. 171-179.

¹⁰⁸ Shih Studime Historike 1991, nr.3-4, f. 86.

¹⁰⁹ Shih V. Buharaja, *Kazaja e Delvinës* (nga Defteri osman i sanxhakut të Delvinës i vitit 1583). "Studime historike" 1992, nr. 1-4, f. 125, 126, 127 etj.

¹¹⁰ *Defteri i regjistrimit osman të sanxhakut të Delvinës i vitit 1583*, f. 66. Të dhënat e këtij Defteri Osman për emrat *Gjon*, *Gjokë*, *Gjin*, *Gjikë* dhe *Pal* për Himarën, *Dhërmiun* dhe *Palasën* në këtë studim janë nxjerrë nga materiali i transkribuar prej historianit Petrika Thëngjilli, që pati mirësinë të ma vinte në dispozicion.

cilët 17 veta mbajnë emrin *Gjon* (5 veta) ose *Gjo-kë*<*Gjon-kë* (12 veta) dhe 11 veta dalin me mbiemrin *Gjon*, si p.sh.: *Gjon* Palloshi (2 herë), *Gjon* Pavllari Mëhilli, *Gjon* Leondari, *Gjon* Menika, *Gjoka* Boga, *Gjoka* Dhamo, *Gjoka* Nika, *Gjok* Gjini, *Gjoka* Jorgo, *Gjok* Menkuli etj.; Petri *Gjoni*, Mark *Gjoni*, Gjika *Gjoni*, Gjini *Gjon* Aleks, Dhimo *Gjon* Vllasi, Kond *Gjoni*, Nikolla *Gjoni* etj.

Po në këtë defter për fshatin *Dhërmi* janë regjistruar 53 kryefamiljarë, ndër të cilët emri *Gjon* del një herë si emër i parë (*Gjon* Panoja) dhe një herë si mbiemër (*Gjin Gjoni*); edhe trajta *Gjokë* del vetëm një herë (*Gjoka* Qezari).

Po në këtë defter për fshatin *Palasë* janë regjistruar 95 kryefamiljarë, ndër të cilët emri *Gjon* del 5 herë si emër i parë dhe një herë si mbiemër, kurse trajta *Gjokë* del 2 herë: *Gjon* Lehamo, *Gjon* Gjiraçe, *Gjon* Mihali etj., Gjini *Gjoni*, *Gjoka* Pali etj.

Atë e ndeshim edhe në dokumente të mëvonshme, si p.sh. një letër, që përfaqësuesit e krahinës së *Himarës* i dërguan ministrit të qeverisë së Napolit në vitin 1791, është nënshkruar, ndër të tjerë, edhe nga Pano *Gjon-ushi* (*Himarë*), Athanas *Gjo-leka*<*Gjon* Leka, Nestur *Gjo-kë* Athanasi (*Vuno*)¹¹¹. Po ky autor¹¹² boton edhe një listë me emrat e parësisë së krahinës së *Himarës*, ndër të cilët gjejmë edhe: *Gjo-kë* Kokëveshi, Dhimo Pano *Gjon-ushi*, Strati *Gjo-k-a* (*Himarë*), Spiro Polimer *Gjo-k-a* (*Dhërmi*) etj.

10. Në fshatrat e Labërisë emri *Gjon* gjatë shekujve të fundit ndeshet më fort në fjalë të përbëra, që shërbejnë si emra familjesh (*llagape*) dhe toponime (me burim *llagapesh*), si: *Gjoleka*<*Gjon* Leka, *Gjoliku*<*Gjon* Liku, *Gjovarfi*<*Gjon* Varfi, *Gjomema*<*Gjon* Mema etj. Të kihen parasysh edhe toponimet e Kurveleshit: *Gjigjone-t*<*Gjin* Gjone-t, *Gjodede-ja*<*Gjon* Dede-ja, *Gjolige-ja*<*Gjon* Lige-ja, *Gjomëhille-ja*<*Gjon* Mëhille-ja etj.¹¹³

¹¹¹ Shih S. Rusha, *Himara në stuhitë e shekujve*. Tiranë, 2001, f. 153 (me referencën përkatëse).

¹¹² *Po aty*, f. 154v. (me referencën përkatëse).

¹¹³ Shih A. Dhrimo, *Një vështrim gjuhësor mbi toponiminë e Kurveleshit*. SF 1974, nr. 3-4, f. 45.

Emri *Gjon* dhe trajta *Gjokë* dalin edhe në të folmen dhe në toponiminë e fshatit *Qeparó*, si: Buza e *Gjone*, Buza e *Gjokëpjetrit* [<Gjokë-Pjetrit], fisi *Gjonaj*, Lugu i *Gjodhimësë* [<Gjon Dhimësë], Rrahu i *Dhimëgjoke* [<Dhimë - Gjoke], Rëza e *Gjomuzhaqit* [<Gjon Muzhaqit] etj.¹¹⁴

11. Një problem më vete përbën emri *Gjin*, i cili, siç dihet, ndeshet vetëm në trevat shqipfolëse. Ky emër në përgjithësi mbahet si një variant i emrit *Gjon*, për çka do të dëshmonte fakti që emri i skelës së *Shëngjinit* [<Shën Gjini] në italishte është përkthyer *San Giovanni di Medua*¹¹⁵. Por rruga dhe koha e shfaqjes së emrit *Gjin* nuk janë të qarta. Të kihet parasysht edhe vërejtja e Çabejt¹¹⁶: “Nuk është e qartë lidhja historike midis dy trajtave shqiptare të këtij emri: *Gjon* e *Gjin*.” Gjithsesi, duhet pranuar që emri *Gjin* duhet të jetë shfaqur mjaft herët, për çka dëshmon prania e tij në të gjitha trevat shqiptare si një emër i ndryshëm nga *Gjon*.

Emri *Gjin* ka qenë mjaft i përhapur edhe në viset e Shqipërisë Jugore, siç na dëshmojnë, ndër të tjera, emrat e *Gjin* Bua Shpatës, *Gjin* Fratit dhe *Gjin* Zenevisit të shekullit XIV¹¹⁷. Edhe i ati i Gjon Muzakës quhej *Gjin* [shkruar *Ginno*]¹¹⁸. Ky emër ka qenë i përdorur edhe ndër arbëreshët e Greqisë, ku ndeshet ende, megjithëse rrallë, sepse është zëvendësuar me trajta të tjera gjegjëse, si *Janj-i*, *Jano-a*, *Janko-a* etj.¹¹⁹ Kurse tek arbëreshët e Italisë nuk përdoret më, por gjurmët e tij ndeshen në kujtimet e tyre, siç na dëshmon vepra e Gavril Darës

¹¹⁴ Shih N. Sotiri, *vep. e përmendur*, f. 120, 254, 266, 277, 278.

¹¹⁵ Toponimi *Shëngjin* del edhe në zonën e Shëngjergjit (Tiranë); ai dëshmohet edhe në Defterin Osman të vitit 1431 dhe në atë të vitit 1467 (shih D. Luka, *Studime gjuhësore*, VI, Shkodër 2001, f. 132, 155).

¹¹⁶ Shih E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, VI. Tiranë, 1996, f. 336.

¹¹⁷ Shih *Burime tregimtare bizantine*, f. 240, 243, 249.

¹¹⁸ Shih Ch. Hopf, *Chroniques gréco-romanes, inédites ou peu connues*, Berlin, 1873, f. 273.

¹¹⁹ Shih H. J. Sasse. *Arvanitika. Die albanischen Sprachreste in Griechenland*. Wiesbaden, 1991, f. 118.

(të Riut), ku përmenden *Gjin Muzaqi*¹²⁰, *Gjin Manëzi*¹²¹, Nik e Pal *Dukagjini*¹²².

12. Për përdorimin e dendur të dikurshëm të këtij emri në Shqipërinë e Jugut dëshmojnë edhe Defterët e Regjistrimit Osman të shekujve XIV - XV. Në Defterin e Sanxhakut të Arvanidit të vitit 1457, të botuar nga Inalçiku më 1987, ky emër ndeshet disi më rrallë, si p.sh. në Myzeqe dhe Skrapar. Kurse në defterin e viteve 1519-1520 ai, ashtu si emri *Gjon* (shih më sipër), ndeshet shumë dendur. Kështu vetëm në fletën 86 të atij defteri në fshatin Goranxi e Sipërme si emër personi dhe si mbiemër (llagap) *Gjin* është përdorur 24 herë, si p.sh. *Gjin Leka* (2 herë), *Gjon Gjini* (2 herë), *Gjin Gjoni*, *Leka Gjini* (2 herë), *Gjin Deda* etj.¹²³

Emri dhe mbiemri *Gjin* del dendur edhe në Defterin e Sanxhakut të Delvinës të vitit 1583, si p.sh.: *Gjin Dolemi*, *Gjin Zhupa*, *Gjin Kumlla*, *Qezar Gjini*, *Jorgo Gjini*, *Gjokë Gjini*, *Gjon Gjini* etj.¹²⁴

Po në këtë defter ky emër dëshmohet edhe për *Himarën*, *Dhërmiun* dhe *Palasën*, ku del relati visht dendur. Kështu në Defterin e Sanxhakut të Delvinës të vitit 1583 ndër 137 kryefamiljarë të regjistruar në Himarë emri *Gjin* del 19 herë (6 herë si emër i parë dhe 13 herë si mbiemër); p.sh. *Gjin Gjoni* *Aleksi*, *Gjin Gjorraj*, *Gjin Todori*, *Gjin Meksi* etj.; *Gjok Dhim Gjini*, *Todor Gjini*, *Gjok Gjini*, *Todor Gjini* *Gjoni*, *Dhimo Gjini* *Dhima*, *Gjok Gjini* *Petri*, *Nika Gjini*, *Martin Gjini* etj.

Për Dhërmiun po në këtë defter ndër 53 kryefamiljarë të regjistruar emri *Gjin* del 11 herë (9 herë si emër i parë dhe 2 herë si mbiemër); p.sh. *Gjin Gjoni*, *Gjin Kondi*, *Gjin Dhima* etj.; *Leka Gjini* (2 herë) etj.

Kurse për Palasën në këtë defter ndër 95 kryefamiljarë të regjistruar emri *Gjin* del vetëm 2 herë si emër i parë: *Gjin Gjoni* dhe *Gjin Sallaja*.

Emrin *Gjin* për fshatrat e krahinës së Himarës e ndeshim, ndër të tjera, edhe në letrën, që përfaqësuesit e asaj krahine i dërguan në vitin 1791 ministrit të

¹²⁰ Shih *Kënga e sprasme e Balës*, f. 174, 188.

¹²¹ *Po aty*, f. 188.

¹²² *Po aty*, f. 256.

¹²³ Shih F. Duka, *Realiteti etnik...* (1991), f. 171v.

¹²⁴ Shih V. Buharaja, *vep. e përmendur* (1992), 125vv.

qeverisë së Napolit, ku gjejmë: *Gjini* Dhimo (Himarë), si edhe në listën e parësisë së fshatrave të Himarës, ku gjejmë: Jani *Stragjini*, Jani *Petro-gjini* (Himarë), Dhimo *Gjini* (Shën Vasil), Athanasio *Gjini* (Vuno), Gjokë *Gjini* (Qeparo) etj.¹²⁵

Por sot në Shqipërinë e Jugut ky emër, dikur mjaft i përhapur, pothuajse nuk përdoret më si emër personi. Ai ndeshet ende në disa mbiemra familjesh (llagape), si Niko *Gjini*, Thoma *Gjini* etj., si edhe në disa mikrotoponime dhe jo vetëm në fshatrat e krishtera. Kështu, kemi: Bregu i Thoma *Gjinit*, *Gjipeçi*<Gjin Peçi (Kuç), Qaf`e Mustafa *Gjinit* (Bolenë), *Gjibozhat*<Gjin Bozhat (Çorraj), *Gjigjone-t*<Gjin Gjone-t etj. (Gusmar), *Gjimashet*<Gjin Mashe-t, *Gjin Mazhi* (Kallarat), *Gjipjetri*<Gjin Pjetri (Fterrë) etj.¹²⁶

13. Në fshatrat e Bregdetit Jugor, që janë edhe objekt i këtij kreu, ky emër dëshmohet më fort në trajtën *Gjikë*<*Gjin-kë*. Por sidomos në mikrotoponimi ndeshet edhe trajta *Gji-[n]*. Kështu kemi në të folmen e Qeparoit: *Ndre-gjini*, Lugu i *Gjivlashit* [<Gjin Vlashit], *Gjikë-bitaj*, maja e *Gjipogdanit* [<Gjin Pogdanit], Përroi i *Nikë-gjinit* etj.¹²⁷

Për sa i takon trajtës *Gjikë*, kjo për fshatrat e Himarës dëshmohet relativisht herët. Kështu në një letër, që i është dërguar Papës Gregori XIII më 12 korrik 1577 “nga Himara, d.m.th. nga Epiri i shqiptarëve”, thuhet, ndër të tjera, se ata [himariotët] po dërgojnë pranë Shenjtërisë së tij si përfaqësues të tyre dy bashkëqytetarë të tyre, njëri nga të cilët quhej *Gjikë* Nikolla.¹²⁸ Ky emër dokumentohet edhe në Defterin Osman të Sanxhakut të Delvinës të vitit 1583, ku ai del 4 herë për Himarën (*Gjik* Gjoni, *Gjik* Llanka, *Gjika* Llazari, *Gjika* Dhima), 2 herë për Dhërmiun (*Gjika* Todor, *Gjika* Pano) dhe 2 herë për Palasën (*Gjika* Gjiraçe, *Gjik* Todori).

¹²⁵ Shih S. Rusha, *vep. e përmendur*, f. 151vv. - me referencat përkatëse.

¹²⁶ Shih A. Dhrimo, *vep. e përmendur*, f. 45.

¹²⁷ Shih N. Sotiri, *vep. e përmendur*, f. 5, 7, 268, 120, 269, 274.

¹²⁸ Shih N. Borgia, *I monaci basiliani d'Italia in Albania. Appunti di storia missionaria. Secoli XVI-XVIII*, Roma, 1935, f. 13.

Emrin *Gjikë* e gjejmë edhe në materialet e botuara nga S. Rusha¹²⁹ për vitin 1791, ku gjejmë, ndër të tjera: Spiro Qezar *Gjika*, *Gjikë* Kokë Aleksi (Himarë), *Gjikë* Dina, Dhimo *Gjika* (Dhërmi), *Gjikë* Spiro, Kosta *Gjika* (Vuno) etj.

14. Edhe emri *Pal*, që ka hyrë ndër stërgjyshërit e shqiptarëve nëpërmjet romakëve, në këtë trajtë ka qenë i përdorur si në Veri edhe në Jug të trevave arbëreshe a shqiptare, por gjatë shekujve të fundit në trevat jugore ai ka ardhur duke u zëvendësuar gjithnjë e më shumë nga trajta *Pavël ~ Pavl-i* dhe *Pavlllo ~ Pavllu-a* a *Pavlllo-ja*, nën ndikimin e greqishtes *Pavlos*. Ky emër është i përhapur në gjithë botën e krishterë, por me trajtën *Pal* shfaqet vetëm në shqipe, kurse në gjuhë të tjera ai del me trajta disi të ndryshme (shih për këto temën për Epirin në Kreun II).

Trajta e vjetër *Pal* sot përdoret më fort në Shqipërinë Veriore, ku dëshmohet qysh herët. Mjafton të përmendim emrat e *Pal Engjëllit* e të *Pal Dukagjinit*. Në këtë trajtë dëshmohet ky emër edhe në Defterin e Regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485, si p.sh.: *Pali*, i biri i Nikollës, *Pali*, i biri i Shirgjtit, Gjon *Pali*, Petr *Pali*, *Pal* Marku, *Pal* Gjergji, *Pal* Gjoni etj.¹³⁰ Edhe autorët e vjetër veriorë (Buzuku, Budi etj.) përdorin rregullisht trajtën *Pal* ose *Pāl*, si p.sh. gjejmë te Buzuku: *Pāl*, përse ti më bdon ...¹³¹, shenjtji Gjon e *Pal*.

Edhe në trevat jugore shqiptare trajta e vjetër *Pal* ndeshet ende në disa krahina, si në Myzeqe, Korçë etj. Të kihet parasysht edhe emri i *Shën Palit*, që ndeshet në të gjitha viset e Shqipërisë. Për më tepër, kjo trajtë e vjetër mbijeton edhe nëpër mikrotoponime të fshatrave të bregdetit jugor, si p.sh. në Qeparó: Buza e *Pale*, Bishti i *Kopalit*, Kroi i *Kopalit* [*i Kostë Palit*]¹³². Të kihet parasysht edhe mbiemri *Gjipali* < *Gjin Pali* në Çorraj të Kurveleshit dhe në Dukat. A. Dhrimoja¹³³ përmend edhe mikrotoponimin *Vij-e Pale* (Fterrë).

¹²⁹ Shih S. Rusha, *vep. e përmendur*, f. 151vv.

¹³⁰ Shih S. Pulaha, *vep. e përmendur, passim*.

¹³¹ Shih f. LXXXIII/2 = 93/2.

¹³² Shih N. Sotiri, *vep. e përmendur*, f. 254, 252, 263.

¹³³ Shih A. Dhrimo, *vep. e përmendur*, f. 44.

Për vjetërsinë e përdorimit të trajtës *Pal* edhe në trevat jugore shqiptare, dëshmojnë, ndër të tjera, edhe defterët osmanë të shekujve XV - XVI. Këtu është për të përmendur sidomos Defteri Osman i Sanxhakut të Vlorës i vitit 1520, ku për krahinën e Dropullit emri *Pal* ndeshet si emër personi dhe si mbiemër (llagap); p.sh.: *Pal Çupi*, *Petri Pali*, *Pal Busi*, *Gjon Pali*, *Nika Pali*, *Pal Petri*, *Gjin Pali*, *Pali Tupe*, *Pal Nika* etj. Por aty nuk mungon edhe trajta më e re *Pavël*¹³⁴. Trajta e vjetër *Pal*, krahas më të resë *Pavël*, del edhe në Defterin Osman të Sanxhakut të Delvinës të vitit 1583, si p.sh.: truallishta *Pali*, *Pali Gjoni*, *Pal Gola*, *Pali Dhimo* etj.¹³⁵ Nga të dhënat e të njëjtit defter për Himarën emri *Pal* dëshmohet në 5 raste ndër 137 kryefamiljarë të regjistruar (*Pali Dhjako*, *Pal Melani*, *Pali Panajoti*, *Gjok Pali*, *Gjin Pali*), kurse për Dhërmiun dëshmohet në 4 raste ndër 53 kryefamiljarë të regjistruar: *Pal Nika*, *Leondar Pali*, *Todor Pali* (2 herë) dhe për Palasën dëshmohet në 8 raste ndër 95 kryefamiljarë të regjistruar: *Pali Lihori* (?), *Pal Lehkani* (?), *Pali Papa*, *Pali Paskali*, *Pali Dhimo*, *Jorgo Pali*, *Nika Pali* etj. Trajta *Pal* dëshmohet edhe në dokumentin e lartpërmendur të vitit 1791 ku gjejmë: *Malo Pali* (Kleparo).¹³⁶

Trajta e vjetër *Pal* dëshmohet edhe tek arbëreshët e Italisë: Shën Mihilinë, Shënj' Janjinë, Shën Pjetrin, S[hën] *Palinë*.¹³⁷ Të kihet parasysht edhe kënga legjendare e *Pal Golemit*, aq e njohur tek arbëreshët e Italisë. Madje, në vepën e Gavril Darës të Riut, përveç heroit legjendar *Pal Golemi*, përmenden edhe *Pal Manëzi* dhe *Pal Dukagjini*, bashkëkohës të Skënderbeut.¹³⁸

15. Prania e emrave të vjetër *Gjon/Gjokë*, *Gjin/Gjikë*, *Pal* dhe e disa emrave të tjerë të krishterë me trajta të vjetra të dallueshme nga emrat gjegjës të popujve të tjerë, si *Gjergj*, *Mëhill*, *Mërtir*<*Martin* në vendbanimet e krishtera të

¹³⁴ Shih F. Duka, *Realiteti etnik...* (1991), f. 171-176, 178, 187-188.

¹³⁵ Shih V. Buharaja, *vep. e përmendur*, f. 124-127.

¹³⁶ Shih S. Rusa, *vep. e përmendur*, f. 153, 154.

¹³⁷ Shih M. Mandalà, *Il Codice Chieutino* i shekullit XVIII. Comune di Mezzoiuso (Palermo). 1995, f. 450.

¹³⁸ Shih G. Dara (i Riu), *vep. e përmendur*, f. 70, 256.

Bregdetit Jugor, si edhe në fshatrat e brendshme të Labërisë dhe në vise të tjera të Shqipërisë Jugore dhe Veriore, është një dëshmi e qartë për burimin e përbashkët të këtyre emrave ndër stërgjyshërit e shqiptarëve, pas përhapjes së hershme të krishtërimin ndër ta. Dhe në përgjithësi pranohet që krishtërimi ndër stërgjyshërit e shqiptarëve ka nisur të përhapet qysh në shekujt e parë, gjithsesi para shekullit IV të erës sonë.¹³⁹

16. Siç u përmend edhe pak më sipër, ka edhe të dhëna të tjera, që dëshmojnë se banorët e bregdetit jugor, duke përfshirë edhe ata të *Himarës*, *Dhërmiut* dhe *Palasës*, nuk e kanë veçuar veten nga shqiptarët e tjerë dhe si gjuhë amtare gjatë shekujve kanë pasur gjuhën shqipe. Kështu p.sh. në letrën e sipërpërmendur, që himariotët i dërguan Papës më 1577, ata kujtojnë edhe “trimin Skënderbe”, të cilin e quajnë “mbreti ynë i përndritur”.¹⁴⁰ Edhe në letrën e dërguar careshës Elizabeta Petrovna të Rusisë më 1759 përfaqësuesit e krahinës së Himarës e përmendin emrin e Skënderbeut.¹⁴¹

17. Për sa i takon gjuhës amtare burimore të banorëve të Bregdetit Jugor, duhet pasur parasysh jo vetëm ndonjë konsideratë e përgjithshme, por edhe disa dëshmi konkrete, që na kanë lënë disa të huaj, të cilët kanë qëndruar për një kohë pak a shumë të gjatë midis tyre. Si konsideratë e përgjithshme vlen të ritheksohet se jo vetëm që nuk është dokumentuar gjëkund ndonjë imigrim grekësh në vendbanimet *Himarë*, *Dhërmi* e *Palasë* në të kaluarën e largët apo të afërt, por as rrethanat historike e shoqërore nuk do të kishin bërë të mundur që në këto vendbanime krahas greqishtes të ishte përhapur edhe shqipja, madje si gjuhë parësore. Siç u vu në dukje edhe më sipër, Perandoria Bizantine dhe kisha greke nuk do të kishin ndihmuar në përhapjen e shqipes në këto katunde të krishtera, pranë të cilave gjendeshin edhe një varg katundesh të tjera shqipfolëse, që në një pjesë të madhe gjatë shekujve të fundit u myslimanizuan.

¹³⁹ Shih Sh. Demiraj, *Prejardhja ...*, f. 108vv. - me literaturën përkatëse.

¹⁴⁰ Shih Borgia, *vep. e përmendur*, I (1935), f. 32.

¹⁴¹ Shih *BShSh* 1955/II, f. 158.

18. Për sa u takon dëshmime të të huajve mbi gjuhën e folur në këto katunde, këto janë relativisht të shumta, por këtu do të vëmë në dukje vetëm disa që na duken më kuptimplote. Dëshmia e parë lidhet me pohimet e disa misionarëve të dërguar nga Vatikani gjatë shekujve XVII-XIX ndër të krishterët e krahinës së Himarës. Ata që në përgjithësi ishin priftërinj ortodoksë, të cilët njihnin autoritetin e Papës, përpiqeshin t' i mbanin të krishterët e kësaj krahine të lidhur me Vatikanin. Misioni në fjalë ndahet në dy periudha.¹⁴² Në periudhën e parë gjatë vjetëve 1630-1685, misionarët ishin të gjithë me origjinë të huaj, kryesisht greke, të lidhur me Vatikanin. Kurse në periudhën e dytë gjatë vjetëve 1692-1741 misionarët ishin ose nga arbëreshët e Sicilisë, si p.sh. Basilio Matranga nga Munxifsi (Mezzoiuso), Giuseppe Schirò nga Hora e Arbëreshëve etj., ose të huaj që e kishin shqipen gjuhë të mësuar, siç ishte p.sh. Nilo Catalano, i cili e kishte mësuar shqipen në manastirin e katundit arbëresh të Munxifsit dhe ka lënë dorëshkrim edhe një grammatikë dhe një fjalorth të gjuhës shqipe. Nga dëshmitë e këtyre misionarëve do të përmendim vetëm ato të grekut Neofito Rodinò dhe të priftit tjetër me origjinë greke Giovanni Giuseppse De Camillis, si edhe të misionarit arbëresh Giuseppe Schirò.

19. Neofito Rodinò (157? - 1655), me origjinë nga Qiproja, u ngarkua me mision në krahinën e Himarës, ku qëndroi gjatë vjetëve 1633-1642, kryesisht në Dhërmi dhe në Himarë. Ai mbante pranë një prift vendës, të quajtur Dhimitër, për të cilin thotë se “e njeh shumë mirë gjuhën shqipe, sepse është i kësaj kombësie dhe është katolik i vërtetë”. Dhe pikërisht këtë prift shqiptar ai e ngarkoi të përkthente shqip Katekizmin, që nuk e pa dritën e botimit, sepse nga Roma i erdhi përgjigja se “Doktrina e Krishterë tashmë është përkthyer dhe botuar në gjuhën shqipe”.¹⁴³ Në këtë rast është fjala për *Doktrinën e Krishtenë* të Pjetër Budit, të botuar më 1618 në Romë. Gjithsesi, fakti që një misionar me origjinë greke e ndjeu të nevojshme që për të krishterët e krahinës së Himarës të përkthehej Katekizmi në gjuhën shqipe, është një dëshmi e qartë që tregon se të krishterët e asaj krahine ishin shqipfolës.

¹⁴² Shih N. Borgia, *I monaci basiliani d'Italia in Albania. Appunti di storia missionaria. Secoli XVI-XVIII. Periodo secondo*. Roma, 1942, f. 11; P. Bartl, *vep. e përmendur*, f. 326v.

¹⁴³ Shih N. Borgia, *vep. e përmendur*, I (1935), f. 49.

20. Edhe më qartë na e jep këtë misionari tjetër i ritit ortodoks dhe me origjinë greke Giovanni Giuseppe De Camillis¹⁴⁴, i cili ka shërbyer në krahinën e Himarës gjatë vjetëve 1667-1672 dhe ka qëndruar kryesisht në Dhërmi e në Himarë. Në relacionin përfundimtar, që i paraqiti Vatikanit, ai sugjeroi që të dërgoheshin “në Romë dy ose tre të rinj nga viset kryesore të krahinës, për të mësuar në Kolegjin Grek virtutin dhe letrat, si edhe për t’iu përshtatur zakoneve të Italisë, sepse, kur të ktheheshin pastaj në vendin e tyre, secili prej tyre mund të kishte shumë më tepër sukses se ne e të huajt e tjerë, jo vetëm për arsye të gjuhës shqipe, që flitet përgjithësisht në të tërë krahinën dhe që ne të tjerët sikurse edhe grekët nuk e dimë, por edhe për arsye të mbështetjes së miqve dhe të të afërmeve të tyre”¹⁴⁵

21. Lidhur me përdorimin e gjuhës shqipe në katundet në shqyrtim vlen të përmendet edhe një njoftim i misionarit Giuseppe Schirò, nga Hora e Arbëreshëve (Sicili), i cili ka qëndruar në krahinën e Himarës (më fort në Dhërmi) për shumë vjet. Në një relacion të vitit 1729, duke vënë në dukje interesimin e popullsisë së krishterë për punën e misionarëve sidomos me të rinjtë, ai shkruan, ndër të tjera: “Qëndrimi i popullsisë ishte i tillë që i lejonte misionarët t’u mësonin [të rinjve - Sh. D.] doktrinën e krishterë, në mënyrë që ta përsëritnin atë përmendsh në formë dialogu në sheshet publike në gjuhën greke ose shqipe; dhe në këtë mënyrë mësoheshin me kënaqësi edhe të rriturit, të cilët, të tërhequr nga kurioziteti, vinin të dëgjonin ushtrimin e shenjtë, sidomos të afërmit dhe prindërit e fëmijëve.”¹⁴⁶ Të kihet parasysh se mësimet fetare për besimtarët e ritit ortodoks duheshin thënë në radhë të parë greqisht, por misionarët me origjinë arbëreshe ua mësonin ato fëmijëve edhe në gjuhën e tyre amtare shqipe. Madje, misionari italian me origjinë spanjolle Nilo Catalano¹⁴⁷, i ftuar nga 500 banorët e fshatit Pilur për të thënë meshën ditën e Shën Thanasit, u predikoi atyre në gjuhën

¹⁴⁴ Shih P. Bartl, *vep. e përmendur*, f. 330. v. Edhe vetë Bartl-i, *po aty*, vë në dukje se “të krishterët në Himarë, në shumicën e rasteve, ishin shqiptarë”.

¹⁴⁵ Shih N. Borgia, *vep. e përmendur*, I (1935), f. 158.

¹⁴⁶ Shih N. Borgia, *vep. e përmendur* II (1942), f. 140.

¹⁴⁷ Shih N. Borgia, *po aty*, f. 38.

shqipe¹⁴⁸.

22. Edhe nga vëzhgimet e disa të dërguarve nga Europa Perëndimore del qartë se banorët e vendbanimeve të Bregdetit Jugor shqiptar, përfshirë këtu edhe *Himara, Dhërmiu dhe Palasa*, si gjuhë amtare kishin shqipen. Kështu, francezi François Charles Henry Louis Pouqueville (1770-1838), ish-konsull i Francës në Janinë dhe në Patras, i cili i ka njohur nga afër trevat jugore shqiptare, në veprën e tij *Voyage dans la Grèce*¹⁴⁹, duke bërë fjalë për mbeturinat e kështjellës së dikurshme të Himarës, shkruan, ndër të tjera: “Mund të përfundohet se ajo është shkatërruar për të fundit herë në një periudhë shumë të afërt të ngadhënjimit të Perandorisë nga myslimanët, dhe se mbeturinat e popullsisë së saj do të kenë themeluar qytetin e Himarës, që ka sot pesëqind *familje shqiptare të krishtera* [nënvizimi im - Sh. D.]”.

23. Edhe anglezi William Martin Leake, i cili i ka vizituar këto vise disa herë gjatë dhjetë vjetëve në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit XIX, në veprën e tij *Travels in Northern Greece*, I,¹⁵⁰ shkruan se në Korfuz kishte takuar një herë Kontin Gjika, nga Dhërmiu. Ai ia kishte përshkruar vendin si shumë piktoresk dhe të pasur në lëndë drusore. Autori shton: “Gjuha greke flitet pothuaj nga të gjithë burrat dhe italishtja nga ata që kanë jetuar përjashta; por gratë në përgjithësi dinë pak nga ndonjë gjuhë tjetër përveç shqipes.”

Këto të dhëna, që Leake-u mund t’i ketë marrë ose nga Konti Gjika ose drejtpërdrejt nga takimet me banorë të tjerë të këtyre vendbanimeve, dëshmojnë qartë se gjuha e grave, gjuha e familjes, në kohën e tij ishte pa dyshim shqipja. Të kihet parasysh se në atë kohë gratë, ndryshe nga burrat, nuk rrihnin kurbetin dhe përgjithësisht nuk kishin kontakte me të huaj. Prandaj në shumicën dërrmuese ato dinin dhe flisnin vetëm shqip. Për më tepër, siç pohon S. Rusha¹⁵¹, “si në Himarë, në

¹⁴⁸ Shih N. Borgia, *po aty*, f. 64.

¹⁴⁹ Shih vëll. I (1820), f. 256.

¹⁵⁰ Shih William Martin Leake, *Travels in Northern Greece*, I. London 1835, f. 88.

¹⁵¹ Shih S. Rusha, *vep. e përmendur*, f. 139.

Dhërmi edhe në Palasë të vajtuarit edhe të kënduarit janë bërë gjithmonë shqip.”; e kjo duket qartë edhe nga këngët popullore të asaj treve, të mbledhura nga Fane Veizi, prej Himare, dhe të botuara më 1998. Një pjesë e mirë e këtyre këngëve janë mbledhur pikërisht në Himarë, megjithëse mjaft prej tyre këndohen edhe në fshatra të tjera të bregdetit. Madje, në një pjesë prej tyre përmendet kalaja e vjetër e Himarës, ose kujtohen luftërat kundër turqve. Gjithsesi, vajtimet dhe këngët në gjuhën shqipe janë një tjetër dëshmi, që tregon se gjuha amtare e trashëguar brez pas brezi në këto tri vendbanime ka qenë pikërisht shqipja.

24. Të dhënat e Leake-ut përputhen me ato që thuhet në letrën që përfaqësuesit e krahinës së Himarës, midis të cilëve edhe himarioti Gjika Nestor Spiro dhe dhërmiasi Gjika Vreto, i dërguan më 1759 careshës së Rusisë Elizabeta Petrovna. Në atë letër, me të cilën kërkohej ndihmë dhe bashkëpunim në luftën kundër turkut, thuhet, ndër të tjera: “Shtojmë vetëm se besimi ynë është ortodoks, jemi të gjithë nën kryesinë e një peshkopi dhe lidhemi në pikëpamje fetare me patrikun e Konstantinopojës; flasim shqip, atë gjuhë që flitet në Shqipërinë e afërme dhe në Bosnje (?), po në vende të ndryshme të gjithë të mësuarit flasin greqisht, e familjet më të shquara përdorin edhe italishten, nga shkak se shumë oficerë shërbejnë në vende të huaja dhe shumë të rinj dërgohen në seminarin e Padovës dhe të Napolit.”¹⁵²

Pra, si në këtë letër të vitit 1759, ashtu edhe në veprën e porsapërmendur të Leake-ut bëhet fjalë për përdorimin e greqishtes dhe të italishtes, krahas gjuhës kryesore, shqipes, nga shtesa të caktuara të popullsisë së disa katundeve të Bregdetit Jugor shqiptar në kohën e tyre. Në të dyja këto burime sqarohet se italishtja përdoret nga burrat, që kanë shërbyer në ushtri të vendeve të huaja e në këtë rast nuk është vështirë të kuptohet se është fjala për ata që kanë shërbyer në ushtrinë e Republikës së Venecies dhe të Mbretërisë Spanjolle në Napoli, ku në vitin 1737 u themelua edhe batalioni mbretëror maqedonas. Madje, siç vë në dukje N. Borgia¹⁵³, midis këtyre dy shteteve të huaja ka pasur edhe njëfarë rivaliteti në përpjekjet për të

¹⁵² Shih *BShSh*, 1955/II, f. 159.

¹⁵³ Shih N. Borgia, *vep. e përmendur*, II (1942), f. 193v.

rekrutuar ushtarë nga trimat e krahinës së Himarës. Por italishtja nuk arriti të përdorej si gjuhë e dytë nga një masë e gjerë në asnjë nga vendbanimet e krahinës së Himarës e kjo është e shpjegueshme, po të kihet parasysh se numri i atyre që shërbenin në ushtritë e Venecies dhe të Mbretërisë Spanjolle në Napoli ishte i kufizuar e po kështu edhe numri i atyre që mund të shkonin në Itali për studime ose në kërkim të ndonjë pune.

25. Ndryshe qëndron puna me greqishten, e cila ka pasur një përhapje relativisht më të gjerë në Bregdetin Jugor shqiptar; madje në *Himarë, Dhërmi* dhe *Palasë* gjatë shekujve të fundit ajo është përdorur edhe si gjuhë e dytë, krahas shqipes, nga një masë e konsiderueshme banorësh. Kjo dukuri ka tërhequr me të drejtë vëmendjen e disa studiuesve dhe shpjegimi i saj paraqitet bukur i vështirë, po të kihet parasysh se këto tri vendbanime kanë rreth e rrotull fshatra shqipfolëse; madje midis Himarës dhe Dhërmiut ndodhet katundi Vuno, që është shquar jo vetëm për një shqipe të bukur, por edhe për një nivel të ngritur arsimor e kulturor. Për më tepër, nuk mund të përcaktohet me saktësi as se qysh kur është shfaqur kjo dukuri. Gjithsesi, në bazë të njoftimeve të misionarëve bazilianë italianë dhe të të huajve të tjerë, që u përmendën këtu më sipër, mund të pohohet se ndër burrat e këtyre tri vendbanimeve përdorimi i greqishtes, krahas shqipes, ishte diçka që binte në sy qysh në shekujt XVII-XIX. Kjo dukuri atje mund të jetë edhe më e hershme, por për këtë nuk kemi të dhëna.

26. Për sa u takon faktorëve, që i kanë dhënë shkas një dukurie të tillë në *Himarë, Dhërmi* e *Palasë*, nuk dimë që të jetë bërë ndonjë studim shkencor. Vetëm shkrimtari Petro Marko, nga Dhërmiu, në veprën e tij “Intervistë me vetveten”¹⁵⁴ është përpjekur ta shpjegojë atë me ndikimin e disa faktorëve. Sipas tij, kjo dukuri ka nisur të shfaqet sidomos pas vitit 1820, kur Greqia fitoi pavarësinë nga Turqia dhe nisi një fushatë greqizimi të popullsisë së kësaj ane. Gjithnjë sipas tij, pas myslimanizimit të katundeve të brendshme të Labërisë banorët e krishterë të bregdetit, në raste luftërash, njerëzit e moshuar dhe fëmijët nuk i çonin më për t’i strehuar në

¹⁵⁴ Shih Petro Marko, *Intervistë me vetveten*. Tiranë, 2000, f. 48v.

fshatrat labe, por në Korfuz e në Gjirit, ku qëndronin shumë vjet, derisa mbaronin operacionet ndëshkimore turke. Ai shton: “Thonë se banorët e Dhërmiut shkonin në ishullin grek [= Korfuz - SH. D.], kurse ata të Himarës në Gjirit. Prandaj dhe kur flasin greqisht, dhërmijasit flasin si korfjatët, kurse himarjotët si gjiritlinjtë.” Ai vë në dukje edhe rolin e shkollave greke dhe të meshës që thuhej greqisht, si edhe tregtinë, që bëhej me Korfuzin e Janinën. Ai vë në dukje gjithashtu edhe propagandën greke, që i paraqiste ortodoksët si grekë, kurse myslimanët si turq.

27. Këto shpjegime, që jep shkrintari Petro Marko për dukurinë në shqyrtim, në thelb janë të sakta. Por ato kanë nevojë të argumentohen dhe të thellohen më tej. E për këtë duhen bërë hulumtime të posaçme historike dhe dialektore, për të kuptuar më mirë rrethanat, që i kanë dhënë shkas përhapjes së greqishtes vetëm në vendbanimet *Himarë*, *Dhërmi* dhe *Palasë*. Gjithsesi, nga sa u shtjellua në këtë trajtesë, mund të pohohet që përhapja e greqishtes në këto vendbanime është një dukuri jo fort e vjetër. Ajo duhet të jetë shfaqur pas pushtimit turk të Shqipërisë, kur banorët e këtyre vendbanimeve për shkak të trysnisë së turqve, nga njëra anë, dhe të kushteve të vështira ekonomike, nga ana tjetër, ishin të detyruar t’i shtonin kontaktet me botën greke, me të cilën i lidhte edhe feja e përbashkët ortodokse, si edhe lufta kundër të njëjtit pushtues të huaj. E zgjerimi i vazhdueshëm i kontakteve me grekët, sidomos nëpërmjet mërgimit në viset greke, si edhe nëpërmjet rrugëve të tjera (arsimimi në shkollat greke dhe shërbesat fetare po në gjuhën greke) nuk mund të mos i jepnin shkas përhapjes gjithnjë e më shumë të greqishtes në këto vendbnime më parë kryesisht ndër meshkujt, ashtu siç e konstatoi Leake-u qysh në fillim të shekullit XIX. Gjithsesi, nuk mund të mos bjerë në sy fakti që përhapja e greqishtes në këto tri vendbanime ka ardhur duke u zgjeruar krahas zgjerimit të kontakteve të banorëve të këtyre tri vendbanimeve, me botën greke sidomos pas shpalljes së pavarësisë së shtetit grek në fillim të shekullit XIX, ashtu siç e vuri në dukje Petro Markoja. Por mbetet për t’u hulumtuar lidhur me vërejtjen e Petro Markos për dallimet dialektore të greqishtes së folur nga himarjotët dhe nga dhërmijasit. Gjithsesi, duke u mbështetur në sa u shtjellua në këtë studim, del e qartë se, për sa i takon gjuhës amtare, banorët e këtyre tri qendrave nuk mund të veçohen nga ata të

katundeve rreth e rrotull tyre, qofshin ata të krishterë apo të mylimanizuar.

28. Nga sa u shtjellua përmbledhtas në këtë kapitull, del qartë gjithashtu se, për sa i takon gjuhës amtare, shqipes, e folmja e Bregdetit Jugor shqiptar nuk mund të veçohet nga të folmet e tjera të dialektit jugor të gjuhës shqipe dhe, ashtu si këto, i është nënshtruar një evolucioni të pandërprerë qysh nga kohët e lashta. E ky evolucion i gjatë me karakter dialektor dhe nëndialektor parakupton një prani të pandërprerë të elementit të vjetër autokton, i cili, me gjithë trysnitë e shumta, sidomos gjatë pushtimit romak, ka mundur ta ruajë identitetin e vet etnik, ashtu si etnosi arbëresh në përgjithësi.

Kreu i gjashtë

Gjuha amtare në vendbanimet e gjirit të Vlorës gjatë shekujve

1. *Gjiri i Vlorës*, nga vetë pozicioni i tij gjeografik si një nyjë ndërlidhëse e ujërave të dallgëzuara të detit Jon dhe të Adriatikut me ato të detit Mesdhe dhe përballë Gadishullit Apenin, nuk mund të mos ketë tërhequr qysh në kohëra shumë të hershme vëmendjen e njerëzve, që kanë gjetur aty kushte shumë të përshtatshme jetese. Për më tepër, klima e butë mesdhetare dhe prapatoka e këtij gjiri duhet ta kenë nxitur edhe më shumë interesimin e njerëzve për t'u vendosur atje. Prandaj nuk është ndonjë tepri të mendohet që kjo trevë të ketë qenë e banuar qysh shumë kohë para ardhjes së tribuve indoeuropiane në Gadishullin Ballkanik. Por mjerisht, sot për sot, nuk dimë asgjë për banorët më të hershëm të kësaj treve dhe për gjuhën a gjuhët, që kanë pasë folur ata. Ajo që mund të pohohet me saktësi sot, është se në këtë trevë qysh në kohë të lashta ka pasur qendra të banuara, që kanë tërhequr edhe vëmendjen e tregtarëve grekë, të paktën, qysh nga mesi i mijëvjeçarit të fundit para erës së re. Nga ato qendra të banuara kemi të dhëna më të hershme për *Orikun* dhe për *Aulonën* a *Vlorën*. Por do pasur parasysh se gjatë shekujve ndonjë vendbanim i këtij gjiri mund edhe të jetë zhdukur, ashtu siç është zhdukur *Oriku* i lashtë, i cili në përgjithësi mbahet si një qendër e themeluar nga grekët aty nga shekulli VI para erës së re (shih shën. 165). Por, siç e kemi vënë në dukje edhe në temën kushtuar “kolonive” greke e romake në këtë libër, është tashmë një gjë e njohur që grekët e vjetër për qëllime tregtare themelonin “koloni” në vende të popujve të tjerë, me të cilët bënin tregti. Për më tepër, tregtarët grekë në ato “koloni” nuk ishin të shumtë dhe shpejt a vonë përziheshin me popullsinë vendëse. Gjithsesi, për *Orikun*, që përmendet gjithnjë e më pak pas shekullit II të erës sonë, dimë vetëm se ka qenë për njëfarë kohe në lashtësi si një ndër skelat më të rëndësishme të bregdetit perëndimor të Gadishullit Ballkanik. Por me ç'popullsi bënin tregti “kolonët” grekë të Orikut? Ajo nuk duhet të ketë qenë e ndryshme nga popullsia e gjirit të Vlorës në

përgjithësi. Gjithsesi, popullsia vendëse nuk ka qenë greke, sepse, siç u vu në dukje edhe pak më sipër, grekët themelonin “koloni” tregtare pranë popujsh të tjerë (shih Islami: 1992, 7v.).

Arkeologu austriak Karl Paç qysh në fillim të shekullit XX zbuloi edhe gjurmët e një skele të hershme në pjesën veriperëndimore të këtij gjiri dhe pikërisht në vendin e quajtur *Pllaka* të Zvërnecit. A ka qenë këtu dikur qyteti-skelë i Vlorës apo jo, kjo mbetet për t’u hulumtuar. Gjithashtu gjatë bregdetit të *Gjirit të Vlorës* dhe në prapatokën pas tij duhet të ketë pasur edhe vendbanime të tjera, siç është p.sh. rasti i *Kaninës*, që është themeluar qysh herët në një vend aq strategjik¹⁵⁵.

2. Pra, nga vendbanimet e vjetra të Gjirit të Vlorës vetëm qyteti-skelë i Vlorës ka mbijetuar. Prandaj, në paragrafët ndjekës do të merremi kryesisht me këtë vendbanim. Emri i Vlorës është një ndër të paktët emra gjeografikë të bregdetit lindor të Adriatikut dhe të Jonit, që i kanë qëndruar kohës qysh nga periudhat e lashta. Në bregdetin e banuar nga popullsia shqiptare ky emër gjeografik del i një lashtësie pak a shumë të përafërt me ata të *Durrësit*, *Shkodrës*, *Lezhës* dhe *Ulqinit*¹⁵⁶. Këta emra gjeografikë nuk do të mund t’i kishin qëndruar kohës, në rast se vendbanimet e emërtuara prej tyre nuk do të kishin pasur një vazhdimësi të pandërprerë përdorimi në rrjedhë të shekujve. E kjo vazhdimësi shpjegohet, në radhë të parë, me pozicionin e tyre gjeografik, që ka bërë që vendbanimet e emërtuara prej tyre të mos mbeteshin të papopulluara. Por ç’popullsi ka banuar në këto qendra të rëndësishme në rrjedhë të kohës, kjo çështje mbetet e hapur, po të mbahet parasysh sidomos fakti që trevat e banuara sot nga shqiptarët u janë nënshtruar pushtimeve të ndryshme të huaja, që në disa raste kanë zgjatur me shekuj, siç është p.sh. rasti i pushtimit romak. Dhe është me të vërtetë një nga të papriturat e historisë që një

¹⁵⁵ *Kanina* si vendbanim duhet të jetë shumë e vjetër. Për Kaninën shih D. Komata (1991). Por emri *Kaninë* nuk duhet të jetë shumë i lashtë, sepse emrat e vendbanimeve shpesh kanë ndryshuar gjatë shekujve. Gjithsesi, ky emër nuk duhet të jetë as shumë i ri. Emri *Kaninë* i takon periudhës parasllave të shqipes; Selishçevi në veprën e tij të vitit 1931 nuk e ka përfshirë ndër emrat sllavë të vendbanimeve të Shqipërisë.

¹⁵⁶ Për emrat e këtyre qyteteve shih shënimet përkatëse te Demiraj: 1999, 130 vv.

pjesë e mirë e popullsisë së trevave të banuara nga stërgjyshërit e shqiptarëve mundi t'i rezistonte procesit të romanizimit dhe më pas të sllavizimit, që përfshiu pjesën më të madhe të Gadishullit Ballkanik.¹⁵⁷

3. Për praninë e hershme të stërgjyshërve të shqiptarëve në viset lindore të Adriatikut dhe të Jonit dëshmojnë qartë, ndër të tjera, edhe disa emra të lashtë gjeografikë të këtyre viseve, të cilët në rrymë të shekujve kanë pësuar ndryshime fonetike në përputhje me rregullsitë e evolucionit të sistemit fonologjik të gjuhës shqipe. E një ndër këta emra gjeografikë është edhe ai i *Vlorës*, që është edhe objekt i kësaj teme, ku do të trajtohen: 1) Koha e themelimit të këtij vendbanimi. 2) Burimi i emrit të këtij qyteti dhe cilët kanë qenë themeluesit e tij. 3. (Dokumentimi i tij ndër shekuj). 4. Përbërja etnike e tij në rrjedhë të shekujve në dritën e dëshmiave të gjuhës shqipe.

4. Për kohën e themelimit të *Vlorës* nuk kemi të dhëna të qarta, sepse edhe emri i saj del relativisht vonë nëpër burime të shkruara. Ajo dokumentohet për herë të parë me emrin *Aulon* në dy burime të rëndësishme të shekullit II të erës sonë dhe pikërisht te shkrimtari grek *Lukiani* si dhe te gjeografi i mirënjohur i Aleksandrisë, *Ptolemeu*.

Lukiani e përmend emrin e *Vlorës* në një nga shkrimet e tij, ku thotë ndër të tjera: "... dhe së andejmi duke rënë në një shtrëngatë të fortë, ditën e dhjetë erdhëm te *Helidonët*¹⁵⁸ përmes *Aulonës*, ku për pak të gjithë do të ishim mbytur në ujë"¹⁵⁹.

5. Të dhëna disi më të plota për *Aulonën* e shekullit II të erës sonë na jep *Ptolemeu* në veprën e tij *Gjeografia*. Këtu, në Librin III, kap. 12, ai e trajton *Aulonën* në Provincën (romake) të *Makedonisë*¹⁶⁰ dhe në paragrafin 3 të atij kapitulli

¹⁵⁷ Për romanizimin e vendeve ballkanike shih temën përkatëse në këtë libër (Kreu IV).

¹⁵⁸ *Helidon* (= dallëndyshe) është përkthimi greqisht i emrit të fisit të taulantëve. *Taulant* duhet të jetë trajta më e vjetër e emrit *dallënd-yshe* (me prapashtesën femërorizuese /-yshe/ </-ushe/. Për evolucionin *taulant->dallënd-* (yshe) shih Çabej: 1987, 157 v. dhe Demiraj: 1999, 208.

¹⁵⁹ Shih *Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë*, faqe 232.

¹⁶⁰ Sipas ndarjes administrative të Perandorisë Romake të shekullit II para erës sonë, në Provincën e *Makedonisë* përfshiheshin edhe shumë vise të banuara nga fise ilire e midis tyre edhe *Durrësi*, *Apolonia* dhe *Vlora*.

e përfshin atë në “tokën e taulantëve”, duke e quajtur *qytet, skelë* (polis, epineion).¹⁶¹

Në përkthimin italisht të *Gjeografisë* së Ptolemeut të bërë në vitet 1564¹⁶² dhe 1574¹⁶³, faqe 165, përkatësisht 161, jepet ky përcaktim: *Aulona città navale. La Valona degli Elimioti*.¹⁶⁴

Fakti që Ptolemeu e quan *Aulonën* “qytet, skelë”, dëshmon se ky “qytet, skelë” ishte themeluar pa dyshim shumë kohë më përpara, sepse një “qytet, skelë”, sidomos në lashtësi, nuk mund të ndërtohej brenda një kohe të shkurtër. Por arsyeja përse ky “qytet, skelë” ka mbetur pa u përmendur nga autorë më të vjetër grekë e romakë, nuk është e qartë. Ndoshta, kjo do lidhur me vëmendjen më të madhe, që i është kushtuar në shekujt e mëparshëm një qendre tjetër të rëndësishme të *Gjirit të Vlorës* dhe pikërisht *Orikut* (Orikon)¹⁶⁵, i cili pas shekullit II të erës sonë del gjithnjë e më rrallë në dokumentet antike.

6. Pra, qyteti-skelë i *Aulonës* së lashtësisë është themeluar pa dyshim disa shekuj para shekullit II të erës sonë, por sot për sot nuk mund të thuhet asgjë me saktësi për kohën e mirëfilltë të themelimit të saj. Gjithsesi, duke pasur parasysh pozitën e rëndësishme të *Gjirit të Vlorës* dhe kushtet e favorshme klimatike të

¹⁶¹ Shih Claudii Ptolemaei Geographia, Edidit Carolus Fridericus - Augustus Nobbe, editio stereotypa. Tom I. Lipsiae sumptibus et typis Caroli Tauchnitii, 1843.

¹⁶² Shih *La Geographia di Claudio Tolomeo Alessandrino, nuovamente tradotta di Greco in Italiano da Ieronimo Ruscelli*. In Venetia. MDLXIII, faqe 165.

¹⁶³ Shih *La Geografia di Claudio Tolomeo Alessandrino. Già tradotta di Greco in Italiano da Rugiero Ruscelli et hora in questa nuova editione da M. Gio. Malombra* in Venetia. MDLXXIII, faqe 161.

¹⁶⁴ Ptolemeu në të vërtetë e përfshinte *Aulonën* ndër qytetet e taulantëve, kurse si qytet të elimiotëve përmend *Byllis*-in. Gjithsesi, edhe fisi i elimiotëve përfshihej në Provincën Romake të *Makedonisë* (shih shënimin 160).

¹⁶⁵ *Oriku* dëshmohet qysh te Herodoti (shekulli V p. e. s.) dhe përmendet edhe nga Skylaksi, Polibi, Skymni, Ciceroni, Cezari, Livi, Mela, Plini, Apiani, Ptolemeu etj. (shih *Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë*, faqe 21, 36, 61, 73, 83, 87 vv., 183 etj.). Ky qytet bregdetar mendohet të jetë themeluar aty nga shekulli VI para erës sonë.

zonës përreth, mund të pohohet se ajo trevë ka qenë e populluar qysh prej kohësh shumë të lashta dhe si rrjedhim është ndjerë nevoja qysh herët që në atë trevë të themeloheshin edhe qytete bregdetare për zhvillimin e tregtisë. Dhe prandaj nuk është një rastësi që në atë pellg dëshmohen qysh në lashtësi dy qytete: *Aulona* dhe *Oriku*.

Nga këto dy qytete bregdetare *Oriku* dëshmohet qysh nga shekulli VI para erës sonë (shih shënimin 165), kurse *Aulona* dokumentohet vetëm qysh nga shekulli II i erës sonë. Por kjo nuk do të thotë që *Aulona* është më pak e lashtë. Për këtë fjalën e fundit do ta thotë arkeologjia, pasi të jetë saktësuar më parë se ku ka qenë *Aulona* e lashtë, sepse, sipas disa dijetarëve, ajo ka qenë diku më në veriperëndim (shih § 7).

7. I pari dijetar, që parashtrroi hipotezën se *Aulona* e lashtë ka qenë e vendosur më në veriperëndim, ishte arkeologu austriak Karl Paç (Carl Patsch). Në një ekspeditë studimore në fillim të shekullit XX ky dijetar gjatë kërkimeve të tij zbuloi në një zonë bregdetare të quajtur *Pllaka* mbeturinat e një moli të vjetër, në pjesën më të madhe nën ujë, si edhe disa mbeturina të tjera arkeologjike. Kjo zonë, që ndodhet në skajin verior të Gjirit të Vlorës, përkundrejt Sazanit dhe kepit të gadishullit të Karaburunit, përkon me atë të *Treportit*. Sipas Paçit (1904, f.63), kjo zonë, e mbrojtur nga erërat e shirokut dhe të garbisë¹⁶⁶, “ishte shumë e përshtatshme për një skelë”. Ai shton: “Kjo rrethanë si edhe fakti që në vetë Vlorën dhe në skelën e saj, të paktën deri sot, nuk janë gjetur mbeturina antike, na bënë të supozojmë që *Aulona* e lashtë ka qenë e vendosur këtu në *Pllaka* dhe vetëm më vonë ka ndodhur zhvendosja e saj në Vlorën e sotme në rrëzë të malit, qoftë për arsye ndodhish elementare, qoftë për arsye të parapëlqimit të turqve për të banuar në vise më të larta.”

Këtë supozim të Karl Paçit e miraton edhe Jireçeku (1916, f.176), i cili shton se në Vlorën antike “në shekujt V dhe VI ka pasur edhe një peshkop, që më vonë u vu nën urdhrat e metropolitit të Durrësit”. E kjo dëshmon se ky qytet i lashtë gjatë atyre shekujve ka qenë një vendbanim me rëndësi.

¹⁶⁶ Erëra që fryjnë nga jugu dhe perëndimi.

Mbeturina të një qyteti bregdetar të lashtë në zonën e quajtur *Pllaka* janë zbuluar edhe gjatë gërmimeve të kryera nga Instituti i Arkeologjisë i Tiranës gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX, por çështja nëse aty duhet lokalizuar *Aulona* e lashtë, ka mbetur e hapur.¹⁶⁷ Nuk po ndalem më tej në çështjen e lokalizimit të qytetit të lashtë të *Aulonës*, aq më shumë sepse kjo çështje del jashtë fushës së hulumtimeve të mia.

8. Por cilët kanë qenë banorët e parë, ose themeluesit e këtij qyteti-skelë të lashtësisë? Edhe sqarimi i kësaj pyetjeje paraqitet shumë i vështirë. Sipas Jireçekut (1916, 176vv.), emri i *Vlorës* (Αυλον) është prej burimi grek dhe kishte kuptimin “luginë, lug, kanal”. Ai shton se me emrin *Aulon* kishte edhe një qytet tjetër në Gadishullin Kalçidik dhe një krahinë në Meseni (Peloponez). Edhe Krahe-ja (1925, f.1) e përfshin *Aulonën* ndër emrat gjeografikë prej burimi grek me kuptimin “luginë, grykë”. Por nuk del e qartë nëse ata mendonin që qyteti-skelë me këtë emër në bregdetin e Adriatikut është themeluar nga kolonë grekë¹⁶⁸.

9. Gjithsesi, lidhur me themeluesit e këtij qyteti-skelë duhet mbajtur parasysh fakti që Ptolemeu atë e përfshin ndër qytetet e fisit ilir të *taulantëve*, kurse përkthyesit italianë të Ptolemeut në shekullin XVI e quajnë atë “qytet i *elimiotëve*” (shih §5). Për më tepër, në burimet e lashta dhe mesjetare nuk del gjëkund që popullsia e këtij vendbanimi të ketë qenë greke. Natyrisht, nuk përjashtohet mundësia që në lashtësi midis popullsisë vendëse të ketë pasur edhe një numër të kufizuar kolonësh grekë, të ardhur për qëllime tregtie, të cilët me kohë janë asimiluar nga vendësit. Edhe mundësia që emri i *Aulonës* të ketë qenë prej burimi grek, nuk duhet përjashtuar,

¹⁶⁷ Shih Bereti: 1977-78, 287; 1985, 313; 1986, 258; Ceka: 1982, 19. Ky i fundit lokalizon këtu qytetin bregdetar *Throni* të fisit ilir të *amantëve*.

¹⁶⁸ Grekët e vjetër qysh në gjysmën e parë të mijëvjeçarit të fundit para erës sonë themeluan koloni tregtare në vise të ndryshme të Mesdheut, sidomos në Azinë e Vogël dhe në Italinë e Jugut. Madje, kjo e fundit në lashtësi quhej *Megale Hellas* ose *Magna Graecia* “Greqia e Madhe”. Kolonë grekë, në një numër të kufizuar, qenë vendosur edhe në disa qendra bregdetare të tjera të Adriatikut, si Durrësi, Apolonia, Lisosi etj.

po të kemi parasysht ndikimin e madh të kulturës dhe të gjuhës greke në kohë të lashta. Për më tepër, edhe shpjegimi kuptimor, që i jepet emrit të këtij qyteti nëpërmjet greqishtes *Aulon* “luginë, lug, kanal”, duket sikur e mbështet një mundësi të tillë, po të mbahet parasysht pozicioni i këtij vendbanimi, ashtu siç e njohim në kohë të reja. Por një shpjegim i tillë kuptimor nuk do të dilte i mbështetur, në rast se *Vlora* e dikurshme ka qenë themeluar diku gjetkë, ashtu siç supozojnë Paçi, Jireçeku e ndonjë tjetër.

10. Çështja e fundit ndërlikohet edhe më shumë, po të kemi parasysht se në burimet latine, italiane dhe sllave emri i këtij qyteti del me fundoren /-a/. Kështu p.sh., në dy *Itinerarë romakë* të shekujve të parë të erës sonë emri i këtij qyteti del në trajtat *Aulona*¹⁶⁹. Edhe në burimet italiane të mesjetës emri i këtij qyteti del me fundoren /-a/ dhe pikërisht në trajtat *Aulona*, *Avalona*, *Avallona*, *Avelona*, *Lavalona*, *Lavellona* etj. Kurse në burimet e vjetra serbe dëshmojnë trajtat *Avlona* dhe *Vavlona*¹⁷⁰, kjo e dyta, me sa duket, me shtimin e nistores /-v/, që duhet ta ketë burimin te parafjala sllave /v/ (= në).

Siç shihet, në burimet latine, italiane dhe sllave emri i këtij qyteti del me fundoren e patheksuar /-a/. Edhe trajtat e dokumentuara ndër shqiptarët *Vlonë/Vlorë* parakuptojnë praninë e dikurshme të fundores së patheksuar /-a/, e cila është reduktuar në /-ë/. Praninë e një zanoreje fundore në këtë rast e dëshmon edhe rotacizmi /-n-/>/-r-/ në dialektin jugor, ku kjo dukuri fonetike, siç dihet, është vërtetuar vetëm atëherë kur /-n-/ është ndodhur midis dy zanoresh qysh në periudhën parasllave

¹⁶⁹ Shih Miller: 1916, 497 (në hartë), 562; Cuntz: 1929, 49, 76, 78, 100, 101. Në këta dy itinerarë romakë emri i këtij qyteti jepet me një (-o-) të zakonshme, çka përputhet me trajtën e dokumentuar të emrit të tij ndër shqiptarët. E kjo i shton edhe një tjetër pikëpyetje saktësisë së trajtës së Ptolemeut, i cili e jep me /-o-/ të gjatë (*Aulōn*). Të kihet parasysht se një /-o-/ e gjatë e asaj periudhe në gjuhën shqipe duhej të kishte dhënë /-e-/, ashtu si në huazimet latine (shih Demiraj: 1996, 56v. - me literaturë). Emri *Aulona* duhet të jetë shfaqur në një kohë kur /o/ e shkurtër indoeuropiane nuk shndërrohej më në /a/, gjithsesi mjaft herët (shih Demiraj: 1996, f. 49).

¹⁷⁰ Shih *Acta et diplomata*, I (1913), *passim*; Jireçek: 1916, f. 177.

të shqipes.¹⁷¹ Pra, si burimet e vjetra latine dhe italiane ashtu edhe trajtat e shqipes dëshmojnë se emri në shqyrtim duhet të jetë përdorur qysh herët me fundoren /-a/. Sipas Jireçekut (1916, f.177), forma me fundoren /-a/ është më e vonë dhe përfaqëson trajtën e kallëzores greke (*eis Aulona*). Kuptohet vetiu që ky shpjegim i Jireçekut është i kushtëzuar nga mendimi i tij që emri i *Vlorës* është prej burimi grek. Por ky shpjegim i Jireçekut për fundoren /-a/ nuk gjen mbështetje tek emrat e tjerë gjeografikë të lashtë si *Apolonia* dhe *Scodra*, që në gjuhë të tjera, si edhe në gjuhën shqipe, nuk janë përfaqësuar me trajtën e rasës kallëzore, megjithëse, sipas mendimit mbizotërues, *Apolonia* mbahet prej burimi grek dhe e themeluar nga kolonë grekë.¹⁷²

11. Mendimi që *Aulona* të jetë prej burimi grek, parakupton në njëfarë mënyre që themeluesit e saj të kenë qenë grekë, ashtu si ata të *Aulon*-it të Peloponezit dhe të Gadishullit Kalçidik. Por në këtë rast do të pritej që emri i banorit të këtij vendbanimi të ishte formuar me prapashtesën greke *-it*, ashtu si ata të dy vendbanimeve greke të sapopërmendura, që e quajnë veten *aulon-it-es*. Kurse banorët e Vlorës e kanë quajtur veten *vlonjat*<*vlon-i-at*, që është formuar me prapashtesën *-at* (*-iat*), e cila me emra banorësh të një vendi del në një numër shumë të kufizuar rastesh si në shqipe (krahaso edhe *konispol-at*, *korf-iat*) ashtu edhe në greqishte (krahaso *spart-iat-es*, *man-iat-es*). Por a është kjo prapashtesë te emri *vlonjat* prej burimi grek, siç mendojnë Xhuvani-Çabej (1962, f.24), apo duhet lidhur me prapashtesën vendëse *-at* (si te *Duk-at*, *Dunav-at*, *Fil-at*, *Bush-at*, *Kastr-at* etj.), kjo mbetet për t'u hulumtuar.¹⁷³ Gjithsesi, tek emri i prejardhur *vlonjat* bie në sy

¹⁷¹ Shumica e gjuhëtarëve kanë pranuar që rotacizmi, si dukuri fonetike, nuk ka vepruar në huazimet sllave të shqipes. Por disa mendojnë se kjo dukuri ka vazhduar deri aty nga fundi i shekullit X të erës sonë. Mendimi i të parëve del më i mbështetur (shih Demiraj: 1996, 242 vv. - me literaturë).

¹⁷² Për çështjen e “kolonive” greke shih temën përkatëse në këtë libër (Kreu III). Për rastin konkret të Apolonisë të kihet parasysh vërejtja e Hammond-it (1967, f. 426), ku thuhet se në *Apoloni* numri i “kolonëve” grekë ishte rreth dyqind veta.

¹⁷³ Shih për këtë prapashtesë Xhuvani-Çabej: 1962, f. 23.

edhe qiellzorëzimi i bashkëtingëllores /n/ në /nj/, dukuri kjo gjithashtu e vjetër e gjuhës shqipe.¹⁷⁴

12. Edhe shndërrimet e tjera fonetike, që ka pësuar emri i *Vlorës*, në krahasim me *Aulona*-n e lashtësisë, dëshmojnë se ky emër ka qenë në përdorim të vazhdueshëm qysh prej kohësh të hershme ndër stërgjyshërit e banorëve të sotëm të kësaj zone. Këtu është fjala jo vetëm për rotacizmin /-n-/>/-r-/, por edhe për shndërrimet, që vihen re në rrokjen nistore *Vlo-* përkundrejt *Aulo-*. Siç bie në sy, këtu diftongu nistor /au-/ është reduktuar në gjysmëzanoren /-u/, e cila është shndërruar rregullisht në /v-/. Ky shndërrim duhet të jetë kryer, para se një /-l-/ e vjetër ndërzanore të shndërrohej rregullisht në /-ll-/ në gjuhën shqipe, sepse përndryshe në shqipen e dokumentuar do të kishim **Vllonë/Vllorë*. E duke qenë se evolucioni i bashkëtingëllores /-l-/ midis dy zanoresh në /-ll-/, në përgjithësi, i takon periudhës parasllave të shqipes¹⁷⁵, duhet pranuar që evolucioni *Aulo->Vlo-* të *Vlonë/Vlorë* është kryer mjaft herët. E kjo është një tjetër dëshmi gjuhësore, që vërteton se emri i këtij qyteti ka qenë në përdorim të hershëm ndër të parët e shqiptarëve të sotëm.

13. Nga analiza, që iu bë evolucionit të emrit gjeografik *Aulona>Vlonë/Vlorë* dhe emrit të prejardhur *vlonjat* < **vlon-iat-*, del qartë se qysh në kohëra të hershme banorët e këtij vendbanimi, në pjesën më të madhe, i përkisnin atij etnosi, nga i cili rrjedhin shqiptarët e sotëm. Natyrisht, përbërja demografike e këtij qyteti të lashtë dhe e viseve përreth ka pësuar edhe ndryshime në rrymë të shekujve. Kështu p.sh., nuk përjashtohet jo vetëm prania e disa kolonëve grekë të ardhur në kohë të lashta për qëllime tregtare, por edhe një romanizim i pjesshëm i popullsisë së kësaj treve gjatë sundimit romak. Madje, edhe në kohëra relativisht më të vona ka pasur edhe ardhacakë të tjerë, si sllavë, hebrej¹⁷⁶ etj. Por këto ndryshime demografike nuk kanë mundur ta ndërpresin vazhdimësinë e popullsisë autoktone, e cila ka përbërë kurdoherë bërthamën kryesore të popullsisë së kësaj treve.

¹⁷⁴ Shih për këtë Demiraj: 1996, f. 166 - me literaturën përkatëse.

¹⁷⁵ Shih për këtë Pedersen: 1897, 535 v.; Çabej: 1987, 241 v.; Demiraj: 1996, 170 vv.

¹⁷⁶ Kështu, p.sh., në një veper gjeografike të botuar në fillim të shekullit XVII pohohet,

14. Por ç'gjuhë kanë folur banorët e qytetit dhe të Gjirit të Vlorës gjatë shekujve? Kjo pyetje, natyrisht, parakupton që të sqarohet më parë nëse ata banorë gjatë shekujve kanë folur një apo më shumë se një gjuhë. Këtu është fjala për gjuhët e folura pas ardhjes së tribuve indoeuropiane në Gadishullin Ballkanik, sepse gjuhët jo-indoeuropiane të folura para ardhjes së tribuve indoeuropiane në Ballkan dhe në Europë në përgjithësi janë sot për sot të panjohura për ne, me përjashtim të gjuhës së baskëve, që flitet në viset kufitare midis Spanjës dhe Francës. Sqarimi i pyetjes së mësipërme edhe për periudhën pas ardhjes së tribuve indoeuropiane në viset e banuara sot nga shqiptarët paraqitet bukur i vështirë, sepse jo vetëm për kohërat e hershme, por edhe për periudhën e mesjetës nuk mund të flitet për popullsi krejt të papërziera jo vetëm në Gjirin e Vlorës dhe në viset e banuara nga shqiptarët, por edhe në Gadishullin Ballkanik e më gjerë. Mjafton të kujtojmë dy periudhat e sundimit të mbretërisë bullgare gjatë shekujve IX-XIII dhe të mbretërisë serbe të Nemanjidëve gjatë shekujve XII-XIV, që kanë lënë gjurmë të shumta jo vetëm në fjalorin e gjuhës shqipe por edhe në emrat e vendeve, gjurmë këto që të lënë përshtypjen e një kolonizimi të pjesshëm të viseve shqiptare nga ana e pushtuesve sllavë. E njëjta vërejtje vlen edhe për periudhat më të hershme, sidomos për periudhën e sundimit të gjatë romak, që solli si pasojë romanizimin e një pjese të mirë të popujve të Ballkanit, si edhe për periudhën më të hershme të themelimit të “kolonive” greke në brigjet e Mesdheut, të Adriatikut¹⁷⁷ e gjetkë. Si rrjedhim i këtyre ngjarjeve historike për periudhat e lashtësisë dhe të mesjetës është vështirë të flitet për një popullsi krejt

natyrisht në mënyrë të tepruar, se pjesa më e madhe e popullsisë së Vlorës në atë kohë ishin hebrenj. Është fjala për veprën *Geografia*, cioè *Descrizione Universale della Terra...*, Dal R. D. Leonardo Cernoti, canonico di San Salvatore. In Padova MDCXXI, ku në faqen 121/b pohohet për Vlorën: “Hebrei l’habitano per la maggior parte.” Prania e konsiderueshme e hebrenjve në Vlorë në fillim të shekullit XVII përkon me periudhën e mërgimit të tyre të detyruar nga Spanja në fund të shekullit XVI (shih për këtë Kagan etj.: 1987, f. 331).

¹⁷⁷ Në bregdetin ilirian grekët me origjinë dorase themeluan “koloni” për qëllime tregtare në Durrës, Lezhë, Apolloni e Vlorë. Por kjo nuk parakupton që këto vendbanime janë themeluar nga grekët (shih për këtë Demiraj: 1999, 130vv., 147v., 150vv.).

homogjene në viset e banuara nga shqiptarët, duke përfshirë edhe vendbanimet e *Gjirit të Vlorës*. Madje, siç dihet, ka pasur ndonjë dijetar si Konstandin Jireçeku, që ka menduar për një helenizim dhe romanizim pothuaj të plotë të Gadishullit Ballkanik në lashtësi, mendim ky që nuk i ka qëndruar kritikës. Jireçeku dhe ndonjë tjetër studiues e kanë mbështetur një mendim të tillë në faktin që për periudhën e lashtë në viset veriore të Shqipërisë dëshmohen mbishkrime latine, kurse në viset jugore dëshmohen mbishkrime greke, sepse në atë kohë latinishtja dhe greqishtja shërbenin si dy gjuhë kulture. Por kjo nuk do të thotë që popullsia vendëse e këtyre viseve fliste latinisht apo greqisht.

15. Në të tilla rrethana, pyetja se ç'gjuhë është folur në vendbanimet e *Gjirit të Vlorës* në lashtësi dhe në mesjetë, në mungesë të dhënash të dokumentuara me shkrim për periudhat e hershme, mund të ndriçohet kryesisht nëpërmjet të dhënave të tërthorta, që mund të nxirren nga analiza e disa fakteve të gjuhës amtare, që flitet në këto vise në periudhën e dokumentuar historike. E në këtë rast shqipja si gjuhë amtare e vendbanimeve të *Gjirit të Vlorës* nuk mund të veçohet nga gjuha amtare e banorëve të Shqipërisë Jugore në përgjithësi. A janë banorët e këtyre viseve autoktonë qysh prej kohësh të hershme, apo stërgjyshërit e tyre kanë shtegtuar në këto vise, pa u vënë re, relativisht vonë, siç supozojnë disa studiues të huaj? Po të pranohej supozimi i fundit, atëherë do të pranohej detyrimisht që ata kanë asimiluar një popullsi të mëparshme të helenizuar apo të romanizuar. Por në një rast të tillë duhet pasur parasysh jo vetëm fakti që nuk ka asnjë dëshmi historike për një shtegtim të tillë, por edhe fakti tjetër që ka qenë e pamundur që një popullsi e paorganizuar dhe e pazhvilluar kulturalisht të ketë asimiluar një popullsi të helenizuar apo të romanizuar, që jo vetëm duhej të ishte më e organizuar dhe më e zhvilluar, por gëzonte edhe mbështetjen politike dhe morale të autoriteteve romake më parë dhe të autoriteteve greke-bizantine më pas.

16. Gjithsesi, mendimi që Shqipëria Jugore në përgjithësi dhe i ashtuquajturit Epir në veçanti ishin të helenizuar në lashtësi nuk ka asnjë mbështetje dhe për këtë arsye është kritikuar me të drejtë edhe nga një studiues specialist i kësaj treve, siç ishte dijetari anglez N. G. L. Hammond, i cili, siç u vu në dukje në temën kushtuar

Epirit (Kreu II, § 13), në faqen 423 të vëllimit të parë të veprës së tij madhore *Epirus* (1967) e kundërshton një gjë të tillë.

Por arsyetimi i mësipërm është një argument *ex silentio*. Prandaj në këtë rast është e nevojshme të parashtrohen edhe disa të dhëna konkrete, që do të dëshmonin për një prani të hershme dhe të vazhdueshme të popullsisë autoktone në Shqipërinë Jugore në përgjithësi dhe në vendbanimet e *Gjirit të Vlorës* në veçanti. Këto të dhëna, që do të kërkonin një monografi të gjerë, janë parashtruar përmbledhtas në temat kushtuar Epirit (Kreu II) dhe fshatrave të Bregdetit Jugor (Kreu V). Prandaj këtu do të kufizohemi vetëm në disa emra njerzish tipikë, që dëshmojnë për një vazhdimësi të pandërprerë të popullsisë autoktone shqiptare në trevat e tyre të sotme në *Gjirin e Vlorës*. E për këtë qëllim do të nisemi nga periudha e dokumentuar historike, për t'u ngjitur shkallë-shkallë në periudhat më të hershme. Dhe po e nisim me periudhën e pushtimit osman të Shqipërisë, kur turqit për qëllimet e tyre pushtuese bënë regjistrime të herëpashershme të popullsisë së viseve të pushtuara. Dhe ndër emrat e banorëve të qytetit të *Vlorës* dhe të *Kaninës* në këto regjistrime dalin rregullisht edhe disa emra të vjetër tipikë shqiptarë, si: *Gjon, Gjini, Gjiki, Gjergj, Pal* etj., që ndeshen edhe në regjistrimet osmane të popullsisë së viseve të tjera të Shqipërisë Jugore dhe Veriore.

17. Emrat *Gjon* dhe *Gjini*, siç u shtjellua në temën kushtuar Epirit, kanë të njëjtin burim dhe përfaqësojnë trajtat shqiptare të një emri të krishterë me origjinë hebraike, që është përhapur nëpërmjet romakëve në të gjitha gjuhët e Europës dhe më gjerë. Emri *Gjon* ndeshet edhe sot në qytetin e *Vlorës* dhe në rrethinat e saj, madje kryesisht ndër banorë myslimanë. Mjafton të kujtojmë këtu se në fshatin Tragjas *Gjon* në brezin e vjetër ndeshet edhe si emër personi edhe si emër fisi, si p.sh. *Gjovarfi* < *Gjon Varfi* etj. Në Tragjas kishte edhe një lagje me emrin *Mehmet Gjoni*.¹⁷⁸ Natyrisht, ky emër dëshkohet relativisht më dendur në defterët e regjistrimit të popullsisë të periudhave të ndryshme të sundimit osman dhe kuptohet vetiu që

¹⁷⁸ Shih P. Thëngjilli: 2005, f. 45. Po në këtë botim, f. 73 ndeshet edhe emri *Abdullah Gjoni* në Goricë.

dikur ai është përdorur nga pjesa e krishterë e popullsisë. Por edhe midis të krishterëve të Jugut në përgjithësi, nën ndikimin e kishës greke, kishin nisur prej kohësh të përhapëshin trajtat greke si *Jani, Jorgo, Pavllo* etj. në vend të trajtave të vjetra shqiptare *Gjon, Gjin, Gjergj, Pal* etj. Kështu, në regjistrin turk të vitit 1520 për qytetin e Vlorës, ashtu si për qytetin e Gjirokastrës¹⁷⁹, emrat *Gjon* dhe *Gjin* ndeshen më rrallë, kurse për qytetin e Kaninës ndeshen disi më dendur. Edhe më dendur ndeshen këta emra në regjistrimet turke për fshatrat e Bregdetit (Himarë, Dhërmi e Palasë), si edhe për fshatin Goranxi e Sipërme etj.¹⁸⁰ Gjithsesi, në regjistrimin turk të vitit 1520 në qytetin e Vlorës ndeshet, ndër të tjera: *Gjon* Mostura, ndërsa në qytetin e Kaninës ky emër ndeshet disi më shpesh: *Jorgo Gjon-i, Gjon Spiri, Andria Gjon-i, Gjon Miho, Kalo Gjon-i, Gjon Nikolla, Gjon Dhimo, Gjon Boriq-i*¹⁸¹

18. Vlen të shënohet se emri *Gjon* në rrethin e Vlorës ka lënë gjurmë edhe në toponimi. Kështu, emri i fshatit *Gjorm* në Defterin e regjistrimit osman të vitit 1431 shënohet në trajtën *Gönemi* [= Gjonëm-i] si një vendbanim i vilajetit të Kaninës me 13 shtëpi. Por po në këtë defter për të njëjtin Vilajet të Kaninës shënohen edhe dy vendbanuime të tjera me emrin *Gönemi* me 25 shtëpi si edhe *Gönemi* me 38 shtëpi 1431.¹⁸² Por sot në rrethin e Vlorës ka vetëm një fshat me emrin *Gjorm*. Në këtë rast kemi të bëjmë me një trajtë të evoluar të toponimit *Gjonëmi*, ku ruhet /-n-/-ja ndërzanore e paevoluar në /-r-/¹⁸³. Të kihet parasysh se në të njëjtin regjistrim

¹⁷⁹ Për qytetin e Gjirokastrës shih Duka: 2002.

¹⁸⁰ Për fshatrat e Bregdetit të Poshtëm shih Demiraj: 2004, f. 253v.

¹⁸¹ Shih IBOA, Defteri nr. 99, f. 9, 44, 46, sipas një kumtimi miqësor të historianit prof. Ferit Duka.

¹⁸² Shih Inalcik: 1987, f. 38, 51, 55.

¹⁸³ Për lidhjen e emrit të fshatit *Gjorm* me emrin vetjak *Gjon* shih Çabej: 1956, faqe 127. Por në këtë rast mbetet për t'u sqaruar koha kur ka ndodhur rotacizmi *Gjonëm* > *Gjorm*. Në rast se ka ndodhur pas regjistrimit të vitit 1431, atëherë kjo dukuri nuk është zhvilluar me rrugë fonetike, por analogjike, sepse rotacizmi si dukuri fonetike i takon periudhës parasllave të shqipes (shih Demiraj: 1996, 2242v.)

janë shënuar edhe dy vendbanime të tjera me të njëjtin emër dhe pikërisht *Gönöma* [Gjon-ëm-a, sot Gjormë] në vilajetin e Pavllo Kurtikut [= Kërrabës] dhe *Gönömi* [= Gjon-ëm-i] në vilajetin e Krujës¹⁸⁴. Në këtë rast bie në sy se për fshatrat e Vlorës dhe të Krujës regjistruesi ka përdorur nyjën shquese /-i/ të rasës emërore njëjës të gjinisë mashkullore, kurse për fshatin e vilajetit të Kërrabës ka përdorur fundoren /-a/, që duhet të jetë trajta femërore e së njëjtës nyjë të rasës emërore njëjës.

19. Edhe emri *Gjin*, që mbahet si një variant i emrit *Gjon*, është edhe më tipik për viset e banuara nga shqiptarët, sepse ai nuk ndeshet në asnjë gjuhë tjetër. Ky emër në viset jugore përdoret edhe më dendur me prapashtesën /-kë/: *Gjikë* < *Gjin-kë*. Mjafton të kujtojmë këtu fisin e *Gjikajve* të qytetit të Vlorës dhe atë të fshatit Tërbaç. Edhe ky emër për qytetin e Vlorës dhe rrethinat dëshmohet në defterët e regjistrimit osman të periudhave të ndryshme. Kështu, në disa regjistra të fundit të shekullit XIX dhe të fillimit të shekullit XX, gjejmë: Gjergj *Gjini* Palasa, Kostandini i biri i *Gjikës* nga Poliçani, Llambi Jorgji *Gjika* nga Poliçani, Mino Thanas *Gjika* nga Poliçani, Qiric *Gjini* nga Palasa.¹⁸⁵

Ky emër ndeshet disi më dendur në defterin e regjistrimit osman të vitit 1520 si në qytetin e Vlorës edhe në Kaninë. Kështu në atë defter gjejmë, ndër të tjera, për qytetin e Vlorës: Jani *Gjin-i*, *Gjin* Kolsh-i, *Gjin* Strati, ndërsa për qytetin e Kaninës gjejmë, ndër të tjera: Sima *Gjin-i*, *Gjin* Dhimo, *Gjin* Todr-i, *Gjin* Deda, *Gjin* Maranx-i.¹⁸⁶

20. Prania e këtyre emrave dhe e emrave të tjerë shqiptarë edhe në defterët e regjistrimit osman të shekujve të mëparshëm dëshmon qartë se turqit në *Vlorë*, *Kaninë* dhe në atë krahinë në përgjithësi kanë gjetur një popullsi kryesisht shqiptare,

¹⁸⁴ Shih Inalcik: 1987, f. 93 dhe 103. Në f. 120 të këtij botimi gjejmë edhe emrin *Dimitri Gjonëma*.

¹⁸⁵ Shih P. Thëngjilli: 2005, f. 73, 80, 86, 87, 88, 93.

¹⁸⁶ Shih IBOA. Defteri nr. 99, f. 5, 8, 9, 44, 6, gjithnjë sipas kumtimit miqësor të prof. Ferit Dukës.

e cila i kishte trashëguar këta emra nga të parët e vet. Dhe është e njohur tradita e vjetër e shqiptarëve dhe e popujve të tjerë për të përjetësuar të parët e tyre nëpërmjet emrave të gjyshërve e të stërgjyshërve. Natyrisht, edhe në rastin tonë gjatë shekujve në emërtimin e fëmijëve nuk kanë munguar edhe ndikimet e gjuhëve të tjera. Kështu p.sh. në vend të trajtës së vjetër shqiptare *Gjon* në viset jugore gjatë shekujve të fundit, nën ndikimin e greqishtes, është përhapur shumë trajta *Jani*. Gjithsesi, përdorimi i trajtave të vjetra të emrave të tillë si *Gjon*, *Gjin* etj. gjatë shekujve në qytetin e *Vlorës* dhe rrethinat nuk mund të vështrohet i shkëputur nga përdorimi i tyre në viset e tjera të Shqipërisë Jugore, sidomos të Bregdetit Jugor shqiptar në përgjithësi (shih për këtë temën përkatëse në Kreun V të këtij libri). Prania e këtyre emrave dhe e emrave të tjerë të lashtë të trashëguar brez pas brezi, si edhe disa dukuri të vjetra gjuhësore të dialektit jugor të shqipes, siç janë evolucioni /-a-/ /-ë-/ para bashkëtingëlloreve hundore (si *nënë* <*nanë*, e *ëma* <*e ama* etj.), rotacizmi (si *Vlorë* <*Aulona*, *zër-i* <*zan-i* etj.) etj. dëshmojnë qartë për praninë e pandërprerë të popullsisë vendëse në këto vise, ku gjuha amtare është folur brez pas brezi, me gjithë trysninë e ushtruar nga gjuhë të tjera, si: greqishtja, latinishtja, sllavishtja dhe italishtja (venecianishtja). E kjo gjuhë amtare ka qenë mbizotëruese edhe në kohët më të vështira të sundimit të huaj, siç ishte periudha e gjatë e pushtimit romak, kur latinishtja si gjuhë zyrtare e administratës dhe e kolonëve romakë, si kudo në Ballkan dhe në Europën Perëndimore, edhe këtu duhet të ketë pasur një të përhapur të gjerë. Madje, mund të mendohet se në qytetin e *Vlorës* dhe në *Orik* duhet të jenë vendosur edhe kolonë romakë. Por popullsia vendëse, e përtëritur vazhdimisht edhe me të ardhur nga fshatrat përreth, mundi ta ruante gjuhën amtare. Gjithsesi, ndikimi i latinishtes këtu, ashtu si edhe në viset e tjera të Ballkanit Perëndimor, erdhi e u dobësua pas ndarjes së Perandorisë Romake në dy pjesë në fund të shekullit IV. Siç dihet, viset e banuara nga të parët e shqiptarëve mbetën nën juridiksionin e Perandorisë Romake Lindore a Bizantine, në të cilën latinishtja si gjuhë zyrtare erdhi e u zëvendësua nga greqishtja¹⁸⁷, e cila ishte edhe gjuha kishtarë e ortodoksizmit.

¹⁸⁷ Greqishtja e zëvendësoi latinishten si gjuhë zyrtare në Perandorinë Bizantine aty nga shekullit VI i erës sonë (shih Mihăescu: 1978, f. 55.).

21. Por në Gjirin e Vlorës dhe pikërisht në veriperëndim të qytetit dhe shumë afër tij ndodhet edhe një fshat me emrin *Nartë* me një popullsi greqishtfolëse, dhe në jug të lagunës së atij fshati, ndodhet gadishulli i *Zvërnecit*, ku banorët flasin greqisht dhe vllahisht. Në një ishull të vogël aty pranë ka edhe një manastir kallogjerësh, që si gjuhë të përditshme përdorin greqishten. Emri i fshatit të *Nartës* a *Artës* na kujton atë të *Artës* a *Nartës* së gjirit të *Ambrakias* (shih II, § 35). Pas gjithë gjasash, duhet të ketë ndonjë lidhje historike midis banorëve të parë të këtij fshati dhe zonës së qytetit të vjetër të *Artës* a *Nartës* në gjirin e *Ambrakias*. Edhe trajta e përbashkët *Nartë* (me nistoren /N-/ nuk duhet të jetë një rastësi. Madje, sipas Hammond-it (1967, f.131), banorët e *Nartës* a *Artës* së *Vlorës* e quanin fshatin e tyre *Palioarta* (= *Arta* e vjetër), ndoshta në bazë të një tradite gojore për të përkujtuar prejardhjen e një pjese të tyre nga zona e *Artës* a *Nartës* së gjirit të *Ambrakias*. Mirëpo M. B. Hatzopoulos-i në punimin “The boundaries of Hellenism in Epirus during Antiquity” (1997, f.145) mendon ndryshe. Sipas tij (f.145), “Është krejt rastësi që në kohën e sotme fshatrat greqishtfolëse më veriore janë *Arta* dhe *Zvërneci* në Gjirin e Vlorës - mbeturina të izoluara të horikioive dhe balaitajve të lashtë. Pra, sipas këtij autori, banorët e parë të këtyre dy fshatrave e kanë prejardhjen nga njerëz të mërguar prej fisit të *balaitajve*, që banonin “në prapatokën e Apolonisë”, d.m.th. afër kufirit verior të Epirit (shih Ceka: 1987, f.53, Hammond: 1997, f.55 dhe P. Cabanes: 1997, f.89) dhe prej fisit të *horikioive*. Me sa duket, me këta të fundit ai ka pasur parasysh fisin e *orikioive*, që përmend Hammond-i (1967, 609 dhe 817) si banorë të qytetit a të zonës së *Orikut* në Gjirin e Vlorës (shih §§ 1 dhe 6). D. m. th., sipas Hatzopoulos-it, banorët e *Nartës* së Vlorës duhet të jenë pasardhës të një popullsie mjaft të vjetër greqishtfolëse. Një gjë e tillë duhej argumentuar jo vetëm historikisht por edhe gjuhësisht, sepse ky studiues nuk jep ndonjë burim, që të vërtetojë se banorët e parë greqishtfolës të *Nartës* së *Vlorës* janë shumë të hershëm dhe se fiset e lartpërmendura të *orikioive* dhe të *balaitajve* flisnin greqisht në kohën kur një pjesë e tyre, sipas tij, duhet të jenë shpërngulur për në fshatin *Artë* a *Nartë*. Ai nuk jep as ndonjë sqarim për emërtimin e këtij fshati, që përkon me emrin e *Artës* a *Nartës* të gjirit të *Ambrakias*. Në këtë rast ai në shënimin 97 i

referohet Hammomnd-it (1967, f.131-132), i cili aty (f. 132) pohon vetëm: “Ka të ngjarë që Arta në lashtësi ishte një vend i hapët, ndoshta me disa fortifikime.” Pra, Hammond-i aty nuk bën ndonjë pohim si ai i Hatzopoulos-it, megjithëse vë në dukje se në muret e të dyja kishave të fshatit *Nartë* ai kishte vënë re edhe disa relike të vjetra. Por prania e këtyre relikeve në ato kisha nuk dëshmon për vjetërsinë e madhe të atyre faltoreve, për ndërtimin e të cilave mund të jenë përdorur edhe materiale të vjetra të gjetura në vende të tjera rreth e rrotull. Të kihet parasysht gjithashtu se Hammond-i si qytetin e *Orik*-ut ashtu edhe banorët e tij, *orikioi*, i shkruan me nistoren /O-/, që në këtë rast përfaqëson shkronjën greke *omega* të prirë nga aspiracioni i butë (πνεῦμα ψιλόν) /Ω-/, ashtu siç paraqiten edhe nëpër burime të tjera, dhe jo me nistoren Ho-, siç bën Hatzopoulos-i, sepse në një rast të tillë *omega* greke do të ishte prirë nga një aspiracion i ashpër (πνεῦμα δασύ) /Ω-/.

22. Gjithsesi, pohimi i Hatzopoulos-it del i pambështetur, edhe sikur të pranohej pa asnjë rezervë që fisi i *orikioive* dhe ai i *balaitajve* të kenë qenë të helenizuar në lashtësi, çka është e dyshimtë, për të mos thënë e pasaktë. Për këtë çështje, për të cilën shih vërejtjet e bëra në Kreun II, § 13 lidhur me gjuhën amtare të Epirit në lashtësi, si edhe në Kreun III, § 2 lidhur me përhapjen e greqishtes në “kolonitë” greke të lashtësisë, nuk e shohim të nevojshme të ndalemi këtu përsëri. Por nuk mund të mos ritheksojmë se fakti që mbishkrimet greke në trevat jogreke, si p.sh. ai i pllakës prej bronzi i *Balaitaj*-ve në shek. II para erës së re (shih për këtë Ceka: 1987, f.92-93) etj. nuk dëshmojnë se popullsia vendëse atje fliste greqisht, por se greqishtja, para përhapjes së latinishtes, ishte bërë, si të thuash, gjuha e shkruar zyrtare e qarqeve administrative (shih edhe II, §§ 5, 12). Gjithashtu do pasur parasysht se banorët greqishtfolës të *Nartës* (dhe të *Zvërnecit*), po të kishin qenë aq të hershëm, nuk do të mund ta kishin ruajtur greqishten gjatë shekujve, ashtu siç nuk e kanë ruajtur edhe “kolonistët” e vjetër grekë të *Orikut*, të *Aulonas*, të *Apolonias*, të *Epidadmosit* etj., ku nuk ka mbetur ndonjë greqishtfolës i lashtësisë. Për më tepër, të kihet parasysht edhe se *Narta* ndodhet fare afër qytetit të *Vlorës*, ku banorët e atij fshati shisnin peshk, kripë, verë etj. në shkëmbim të mallrave të tjera, dhe është e rrethuar nga fshatra shqipfolëse. Këto rrethana të bëjnë të mendosh

që stërgjyshërit e banorëve greqishtfolës të *Nartës* (dhe të *Zvërmecit*) duhet të jenë të ardhur aty në kohë relativisht jo të hershme për arsye që mbeten për t'u hulumtuar. Gjithsesi, *Arta* a *Narta* e *Vlorës* është patjetër e një periudhe më të vonë se *Arta* a *Narta* e *Ambrakias*, e dëshmuar, të paktën, qysh nga shekulli VI para erës së re (shih II, § 35). Kurse në vendin, ku ndodhet *Arta* a *Narta* e *Vlorës* në lashtësi, siç u përmend pak më sipër, nuk dëshmohet ndonjë vendbanim. Të kihet parasysh edhe se vendi, ku ndodhet ky fshat, pranë një lagune, ku qysh prej kohësh të lashta është prodhuar kripë, nuk duhet të ketë qenë i përshtatshëm për ndërtimin e ndonjë skele, aq më shumë kur dihet se në *Gjirin e Vlorës* ishin ndërtuar skela në *Orik*, *Vlorë* e *Treport*.

23. Por sot për sot nuk mund të thuhet asgjë me siguri se kur është themeluar fshati greqishtfolës i *Artës* a *Nartës* së *Vlorës*. Sipas një kumtimi miqësor të Ferit Dukës, në defterin osman të livasë së *Vlorës* nr. 24 të vitit 1506, që i fotokopjuar ndodhet në Arkivin e Institutit të Historisë, Tiranë (Dosja L. 601, f. 3), përmendet fshati *Narda* (= *Narta*) në vartësi të *Vlorës* me shtëpi 68, beqarë 11 dhe të veja 3. Edhe në defterin e hollësishëm osman të livasë së *Vlorës* të vitit 1520, që ruhet gjithashtu i fotokopjuar në Arkivin e Institutit të Historisë (Dosja L. 7 + 33, faqe 16), po në atë fshat dalin të regjistruar 80 kryefamiljarë. Kurse në defterin osman të Livasë së *Vlorës* për vitin 1583, që i fotokopjuar ndodhet gjithashtu në Arkivin e Institutit të Historisë, në fletën 19/b përmendet fshati *Narda* [= *Narta*] me 36 kryefamiljarë. Në bazë të këtyre të dhënave del se ai fshat duhet të jetë themeluar para vitit 1506 dhe se banorët e tij më 1583, në krahasim me vitin 1506 dhe me vitin 1520 ishin pakësuar. Por nuk mund të thuhet asgjë me saktësi se kur është themeluar fshati *Nartë*, i cili në defterët osmanë del i regjistruar me trajtën *Narda*, ku bashkëtingëllorja e pazëshme /-t-/ është shenjuar me gjegjësen e saj të zëshme nga regjistruesit osmanlli. Ndoshta familjet e para të tij do të jenë sjellë a do të kenë ardhur vetë për të punuar në kriporet pranë atij fshati nga vise më jugore si *Arta* a *Narta* e gjirit të *Ambrakias*. Por pjesërisht ata do të kenë ardhur edhe nga fshatra të tjera më të afërta, siç mund të nënkuptohet nga mbiemri (llagapi) *Palas-a*, që del në defterin osman të vitit 1520 (shih pak më poshtë).

Për të pasur një ide më të qartë për banorët e këtij fshati më 1520 dhe më 1583, po japim këtu listën e plotë të emrave të kryefamiljarëve, sipas defterëve osmanë përkatës, të transkriptuar nga Ferit Duka:

Më 1520: Jorgji Kakaliç-i, Dhimo Bogdan-i, Jani Palas-a, Todër Tërbar-i, Paskal Tërbar-i, Mihal Papamihal-i, (I) Zgur Rapun-i, Anastas Luka, Miho Kakaliç-i, Niko Psara, (I) Stamad Rapun-i, Jorgji Pekardho, Leso Pekardho, (I) Zgur Pekardho, Hristo Bogdan-i, Mihal Dhimo, Bozhimir Dhimo, Todër Jorgji, Dhimo Odema, Hristo Miho, Dhimo Uzkan, Todër Uzkan, Jani Uzkan, Niko (I) Kseno, Duka Dede, Jani Duka, Qirjaq Duka, Qirjaq Milo, Qirjaq Lasku, Miho Rapun-i, Milo Rapun-i, Dhimo Nako, Foto Makri, Milo Gjergo, (I) Stamad Kaljo (?), Bagraç Palas-a(i), Jorgji Thoma, Kosta Thoma, Jani Thoma, Theodhozi (I) Skatan-i, Jorgji Papamihal-i, Vasil Papamihal-i, Duka Jorgji, (I) Stefan Çani, Duka Thoma, (I) Strat Duka, Bozhimir (I) Stapo, Jani Bozhimir-i, Nikolla Bozhimir-i, Dhimo Aleks, Vaso Açar-i, Vaso Potora, Kosta Potora, Dhimo Açani, Nikolla Çullo, Jorgo Luka, Jani Kseno (Osto?), Dhimo Kseno (Osto?), Jani Niqifor-i, Nako Kakaliç-i, Jorgo Vaso, Merkondi Aktar-i, Mihal Bogdan-i, Mihal Vasil-i, Thomko Makri, Niko Sopi, Pozhimir (Porkir?) Kamashefi (?), Nikolla Uzkan, Dhimo Vaso, Niko Kakaliç-i, Dhimo Potera, Sheno (I) Strabar-i, Dhimo Duka, Jorgo Shirman-i, (I) Stamad Palasa, (I) Stefano Palasa, Jorgji Niqifor-i, Bozhimir (Borkir?) Kaljo, Jani Vidhimo, Nika (I) Stamo.

Më 1583: Seno Dhimo, Niko Simo, Nikolla Dhimo, Kalidhi (?) Deda, Vaso Lito, nga Maura, Jani LLaq-i, Duka Nedelko, Vasil Jorgji, Jani Kukri, Miho Teodor-i, Kalonari Jani, Malo Bozhiq-i, Sandri Dhimo, Jano Paska (Çashka?), (I) Zgur Dhimo, Marid Niko, (I) Stavre Jorgji, Agushi Ruli, Jorgji (I) Stanko, Qirko Zara, Todër Nikolla, Miho Niko, Jani Andoni, Sandri Nikolla, Roni (I) Stamad, Todër (I) Stamad-i, Jani (I) Stamad-i, Jorgji (I) Stamad-i, Ravena (?) Nabo, Dhimo Peronad-i, Seva Lasko, Zoti Lasko, Jani Miçure, Jorgji Bulku, Duka Hristo, Seva Mitro.

Gjithsesi, në bazë të onomastikës, që jepet në Defterin osman të vitit 1520 dhe në atë të vitit 1583, sipas transkriptimit të Ferit Dukës, banorët e *Nartës* së Vlorës si në vitin 1520 edhe në vitin 1583 mbartnin emra të zakonshëm të shqiptarëve

ortodoksë, që në përgjithësi ishin të ndikuar nga emrat gjegjës të greqishtes, por pa fundoren karakteristike greke (-s) si: *Jani Malo Bozhiq, Jani Miçure, Jani Andoni, Vasil Jorgji* (krahaso trajtat gjegjëse greke *Janis, Vasilis dhe Jorgos*) etj. Por nuk mungojnë edhe emra thjesht shqiptarë si *Agushi Ruli, Jorgji Bulku, Duka Dede*. Gjithashtu edhe prania e disa tingujve, që i mungojnë greqishtes së re, si /b, ç, d/, te disa emra të këtij fshati atëherë (shih shembujt këtu më sipër), dëshmon qartë për origjinën jogreke të bartësve të tyre.

Por përdorimi i greqishtes nga banorët e këtij fshati mbetet për t'u sqaruar historikisht nëse është i kryehershëm apo është pasojë e ndonjë faktori të jashtëm, që mbetet për t'u hulumtuar. Po të ketë qenë i kryehershëm, atëherë ka të ngjarë që një pjesë apo të gjithë banorët e parë të këtij vendbanimi jo të hershëm të kenë ardhur a të jenë sjellë nga zona e Nartës a Artës së Ambrakias në një kohë kur popullsia e atjeshme kishte nisur të helenizohej (shih për këtë dukuri II, § 36). Gjithsesi, kjo çështje, që mbetet e hapur, kërkon hulumtime të mëtejshme për të krahasuar edhe tipin nëndialektor të greqishtes së këtij fshati me ato të nëndialekteve të greqishtes, sidomos të greqishtes mesjetare.

24. Në përfundim të këtij kapitulli kushtuar gjuhës amtare të popullsisë në vendbanimet e *Gjirit të Vlorës* gjatë shekujve, mund të pohohet se, me përjashtim të *Nartës* dhe të *Zvërmecit*, gjuha shqipe, me gjithë rrebeshet e kohëve të ndryshme, mundi të mbijetonte ashtu si në viset e tjera të banuara nga të parët e shqiptarëve në përgjithësi, duke zhvilluar edhe ato dukuri që janë karakteristike për dialektin jugor të shqipes. Faktorët kryesorë, që kanë bërë të mundur ruajtjen e gjuhës shqipe në rrymë të shekujve e sidomos gjatë pushtimit romak, i kemi shtjelluar në Kreun IV të këtij libri. Në rastin e *Vlorës* dhe të qyteteve bregdetare të Shqipërisë për ruajtjen e gjuhës amtare të trashëguar brez pas brezi një rol të rëndësishëm ka luajtur edhe përtëritja e herëpashershme e popullsisë me të ardhur nga fshatrat e krahinave përkatëse sidomos pas ndarjes së Perandorisë Romake, kur viset shqiptare mbetën në zonën periferike të Perandorisë Bizantine, e cila në këto vise nuk mund të ushtronte më ndikimin asimilues të dikurshëm të Perandorisë së Romës.

Kreu i shtatë

Rreth fshatrave të *Dropullit* e të *Vurgut* dhe banorëve të tyre gjatë shekujve

1. Fshatrat e luginave të *Dropullit* dhe të *Vurgut* të Delvinës në gjendjen e sotme të popullsisë së tyre paraqiten si ishuj gjuhësorë greqishtfolës të rrethuar nga fshatra shqipfolëse. Prania e një popullsie greqishtfolëse në ato fshatra paraqit disa pikëpyetje, që kërkojnë shpjegim. Në radhë të parë, duhet sqaruar se cila ka qenë gjuha amtare në ato fshatra gjatë shekujve të mëparshëm dhe si shpjegohet mbizotërimi i greqishtes në popullsinë e tyre. Në rastin e *Dropullit* paraqit interes edhe sqarimi i burimit të këtij emri vendi. Dhe po e nisim pikërisht me këtë çështje, aq më shumë që në këtë kapitull vëmendja kryesore do të përqendrohet më fort në fshatrat e kësaj luginë.

2. Për emrin e luginës së *Dropullit*, që sot banohet kryesisht prej një popullsie greqishtfolëse, të shpërndarë në 33 fshatra, janë dhënë tri shpjegime: 1. *Dropull*<*Drinó-polis* “qytet i Drino-s”; 2. *Dropull*<*Hadrianoú-polis* “qytet i Hadrianit”; 3. *Dropull*<*drynós-polis* “qytet i listë a prej lisi”. Etimologjia e parë është parashtruar nga Çabej¹⁸⁸. Sipas këtij studiuesi, lugina e *Dropullit* e ka marrë emrin nga lumi *Drino*, që e përshkon këtë zonë dhe është zhvilluar nga një **Drinopull*, **Drnopull*, **Drropull*, greqisht *Dhrinópolis*. Kurse studiues të tjerë e lidhin emrin e *Dropullit* me emrin e perandorit romak *Hadrian-us* (76-138), i cili, sipas tyre, në shekullin II të erës së re e pat themeluar atë qytet duke i dhënë edhe emrin e tij *Hadriano(u) polis* “Qytet i Hadrianit”. Etimologjia e dytë, e cila është historikisht më e mbështetur, është përkrahur nga Hammond-i, Cabanes-i etj. Sipas Hammond-it¹⁸⁹, “Emri *Dhropull* është marrë nga emri bizantin i peshkopatës së krishterë të

¹⁸⁸ Shih Çabej, E. *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, vëll. III (Tiranë 1987), f. 319.

¹⁸⁹ Shih Hammond, N. G. L. *Epirus*, Oxford 1967, f. 31.

Druinopolisit, që është një korrupsim i Hadrianopolis-it”. Sipas Cabanes-it¹⁹⁰, *Hadrianopolis*-i ishte një koloni romake, “që ishte themeluar në shekullin II pas Krishtit afër Gjirokastrës së sotme”. Kuptohet se është fjala për një “koloni” të themeluar në kohën e perandorit romak Hadrianus (117-138), nga i cili e ka marrë emrin ai qytet-koloni, rrënojat e të cilit (një theatër, nekropoli etj.) janë zbuluar në katundin e sotëm të Sofratikës, pranë Gjirokastrës nga A. Baçe¹⁹¹. Do pasur parasysh se është fjala për një vendbanim më të hershëm që, kur u emërtua *Hadrianopolis*, kishte marrë përmasat e një qyteti. E banorët më të hershëm të atij vendbanimi, pas gjithë gjasash, nuk kanë qenë etnikisht të ndryshëm nga banorët e tjerë të ashtuquajturit *Epir*. Kurse hipoteza e tretë, e cila nuk ka ndonjë mbështetje historike, është parashtruar në një dorëshkrim në formën e një “*kronike*”, që i dha në Gjirokastrë më 1806 peshkopi i Drinopolit konsullit francez pranë Oborrit të Ali pashë Tepelenës, Pouqueville, i cili e botoi atë në fund të vëllimit V të veprës së tij *Voyage dans la Grèce* bashkë me përkthimin frëngjisht më 1821¹⁹². Ky dorëshkrim, të cilit i mungon edhe fillimi edhe fundi, si edhe emri i autorit, sipas Pouqueville-it (*vep. e përm. f. 357*), duhet të jetë shkruar aty nga fillimi i shekullit XVII. Sipas të dhënave të kësaj “*Kronike*”, banorët e parë të *Dropullit* ishin një grup të shpërngulurish nga Athina për arsye të paqarta në një kohë mjaft të hershme, por të papërcaktuar. Ata pas disa peripecish qenkëshin vendosur në disa vise të pabanuara të luginës së *Dropullit* të sotëm, ku për 64 vjet paskëshin jetuar duke u ushqyer me mjaltin, që bletët e egra depozitonin nëpër zgavrat e lisave të pyjeve dhe vetëm pastaj, pas disa konfliktesh me popullsinë vendëse (molosët dhe ajdonatët), paskëshin filluar të mbillnin bimë ushqimore. Ata, sipas kësaj “*Kronike*”¹⁹³, më në fund paskëshin themeluar edhe një vendbanim a qytet, të cilit i paskëshin vënë emrin

¹⁹⁰ Shih Cabanes, Pierre. *Epirus in the Roman period*. Në: *EPIRUS. 4000 years of Greek history and civilization*. Athens 1997, F. 127.

¹⁹¹ Shih Baçe, Apollon. *Sofratikë*. Në “*Iliria*” 2/1983, f. 256.

¹⁹² Shih Pouqueville, F. -C., -H., *Voyage dans la Grèce.*, vol. V, Paris 1821, 318-355.

¹⁹³ Shih Pouqueville, *po aty*, f. 318.

Druinópolis “qytet prej lisi a lisash” nga greqishtja *dryínos*¹⁹⁴ “i lis-të, prej lisi” dhe *polis* “qytet”. Ky shpjegim në trajtë legjende, pa ndonjë mbështetje dokumentare historike, nuk është përfillur nga studiues të tillë si Hammond-i, Cabanes-i etj. Siç shihet, ky shpjegim i fundit është i mbuluar me një vello misteri, që është vështirë të ndriçohet historikisht. Për më tepër, në atë “*Kronikë*” ka edhe disa elemente të tjera, që nuk e mbështetin lashtësinë e një shtegtimi të tillë të supozuar. Aty flitet, ndër të tjera, edhe për një udhëheqës të atyre të shpërngulurve me emrin *Titos*, i cili, pas themelimit të *Druinopolit*, shkoi e themeloi në grykën e afërt alvanite [= shqiptare] një kështjellë, që e quajti *Titupolis*, “që tashti quhet Tepeleni”. Aty flitet gjithashtu për themelimin e një qyteti me emrin *Albiupolis* “sot Albasani” nga njëfarë *Albas* (!).¹⁹⁵

Prandaj, nga tri shpjegimet e mësipërme më i mbështetur del ai sipas të cilit zona e *Dropullit*, që përfshin fshatra në të dyja anët e lumit *Drino* në afërsi të Gjirokastrës e të Libohovës, e ka marrë emrin nga qyteti *Hadriano(u) polis*, i cili duhet të ketë qenë një qendër e rëndësishme administrative dhe ekonomike e asaj zone dhe dikur aty ka pasur edhe një peshkop.¹⁹⁶ Emërtimi i një qyteti sipas emrit të një personazhi të caktuar nuk është një dukuri e panjohur në historinë e popujve. Mjafton të kujtojmë këtu *Konstantinopolin* (Stambollin e sotëm) apo *Petersburgun*

¹⁹⁴ Nuk është e qartë se si duhet ta ketë shqiptuar autori i kësaj “*Kronike*” shkronjën greke *delta* në këto fjalë, si mbylltore (okluzive) të zëshme /d-/ apo si fërkimore (frikative) të zëshme /dh-/, sepse greqishtja qysh para erës së re okluzivet e zëshme kishte nisur t’i shqiptonte si fërkimore të zëshme (shih Rix: *Historische Grammatik des Griechischen*. Darmstadt 1976, f. 83). Si rrjedhim, në greqishten e sotme mungojnë okluzivet e zëshme /b, d, g/, të cilat në rast nevoje riprodhohen me anë dyshkronjëshash, përkatësisht /mp, nt, gk/.

¹⁹⁵ Shih Pouqueville, *po aty*, f. 320, 322. Nuk po ndalemi më gjatë në të dhënat e kësaj “*Kronike*”, e cila, me sa duket, është shkruar nga një njeri pa një qartësi për zhvillimin e ngjarjeve historike. Të kihet parasysh se Pouqueville-i nuk e ka riprodhuar këtë “*Kronikë*” në asnjë nga të gjashtë vëllimet e botimit të dytë të veprës së tij me titullin *Voyage de la Grèce, revue, enrichie et augmentée*. Paris 1926-1927.

¹⁹⁶ Shih Hammond, *vep. e përm.*, f. 195.

etj. Për temën tonë në këtë rast ka më shumë rëndësi të hetohet se në cilën gjuhë (në greqishte apo në gjuhën e stërgjyshërve të shqiptarëve) ka ndodhur ndryshimi aq i madh fonetik midis trajtës burimore *Hadriano(u)polis* dhe trajtës së sotme *Dropull* (në greqishte *Dhropolis*). E kjo vërejtje vlen edhe sikur të pranohej që lugina e *Dropullit* ta ketë marrë emrin nga qyteti *Drino-polis*, emërtuar kështu nga lumi *Drino*, siç mendon Çabej.

3. Evolucioni *Hadrianoupolis*>*Dropull* ose *Drinopolis*>*Dropull* (ose edhe *Drynopolis*>*Dropull*) dëshmon se një ndryshim i tillë fonetik ka ndodhur midis një popullsie shqipfolëse dhe jo greqishtfolëse për këto arsye:

1. Në gjuhën shqipe, për shkak të theksit të saj kryesisht dinamik¹⁹⁷, fjalët në përgjithësi dhe emrat e vendeve në veçanti kanë pësuar reduktime të mëdha fonetike, siç ka ndodhur, ndër të tjera, edhe me emrin e qytetit të *Berat-it*, i cili e ka burimin tek emri sllav *Belgrad*, që zëvendësoi emrin e mëparshëm të këtij qyteti në kohën e pushtimit të mbretërisë bullgare në kapërcyell të mijëvjeçarit të dytë të erës sonë¹⁹⁸. Kurse në greqishte, për shkak të theksit të saj kryesisht muzikor¹⁹⁹, fjalët e vjetra kanë pësuar më pak ndryshime.

2. Në greqishte bashkëtingëllorja mbylltore (okluzive) dhëmbore e zëshme /d/ qysh para erës së re ka evoluar në fërkimoren (frikativen) ndërdhëmbore të zëshme /dh/ (shih shën. 194), kurse shqipja gjatë shekujve i ka ruajtur të dalluara tingujt /d/ dhe /dh/. Në këtë rast të kihet parasysh edhe emri i lumit *Drino*, që në përgjithësi pranohet se ka qenë prej burimi ilir.²⁰⁰

3. Tingulli /-l-/ midis dy zanoresh në fjalët e vjetra, të trashëguara apo të huazuara, ka dhënë rregullisht /ll/ në gjuhën shqipe, kurse në greqishte një /-l-/ e ndjekur nga një zanore e përparme është shqiptuar kurdoherë si një bashkëtingëllore qiellzore.

¹⁹⁷ Shih Demiraj, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*. Tiranë, 1999, f. 45.

¹⁹⁸ Shih më hollësisht për këtë Demiraj, *Prejardhja e shqiptarëve sipas dëshmive të gjuhës shqipe* (1999), f. 129.

¹⁹⁹ Theksi kryesisht muzikor në greqishte ka mbizotëruar deri në periudhën pasklasike (shih Rix, Helmut: *Historische Grammatik des Griechischen*. Darmstadt, 1976, f. 41 v.).

²⁰⁰ Shih Çabej, *vep. e për.m.*, f. 319. v. - me literaturën përkatëse.

4. Edhe evolucioni /-o-/>/-u-/ në rrokjen e fundit dëshmon se *Dropull* ka arritur në këtë trajtë fonetike në gojën e shqipfolësve, nën ndikimin e bashkëtingëllores dybuzore paraprijëse /-p-/, kurse në greqishte një dukuri e tillë nuk ka ndodhur, si p.sh. te *poli(s)*, *politis*, *Dhropolis* etj. Për t'u bindur edhe më shumë për këtë, nuk është pa interes të përmendet këtu edhe evolucioni fonetik, që ka pësuar emri i një qyteti tjetër të vjetër homonim afër Bosforit. Është fjala për *Hadrianopol*-in e Trakisë (në pjesën europiane të Turqisë), që në gojën e grekëve ka evoluar në *Andrinopol*, kurse në gojën e turqve ka përfunduar në *Edimé*, si rrjedhim i ligjësive të evolucionit fonetik të turqishtes.

Si rrjedhim, nga dy trajtat e sotme *Dropull* (ndër shqipfolësit) dhe *Dhropolis* (ndër greqishtfolësit) burimore është e para me nistoren /D-/. Mjafton të kihet parasysh se shqipfolësit nuk do ta kishin të vështirë të huazonin trajtën greke *Dhropol- is*, sepse në gjuhën shqipe janë në përdorim edhe bashkëtingëllorja mbylltore /d/ edhe fërkimorja /dh/ (krahaso, ndër të tjera, edhe fshatin *Dhrovjan*), kurse në greqishte shkronja *delta* që, sikurse u vu në dukje pak më sipër, dikur shqiptohet si mbylltore e zëshme /d/, prej kohësh shqiptohet vetëm si fërkimore e zëshme /dh/. Prandaj greqishtfolësit e asaj zone e kanë shndërruar automatikisht nistoren /D/ në /Dh-/ shkruar /δ/ dhe rrokjen fundore *-pull* e kanë zëvendësuar me trajtën greke *polis: Dhro-polis*.

4. Por vërejtjet e mësipërme gjuhësore parakuptojnë që banorët e hershëm të luginës së *Dropullit* duhet të kenë qenë të një trangu me stërgjyshërit e shqiptarëve të viseve të tjera rreth e rrotull dhe që greqishtja e folur në fshatrat greqishtfolëse të asaj luginë është përhapur në një periudhë relativisht të vonë. Siç shihet, kemi të bëjmë me çështje të vështira për t'u sqaruar, sidomos po të kihet parasysh se gjendja e sotme gjuhësore e fshatrave të luginës së *Dropullit* duket sikur e përgënjeshton pohimin e mësipërm. Dhe në të vërtetë në shumicën e vendbanimeve të asaj luginë sot flitet greqisht. Prandaj në këtë rast mbetet për të sqaruar nëse përhapja e greqishtes në atë zonë është e hershme apo relativisht e vonë. Kjo çështje paraqitet e vështirë për t'u ndriçuar si duhet, jo vetëm sepse mungojnë dokumentet historike për të kaluarën e lashtë dhe të mesme të kësaj zone, por edhe sepse ka qenë mjaft i

përhapur mendimi i mbrojtur sidomos nga Jireçeku²⁰¹, sipas të cilit në pjesën jugore të Gadishullit Ballkanik, ku bën pjesë edhe Shqipëria Jugore, ka mbizotëruar greqishtja, ndërsa në pjesën veriore të tij ka mbizotëruar latinishtja. Megjithëse mendimi i fundit, që mbështetet në mbizotërimin e mbishkrimeve greke në Ballkanin Jugor, përkatësisht të mbishkrimeve latine në Ballkanin Verior, tashmë është kapërcyer, sepse ngatërronte gjuhën e mbishkrimeve me gjuhën e folur të popujve të Ballkanit në lashtësi, për zonën e *Dropullit*, që ndodhet afër trevave greke të mirëfillta, çështja në shqyrtim mbetet e hapur.

5. Në këto rrethana, për sqarimin e këtyre çështjeve duhen shqyrtuar me kujdes të gjitha burimet e mundshme, që lejojnë të ngjitemi shkallë-shkallë në të kaluarën. E në këtë rast të vetmin burim të sigurtë na e japin regjistrimet osmane të popullsisë së kësaj zone gjatë shekujve të parë të sundimit të tyre në vendet ballkanike. Siç dihet, turqit osmanlli, të cilët gjetën në Ballkan popuj të krishterë të lidhur në pjesën më të madhe me Kishën Ortodokse Bizantine, për qëllimet e tyre filluan herët regjistrimin e popullsisë në vendet e pushtuara prej tyre, duke shënuar si emrat e qyteteve dhe të fshatrave, ashtu edhe emrat e kryefamiljarëve, kryesisht meshkuj, por në disa raste edhe gra të veja. Regjistruesit ishin të interesuar të ishin sa më të saktë në shënimin e emrave të kryefamiljarëve, të cilët në regjistrimet e para ishin të gjithë të krishterë. E nga veçoritë gjuhësore të emrave të kryefamiljarëve në ato regjistrime nuk është e vështirë të dallohet përkatësia etnike dhe gjuha e tyre amtare në përgjithësi. Në zbatim të atij programi ata regjistruan edhe kryefamiljarët e fshatrave të *Dropullit* ku, siç do të vihet në dukje më poshtë, bie në sy prania e disa emrave tipikë shqiptarë, megjithëse nuk mungojnë edhe trajta emrash të ndikuar nga trajtat gjegjëse greke, çka është e kuptueshme, po të kihet parasysh ndikimi i madh i kishës greke-bizantine në viset e Shqipërisë Jugore në përgjithësi, sidomos në të kaluarën.

6. Deferët e parë osmanë të regjistrimit të popullsisë kanë një rëndësi të veçantë, sidomos kur është fjala për fshatrat e zonës së *Dropullit*, ku janë vërtetuar

²⁰¹ Shih Jireçek, Konstantin. *L'eredità di Roma nelle città della Dalmazi. durante il Medioevo*. A cura di Mario Capaldo. Roma 1984. Faqe 19v.

ndryshime të mëdha demografike gjatë periudhës së pushtimit osman. Për të pasur një ide qoftë edhe të përafërt për këto ndryshime, po japim më parë gjendjen e sotme të popullsisë në këtë zonë dhe pastaj do të paraqisim gjendjen e saj, ashtu siç del nga defterët e regjistrimeve të para osmane. Në zonën e *Dropullit*, sipas të dhënave të *INSTAT*-it të vitit 2001, ka sot 33 fshatra me banorë greqishtfolës dhe pikërisht: *Derviçan, Goranxi, Vanister, Haskovë, Dhuvjan, Sofratikë, Terihat, Goricë, Frashtan, Lugar, Grapsh, Peshkëpi e Sipërme, Peshkëpi e Poshtme, Glinë, Vrahogoranxi* dhe *Radat* në *Dropullin e Poshtëm* me kryeqendër *Sofratikën*; *Jorgucat, Zervat, Bularat, Bodrishtë, Kërrë, Vodhinë, Pepel, Klishar, Selo, Llovinë, Krioner, Sotire, Llongo, Koshovicë, Dritë* (ish-*Ajo Nikolla*), *Kakavie* dhe *Vrisera* në *Dropullin e Sipërm* me kryeqendër *Vriseranë*.

Kurse në Defterin e regjistrimit osman të Sanxhakut të Vlorës të vitit 1519-1520, të riprodhuar nga Ferit Duka²⁰², ndër ziametet e kazasë së Gjirokastrës së livasë së Vlorës, janë shënuar këto fshatra të luginës së Dropullit: *Goranxi e Sipërme, Qestorat, Asharat (= Isharat)*²⁰³, *Goranxi e Poshtme, Vodhinë, Korshovicë, Jorgucat, Bodrishtë* (bashkë me mëhallën *Karasilit*), *Terihat, Lugari, Goricë, Grapsh, Dhuvjan, Llovinë, Krinë, Derviçan, Haskovë, Vanishë* dhe *Sofratikë*, d.m.th. 19 fshatra.

Kryefamiljarët e këtyre fshatrave të *Dropullit* në kohën e pushtimit turk, në bazë të regjistrimeve osmane të popullsisë dalin kryesisht me emra vetjakë karakteristikë shqiptarë, si *Gjon, Gjin, Gjergj, Lekë, Pal* etj., megjithëse nuk mungojnë edhe trajtat gjegjëse të këtyre emrave të ndikuar nga kisha ortodokse greke: *Jani, Jorgo, Aleks, Pavllo* etj. Këto trajtat e fundit janë të shpjegueshme, po të kihet parasysh roli i madh i kishës ortodokse greke në Shqipërinë Jugore në përgjithësi dhe në këtë zonë në veçanti. Këtu poshtë po japim disa shembuj me emra kryefamiljarësh nga fshatrat *Goranxi e Sipërme, Goranxi e Poshtme, Derviçan* dhe *Sofratikë*.

²⁰² Shih "Studime historike" 3-4/1991 (Tiranë 1994), f. 167-199.

²⁰³ Sot Qestorat (shqipfolës).

7. Sipas regjistrimit osman të vitit 1519-1520. Në fshatin *Goranxi e Sipërme* (me 170 kryefamiljarë) trajta karakteristike shqiptare *Gjon* del 30 herë si emër vetiak apo si mbiemër (llagap): *Gjon* Sima, *Gjon* Braili, *Gjon* Petra, *Gjon* Martini (2 herë), *Gjon* Guma (2 herë), *Gjon* Tupe, *Gjon* Gjini (2 herë), *Gjon* Brati, *Gjon* Thanasi, *Gjon* Nika, *Gjon* Pali, *Gjon* Leka (2 herë), Dhima *Gjoni*, Leka *Gjoni* (2 herë), Deda *Gjoni* (2 herë), Kava *Gjoni*, Guma *Gjoni*, Sima *Gjoni*, Martin *Gjoni*, Zoja (Zota) *Gjoni*, Vreto *Gjoni*, Stamad *Gjoni*, Gjini *Gjoni*, Gjika²⁰⁴ *Gjoni*.

Po në atë fshat del shpesh (24 herë) edhe emri tjetër tipik shqiptar *Gjin*: *Gjin* Leka (2 herë), *Gjin* Dedushi, *Gjin* Dhima (2 herë), *Gjin* Gjoni, *Gjin* Isheri, *Gjin* Muzhaqi, *Gjin* Martini, *Gjin* Deda, *Gjin* Boga, *Gjin* Kondi, Lush (Losh?) *Gjini*, *Gjon* *Gjini* (2 herë), Leka *Gjini* (2 herë), Deda *Gjini*, Stoja *Gjini*, Nika *Gjini*, Andre *Gjini*, Dhima *Gjini*, Kond *Gjini*, Shtin *Gjini*. Do shënuar se ndër kryefamiljarët e atij fshati nuk del asnjë herë trajta *Jani*, e ndikuar nga greqishtja.

Po kështu edhe në fshatin *Goranxi e Poshtme* (me 151 kryefamiljarë) në të njëjtin defter osman ndeshen emrat *Gjon* e *Gjin*, si p.sh: *Gjon* Papadopulo, *Gjon* Bazhani, *Gjon* Deda, *Gjon* Kondi, *Gjin* Bazhani (2 herë), *Gjin* Ruvini, *Gjin* Kostandini, *Gjin* Nako, *Gjin* Andoni. Por këtu ndeshet më shumë trajta *Jani*.

8. Emrat *Gjon* e *Gjin* si edhe emra të tjerë shqiptarë janë të pranishëm në të njëjtin defter, diku më shumë e diku më pak, edhe në fshatrat e tjerë të *Dropullit*, duke përfshirë edhe fshatin *Derviçan* afër Gjirokastrës, që në atë defter paraqitet me një popullsi mjaft të madhe për kohën dhe që, me sa duket, ka qenë mjaft i ndikuar nga kultura greke. Kështu edhe në atë fshat gjejmë emra karakteristikë të përdorur nga shqiptarët, si: *Jani Gjini*, *Gjin* Spato, *Gjon* Jorgji, *Jorgo Gjoni*, *Nako Bard(h) i*, *Jorgo Babi*, *Mano Çuni*, *Dartho Çuni*, *Jani Çuni*, *Kosta Lula*, *Mano Shpata*, *Lluka Prushi*, *Dhimo Prushi*, *Jani Dragoi* etj.²⁰⁵ Kurse në *Sofratikë* (me 61 kryefamiljarë) del vetëm një herë emri *Gjin* (*Gjin* Pavllo), dhe dy herë emri

²⁰⁴ Edhe *Gji-kë*<*Gjin-kë* është një emër tipik shqiptar, që ndeshet dendur në Shqipërinë e Jugut jo vetëm ndër të krishterët, por (si mbiemër) edhe ndër myslimanët.

²⁰⁵ Shih Duka, Ferit, *vep. e përm. f.* 171vv. dhe 192vv.

Gjon në fund të kryefamiljarëve: “Bashtina e vejushë *Maries*, e bija e *Gjonit*, në dorën e *Gjonit*.”²⁰⁶ Në këtë fshat ka edhe emra të tjerë shqiptarë, si: *Niko Ballçi*, *Jorgo Ballçi*, *Dhimo Ballçi*, *Mano Ballçi*, *Vreto Leka*, *Niko Papileka*, *Staso Dimali*. Ndër kryefamiljarët e atij fshati mbizotërojnë emra prej burimi grek, si: *Jani*, *Jorgo*, *Pavlo*, *Aleks* etj. Por këta emra prej burimi grek si ndër kryefamiljarët e këtij fshati, ashtu edhe ndër ata të fshatrave të tjerë të *Dropullit* nuk janë shënuar me fundoren /-s/ karakteristike për emrat e greqishtes si *Janis*, *Jorgos*, *Pavlos* etj.

Të kihet parasysh se ndër emrat e përmendur në ato fshatra ka edhe të atillë, që përmbajnë bashkëtingëlloret /b/, /d/, /ç/, që i mungojnë greqishtes së re, si: *Bazhan*, *Ballçi*, *Babi*, *Çuni*, *Dimali* etj.

9. Prania e emrave tipikë shqiptarë në regjistrimet e para osmane në fshatrat e *Dropullit* dëshmon se ata banorë atje i kishin trashëguar këta emra brez pas brezi nga të parët e tyre. Mundësia që të parët e tyre të kenë shtegtuar atje dikur, në të kaluarën, dhe të kenë asimiluar një popullsi të mëparshme greqishtfolëse, përjashtohet për këto arsye: 1. Ndonjë shtegtim i tillë nuk dëshmohet historikisht, megjithëse, siç dihet, kronikanët grekë kanë qenë shumë të vëmendshëm për të shënuar lëvizje të tilla popullsish. E ashtuquajtura “*kronikë e Dropullit*”, siç u vu në dukje edhe më sipër, është pjellë fantazie. 2. Një popullsi më pak e zhvilluar, siç kanë qenë të parët e shqiptarëve, nuk mund të asimilonin një popullsi relativisht më të zhvilluar, siç kanë qenë grekët, aq më shumë kur këta kishin edhe mbështetjen e administratës bizantine dhe të kishës ortodokse greke, që si gjuhë zyrtare kishin greqishten. Siç dihet, pas ndarjes së Perandorisë Romake në dy pjesë, Perandoria e Lindjes (a Bizantine) me kryeqendër Bizantin, si gjuhë zyrtare të administratës dhe të ushtrisë dalngadalë e zëvendësoi latinishten me greqishten dhe kjo e dyta u bë mbizotëruese aty nga fundi i shekullit VI të erës sonë²⁰⁷. Edhe kisha ortodokse greke si gjuhë liturgjike kishte greqishten, sidomos pas ndarjes së dy kishave në shekullin XI të erës sonë. Dhe

²⁰⁶ Shih Duka, Ferit, *po aty*, f. 198v.

²⁰⁷ Shih Mihaescu, Haralambie, *La langue latine dans le sud-est de l'Europe*. Bucuressti - Paris, 1978, f. 55.

është një gjë e njohur që greqishtja si gjuhë liturgjike përdorej më parë jo vetëm në kishat ortodokse me popullsi greke, por edhe në ato të popullsive jogreke të Ballkanit e sidomos të Shqipërisë Jugore.

10. Si rrjedhim, nuk paraqitet shumë e vështirë për t'u sqaruar historikisht dhe gjuhësisht çështja e gjuhës së fshatrave greqishtfolëse të *Dropullit* sot. Siç u vu në dukje pak më sipër, në kohën e regjistrimeve osmane të shekullit XVI nga emrat e banorëve të atyre fshatrave duket qartë prania e elementit shqiptar, i cili duhet të ketë qenë mbizotërues, megjithëse, po të kihet parasysh pozicioni i tyre gjeografik, nuk mund të përjashtohet edhe mundësia e ndonjë elementi greqishtfolës në to. Por përhapja e greqishtes në këto fshatra i takon periudhës pas pushtimit osman, pra, është një dukuri relativisht e vonë, që kërkon shpjegim. Gjithsesi, problemi i përhapjes së greqishtes në fshatrat e *Dropullit* është i ngjashëm me atë të fshatrave greqishtfolëse të *Vurgut* të Delvinës. Prandaj po ndalemi pak edhe për këto fshatra.

11. Emrat e njerëzve me trajta tipike shqiptare ndeshen edhe në Defterin e Sanxhakut të Delvinës të vitit 1431-32 për *Vurgun*, që është quajtur kështu nga fjala e greqishtes së re *vrkos* "vend i ulët, moçalishte". Në atë defter atëherë janë dëshmuar vetëm katër fshatra: *Finiki* (Finiqi), *Vurgo*, *Jeromi* dhe *Krajna* (Kranéja) me shumë pak banorë²⁰⁸. Nga këto fshatra *Finiqi* të kujton emrin e qytetit të lashtë të kaonëve, *Phoeniks*, të themeluar aty nga shekulli V para erës së re. Edhe në ato fshatra janë dëshmuar emra tipikë shqiptarë, si: *Gjin Reçi*, *Gjin Panariti*, *Gjin Zagorino*, *Gjin Krali* (Frali), *Leka Gjini* (2 herë), *Kozha Gjini*, *Gjin Vija*, *Zhupa Gjini*, *Gjini Spiri*, *Gjin Andrea*, *Kont Gjini Andrea*, *Gjon Dorza*, *Gjon Zhurmo*, *Meksh Gjoni*, *Polimer Gjoni*, por edhe *Jani Jagop*, *Jani Katani*, *Jani Kosta*, *Jani Bogdani*, *Luka Jani*, *Jani Ispatari*, *Nika Jani* (Finiq), *Gjin Ilia*, *Gjin Pelegri*, *Gjin Kasnesi*, *Gjon Pelegri*, *Dhimo Gjini*, *Gjon Martini*, *Martin Gjoni*, *Deda Gjoni* (Krane)²⁰⁹. Vlen të shënohet se pak a shumë e njëjtë paraqitet onomastika e këtyre fshatrave edhe në defterët osmanë të vitit 1583 për Sanxhakun e Delvinës. Sa për

²⁰⁸ Shih Shkurti, Spiro: *Vurgu. Vështrim etnografik*. Tiranë 1987, f. 24.

²⁰⁹ Shih *po ai, po aty*, f. 27-29.

shembull, po përmendim këtu disa emra tipikë shqiptarë të fshatit *Finiq* në atë defter, si: *Nikë Gjoni* (3 herë), *Gjoni Duka*, *Dhimo Gjoni*, *Qirjak Gjoni*, *Gjero Gjoni*, *Jani Gjoni*, *Gjon Nikolla*, *Ilia Gjoni* (2 herë), *Gjin Nika*, *Gjin Dhimo*, *Jani Gjini* etj. Megjithatë, në këtë defter mbizotërojnë emra të ndikuar nga greqishtja, si *Jani*, *Jorgo* etj. (shih Buharaja: 1992, f.130v.)

Por, sipas Shkurtit²¹⁰, në zonën e Vurgut më 1927 gjendja ka ndryshuar shumë. Në atë vit atje janë regjistruar 25 fshatra: *Çukë*, *Pal*, *Aliko*, *Çaush*, *Tremul*, *Kasëmallajbej*, *Kaliveshush*, *Jermë*, *Halo*, *Kalivepasha*, *Krané*, *Ymerefend*, *Finiq*, *Vrion*, *Memushbej*, *Hajdëragas*, *Qenurjo*, *Karalibej*, *Vromero*, *Karahaxh*, *Mavropull*, *Metog e Gjashtë*, *Rahullë*, *Shijan*, *Muçopolit*, *Mullamus*, që në vitin 1927 kishin një popullsi të përgjithshme prej 3262 banorësh. Pra, shumica e këtyre fshatrave duhet të jenë themeluar pas regjistrimit osman të shekullit XV. Madje, sipas Shkurtit²¹¹, disa nga fshatrat e rinj të Fushës së Vurgut janë krijuar në fund të shekullit XVIII dhe në fillim të shekullit XIX. Një pjesë e mirë e banorëve të këtyre fshatrave të rinj janë sjellë si bujq nga krahina greqishtfolëse prej Omer pashë Vrionit, nga i cili ka marrë emrin edhe fshati *Vrion*²¹², si edhe prej Ali pashë Tepelenës. Por një pjesë tjetër kanë ardhur ose janë sjellë me forcë në ato zona. Për sjelljen me forcë të një pjese të kësaj popullsie në kohën e Ali pashë Tepelenës, na dëshmon edhe ish-konsulli francez në Janinë, Pouqueville-i²¹³, i cili përshkruan një episod të tillë të vitit 1815: “Karvanet, ndërresat për transportimin e plaçkave ishin rregulluar si për largimin nga afrimi i armikut. Shkëputnin nga trashëgimia e prindërve bujqit, fëmijët e tokës; shkëputnin nga vatrat e tyre gra të reja, vajza të druajtura dhe fëmijë. Tërhiqnin pleq të rënduar nga vjetët, për t’i transportuar në Aidoni, në rrethinat e orizoreve të qelbura të kënetës skëterrë, ku u premtohej se do t’u ndërtonin kasolle dhe fshatra. Ndërsa këta kolonë pleq linin pas varret e etërve të tyre, arrinin në këtë

²¹⁰ Shih *po ai, po aty*, f. 46v.

²¹¹ *Po ai, po aty*, f. 43.

²¹² *Po ai, po aty*, f. 35, 43.

²¹³ Shih Pouqueville, *Voyage de la Grèce*, vol. II (deuxième édition. Paris 1926), f. 27.

vend nga jugu i Epirit një pjesë e popullsisë së krishterë të Prevezës, grupe të tëra njerëzish nga Thesalia dhe Maqedonia, që i kishin zhvendosur si kope të ulëta, për të ripopulluar një vend, të cilin zemërimi i tiranit më hakmarrës po e shkretonte ...”

12. Sipas Spiro Shkurtit²¹⁴, një pjesë tjetër e popullsisë së fshatrave të Vurgut kanë ardhur aty nga vise shqipfolëse, kryesisht kodrinore e malore, në fillim si barinj me kopetë e tyre për kullota dimërore, por më pas janë vendosur atje përgjithmonë, ose për arsye të tjera. E një mendim të tillë e gjejmë edhe te Rami Memushaj, sipas të cilit shpërnguljet masive të popullsisë nga Kurveleshi “... vijuan edhe gjatë shekullit XVIII nga shkaku i epidemisë së kolerës që preku më 1720 krahinën, por edhe për t’i shpëtuar trysnisë islamizuese, e cila në këtë shekull arriti kulmin e vet. Shumë familje u vendosën në fshatra të pellgut të Delvinës, të Bregdetit, të luginës së Drinos etj.”²¹⁵ Një dukuri e tillë nuk ka qenë e papritur, sepse gjatë shekujve, sidomos në disa periudha, kur mbipopullimi i viseve malore e ka bërë të pamundur jetesën në ato treva, një pjesë e popullsisë ka qenë e shtrënguar të shpërngulet dhe të vendoset në vise më të ulëta, sidomos kur këto kanë qenë më pak të populluara, siç kanë qenë viset e luginës së *Dropullit* dhe të *Vurgut* të Delvinës. Dhe me kalimin e kohës ardhacakët janë përzier edhe me anë martesash me banorët greqishtfolës, të sjellë, siç u përshkrua pak më sipër, me rrugë paqësore ose me forcë. Nga kjo përzierje ardhacakët e rinj të krishterë dalngadalë janë asimiluar gjuhësisht prej popullsisë së sjellë nga viset greqishtfolëse, që ishin të të njëjtit besim ortodoks. E, siç dihet, në periudhat e mëparshme përkatësia në të njëjtën fe luante një rol vendimtar në marrëdhëniet midis njerëzve. Gjithsesi, kjo dukuri, që do të meritonte të shqyrtohej më në thellësi, po të kishim dokumentimin e nevojshëm, nuk paraqit ndonjë gjë të papritur, po të kemi parasysh faktin e njohur që në viset kufitare me Greqinë greqishtja, duke pasur edhe mbështetjen e kishës ortodokse greke, me kalimin e kohës kurdoherë ka ngadhënjyer, aq më shumë kur pjesa greqishtfolëse ka qenë relativisht e madhe në numër, si në rastin e fshatrave të *Dropullit* e të *Vurgut*. Për këtë dukuri

²¹⁴ *Vep. e për. .f. 38vv.*

²¹⁵ Shih Memushaj, *Histori e Kurveleshit*, I. Tiranë 2004, f. 36.

mjafton të përmendim rastin e katundit më të madh të *Vurgut, Finiqin*, i cili në kohën e regjistrimeve të para osmane paraqitet me një popullsi që, siç u vu në dukje pak më sipër, mbartte emra tipikë shqiptarë, kurse sot paraqitet si greqishtfolëse. Ky fshat ka ruajtur emrin e qytetit të lashtë epirot të *Finikut (Phoenice)*, të themeluar jo më vonë se shekulli IV para erës sonë. Ndër gërmadhat e atij qyteti të lashtë janë zbuluar një teatër, akropoli etj., por nuk janë gjetur gjurmë varresh greke “brenda qytetit”.²¹⁶

13. Por a ka qenë i vjetër elementi shqiptar i dikurshëm në fshatrat e *Dropullit* dhe të *Vurgut*, apo shqiptarët a arbëreshët, siç quheshin më parë, atje kanë qenë të ardhur nga vise më veriore, sidomos gjatë shekullit XIV në kohën e Stefan Dushanit, për të cilin ndonjë studiues mendon se për zgjerimin e mbretërisë së tij e ka inkurajuar elementin shqiptar të zbrësë edhe në viset e të ashtuquajturit *Epir*, ku përfshihet edhe *Lugina e Dropullit* dhe *Vurgu*? Kështu, D. Nicol-i²¹⁷ pohon se Stefan Dushani “... inkurajoi shqiptarët që ta kryenin këtë punë për të duke u futur në Epir dhe Thesali”. Nuk del e qartë se për ç’dyndje shqiptarësh (a më saktë, arbëreshësh) në shekullin XIV është fjala në këtë rast. Por, siç u vu në dukje edhe në temën për Epirin (Kreu II, §§ 19-20), në përgjithësi dihet se në shekullin XIV, si edhe më herët e më vonë kanë ndodhur shtegtime shqiptarësh në viset greke, sidomos në Thesali, Atikë, Beoti e Peloponez, si edhe në disa ishuj grekë të Egjeut. E një pjesë e atyre shtegtarëve shqipfolës kanë qenë pikërisht nga viset shqipfolëse të *Epirit* dhe të *Shqipërisë Jugore* në përgjithësi, ku në vitet 20-30 të atij shekulli kishin shpërthyer kryengritje kundër pushtetit bizantin, që u shoqëruan me masa të rënda ndëshkimore (shih Xhufi: 2006, 358 v.). Prandaj rrethanat historike në atë rast do të kenë nxitur largimin e popullsisë shqipfolëse nga zona e *Dropullit* dhe e *Delvinës*.

14. Por edhe pas gjithë këtyre që u thanë këtu më sipër, pyetja se sa i vjetër

²¹⁶ Shih më hollësisht për këtë qytet të lashtë të Epirit veprën e përmendur të Hammond-it, *Epirus*, f. 112-117.

²¹⁷ Nicol, D., *The “Despotate of Epirus”*. Në: *Epirus: 4000 years of Greek history and civilization*. Athens 1997, f. 211v.

ka qenë elementi shqipfolës i dikurshëm në luginën e *Dropullit* dhe në *Vurgun* e Delvinës, mbetet për t' u sqaruar. Kjo pyetje, natyrisht, është e lidhur ngushtë me çështjen e origjinës së popullsisë së të ashtuquajturit *Epir*, ku gjenden këto dy treva, të cilat, siç u vu në dukje më sipër, mbajnë emrat *Dropull* dhe *Vurg*, që për nga burimi nuk lidhen me shqipen. Për më tepër, *Adrianopoli*, nga i cili u përftua emri i *Dropullit*, është konsideruar si një koloni romake. Duke qenë se këto dy çështje për rëndësinë që kanë, në këtë libër janë bërë objekt i një teme të veçantë për Epirin (Kreu II), këtu do të kufizohemi vetëm me vërejtjen e përgjithshme se rrethanat historike-shoqërore të mesjetës në viset në shqyrtim nuk mund të ndihmonin për çhelenizimin e popullsisë së tyre. Në këtë rast, po të kihet parasysh edhe fakti i përmendur pak më sipër, që në defterët osmanë të regjistrimit të popullsisë së kësaj zone shënohen shumë emra kryefamiljarësh jogrekë, atëherë duhet pranuar që edhe në fshatrat greqishtfolës të *Dropullit*, ashtu si edhe në ata të *Vurgut* të Delvinës, greqishtja është përhapur relativisht vonë e kjo dukuri mbetet për t' u shpjeguar. Në përgjithësi, mendohet se në krye të herës, aty nga fundi i shekullit XVIII dhe fillimi i shekullit XIX, banorët e kombësisë greke janë sjellë atje si bujq nga feudalët shqiptarë dhe me kalimin e kohës numri i tyre ka ardhur duke u shtuar. Por Xhufi (2006, f.332), duke u mbështetur në disa të dhëna nga “Kronika e Dropullit”, që u përmend pak më sipër (§ 2), bën fjalë “për një kolonizim edhe më të hershëm grek në Epir, përkatësisht në luginën e Dropullit...” dhe pikërisht për “shpërnguljen e një popullsie greke nga viset e Athinës në një kohë të papërcaktuar.” Lidhur me këtë çështje do pasur parasysh se, pavarësisht nga pasaktësia e të dhënave të “Kronikës së Dropullit”, që u shqyrtua në § 2 me vërejtjet përkatëse, emigrime dhe imigrime njerëzish sidomos në zonat kufitare ka pasur kurdoherë. Do pasur parasysh gjithashtu se, siç u vu në dukje edhe më sipër, në fshatrat e *Dropullit*, ashtu si edhe në ata të *Vurgut*, herë pas here, për arsye të ndryshme, kanë shkuar e janë vendosur edhe banorë shqiptarë nga vise të tjera, që me kohë janë asimiluar nga popullsia greqishtfolëse. Gjithsesi, edhe në rastin e fshatrave greqishtfolëse të *Dropullit*, sikurse në ato të *Vurgut* të Delvinës, gjatë shekujve të fundit ka qenë gjuha greke ajo që është përhapur duke mënjanuar gjuhën shqipe ndër banorët e ardhur nga vise jogreqishtfolëse. E një

dukuri e tillë, që mbetet për t' u hulumtuar më tej, nuk është e papritur, po të kihet parasysh se një proces i tillë është vërtetuar gjatë shekujve të fundit në pjesën më të madhe të viseve jugore të të ashtuquajturit *Epir* (shih Kreun II, §§ 25-36).

Kreu i tetë

Mesapët dhe gjuha e tyre

1. Mesapët dhe gjuha e tyre kanë tërhequr vëmendjen e një vargu studiuesish, sidomos gjatë shekullit XX. Zbulimi i një numri gjithnjë e më të madh mbishkrimesh, sidomos nëpër varre të vjetër të para erës së re, ka bërë të mundur që të kemi njohuri më të shumta dhe disi më të qarta rreth *mesapëve* dhe gjuhës së tyre në përgjithësi. Mbishkrimet e zbuluara, që janë bërë objekt hulumtimesh dhe studimesh, janë botuar dhe vazhdojnë të botohen sidomos nga studiues italianë. Ndër botimet më të plota deri sot me mbishkrime mesape duhen përmendur: Haas: 1962, Parlangèli: 1960, De Simone: 1964, Santoro: 1982, 1983, 1984 etj.

2. Por me gjithë ndihmesat e derisotme nga studiues të ndryshëm, mbeten ende të pasqaruara si duhet çështjet, që kanë të bëjnë me prejardhjen e *mesapëve* dhe me gjuhën e tyre. Sipas shumicës së studiuesve, që janë marrë me këto çështje, *mesapët* kanë qenë prej origjine ilire, të mërguar në skajin juglindor të Italisë për afërsisht aty nga fillimi i mijëvjeçarit të fundit para erës sonë. Por disa studiues të tjerë e kanë kundërshtuar, ose e kanë vënë në dyshim këtë mendim. Mjafton të kujtojmë këtu se në Konferencën e Tridhjetë mbi mesapët, të organizuar në Taranto-Lecce më 1990, profesorët Lombardo e Guzzo e kanë quajtur të arsyeshme të riprodhojnë në referatin e tyre një version të Herodotit (VII 169-171), sipas të cilit *mesapët* mendohet të kenë qenë me origjinë nga Kreta. Në faqen 35 të vëllimit mbi Konferencën për mesapët këta dy studiues italianë pohojnë, ndër të tjera: "Herodoti - mbi bazën e traditave me bazë pjesërisht kreteze - tregon se pas vdekjes së Minosit në Sicili, kretezet, të nxitur nga një perëndi, kishin përgatitur një ekspeditë në masë - pa ndihmën e grekëve - për të shpërguar vrasjen e mbretit të tyre. Por, pas një rrethimi pesëvjeçar të dështuar të kështjellës së Kamikosë, gjatë rrugës së kthimit në atdhe ishin ndeshur me një furtunë të tmerrshme, që i

kishte hedhur, pas mbyajtjes së anijeve, në brigjet e Japigisë²¹⁸; duke qenë të detyruar, për shkak të humbjes së anijeve, të qëndronin në atë vend, themeluan aty qytetin *Hyrie*, duke u shndërruar kështu nga kretezë në *mesapë japigë* dhe nga banorë ishulli në ‘kontinentale’. Pastaj, duke lëvizur nga *Hyrie*, kishin themeluar shumë qytete të tjera, për shkatërrimin e të cilave shumë kohë më vonë - shton historiani në një *parantezë* të mirëfilltë - tarantinasit, bashkë me aleatët e tyre ngurrues të Rexhios, paskëshin pësuar një shpartallim shumë të madh, që ishte bërë “kërdia më e madhe e grekëve, që njihet”.

Siç shihet, ky “tregim” i historianit të madh grek të shekullit V para erës sonë nuk ka ndonjë mbështetje historike, prandaj edhe nuk është pranuar nga shumica e studiuesve të interesuar. Megjithatë, kjo nuk përbën një argument në të mirë të tezës mbi origjinën ilire të *mesapëve*. Prandaj disa studiues kanë shprehur dyshime ose rezerva edhe mbi këtë tezë. Kështu p.sh. Parlange (1962, 13), megjithëse pranon që “rëndësia e mesapishtes është rritur nga fakti se ajo, sipas mendimit të përbashkët të dijetarëve, është e lidhur ngushtë me një nga gjuhët kryesore të Gadishullit Ballkanik, me ilirishten, në faqen 15 shprehet me maturi mbi lidhjet midis mesapishtes dhe ilirishtes dhe midis mesapishtes dhe shqipes. Ja si shprehet ai: “... e kuptojmë se në gjendjen e sotme të çështjes, megjithëse nuk mund të anashkalohen një sërë e rëndësishme përkimesh iliro-mesape dhe një tjetër sërë, jo më pak interesante, përkimesh mesapo-shqiptare, prapë nuk duhet menduar se mund të gjendet një shpjegim ‘shqiptar’ për çdo dyshimin tonë ‘mesapik’ dhe as për të rindërtuar një pararendës ‘mesapik’ për çdo element gjuhësor ‘shqip’.”

3. Edhe De Simone është treguar i matur. Sipas këtij gjuhëtari (1990, f.299), “Nga sa u tha, nënkuptohet një pasojë e mëtejshme: Një ndër pikat ende të diskutueshme më 1971 ishte inkuadrimi ‘ilirik’ i gjuhës mesape. Do të thosha se sot, me gjithë rishfaqjen e ndonjë orvatjeje, asnjë njeri i matur nuk beson se është i

²¹⁸ Është fjala për vendbanimin e japigëve, një fis me prejardhje ballkanike i vendosur në skajin juglindor të Gadishullit Apenin aty nga fillimi i mijëvjeçarit të fundit para erës së re. Këta ishin fqinj me fisin e mesapëve dhe me ata të peucetëve (peuketoi) e të daunëve, gjithashtu me prejardhje ballkanike. Mesapët në disa burime paraqiten si një pjesë e japigëve, me të cilët duhet të kenë pasur një gjuhë të përbashkët.

mundur një trajtim hermeneutik ose krahasues i teksteve mesape mbi bazë 'ilirike'. Me këtë nuk mendoj të përjashtoj krejt një lidhje të mundshme gjenealogjike të mesapishtes me gjuhët ose me dialektet ballkanike në kuptimin gjeografik (po të duan, 'ilirike'). Ky pozicion 'gjenealogjik' sot nuk është as aktual e aq më pak i operueshëm."

Por, sikurse u përmend pak më sipër, disa studiues janë shprehur pa rezerva mbi lidhjet midis mesapishtes dhe ilirishtes. Kështu p.sh. për Hamp-in (1957, f.74) "Nuk mund të ketë asnjë dyshim që mesapishtja dhe ilirishtja janë gjuhë motra, megjithëse të ndara ndoshta nga një gjysmë mijëvjeçari ndryshimi, dhe që në vija të përgjithshme çfarë themi për mesapishten ndoshta vlen barabar edhe për ilirishten. Për ta bërë më të qartë pohimin tonë, duhet të kuptojmë me 'ilirishte' vetëm gjuhën që flitej në Adriatikun Lindor dhe në Dardani ndoshta aq larg në veri sa të shumtën deri në Danub, dhe jo në kuptimin e gjerë të adoptuar nga dijetarë të tillë si Pokorny dhe të kritikuar me të drejtë nga Whatmough-i" ('Word' 6. 242-1950).

Edhe Pellegrini, i cili në veprën e tij *Avviamento alla linguistica albanese* (1995) i ka kushtuar me të drejtë një vend relativisht të gjerë mesapishtes, ka vënë në dukje në f. 48 lidhjen e asaj gjuhe "me gjuhët ballkanike dhe veçanërisht me ilirishten".

4. Për origjinën ilire të mesapëve janë shprehur edhe dijetarë të tjerë, nga të cilët po përmendim vetëm dy, Sufflay-n dhe Hammond-in. Kështu, Sufflay (1916, 14v.) vë në dukje bashkëpërkimin gjuhësor midis shqipes dhe italishtes jugore të Abraceve dhe të Puljes, që ka elemente të substratit të *mesapëve* e të *japigëve*, fise ilire të shpërngulur nga bregdeti ballkanik rreth shekullit IX para erës sonë. Dhe në bazë të arritjeve të gjuhëtarëve të ndryshëm, që ishin marrë me këtë çështje, Sufflay-i përmend disa përkime gjuhësore ndër të dy brigjet e Adriatikut. Ndër këto ai përmend emrat me prapashtesat *-entum*, *-ontum*, *-untum*, *-etum* "dhe sidomos emrat e qyteteve me *-ste* dhe *-este*". Por do pasur parasysh se në kohën e Sufflay-it hulumtimet dhe studimet për mesapishten nuk kishin marrë ato përmasa, që morën në gjysmën e dytë të shekullit XX dhe që kanë nxjerrë në dritë edhe përkime në sistemin fonologjik e gramatikor. Mjafton të përmendim këtu faktin që në mesapishte,

ashtu si në shqipe, mbaresa indoeuropiane e rasës kallëzore njëjës të emrave mashkullorë e femërorë del e evoluar nga */-m/ në /-n/, ashtu si në greqishte, në hetitishte, në armenishten parahistorike dhe në gjuhët balltike (shih këtu më poshtë § 9).

Për origjinën ilire të *mesapëve* është shprehur edhe Hammond-i (1967, f.405), i cili pohon, ndër të tjera: “..... ilirët zinin të paktën disa nga viset në veri të Shqipërisë gjatë bregdetit dalmat; dhe ndoshta prej atyre viseve ilirët kaluan detin Adriatik dhe praktikuan zakone varrimi të ngjashme në Peucetia dhe Picetum qysh nga viti 1000 deri në vitin 900 e këtej.”

5. Mbështetësit e origjinës ilire të *mesapëve* kanë pohuar gjithashtu se ka edhe disa bashkëpërkime thelbësore midis mesapishtes dhe shqipes, sidomos në fjalor. Këtu nuk është rasti të riprodhohet gjithçka është thënë në këtë drejtim. Por unë mendoj se në këtë rast, natyrisht pa nënvleftësuar bashkëpërkimet në fjalor, është më me rëndësi të hetohet nëse midis këtyre dy gjuhëve ka bashkëpërkime të karakterit fonetik dhe gramatikor. Prandaj në këtë studim të shkurtër do të ndalem në disa dukuri fonetike, ku - sipas mendimit tim - mesapishtja dhe shqipja përkojnë.

6. Por para së gjithash dëshiroj të shprehem mbi çështjen e diskutueshme lidhur me tipin *satem* apo *kentum* të këtyre dy gjuhëve, sepse një çështje e tillë ka rëndësi parësore. Për sa i takon shqipes, tashmë të gjithë janë të mendimit se ajo është një gjuhë e tipit *satem*, duke qenë se grykoret qiellzore indoeuropiane i ka shndërruar prej kohësh të hershme në bashkëtingëllore spirante (p.sh. të krahasohen: *dhamb/dhëmb* < **ǵ^hombo*- etj.).²¹⁹ Por për mesapishten dhe ilirishten në përgjithësi një pjesë e mirë dijetarësh kanë shprehur mendimin se i përkisnin grupit të gjuhëve indoeuropiane të tipit *kentum*, ashtu si latinishtja, gjuhët gjermanike etj. Mirëpo, siç kanë vërtetuar Hamp-i (1957, 87v.) dhe Demiraj (1988, 44v.), një mendim i tillë është mbështetur në disa shembuj të mesapishtes dhe të ilirishtes, ku grykoret qiellzore indoeuropiane */^h/ dhe */*ǵ*/ ndiqeshin nga /-l/ ose /-r/; e në një pozicion të tillë fonetik grykoret qiellzore indoeuropiane janë çqiellzorëzuar në disa gjuhë indoeuropiane, ku përfshihen edhe mesapishtja, ilirishtja, shqipja, gjuhët baltike e

²¹⁹ Për më shumë shembuj shih Demiraj: 1996, f. 186.

pjesërisht edhe gjuhët sllave. Prandaj mendimi mbi karakterin *kentum* të ilirishtes dhe të mesapishtes nuk duhet të jetë i saktë.

7. Për sa u takon dukurive të përbashkëta fonetike midis mesapishtes dhe shqipes, këtu unë do të ndalem në këto çështje: 1) Evolucioni i **/o/-së* së shkurtër indoeuropiane në */a/*. 2) Çaspirimi i bashkëtingëlloreve mbylltore të aspiruara indoeuropiane. 3) Evolucioni */-m/>/-n/* në pozicion fundor. 4) Theksimi nistor në disa toponime shumërokëshe të lashta.

Për sa i takon evolucionit **/o/>/a/*, që është pranuar edhe për ilirishten në përgjithësi (shih Krahe: 1941, f.134, 142, Mayer: 1959, 152, 154v.), për mesapishten kjo dukuri është pohuar, ndër të tjerë, nga Parlàngeli (1960, f.13), Haas-i (1962, f.168), Pellegrini (1995, 49v.). Në mbështetje të një pohimi të tillë mjafton të përmendet forma e njëjësit asnjanes të përemrit dëftor *ta* (krahaso *ta noman*, *ta dentan* etj.) dhe të krahasohet ajo me shqipen *ta* në *a-ta* (djathë) dhe me greqishten *tò* (p.sh. *to* sykon “fik-u”, *to* alfa, *to* delta etj.) si, dhe me formën e rindërtuar indoeuropiane **tod*.

Është e vërtetë se një dukuri e tillë është shfaqur edhe në disa gjuhë të tjera indoeuropiane, si në gjuhët gjermanike etj. Por në gjuhët e tjera të lashta të Gadishullit Apenin, duke përfshirë latinishten, **/o/-ja* e shkurtër indoeuropiane është ruajtur e pandryshuar (shih Sommer: 1914, f.143 v., Vineis: 1994, f.300, Silvestri: 1994, f.356). Edhe në gjuhët e tjera të Gadishullit Ballkanik, duke përfshirë trakishten²²⁰, duket se nuk është shfaqur evolucionin **/o/>/a/*.

8. Çaspirimi i bashkëtingëlloreve mbylltore të aspiruara indoeuropiane është një tjetër dukuri e përbashkët e mesapishtes dhe e shqipes. Për këtë dukuri në mesapishte shih, ndër të tjerë, Parlàngeli: 1960, f.13, Haas: 1962, f.180 v., De

²²⁰ Për sa i takon trakishtes, mendimet e dijetarëve në këtë rast nuk përputhen, duke qenë se disa prej tyre mendojnë se edhe në trakishte është shfaqur, qoftë edhe pjesërisht, evolucionin **/o/>/a/*, por disa dijetarë të tjerë e kundërshtojnë këtë mendim (shih Demiraj: 1999, f. 209). Gjithsesi, në këtë rast do mbajtur parasysh vërejtja e Katiçiqit (1976, f. 145): “Problemi qendror [i vokalizmit trak - Sh. D.] është ai i */o/-së* indoeuropiane. Nuk mund të vendoset me siguri nëse ajo u shkri *me/a/-në/*, apo u ruajt e dalluar prej saj”.

Simone: 1964, f.40, 43, kurse për shqipen shih Demiraj: 1996, f. 180 v., 220 - me literaturën përkatëse. Në këtë pikë këto dy gjuhë dallohen qartë nga greqishtja (e vjetër). Për shfaqjen e kësaj dukurie në mesapishte mjafton të përmenden emrat *bili/bilio* dhe *bilia*, që janë vënë në lidhje me emrat gjegjës të shqipes *bir* dhe *bijë* [dikur *bilë*] (shih Çabej: 1976, f.230v.,f. 239v.; Pellegrini: 1995, f.56). Gjithashtu të kihet parasysh edhe emri i perëndeshës *Aprodita* (të krahasohet me trajtën greke *Ap^hrodite*). Për çaspirimin e bashkëtingëlloreve mbylltore të aspiruara në parashqipen qysh nga kohët e lashta mjafton të kihet parasysh se një dukuri e tillë ka përfshirë edhe huazimet nga greqishtja e vjetër, si p.sh. huazimet *mokën(ë)/mokër(ë)* < *māk^hanā*, *lakën(ë)/lakër(ë)* < *lak^hanon* dhe *shkarpë* < *skarip^hos* (shih Thumb: 1910).

9. Evolucionin */-m/ > /-n/ në pozicion fundor është i dëshmuar mirë si në mesapishte ashtu edhe në shqipe të forma e mbaresës së rasës kallëzore njëjës (mashkullore e femërore). Për mesapishten të kihet parasysh, ndër të tjera: *Ana-n* *Aprodita-n*, *veinan-n* *ara-n*, *enna-n*, *ola-n*, *agroria-n* (shih, ndër të tjerë, Parlangeli: 1960, f.64, 344, 368, 377 etj.). Kjo mbaresë në mesapishte del edhe në rasën kallëzore njëjës të përemrit dëftor *ta-n* (shih, ndër të tjerë, Hamp: 1957, f.82, Parlangeli: 1960, f.363, Haas: 1962, f.219 etj.).

Për shqipen forma e mbaresës /-n/ të rasës kallëzore njëjës (mashkullore e femërore) del qartë të forma e kallëzores njëjës të përemrave vetorë *mua/mue* < **mon*, dëftor të (*a-të*) < *tâ* < **ta-n*, pronor *tan-d/tën-d*, pyetës *kâ/kë* < *ka-n* (të kihet parasysh edhe kallëzorja e përemrit të pacaktuar *as-kan-d/as-kën-d*) etj.

Një dukuri e tillë është shfaqur edhe në greqishte, në hetitishte, në armenishten parahistorike e pjesërisht edhe në gjuhët baltike (shih Meillet: 1936, f.56). Pra, në këtë rast kemi të bëjmë me një bashkëpërkim të parashqipes e të mesapishtes me këto gjuhë. Por arsyeja e një evolucioni të tillë mbetet e pasqaruar, po të kihet parasysh se në disa gjuhë të tjera indoeuropiane (si p.sh. në latinishte etj.) një evolucion i tillë nuk ka ndodhur.

10. Disa studiuues (Hamp: 1957, f.83, Mayer: 1959, f.161, Çabej: 1972,

16, Demiraj: 1999, 207v. etj.) kanë vënë në dukje edhe një tjetër bashkëpërkim midis mesapishtes, ilirishtes dhe shqipes. Është fjala për theksimin nistor të disa toponimeve në të dyja brigjet e Adriatikut, të banuara në lashtësi nga *mesapët* dhe nga *ilirët e jugut*, dhe pikërisht të toponimeve *Brúndisium* (sot *Bríndisi*), i quajtur dikur “skela e mesapëve” nga Pseudo-Skimni (shih Lombroso-Guzzo: 1990, f.49), *Tárentum* (sot *Táranto*), *Ódryntum/Hýdruntum* (sot *Ótranto*), nga njëra anë, dhe *Dýrrhachion/Dýrrhachium* (sot *Dúrrës*), *:sannus* (sot *:shëm*), *Drívastum* (sot *Drisht*), *Pólatum* (sot *Pult*), nga ana tjetër. Theksimi nistor i këtyre toponimeve të lashta në të dyja brigjet e Adriatikut vështirë se mund të ketë qenë një rastësi.

11. Edhe nga sa u parashtrua shkurt në këtë kapitull, mund të nxirren këto përfundime: 1. Gjuha e *mesapëve* ka qenë e ndryshme nga greqishtja; prandaj tregimi i Herodotit (shih § 2) është i pasaktë gjuhësisht (si edhe historikisht). 2. Me gjithë ndryshimet e mëdha të shkaktuara nga evolucioni i pavarur i mesapishtes dhe i shqipes në rrjedhë të shekujve në dy zona të ndryshme dhe pa kontakte midis tyre, në këto dy gjuhë mund të vërehen disa bashkëpërkime të rëndësishme, të cilat dëshmojnë se *mesapët* e lashtë dhe stërgjyshërit e shqiptarëve duhet të kenë pasur një origjinë të përbashkët etniko-gjuhësore. Megjithatë, ky problem mbetet i hapur dhe zgjidhja e tij përfundimtare do të varet nga hulumtimet shkencore të mëtejshme. Mbeten gjithashtu për të ndriçuar arsyet e emigrimit të stërgjyshërve të *mesapëve* nga brigjet lindore në brigjet perëndimore të Adriatikut, ku shtegtuan ndoshta qysh nga fillimi i mijëvjeçarit të fundit para erës së re.

First chapter

The Pelasgians and Etruscans

During the last centuries numerous contributions have appeared regarding the presence of pre-Greek and even pre-Indoeuropean peoples in various parts of the ancient Balkans, including Epirus, where the pre-Greek sanctuary of Dodona with its famous oracle was founded. It has generally been admitted that that sanctuary was founded by the Pelasgians. Pouqueville (1826, 189) affirms that the oracle of Dodona was founded by the Pelasgians and that opinion was shared by other scholars as well. Suffice it to recollect here Hammond (1967, 367): “There is little doubt that the first settlers of Dodona came from the south in the Early Bronze Age and were identified in the Greek tradition with the Pelasgians, who were reputed to have founded the oracle. It was evidently in existence when the first Greek-speaking peoples arrived and adopted the sacred place on their own account. The results of excavation are compatible with the tradition.” He further adds (p. 435): “We have already seen that in the period c. 1120 to 800 B. C. Dodona was in touch with the the northern areas only and that she belonged then to the Balkan *milieu*. Close relations with the north continued from 800 to 500 B. C....”

As far as the Balkan Peninsula is concerned, this area, thanks to its geographical position linking Europe with Asia, could not have been a *terra deserta* before the immigrations of the I. E. tribes. The archaeological excavations have already indicated that the Balkan Peninsula was inhabited since a remote Antiquity. Some linguistic data have also indicated that the first Greek tribes, settled in the southern part of this peninsula at the beginning of the second millennium, came into contact with a previous population, which is reputed to have been composed partly of I. E. tribes and partly of non-I. E. ones. The same situation should also be assumed for the other parts of the Balkans. It is, however, of great interest to inquire into the factors that should have contributed to such an ethnic transformation of the Balkan Peninsula, as well as to make clear whether the idiom(s) or dialects of the Pre-I. E.

people(s) has/have exerted any impact upon the languages of the I. E. tribes, that settled in this region.

At the present stage of investigations it is rather difficult to make clear what kind of peoples or tribes did inhabit the Balkan areas prior to the immigrations of the I. E. tribes. However, taking into account the geographical position of these areas near the Mediterranean Sea, one may affirm that those peoples or tribes should have been influenced by the ancient civilisation of the Near East countries. Nor should one exclude the impact of the Pre-Greek population of the Aegean coasts. The ancient presence of such a population has been ascertained not only by the archaeological data, but also by a considerable number of ancient place-names of non-Greek origin, or built up with non-Greek suffixes. Such are the place-names built up with the suffixes *-nth-*, *-s(s)/-tt*, *-n-*, *-m-*, *-mn-*, *-l-*, *-r-*, *-th-*, as *Zákynthos*, *Kórinthos*, *Labýrinthos*, etc., *Knossós*, *Lárisa*, *Parnassós*, *Athēnē* etc. (see Katičić: 1976, 42 sq.). This scholar (*ibidem*, 53) points out: “The suffixal elements, characteristic for the Pre-Greek toponyms and corresponding with Anatolian derivational types, occur also in many Greek words that cannot be explained by a Greek etymology and usually denote plants, animals, and material objects that belong to the Aegean flora, fauna and material culture.” And here Katičić mentions, *inter alia*: *mínthē* ‘mint’, *thálassa* ‘sea’, *kérasos* ‘cherry tree’, *kypárisso* ‘cypress’, *dáphnē* ‘laurel’, *t^hálamos* ‘room’, *kit^hára* ‘guitar’, *lápat^hon* ‘*Rumex acetosa*’ etc.

He further adds (p. 55): “Among the Pre-Greek geographic names there are not only oronyms and hydronyms, but also a quite considerable number of names of cities and towns. From this fact can be concluded that the speakers of Greek found at their arrival the Aegean urbanization already in full development. This observation fits well with the inference from archaeological evidence according to which the first peak of urban life in the Aegean world was reached already in the Early Bronze Age, whereas Greek-speaking tribes invaded the area only at the beginning of the Middle Bronze Age.”

But, although it has generally been acknowledged that the first Greek tribes

found a previous population at the Aegean coasts, various scholars have expressed different opinions regarding the ethnic origin of that population. Some of them, like Kretschmer, Budimir, Georgiev, van Windekens etc., thought that it belonged to the family of I. E. tribes; some others, however, have expressed the opinion that the Pre-Greek population of that area pertained to an autochthonic Mediterranean, that is non-I. E., family. Moreover, some scholars have denominated that Pre-Greek population as *Protindogermanisch* (Kretschmer), *Pelasgian* (Georgiev), *Pelastian* (M. Budimir) and so on (for more details see Katičić: 1976, 57 sq.).

Thus, it is evident that the areas, where the first Greek tribes settled at the beginning of the second millennium B. C., were earlier inhabited. It is quite probable that prior to the Greeks there might have immigrated other I. E. tribes across the Danube or from Asia Minor, where peoples of I. E. origin are evidenced, like the Hittites, Luvians etc. (see Cowgill: 1986, 17 sq.). However, it should be admitted that prior to the immigration of the I. E. tribes the Aegean areas should have been inhabited by a more ancient non-I. E. population. What kind of people(s) they might have been and what kind of language(s) they might have spoken, it is quite impossible to precise at the present stage of investigations, although even in this case various assumptions have been put forward. But we are not dwelling upon them, as they are not within the scope of the present paper. However, the problem of the Pelasgians will be briefly dealt with, as, according to some scholars, they should be regarded as the forefathers of the Albanian people.

The ethnonym *Pelasgian* is at first evidenced in Homer's Iliad, where they are described as inhabitants of Larissa and as "divine Pelasgians". Herodotus (5th century B. C.) goes on to say that they lived, *inter alia*, in Attica, and that they sacrificed everything to the Gods. Furthermore, speaking of the Hellenes, he says that these "after having separated themselves from the Pelasgians, at first were weak". He adds that later on the Athenians expelled the Pelasgians from Attica and then the latter settled in the island of Lemnos. Thucydides, too, mentions the *Pelasgians*, who, according to him, were among the first to call the ancient Greeks by the name *Hellenes*. The Pelasgians have also been mentioned by Aristotle (IV century) in the

Electride islands, by Skymnus (III-II centuries), who says that they founded the temple of Dodona, by Diodorus (I century B. C.), who says that the Pelasgians were the first inhabitants of the Lesbos island, and so on. However, more details about the Pelasgians one can find by the great Greek geographer Strabo, who says:

“For the Pelasgians almost all are of the opinion that they were an ancient tribe scattered all over Greece and particularly in the region of the Aeolians near Thessaly. According to Effor, however, they were of Arcadian origin and devoted themselves to the warfare, and by increasing in number through those who allied to them and to whom they gave their name, they became famous even among the Hellenes, as well as everywhere they settled. In fact we see Pelasgians settled in Crete, as Homer testifies, by putting into Odysseus mouth the following words said to Penelope: ‘In this island inhabited by the Achaeans, the bold Eteocreates, Kydons, Dorians and the divine Pelasgians, each one has its own language. “Then Strabo goes on to say that formerly the Pelasgians had been masters of Thessaly and that “many ancient authors have called Pelasgians even the Epirotic tribes, because they were scattered as far as Epirus. And as these ancient authors have denoted as Pelasgians a great number of heroes, the subsequent authors have called Pelasgians even the tribes guided by these heroes.’ Further Strabo gives some data about the territorial extension of the Pelasgians.

We are not dwelling any longer upon the data given by the ancient authors about the Pelasgians, but we should point out that such data are often covered by a certain cloud of mythology. It suffices to recollect that according to the Roman historian of the Augustus’ time, Justin, even the people of ancient Macedonia were called Pelasgians. It should also be recorded that the Lemnos island, where a non-Greek inscription has been discovered, was inhabited by Pelasgians in ancient times.

It is very difficult to give more detailed data about the Pelasgian population and their language, as we have no direct testimonies written in their own idiom. Among the various scholars who tried to explain the Pelasgian language through some loanwords of Greek that were not compatible with the Greek linguistic system, one should recall VI. Georgiev, van Windekens etc. The latter in his book *Le*

Pélasgique has tried to sum up the main traits of that idiom, among which one should mention: 1. The Pelasgian, like the other I. E. languages, was endowed with short and long vowels, which had generally remained unaltered with the exception of short /o/ that was changed to /a/. 2. It had desaspirated the aspirated voiced occlusives. 3. It was a satem language. 4. Its lexique is exactly unknown, as the only source remain so far a number of loanwords that Greek is assumed to have borrowed from it. From such loanwords one may mention: βασιλευς 'king', δαιμων 'god, divine power etc., θωραξ 'thorax', λαβυρινθος "labyrinth" etc. (see van Windekens 1952, 76, 85, 93, 118sq. - with the apposite literature).

These conclusions, however, should be viewed with a certain reservation, as they are based upon materials written by Greek authors, who should have adapted them to the Greek phonological particularities. A great help would be afforded in this case by the Lemnos inscription of the sixth century B. C. discovered in 1885. The efforts made so far to decipher that inscription have brought about some conclusions concerning the language, in which it was written. It contained four vowels and was characterized by some particularities, which are partially to be found in the evidenced Etruscan language, and thus make it different from Greek (see the Albanian version).

It is also interesting to know with a certain surety the origin and the territorial extension of the Pelasgians. If they have been Indoeuropeans, their origin should be sought in the areas from where the other I. E. tribes have emigrated. Here one should take into account that in such a case they had preceded the Greeks in their historical areas. It is also of great interest to know whether they were scattered in other countries as well and whether they were preceded there by other pre-I. E. peoples. Concerning the last question, one cannot imagine the Balkan peninsula, because of its geographical position, to have been a *terra deserta* before the immigration of the Pelasgians. Some scholars assume that the Pelasgians were scattered out of the Balkan Peninsula as well, as for ex. in Italy. But according to van Windekens and to other scholars their presence is particularly attested in Greece. At any rate, one should not exclude their presence in other Balkan countries as Epirus

and Illyria, *id est* in areas where Albanians are attested in historical times. Moreover, in these areas even traces of pre-I. E. settlements have already been discovered.

Therefore the earlier presence of a Pre-I. E. population should also be acknowledged for the other parts of the Balkan Peninsula, which according to archaeological discoveries should have been inhabited, at least, since the early Neolithic period (about 6. 000 years B. C.). However, in this case, too, it is impossible to give an argued answer to the question concerning the ethnic origin of those inhabitants. It is also rather impossible to conceive of a homogenous Pelasgian population stretching out all over the regions of the Balkan Peninsula. On the contrary, one should think that even if that population should have been, originally, homogenous, it could not have remained unaltered with the passing of time. Therefore we are going to limit the discussion of this issue to the western areas of the Balkan Peninsula, where the Albanian people have been living since many centuries ago. These areas, too, thanks to their geographical position, should have been inhabited since long before the immigration of the I. E. tribes, who are usually called *Illyrians*.

The ancient presence of Pre-I. E. people(s) in this area has been proved, *inter alia*, by the archaeological discoveries at *Maliq, Vashtëmi, Burimas, Podgorie, Barç and Dërsnik* of Coritza district, as well as at *Kamnëk* of Cologna district, at *Blaz* and *Nezir* of Mati district, at *Kolsh* of Kukës district, at *Rashtan* of Librazhd etc

But at the present stage of investigations it is rather impossible to determine the ethnic-linguistic origin of the Pre-I. E. population(s) of the western areas of the Balkan Peninsula. In this case the difficulties are still more numerous than in the case of the Pre-I. E. population of the Aegean coasts, as we have but a very scanty material from the Illyrian language at our disposal.

